

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA  
DEPARTAMENTI I GJUHËS ITALIANE**

*Shqipja përballë latinishtes në tekstet e vjetra (Kuvendi i Arbënit)*



Punim për gradën Doktor  
në Gjuhësi

Paraqitur nga  
**Elda Resmja Molla**

Udhëheqës shkencor  
**Prof.Dr.Seit Mansaku**

Mars, 2012

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA  
DEPARTAMENTI I GJUHËS ITALIANE**

*Shqipja përballë latinishtes në tekstet e vjetra (Kuvendi i Arbënit)*

Punim për gradën Doktor

### ***Falenderime***

*Dëshiroj të falenderoj e t'i shpreh mirënjohjen time të thellë udhëheqësit shkencor, Prof.Dr. Seit Mansaku, për zgjedhjen e temës me interes për historinë e gjuhës shqipe, si dhe për vërejtjet dhe sugjerimet me vlerë gjatë realizimit të punimit.*

*Falenderime të singerta u shkojnë përgjegjësit të Departamentit të Gjuhës Italiane, Prof. Artur Sula, si dhe dekanes së Fakultetit të Gjuhëve të Huaja, Prof. Dr Klodeta Dibra, të cilët vazhdimisht përkrahin dhe synojnë motivimin e pedagogëve në kualifikimet pasuniversitare.*

*Nuk mund të lë pa falenderuar kolegët e mi të Departamentit të Gjuhës Italiane dhe ata të Departamentit të Gjuhës Shqipe për ndihmën dhe këshillat e dhëna, në rastet kur kam pasur nevojë.*

*Së fundmi, dëshiroj të shpreh një falenderim të veçantë për familjen time, ndihma e së cilës në momente të vështira, ka qenë gjithnjë e madhe dhe e pakursyer. Ajo ka ditur të më kuptojë dhe të më përkrahë gjatë gjithë kohës së realizimit me sukses të punimit.*

## Pasqyra e lëndës

Parathënie .....V

**Zhvillimi kulturor e letrar në Shqipërinë e shekullit XV – XVIII. (Vështrim i përgjithshëm)**.....1

1. Humanistët shqiptarë dhe roli i tyre në zhvillimin e gjuhës, kulturës dhe të letërsisë shqipe.....4
2. Kontaktet e para të shqipes së shkruar me latinishten.....7

## Kreu I

### **Kuvendi i Arbënit, ngjarje e rëndësishme për historinë dhe kulturën shqiptare.**

- I.1 Rrethanat historiko- kulturore në të cilat u mbajt Kuvendi i Arbënit..... 10
- I.2 Vendi i tekstit të Kuvendit të Arbënit në kuadër të teksteve të vjetra dhe rëndësia e vendimeve të marra në të .....13
- I.3 Botimi dhe ribotimet e tekstit të Kuvendit të Arbënit..... 16
- I.4 Studimet e deritanishme mbi tekstin e Kuvendit..... 22

## Kreu II

### **Grafia dhe vërejtje gjuhësore në rrafshin fonetik**

- II.1 Alfabeti dhe veçoritë grafike të tekstit..... 28
- II.1.2 Përshkrimi i shenjave grafike..... 31

II.2 Dukuritë më të rëndësishme fonetike në ciklin e shkrimeve të tjera.....	43
--	----

### Kreu III

#### Shqipja përballë latinishtes në rrafshin morfo-sintaksor

III.1 Sistemi emëror.....	53
III.1.1 Emri dhe kategoritë gramatikore të tij.....	53
III.1.2 Gjinia e emrit.....	54
III.1.3 Rasat e emrit.....	58
Rasa emërore.....	59
Rasa gjinore.....	60
Rasa dhanore.....	62
Rasa kallëzore.....	66
Rasa rrjedhore.....	71
III.1.3 Shquarsia e emrit në gjuhën shqipe dhe mungesa e saj në gjuhën latine.....	82
III.2 Përcaktorët e emrit. Vendi dhe përshtatja e tyre në fjali.....	83
Mbiemri dhe përshtatja e tij me emrin.....	84
Dukuria e biflektizmit.....	86
III.2.1 Përemri, llojet e përemrit.....	88
Përemrat vetorë.....	88
Përemrat e pacaktuar.....	89
Përemrat dëftorë.....	90
III.3 Sistemi foljor. Folja dhe kategoritë gramatikore të saj.....	91
III.3.1 Kategoria gramatikore e vetës dhe e numrit.....	92
III.3.2 Kategoria gramatikore e diatezës.....	93
III.3.3 Kategoria gramatikore e kohës.....	95
III.3.4 Kategoria gramatikore e mënyrës.....	98
III.3.4.1 Modus indicativus. Praesens.....	99
Futurum.....	100
Perfectum.....	105
III.3.4.2 Modus coniunctivus / Mënyra lidhore.....	108
Lidhorja nxitëse.....	110
Lidhorja dubitative.....	112
Lidhorja volitive.....	113
III.4 Foljet ndihmëse e gjysmëndihmëse në gjuhën latine e shqipe.....	116
III.5 Nomina verbalia / Format e pashtjelluara të foljes dhe funksionet sintaksore.....	121

III.5.1 Pjesorja. ( <i>Participium</i> ).....	122
Participium praesentis.....	126
Participium futuri.....	128
Participium perfecti.....	130
Funksionet sintaksore të pjesores.....	132
Participium coniunctum.....	134
Ablativi absolute ( <i>ablativus absolutus</i> ).....	135
III.5.2 Gerundi latin. ( <i>Gerundium</i> ).....	139
Gerundivi ( <i>Gerundivum</i> ).....	143
Zgjedhimi perifrastik vepror dhe pjesor. ( <i>coniugatio activa e passiva</i> )..	147
III.5.3 Paskajorja. ( <i>Infinitivus</i> ).....	148
Kallëzorja me paskajoren ( <i>accusativus cum infinito</i> ).....	152
III.6 Lidhëzat dhe funksionet e tyre në fjali. Lidhëzat bashkërenditëse e nënrenditëse.....	157
III.6.1 Fjalitë e nënrenditura.....	158

#### **Kreu IV**

##### **Parafjalët, përdorimi dhe roli i tyre në fjali.**

IV.1 Klasifikimi i parafjalëve.....	168
-------------------------------------	-----

#### **Kreu V**

##### **Veçoritë leksikore të gjuhës së Kuvendit të Arbënit.**

V.1 Gjuha e Kuvendit nga aspekti dialektor.....	182
V.2 Shtresat leksikore të gjuhës së Kuvendit të Arbënit.....	183

#### **Kreu VI**

##### **Vërejtje rreth përkthimit shqip të tekstit latin**

Vërejtje rreth përkthimit shqip të tekstit latin .....	186
Përfundime.....	196

Bibliografi ..... 204

## Parathënie

*Latinishtja, me sundimin politik e ushtarak të vendit e me rrjetën e rrugëve, hyri thellë në tokë, në kundërshtim me greqishten që zotëronte më fort në për bregdetet.*

*Në këtë pikëpamje fuqia ekspansive e latinishtes dhe pasojat historike të asaj kanë qenë shumë të mëdha. Me gjithë këtë proces historik romanizimi nuk depërtoi në të gjitha anët. Në disa vende elementi autokton ruajti individualitetin e gjuhën e tij. Provën për këtë e kemi te populli shqiptar. Ky dhe pse jetoi gjithë kohën brenda sferës romake i shpëtoi romanizimit.*

*Latinishtja ka lënë gjurmë të thella në gjuhën shqipe. Ky ndikim gjuhësor spjegohet më një anë me një sundim të gjatë, mbi pesëqind vjet, më tjetër anë me epërsinë kulturore të botës romake.*

*Përhapjes së latinishtes në Shqipëri, i dha shkas dhe krishtërimi, feja e re që zëvendësoi paganizmin kudo në pellg të Mesdheut.*

*Eqrem Çabej*

### **01. Përligjja e përzgjedhjes së temës.**

*Shkrimet e para shqipe dhe sidomos fillimet e letërsisë së shkruar i përkasin periudhës kur idetë e ndritura të Rilindjes Evropiane kishin kohë që kishin trokitur edhe në Shqipëri dhe janë pikërisht këto ide që përshkojnë këto shkrime.<sup>1</sup> Bëhet fjalë për tekstet e vjetra të gjuhës shqipe që fillojnë me*

---

<sup>1</sup> Të mos harrojmë pa përmendur veprat e humanistëve shqiptarë, M.Barleti, Dh.Frëngu, M.Beçikemi, të cilat përshkohen fund e krye nga idetë humaniste.

*“Mesharin” e Gjon Buzukut dhe “Katekizmin” e Lekë matrëngës në shekullin XVI.*

*Më pas, në shekullin XVIII botohen veprat e Pjetër Budit, të Frang Bardhit dhe Pjetër Bogdanit dhe për të vazhduar më tej me traditën e shkrimit të shqipes në shekullin XVIII, kemi tekstin e Kuvendit të Arbënit, rreth 20 vjet pas “Çetës së profetëve” të Bogdanit, “Dorëshkrimin e Grottaferratës”, “Vëzhgime gramatikore për gjuhën shqipe”, të Françesko da Leçes dhe “Përmbledhja e shkurtër e doktrinës së krishterë” e Gjon Kazazit.<sup>2</sup> Me këto vepra, të cilat ruajnë vlera të mëdha për kulturën shqiptare, në përgjithësi, e për historinë e gjuhës në veçanti, hidhen themelet e letërsisë shqipe, si një letërsi e përkthyer me përmbajtje fetare.*

*Siç mund të shihet, gjatë këtyre shekujve, të cilat përkojnë me pushtimin osman, numri i veprave të botuara në gjuhën shqipe nuk është i madh. Si në shumë gjuhë të tjera edhe në shqipe, tekstet e para janë kryesisht tekste me përmbajtje fetare, të përkthyer kryesisht nga latinishtja, e cila, siç dihet, ka qenë për një periudhë të gjatë gjuhë universale e kishës së krishterë katolike. Pra, dhe ato pak libra që njohën dritën e botimit, kishin karakter fetar dhe gjithnjë në funksion të Kishës dhe propagandës së saj. Përkthimi shqip i këtyre teksteve, si libra të mësimi të fesë a shërbesash fetare, sigurisht që ndikoi mjaft në zhvillimin e lëvrimin e gjuhës shqipe, në shndërrimin e saj nga gjuhë e folur, në gjuhë shkrimi.*

*Një ndër këta tekste është dhe teksti i zgjedhur nga ne, ai Kuvendit të Arbënit, i cili, ndonëse është përkthim nga latinishtja, mbart vlera për njohjen dhe studimin e shqipes së shkruar. Falë botimit shqip të këtij teksti, sigurohet vijimsia e shkrimit të shqipes, e cila, siç u tha, fillon me autorët e vjetër të Veriut dhe përfundon me veprën e Gjon Kazazit. Teksti i Kuvendit të Arbënit ka qenë objekt punimi i disa studimeve historike e gjuhësore. Ndër më të rëndësishmit përmendim studimin e V.Malajt, K. Ashtës, R.Ismajlit, të cilët e kanë parë Kuvendin e Arbënit si ngjarje me rëndësi në historike kishtarë të Shqipërisë, ndërsa tekstin shqip me materialet e Kuvendit, si një korpus i rëndësishëm gjuhësor për të studiuar zhvillimin historik të shqipes së shkruar nga Buzuku, në fillim të shekullit XVIII dhe për të vijuar më tej me shqipen e re. Këto studime janë kryesisht analiza grafike-fonetike me karakter sinkronik e diakronik. Deri tani teksti në fjalë nuk i është bërë analizë e mirëfilltë përshkruese – krahasuese në rrafshin morfologjik e sintaksor dhe aq më pak në krahasim me tekstin latin dhe gjuhën latine, nga e cila është përkthyer.*

---

<sup>2</sup> Me Bogdanin, studiuës si S.Riza në “Pesë autorët më të vjetër të shqipes” mbyllet grupi i autorëve më të vjetër, duke shënuar kështu dhe tekstet më të vjetra të shkrimit shqip. Megjithatë, studiuësi R.Ismajli në librin e tij “Gjuha shqipe e Kuvendit të Arbënit 1706, medndon se ky kufi duhet shtyrë dhe të përfshijë tekstin e Kuvendit të Arbënit dhe veprën e Gjon Kazazit (1743)



*Si rezultat, të gjitha veçoritë e shqipes do të dalin në pah, jo thjesht nga përshkrimi, por nga krahasimi i tyre me latinishten.*

## **02. Objekti, karakteri dhe synimet e punimit.**

*Teksti i Kuvendit të Arbënit, i cili përmban aktet dhe vendimet e marra në kuvend, mbajtur në vitin 1703, është hartuar fillimisht në gjuhën latine në vitin 1706 dhe për të qenë sa më afër dhe sa më i kuptueshëm nga të gjitha shtresat e besimtarëve, u vendos që ky tekst të përkthehej e të botohej dhe në gjuhën shqipe në po atë vit, pra në 1706. Pjesën kryesore të tekstit e zënë dekretet, të cilat janë ndarë në katër pjesë të mëdha dhe secila nga këto pjesë është ndarë në kapituj. Natyra e tekstit është e tipit fetar, ose më saktë fetaro-ideologjik, në të cilin nuk mungojnë as dhe rregullat apo ligjet, të cilat u drejtoheshin komunitetit katolik për të respektuar këto të fundit dhe për t'u riorganizuar. Funksioni kryesor i vendimeve të marra në Kuvend është ai fetar, njohja me gjendjen e kishës katolike dhe problemet që shqetësonin shoqërinë e asaj kohe, duke bërë që ky tekst të përmbajë vlera të rëndësishme historiko-kulturore.*

*Por rëndësia e këtij kuvendi nuk kufizohet me kaq. Teksti ynë mbart vlera të mëdha gjuhësore, sepse mbetet një burim i rëndësishëm, prej të cilit mund të nxirren përfundime për strukturën dhe veçoritë e shqipes në gjysmën e parë të shekullit XVIII, duke ndihmuar në stabilizimin e gjuhës shqipe dhe në zgjerimin e funksionit dhe përdorimit të saj.*

*Studimeve të shumta që i janë bërë këtij teksti, jo vetëm nga pikëpamja e rëndësisë dhe vendit të tij në kuadrin e teksteve të tjera të vjetra, por dhe nga aspekti filologjik e gjuhësor, do t'u shtohet dhe ky punim modest, gjatë të cilit do të bëhen vërejtje gjuhësore, pothuajse në të gjitha rrafshet e gjuhës, ai fonetik, morfologjik dhe sintaksor.*

*Ky studim, në fushën e historisë së gjuhës, ka si objektiv themelor të japë nga njëra anë një pasqyrë të shkallës së zhvillimit historik të shqipes së shkruar dhe nga ana tjetër të na japë informacion mbi strukturën reale të shqipes së kohës nga aspekti i një krahasimi me gjuhën e tekstit burimor, në këtë rast latinishtja. Nga krahasimi i tekstit shqip me atë latin, do të jetë me interes të shohim potencialet e shqipes së fillimit të shekullit XVIII, përballë latinishtes, një gjuhë me traditë shkrimi të hershme. A kanë ndikuar strukturat e latinishtes në ato të shqipes? Nëse po, deri në ç'masë? Për ne do të ishte thuhet e pamundur të përfshinim në studimin tonë të gjitha tekstet e vjetra, jo vetëm se do të duhej një*

*punim më i gjerë e i shtrirë, por dhe për faktin se jo të gjitha tekstet e vjetra janë përkthime nga latinishtja.<sup>3</sup>*

*Për këtë arsye, si burim kryesor, i cili do t'i nënshtrohet analizës gjuhësore, kemi përdorur botimin e dytë latinisht të materialeve të Kuvendit të Arbënit, atë të vitit 1868 dhe botimin shqip të po këtij viti, nën kujdesin e Engjëll Radojës.<sup>4</sup>*

### **03. Struktura e punimit**

*Për të realizuar objektivat e synuara, ky studim përbëhet nga tri pjesë kryesore dhe secila nga këto pjesë strukturohet në kapituj.*

*Në fillim të punimit është bërë një paraqitje e përgjithshme e zhvillimit kulturor e letrar në Shqipërinë e shekujve XV- XVIII, roli i humanistëve dhe veprave të tyre të shkruara në gjuhën latine, si dhe kontaktet e para të shqipes së shkruar me botën latine-romane.*

*Në kapitullin e parë, paraqiten një sërë aspektesh që lidhen drejtpërdrejt me rrethanat e mbajtjes së Kuvendit të Arbënit, si një ngjarje me rëndësi në historinë kishtare të shqiptarëve si dhe me rëndësinë e botimit të akteve të këtij kuvendi në gjuhën latine dhe atë shqipe. Një çështje me rëndësi e trajtuar në këtë kapitull është dhe ajo e vendit të tekstit të Kuvendit të Arbënit në kuadër të teksteve të vjetra dhe rëndësisë së vendimeve të marra në të.*

*Kapitulli i dytë, trajton çështje që lidhen drejtpërdrejt me grafinë dhe alfabetin e përdorur në tekst, përshkrimin e shenjave grafike të ilustruara me shembuj, si dhe rëndësinë që merr ky tekst në vazhdimin e traditës së shkrimit të shqipes me alfabet latin. Dukuritë më të rëndësishme fonetike, të vështruara në ciklin e teksteve të vjetra,<sup>5</sup> zënë pjesën kryesore të kapitullit.*

*Në kapitullin e tretë dhe të katërt, falë një vështrimi krahasues të tekstit latin (teksti burimor) dhe përkthimit të tij në shqipe, (teksti mbërritës) e tërë lënda gjuhësore e tekstit do t'i nënshtrohet një analize përshkruese-krahasuese, e cila do të nxjerrë jo vetëm ndryshimet që ekzistojnë ndërmjet latinishtes dhe shqipes, por dhe ngjashmëritë dhe ndryshimet thelbësore mes strukturave të shqipes së*

---

<sup>3</sup> Përmendim këtu “*Mesharin*” e Buzukut, “*Cuneus Prophetarum*” të Pjetër Bogdanit.

<sup>4</sup> Prift dhe figurë e njohur e kulturës së shekullit XIX.

<sup>5</sup> Çdo dukuri fonetike e vërejtur në tekstin e Kuvendit të Arbënit është krahasuar me tekstet e tjera të vjetra, me shembujt vjelë nga këto tekste.

*sotme dhe asaj të shekullit XVIII, si dhe tiparet e veçanta e të përbashkëta me tekstet e autorëve të vjetër.*

*Në kapitullin e pestë, gjuha e tekstit të Kuvendit të Arbënit do të vështrohet nga ana e përkatësisë dhe e veçorive dialektore, si dhe do t'i bëhet një shtresëzim leksikut të përdorur. Ky tekst ka rëndësi të veçantë për sa i përket historisë së huazimeve në shqipen e fillimit të shekullit XVIII, duke shërbyer si burim i rëndësishëm për studime sociolingustike.*

*Kapitulli i gjashtë trajton një varg çështjesh që lidhen me përkthimin e tekstit latin dhe problemet që dalin si rezultat i përkthimit nga ana e autorit shqipfolës joburimor, i cili jo vetëm që ka bërë përkthim ad litteram, duke shkuar deri në dhunim të strukturës së shqipes, por herë të lë dhe përshtypjen se nuk njihete mirë dhe latinishten gjithashtu. Kjo gjë vërehet sidomos në përkthimin e periudhave tipike latine.*

*Le të shpresojmë që ky punim të sjellë një ndihmesë më shumë në fushën e punimeve morfo-sintaksore, sidomos për historinë e gjuhës shqipe.*

## Hyrje

### **Zhvillimi kulturor e letrar në Shqipërinë e shekullit XV-XVIII.** (*Vështrim i përgjithshëm*)

Në zhvillimin kulturor të një vendi rol kryesor luajnë kushtet historike, si dhe zhvillimi ekonomik - shoqëror. Nuk kishte si të ndodhte ndryshe dhe në Shqipërinë e shekullit XV – XVIII. Kjo periudhë, është konsideruar nga studiuesit si më e rënda në historinë e popullit shqiptar, pasi përkon me pushtimin e gjatë osman, pushtim që nisi menjëherë pas vdekjes së Skënderbeut (1468), për të vazhduar deri në shekullin XIX. Ky pushtim nuk solli asgjë pozitive. Sistemi feudal ushtarak osman arriti të shkatërronte zotërimet e mëdha feudale duke ndërprerë proceset e natyrshme të zhvillimit ekonomik - shoqëror e kulturor të vendit.<sup>6</sup>

Në prag të pushtimit osman, Shqipëria nuk qëndronte larg vendeve të tjera fqinje duke njohur zhvillim të njëjtë me këto shtete. Shekujt XIII – XIV janë shekuj të zhvillimit të marrëdhënieve feudale, të formacioneve shtetërore feudale, me rimëkëmbjen e qyteteve të vjetra dhe lindjen e qyteteve të reja.<sup>7</sup> Krahas zhvillimit ekonomik shkoi dhe zhvillimi kulturor, pasi populli gjatë kësaj kohe, kishte arritur të shprehte kulturën e tij në mënyrën e jetesës, në veprat e artit, në ruajtjen e gjuhës dhe krijimtarisë popullore. Pra, rruga ishte hapur, premisat ishin të mbara. Dalëngadalë, por në mënyrë të vazhdueshme, elemente të qytetërimit dhe të progresit u asimiluan nga qytetarët më të ngritur. Shqipëria nuk qe, siç duan ta paraqesin disa, një vend me njerëz barbarë, të egër dhe analfabetë, por pati një nivel kulturor jo të vogël, me qytete dhe nxorri njerëz të shquar në fushën e letrave, të artit e të shkencës, shkruan

---

<sup>6</sup> Në kohën kur osmanët erdhën, në Shqipëri sundonin princat feudale të cilët ishin në luftë me njëri-tjetrin, vetëm që të zgjeronin sa më shumë territoret e tyre.

<sup>7</sup> *Historia e letërsisë shqiptare*, Tiranë, 1959, f. 12. Mbi humanistët dhe Shqipërinë e asaj kohe të shihet Engjëll Sedaj në periodikun *Flaka e vëllazërimit*, Maj, 1991, Humanistët shqiptarë personalitete të formatit evropian, f.15 shkruan: “*Që prej kohës së formimit të tij populli shqiptar ishte inkuadruar në formatin evropian. Durrësi ishte ura lidhëse me Evropën, sidomos prej sundimit të anxhuinëve e këtej, kurse në disa qendra të tjera, siç ishte Berati, ndjehej formati bizantin që kishte arritur shkallën më të lartë të zhvillimit artistik në personalitetin e Onufrit. Pikturat e tij, në njërin anë dhe figura e shquar e jetës kulturore dhe politiko- shqiptare e pal Engjëllit në anën tjetër, na mundësojnë të kuptojmë se bota shqiptare jo vetëm që nuk ishte e shkëputur nga idetë më përparimtare të kohës, por dhe jepte kontribut të veçantë.*”

Vinçenc Malaj.<sup>8</sup> Por, pushtimi dhe lufta e gjatë ndërpreu hovin dhe prirjen e shoqërisë për t'u bërë pjesë e kulturës dhe ideve humaniste. Duke qenë se kleri kishte në dorë arsimin dhe kulturën, letërsia e vjetër e kësaj kohe është kryesisht e karakterit fetar. Por më vonë, Shqipëria njohu ndikimin e humanizmit dhe idetë e lëvizjes së Rilindjes europiane. Si rrjedhim, krahas letërsisë kishtare, që në periudhën më të vjetër, në shekujt XV-XVI lind dhe zhvillohet një letërsi e natyrës historike, frymëzuar nga idetë e mendjeve përparimtare të njërzimit, bazuar mbi fakte dhe kronika historike, por që mbartte dhe vlera letrare.<sup>9</sup> Bëhet fjalë për veprat e humanistëve shqiptarë si Marin Beçikemi dhe sidomos Marin Barleti, të shkruara në gjuhë latine dhe në dhë të huaj. Është e vërtetë që me pushtimin, zhvillimi kulturor pësoi thyerje, por nuk u ndërpre krejtësisht. Pushtimi osman, nga njëra anë me anë të reformave dhe sidomos me natë të fesë e kulturës islame, tentonte të ndryshonte jetën kulturore deri në asimilim të plotë. Nga ana tjetër, pas ndarjes së kishave të Lindjes e të Perëndimit më 1504, në Shqipëri fillojnë të përhapen tre kultura të ndryshme: kultura greke, kultura katolike latine dhe më vonë ajo sllave. Kështu, në Shqipëri, krahas besimit të ri, atij islam, ekzistonin dhe dy besime të tjera fetare, ai katolik që lidhej me kulturën latino – italiane dhe ai ortodoks i cili lidhej me kulturën bizantine. Të dyja këto kultura, dhe pse vepronin për interesat e tyre, shërbyen në qëndresën ndaj asimilimit. Kështu, në Shqipërinë e shekullit XVI deri në shekullin XVIII, kultura, arsimit, ishte në dorë të klerit të tri besimeve. Në shekullin XVII gjendja ekonomike e popullit përkeqësohet më shumë si rezultat i luftrave të vazhdueshme kundër pushtuesit, të cilat shënonin vetëm humbje të mëdha. Për sa i takon kulturës, mund të themi se gjendja e arsimit të popullsisë së krishterë që e vështirë. Ortodoksët dhe katolikët kishin pak shkolla fetare që ngriheshin pranë ndonjë kisha ose pranë ndonjë fshati. Shkollat katolike përgatishnin mësues klerikë, të cilët njihnin mirë latinishten ose italishten, por jo gjuhën shqipe, gjuhën e popullit. Nga fundi i shekullit XVI dhe fillim i shekullit XVII, Vatikani në kuadrin e Kundërreformës nis reforma të thella dhe vepron gjërësisht për forcimin e katolicizmit në vendet e Ballkanit, dhe sigurisht dhe në Shqipëri. Në këtë mënyrë, lejoi përdorimin e gjuhës vendase, konkretisht atë shqipe, në librat e shërbesat fetare duke zëvendësuar latinishten. Gjuha vendase shihej si mjet i rëndësishëm për përhapjen e fesë. Si rezultat, dhe shkrimet e shqipes së shekullit XVI –XVII qenë me karakter fetar ose didaktik.

---

<sup>8</sup> V. Malaj, *Kuvendi i Arbënit, 1703*, botimi i parë, Shoqata “Don Gjon Buzuku, Ulqin-Tuz, 1998, f. 21. Në fakt, ky punim është përkthim nga Tonin Zadeja, i *Concilio nazionale Albanese del 1703. Inquadramento storico, testo Albanese e glossario*. Universita di Roma, Facoltà di lettere e filosofia, Corso di laurea in lettere, tesi di laurea, anno accademico 1971- 1972.

<sup>9</sup> Po aty, f. 13

Zhvillimin e letërsisë fetare e ndihmoi dhe nevoja për libra fetarë në gjuhën shqipe, për t'i ardhur në ndihmë klerit. Gjatë kësaj kohe u përkthyen vepra me përmbajtje fetare, në funksion të ushtrimit të fesë dhe riteve të saj, sidomos katekizma nga italishtja ose latinishtja. Kjo letërsi u zhvillua kryesisht në Shqipëri e Veriut, duke ndihmuar në lëvrimin dhe pasurimin e gjuhës letrare në bazë të gegërishtes veriore. Në këtë periudhë, njohin dritën e botimit libri i parë i shqipes së shkruar, *Meshari* i Buzukut (1555) dhe *E mbsuame e krështerë* (1592) e Lekë Matrëngës. Në shekullin XVII ky prodhim letrar mori vrull të vërtetë me autorë si Pjetër Budi, Frang Bardhi, Pjetër Bogdani për të mos harruar dhe botimin shqip e latinisht të akteve të mbledhjes së parë të klerit katolik shqiptar, i njohur si *Kuvendi i Arbënit* (1706). Letërsia vazhdoi dhe në shekullin XVIII me vepra të tjera ndër të cilat përmendim veprën e Françesko da Leçes “*Vëzhgime gramatikore për gjuhën shqipe*” (1716) dhe katekizmin e përkthyer nga Gjon Nikollë Kazazi, “*Përmbledhje e shkurtër e doktrinës së krishterë*”, botuar në Romë 1743.

Të gjithë këta autorë të vjetër i bashkonte formimi kulturor latin-italian, duke qenë se shumica qenë priftërinj dhe kishin studiuar në Itali. Në themel të veprave të tyre qëndron alfabeti latin mbështetur në grafinë italiene dhe një numër i konsiderueshëm të fjalëve me burim latin e italian, sidomos të natyrës fetare. Njëkohësisht, një hap tjetër në dobi të zhvillimit të kulturës shqiptare, ishte dhe hapja e shkollave, ku për nevojat e predikimit, klerikëve të ardhshëm u mësohej dhe gjuha shqipe. Një shkollë e tillë u ngrit në Kurbin të Krujës me kërkesë të një prelati të asaj kohe, Gjon Koleshi, i cili kur ishte në Romë në 1625, u shkruante eprorëve të tij se do të duhej të ngrihej një shkollë në Shqipëri, që të mësonin shkrim e këndim.

Rrethit të Lezhës i përkasin dy nga shkollat e para të shqipes. Në çerekun e dytë të shekullit XVII erdhi në Shqipëri një ekip misionarësh françeskanë që ngriti në 1638 në fshatin Pedhanë, afër lumit Mat, një shkollë fillore për fëmijë nga 8-10 vjeç. Një vit më vonë në Blinisht, Zadrimë, u ngrit një shkollë e mesme “*gymnasium*” ku mësonin rreth 50 nxënës. Mësimet zhvilloheshin në gjuhën e vendit (*vernacula lingua*). Për këto shkolla flitet dhe në aktet e Kuvendit të Arbënit, të botuara në 1706 në Romë në një tekst të vetëm, ku ai u rekomandohet shkollave të Kurbinit e të Lezhës, sigurisht edhe për mësimin e latinishtes me anë të shqipes.

Si përfundim, mund të themi se gjithë veprat e letërsisë së shkruar, duke përjashtuar prodhimin letrar të humanistëve, kishin përmbajtje të theksuar fetare, pasi e gjithë kjo letërsi u zhvillua në kohën kur kleri kishte në dorë zhvillimin e kulturës dhe të arsimit. Pavarësisht këtyre rrethanave jo të favorshme, mund të themi se Shqipëria, në shekujt XV – XVIII, njohu një shkallë të caktuar zhvillimi kulturor, dhe pse kryhej nën ndikimin e klerit. Ky zhvillim do të kishte qenë më i

madh dhe në të njëjtat nivele me atë të vendeve fqinje të, nëse pushtimi osman nuk do të kishte ndërprerë procesin e zhvillimit të kulturës shqiptare.

## **1. Humanistët shqiptarë dhe roli i tyre në zhvillimin e gjuhës, kulturës dhe të letërsisë shqipe.**

Më sipër u theksua se në shekullin XV, kur Shqipëria kishte arritur një shkallë të mirë zhvillimi ekonomik - politik, zhvillimi kulturor njohu ndikimin e humanizmit. Kur pushtimi osman e bëri të pamundur lulëzimin e kulturës humaniste në vend, ajo pjesë e inteligjencës shqiptare që ishte formuar nën ndikimin e kësaj lëvizjeje, emigroi jashtë vendit dhe e zhvilloi veprimtarinë e saj në viset e huaja ku dhe u vendos. Prej saj u shquan figura që bënë emër në botën humaniste, si historiani Marin Barleti (1458- 1512), Marin Beçikemi (1468-15260, Dhimitër Frëngu (1443-1525). Figura të tjera janë Leonik Tomeu, Mikel Maruli, Maksim Marioti njohës të shkëlqyer të historisë dhe njëkohësisht përkthyes të klasikëve grekë e latinë. M.Barleti, Dh. Frëngu, M.Beçikemi lanë një varg veprash historike që përshkoheshin fund e krye nga ide humaniste. Veprat e tyre nuk janë vepra të mirëfillta letrare, pasi humanistët e shihnin historinë si një degë të shkencës dhe njëherazi si art. Ky koncept bënte që veprat historike të fitonin karakteristika të veprave artistiko-letrare. Veprat e humanistëve, siç dihet, përfshirë dhe veprat e humanistëve shqiptarë karakterizoheshin nga adhurimi për botën e lashtë greko -latine. Jo më kot në periudhën e humanizmit gjuha dhe kultura klasike, ajo greke e latine u ringjall, pasi humanistët shihnin te veprat antike rolin dhe rëndësinë që merrte njeriu i antikitetit. Në qendër të veprave të tyre ishte njeriu në mendjen dhe gjykimin e të cilit humanistët kishin besim të madh. Njeriu qëndron mbi fatin dhe është i aftë të kalojë çdo vështirësi. Në këtë suazë mund të kuptohen më mirë shumë veçori të veprave humaniste shqiptare e sidomos të figurës më të shquar, M.Barleti vepra e të cilit pati jehonë në Evropë dhe ndikoi fort në historiografinë mbi heroin Gj.Kastrioti. Barleti shihte te Skënderbeu heroin e madh të kohërave, figurën e të cilit ai e ngriti lart në veprat e tij. Vetë Barleti pohon se ka përjetuar ngjarjet dramatike të Shkodrës së viteve 70 të shekullit XV. Gjatë rrethimit të dytë të Shkodrës, ai rrëfen se ka luftuar për mbrojtjen e qytetit, duke u shndërruar kështu në një burim të rëndësishëm për historinë e Shqipërisë së shekullit XV dhe figurës qendrore të asaj kohe, Skënderbeut. Me rënien e Shkodrës në duart e pushtuesve, si shumë bashkëqytetarë, Barleti e shumë intelektualë të tjerë morën rrugët e mërgimit për t'u vendosur në Itali. Në Itali, të gjithë plotësuan shkollimin e tyre duke u bërë njohës të thellë të letërsisë antike e gjuhës latine, cilësi që karakterizonin çdo intelektual humanist të kohës. Veprat e Barletit

“*Rrethimi i Shkodrës*” (Venedik 1504)<sup>10</sup> dhe “*Historia e jetës dhe e bëmave të Skënderbeut*”<sup>11</sup> janë vepra të shkruara në gjuhën latine. Latinishtja atëherë, ishte një gjuhë e përbashkët kulture dhe janë pikërisht humanistët të cilët shkruanin latinisht. Por, nga ana tjetër kishte dhe nga ata të cilët përpiqeshin të shkruanin shqip, sidomos gjatë shekujve XVI–XVIII. Është e qartë që shqipja shkruhej përpara Buzukut. Por kohët përpara humanizmit s’kanë qenë ato të afirmimit të gjuhëve kombëtare në Evropë. Që Barleti e të tjerë si Dhimitër Frëngu e Marin Beçikemi shkruajnë ende latinisht e ndonjë tjetër italisht është e lehtë për t’u shpjeguar pasi, duke jetuar në vend të huaj ata i drejtohen një publiku të huaj gjithashtu. Dhe në atë kohë publiku i kulturuar i lexonte veprat në gjuhën latine. Nga ana tjetër, një nga meritat e humanizmit ka qenë dhe përpjekja për të lëvruar gjuhën kombëtare, gjë që u pengua nga pushtuesit dhe nga kleri.

Një hov i ri u duk në shekujt XVI-XVIII, dhe pse shqipja filloi të shkruhej në lëmin fetar. Por lind pyetja: Cili qe roli humanistëve në zhvillimin kulturor e letrar të Shqipërisë dhe vendi që zë veprimtaria e tyre letrare në letërsinë e vjetër shqiptare? Kjo çështje është trajtuar mjaft nga studiues të shumtë<sup>12</sup>, pasi lidhet drejtpërdrejt me periodizimin e letërsisë së vjetër. Në librin “*Historia e letërsisë shqiptare*” e vitit 1959 dhe në atë të vitit 1971 për letërsi të vjetër shqipe jepej ky përkufizim: “*Letërsi e vjetër shqipe quajmë gjithë prodhimin letrar shqip, që prej fillimit të tij gjer në periudhën e lëvizjes sonë kombëtare, gjer në letërsinë e Rilindjes sonë*”. Për fillimet e saj thuhej “*nuk është e mundur të përcaktohet me saktësi koha e lindjes së letërsisë shqipe të shkruar. Kemi arsye të forta të mendojmë se ajo do të ketë lindur të paktën që nga fundi i shekullit XIII*”. Nga ky qëndrim mund të kuptohet përfshirja e veprave të humanistëve në letërsinë e vjetër shqipe.

Një ndarje tjetër mbetet dhe ajo e “*Historisë së letërsisë shqiptare*” e vitit 1983, e ngjashme dhe me atë vitit 1959.<sup>13</sup> Sipas kushteve dhe veçorive që mori letërsia e vjetër dallohen këto faza të zhvillimit.

Faza e parë e shkrimeve të para rreth shekullit XIII – pjesa e parë e shekullit XV. Kjo është faza më e lashtë e letërsisë shqipe dhe lidhet me kohën e zhvillimit të feudalizmit shqiptar dhe lulëzimin e qendrave ekonomike e të qyteteve

---

<sup>10</sup> “*Rrethimi i Shkodrës*” siç u tha më lart e shkruar në bazë të kujtimeve personale, njohu botimin e parë në gjuhën latine, është ribotuar disa herë i përkthyer italisht, frëngjisht e polonisht. U përkthye shqip më 1960 nga Henrik Lacaj.

<sup>11</sup> Botuar midis viteve 1508-10 në Romë. Përkthimi i plotë shqip është ai i Stefan Priftit, Tiranë, 1964

<sup>12</sup> Mbi periodizimin e letërsisë shqiptare shih dhe Rexhep Ismajli, *Tekste të vjetra të shqipes*, Pejë 2000

<sup>13</sup> Ndryshimi është se në librin e vitit 1959 dallohen tre faza, ndërsa në atë të 1983 është dhe një fazë e katërt, ajo e shekullit XVIII.



shqiptare gjatë shekujve XIII-XIV. Prej prodhimit letrar të kësaj periudhe nuk ka arritur asgjë, gjithçka u zhduk në rrënimet e luftrave.

Faza e dytë (prej pjesës së dytë e shekulli XV – pjesa e parë e shekullit XVI. Këtë fazë e formon veprimtaria e humanistëve shqiptarë të cilët, siç u tha më lart, nën ndikimin e humanizmit evropian ndihmuan në zhvillimin e letërsisë sonë humaniste. Është e vërtetë që veprat e tyre u shkruan në gjuhën latine, por kjo letërsi konsiderohet pjesë përbërëse e kulturës dhe letërsisë sonë shqipe, autorët qenë shqiptarë dhe në qendër të veprave të tyre qenë shqiptarët dhe problemet e tyre.

Këtë periodizim e kanë mbështetur disa studiues, ndër të cilët Mahmud Hysa<sup>14</sup>. Ky autor, në librin e tij shtron një çështje me rëndësi lidhur me gjuhën si kriter kryesor e vendimtar që një vepër t'i përkasë letërsisë së një kombi. Sipas tij duke qenë se të gjitha historitë e letërsisë shqiptare fusin humanizmin shqiptar si fazë të parë dhe shumë të fuqishme e të rëndësishme të letërsisë sonë “besoj se pa asfarë ngurimi duhet ta konsiderojmë *Rrethimin e Shkodrës* si vepër të parë të letërsisë sonë, pavarësisht se ajo është shkruar në gjuhën latine<sup>15</sup>. Sipas Hysës, nuk është gjuha një kriter për të treguar përkatësinë e një autori në një letërsi, por përkatësia kombëtare e autorit dhe përmbajtja e veprës së tij. Kështu, ai në letërsinë shqiptare përfshinte shkrimet e Adae-s<sup>16</sup>, të Kuvendit të Arbënit<sup>17</sup> e të da Lecces<sup>18</sup> “që janë autorë të përkatësisë kombëtare të huaj”.

Traditat e humanizmit e të Rilindjes dhe fillimet e shkrimit shqip janë trajtuar në letërsinë e shkruar në Shqipëri dhe në librin e Robert Elsit “*Historia e letërsisë shqiptare*”.<sup>19</sup>

Duke iu referuar traditës së shqyrtimit të kësaj çështjeje mendojmë se veprat e humanistëve dhe pse të shkruara në gjuhën latine meritojnë të jenë pjesë e letërsisë së vjetër shqipe, pasi kemi të bëjmë me përpjekje të mëdha të humanistëve për të qenë pjesë e kulturës dhe mbi të gjitha pjesë e luftës për shpëtimin e çlirimin e Shqipërisë.

Faza e tretë (prej shekullit XVI – deri në fillim të shekullit XVIII) Kjo përbën fazën e parë letrare të njohur të letërsisë në gjuhën shqipe, e zhvilluar në kushtet e vështira të pushtimit osman. Kjo njihet si letërsia fetare katolike dhe didaskalike<sup>20</sup> dhe shoqërohet nga përpjekjet e reja për shkrimin e shqipes, si një vazhdim i

---

<sup>14</sup> Mahmud Hysa, *Krestomaci e letërsisë së vjetër shqiptare*, Prishtinë 1987.

<sup>15</sup> Po aty, f. 12

<sup>16</sup> Dëshmi e klerikut francez Gulielm Adam (ose Ade) më 1332.

<sup>17</sup> Akte të të cilit u botuan më 1706 fillimisht në latinisht e më pas në shqipe.

<sup>18</sup> Francesco Maria da Lecce, *Osservazioni grammaticali nella lingua Albanese*, Roma, 1716.

<sup>19</sup> Robert Elsie, *Historia e letërsisë shqiptare*, Tiranë,

<sup>20</sup> Bëhet fjalë për veprat me karakter fetar – didaktik që shërbenin dhe si libra mësimorë për shkollat fetare shqiptare të shekullit XVI e më tej, vepra e Buzukut, veprat e Budit, të Bardhit, Bogdanit etj.

letërsisë së vjetër dhe njëkohësisht për zhvillimin e gjuhës letrare, gjë që ishte penguar nga pushtuesit dhe kishat e huaja. Të shkruarit në gjuhën kombëtare u bë në lëmin fetar, gjë e kuptueshme për kohën, kur edhe kulturën e kishte në dorë kleri. Vepra e parë e këtij lloji është “*Meshari*” i Gjon Buzukut (1555), vite gjatë të cilëve kisha u detyrua të bënte lëshime dhe të lejonte përdorimin e gjuhëve amtare në vend të latinishtes. “*Meshari*” është shkruar në alfabetin latin, të cilin e shfrytëzuan dhe autorët që erdhën më pas, si Pjetër Budi (1566-1622), Frang Bardhi (1606 -1643), Pjetër Bogdani (1625- 1689). Sipas Shuteriqit<sup>21</sup> edhe fjalorët dygjuhësh si ai i Bardhit, dhe pse niseshin nga qëllime fetare ose për mësimin e gjuhëve të huaja, ishin tipike të humanizmit. Tipare humaniste sipas Shuteriqit, duhen vënë re më mirë te Bardhi, po kështu dhe te Bogdani, edhe pse ai pohon se puna e Buzukut dhe e pasuesve të tij nuk i përket veprimtarisë tipike humaniste kur shkruajnë shqip. Një qëndrim deri diku të ndryshëm mbi idetë humaniste të Buzukut, mban Ali Xhiku<sup>22</sup>, i cili veprën e Buzukut në veçanti e sheh si jehonë humaniste. Në artikullin e tij Ali Xhiku pohon se, veprat e Buzukut dhe pasuesve të tij patën arritjen më të dukshme falë përpjekjeve të para për përpunimin e gjuhës shqipe si gjuhë kulturore. “*Është e vërtetë, - vijon studiuesi - se disa filologë e humanistë synuan gjallërimin e latinishtes, por kishte dhe nga ata që vlerësuan dhe studiuuan gjuhën e popullit.*”

*Atëherë pse mos e quajmë Mesharin e Buzukut si jehonë të humanizmit në kulturën shqiptare”.*

## 2 Kontaktet e para të shqipes së shkruar me latinishten

Gjatë shekujve XIII-XIV dhe në fillimin e shekullit XV Shqipëria njohu një zhvillim relativisht të mirë kulturor e megjithatë dokumente, që vërtetojnë shkrimin dhe përdorimin e gjuhës shqipe gjatë këtyre shekujve mungojnë. Kjo dukuri lidhet me faktin se, si rezultat i pushtimeve të gjata, humbjeve të mëdha të vlerave materiale, dhe ato pak shkrime që mund të ekzistojnë u zhdukën<sup>23</sup>. Kjo për faktin se ato qenë thjesht dorëshkrime, të shkruara në pak kopje, duke qenë se shtypshkronja e Gutenbergut u shpik vetëm në vitin 1440. Pra, sipas këtyre gjasave, shqipja duhet të ketë qenë shkruar dhe para Buzukut. Dëshmia e dhënë

---

<sup>21</sup> Dhimitër Shuteriqi, *Humanistët dhe shkrimtarët e letërsisë së vjetër*, Zëri i popullit, 1983, nëntor 10

<sup>22</sup> Ali Xhiku, *Vepra e Buzukut si jehonë humaniste*, Revista *Perla* 2005/3, f.49

<sup>23</sup> Historia e letërsisë shqipe, Tiranë, 1959, f.181. Aty M.Domi shkruan: *U dogjën biblioteka, dorëshkrime dhe akte. Me këto u zhdukën dhe momentet e shkrimit shqip të shekullit XIV-XV e më përpara”*

nga arkiveshkvii i Tivarit Guillelmus Adae në vitin 1333 është një provë mjaft e rëndësishme për historinë e shkrimit të shqipes. Kleriku francez shkruan: “...shqiptarët ndonëse kanë një gjuhë krejt me vete e ndryshe nga gjuha e Latinëve, megjithatë në marrëdhëniet e përditshme e në gjithë librat e tyre përdorin shkronjat latine.”<sup>24</sup> Me të drejtë lind pyetja, siç e shtron dhe Çabej<sup>25</sup>: Për cilët libra aludon kleriku francez, duke qenë se nga të dhënat historike del se gjuha zyrtare në Shqipërinë e mesjetës ka qenë e huaj? Pas një analize që bën Çabej arrin në përfundimin se “ librat për të cilat u interesua kleriku francez s’kanë qenë veçse shkrime me karakter fetar”<sup>26</sup>. Pas një dëshmie të tillë, pa dyshim mund të pranojmë se shqipja ka qenë e shkruar që në shekullin XIV dhe se kësaj periudhe i përket krijimi dhe përshtatja e traditës së shkrimit të shqipes me alfabetin latin, traditë që sipas Mansakut<sup>27</sup> vijon gjatë shekujve XVI, XVII e XVIII në rrethanat e një trashëgimie të gjatë lidhjesh kulturore e gjuhësore me botën latino-romane.

Siç dihet, Shqipëria e ka njohur qytetërimin romak qysh nga viti 229 para erës së re kur romakët nisën pushtimin e Ilirisë e deri në vitin 9 të erës re. Sundimi romak dhe kontaktet me botën latine do të vijojnë deri në fund të shekullit IV të erës së re, kur ndodh ndarja e perandorisë romake. E megjithatë, ndikimi i botës latine dhe i latinishtes do të vijojë dhe në shekujt në vazhdim, ndonëse në masë më të kufizuar. Kontaktet e para të shqipes me latinishten vërehen konkretisht dhe në dokumentet e para të shkrimit shqip.

Një dëshmi e gjallë e ndikimeve të latinishtes në fillimet e shqipes së shkruar vërehet qysh në dokumentin e parë të shkruar shqip, Formula e pagëzimit e vitit 1462,<sup>28</sup> shkruar në gegërishte dhe me alfabet latin. Fjalja “*Vnte’ paghesont premenit atit et birit et spertit senit*” është gjetur në një tekst latin dhe sipas Çabej<sup>29</sup>, grafia e njëjtë për të dyja, lehtësia me të cilën shkruesi kalon nga shkrimi i latinishtes në të shqipes, duke përdorur po ato shkronja, dëshmon se në atë kohë kishte njerëz të shkolluar që shkruanin shqip dhe se shqipja shkruhej me gërma latine, duke vijuar një traditë të hershme shkrimi të shqipes në Shqipëri. Kjo gjë, sipas Çabej, vërtetohet dhe nga përdorimi i njëjtë i shkronjave si në tekstin e Formulës së Pagëzimit ashtu dhe në atë të Buzikut. Bëhet fjalë pikërisht për *s*-në me vlerë *z*-je në pozicion intervokalik, *s*-ja me vlerë *sh*-je dhe *ni* për *nj*. Alfabeti latin ose më saktë ai latin-gotik, vijon të përdoret dhe në

---

<sup>24</sup> Eqrem, Çabej, Studime gjuhësore VI, f. 18

<sup>25</sup> Po aty, f.19

<sup>26</sup> Po aty, f.19

<sup>27</sup> “*Kuvendi i Arbënit*” në historinë kulturore, Kuvendi i Arbënit 300-vjetori, Lezhë, 2007, f. 106

<sup>28</sup> Mahir Domi, *Mjete dhe burime për gjurmimin e shqipes në shekullin XV*, Konferenca e Dytë e Studimeve Albanologjike, III,1969, f. 102.

<sup>29</sup> Vep.cit, f. 345

fjalorthin e Arnold fon Harfit i vitit 1497, një dokument gjithashtu i rëndësishëm për shqipen e shkruar.

Në alfabetin latin u mbështet dhe autori i librit të parë të shqipes, Buzuku, në vitin 1555 duke krijuar kështu traditën e shkrimit të shqipes me alfabet latin, si alfabeti më i përshtatshëm që u përgjigjej më mirë shkencërisht veçorive tingullore të gjuhës shqipe dhe që ishte më afër historisë, traditave dhe aspiratave kulturore të shqiptarëve.<sup>30</sup> Alfabeti latin u shfrytëzua nga të gjithë autorët e Veriut dhe përbën bazën e shkrimeve të vjetra shqipe, duke siguruar vazhdimësinë e traditës së shqipes së shkruar.

Grafia e zgjedhur në përkthimet e autorëve të vjetër është ajo latine - italiane. Tradita e përdorimit të saj i ka fillimet qysh me librin e parë shqip të Buzukut për të vazhduar me autorët e tjerë të Veriut<sup>31</sup>. Duke qenë se shqipja ka dhe tinguj, të cilët nuk mund të shënoheshin duke shfrytëzuar vetëm grafisë latino-italiane, autorët ishin të detyruar të shfrytëzonin alfabete të gjuhëve të tjera, siç ishte ai sllav dhe ai grek.

Leksiku është i tejmbushur me fjalë me burim nga latinishtja e italishtja, kjo për faktin se tekstet e vjetra ishin të karakterit fetar dhe terminologjia e përdorur sigurisht që do të ishte ajo fetare.

Duke qenë se kemi të bëjmë me përkthime, ndikime të shumta vërehen dhe në zgjedhjen e disa shprehjeve dhe strukturave sipas modelit italian apo latin, duke shformuar jo rrallë strukturat e mirëfillta të shqipes, dukuri të vëna re dhe nga studiuesit. Kjo dukuri vërehet dhe te Buzuku, Bogdani dhe sidomos te teksti shqip i Kuvendit të Arbënit, i cili do të jetë teksti bazë për realizimin e punimit tonë. Nisur nga kjo situatë, disa prej studiuesve<sup>32</sup> në punimet e tyre mbi gjuhën shqipe, historinë dhe natyrën e saj, jo rrallë herë janë nxituar në nxjerrje të përfundimeve të pasakta mbi natyrën e shqipes në shkrimet e vjetra.

---

<sup>30</sup> S. Mansaku. Vep.cit.f. 106

<sup>31</sup> Pjetër Bogdani, "*Cuneus Prophetarum*" (*Çeta e profetëve*) Botim kritik. Përgatitur nga Anila Omari, Tiranë 2005

<sup>32</sup> A.Cirincione, *Sintassi degli antichi scrittori albanesi*, Roma, 1968

## Kreu I

### Kuvendi i Arbënit, ngjarje e rëndësishme për historinë e kulturës shqiptare

#### I.1 Rrethanat historiko-kulturore në të cilat u mbajt Kuvendi i Arbënit

Pas pushtimit të trevave shqiptare nga perandoria Osmane, në Shqipëri mbizotëronte një gjendje e rëndë politike, ekonomike, morale e fetare e popullsisë. Popullsia e krishterë kishte përballë një kulturë të re, tradita dhe zakone të reja, të cilat doemos do t'i imponoheshin popullit shqiptar. Por ndërsa, siç shkruan F. Duka, në pjesën qytetare të popullsisë feja islame depërtoi më shpejt dhe më fuqishëm në fund të shekullit XVI, ritmet e këtij procesi në zonat fshatare ishin më të ulta katolike.<sup>33</sup> Vendosja e taksave dhe pamundësia për t'u bërë ballë shumë detyrimeve çoi disa në pranimin e fesë islame, qoftë realisht qoftë formalisht.<sup>34</sup> Të tjerë largoheshin në vende të tjera të Evropës për të mos qëndruar nën sundimin osman dhe për ruajtur zakonet e të parëve. Për të mos mjaftuar vetëm kjo, brenda klerit katolik ekzistonin shumë mosmarrëveshje që kishin të bënin me rënien e veprimtarisë së klerit për shkak të mungesës së priftërinjve, sidomos të atyre me shkollë, me gjendjen e mjeruar të kishave, me shkeljen dhe ndryshimin e zakoneve dhe të riteve fetare nga ana e vetë katolikëve. Rrethanat historike të vështira, në fund të shekullit XVII, janë dëshmuar dhe nga Pjeter Bogdani, figura më e ndritshme e këtij shekulli në historinë e popullit shqiptar. Lutja e tij për përmirësim të gjendjes, siç mund të lexohet edhe në librin e tij "*Çeta e profetëve*" ishte: "*Na shpëto, o Zot, se mbaruam*". (*Salva nos, Domine, perimus*)

Për këtë arsye, në këtë situatë lufte për mbijetesë Kisha Katolike filloi të tregojë interes të veçantë për gjendjen shpirtërore, intelektuale dhe materiale të atyre pak besimtarëve katolikë të mbetur. Realisht ndiehej nevoja për një reformim rrënjësor moral, administrativ të jetës fetare të popullit dhe të klerit në Shqipëri. Jo më kot, duke nisur që nga viti 1462, vit kur u mbajt Kuvendi i Matit<sup>35</sup>, në

---

<sup>33</sup> Ferit Duka, *Kriptokristianizmi*, Kuvendi i Arbënit 300-vjetori, vep.cit. f. 65

<sup>34</sup> Bëhet fjalë për dukurinë e kriptokristianizmit ose krishtërimi i fshehtë. "*Krishtërimi i fshehtë përfaqësonte një gjendje kalimtare dybesimi, gjatë së cilës individë të krishterë e përqaftuan islamin vetëm formalisht që t'i shpëtonin pagesës së xhizjes (detyrim), si dhe të gëzonin barazinë me myslimanët në jetën shoqërore*". F.Duka, vep.cit. f.68

<sup>35</sup> Ky është kuvendi i parë kishtar i mbajtur në Shqipëri dhe sipas të dhënave historike është mbajtur në prag të pushtimit të vendit nga perandoria osmane. Për më shume mbi këtë kuvend dhe rrethanave të mbajteses së tij të shihet Çabej, *Studime gjuhësore*, vep.cit. f. 342

materialet e të cilit është ruajtur Formula e Pagëzimit, dokumenti i parë i gjuhës shqipe, e deri në vitin 1912, janë mbajtur disa kuvende të klerit katolik shqiptar. Sipas Çabejt “ këto nuk janë vetëm sinode kishtare. Janë mledhje fetare-politike, ku krerët e kishës bashkë me parësinë e vendit bisedojnë e marrin vendime për të shpëtuar ç’mund të shpëtohet nga visari etik “fe e atdhe”, koncepte që për atë kohë përbëjnë një njësi të pandarë. Këto kuvende shiheshin si një mënyrë për të ruajtur identitetin kombëtar, fenë dhe zakonet dhe njëkohësisht t’i jepnin hov kultivimit të gjuhës shqipe dhe botimit të librave në këtë gjuhë.

Në periudhën 1700-1721, sundimtar i kishës katolike qe Papë Klementi XI, origjina e të cilit ishte nga një familje e njohur në Itali, - familja e Albanëve, me origjinë shqiptare.<sup>36</sup> Nuk është e rastit që pikërisht gjatë kësaj kohe, papa themelon Kolegjin Arbëresh në Shën Demetrio Korone të Kalabrisë, hap katedrën e gjuhës shqipe në kuvendin e Shën Bartolomeut në Romë, ku ka dhënë mësim Françesko Maria da Leçe, autori i gramatikës së parë shqipe, vë kontakte të ngushta me Gjergj Guxetën, arbëreshin e njohur siçilian të kohës dhe themeluesin e kolegjit arbëresh të Palermos.<sup>37</sup> Për këto dhe shumë vepra të tjera konkrete për çështjen shqiptare dhe konsolidimin e klerit katolik shqiptar, papa Klementi XI Albani mbetet një nga figurat më të rëndësishme të historisë kishtare.

Si rrjedhim, rezultatet e punës për reformat e klerit shqiptar filluan të ndiheshin pikërisht në fillimet e vitit 1700, kur më 8 dhjetor të po këtij viti u zgjodh Papë

---

<sup>36</sup> Pas vdekjes së papës Inoçenti XII, më 27 shtator 1700, konklava e kardinalëve për zgjedhjen e papës së ri praktikisht nuk kishte kandidat më të përshtatshëm e më të përgatitur në çdo pikëpamje se kardinali Albani: ai ishte më i aftë se të tjerët edhe për arsye se duke qenë me origjinë shqiptare, njihte situatën e konfrontimeve të vazhdueshme me turqit, të cilët në ato dhjetë vitet e fundit kishin rrethuar disa herë Vjenën dhe i kërcënoheshin gjithë Evropës; kardinali Albani ishte i motivuar më tepër se të tjerët për të organizuar diplomacinë evropiane në luftë kundër kësaj të keqe më të madhe të kohës, siç ishin këta “barbarë” aziatikë. Kështu në mbledhjen e 20 nëntorit 1700 kardinali Albani fitoi shumicën absolute të votave. Ky lajm i paralajmëruar me tymin e bardhë do të shpallet me formulimin e zakonshëm – *habemus papam* – më 23 nëntor 1700, kurse më 18 dhjetor Albani kurorëzohet papë Lateran të Romës. Sipas biografëve papa shquhej për sjelljet e përpikta, puna e palodhshme, temperamentin e përzemërt dhe kujdesin ndaj të varfërve. Krenaria e origjinës shqiptare u shfaq edhe në ato momente, kur u zgjodh papë, ngase nuk u hamend fare që emrit të papënisë, që asocionte fisin e lëvdishëm të Klementit, t’ia shtonte edhe mbiemrin ALBANI për t’u dalluar para botës se është shqiptar. Këtë krenari të madhe ai do ta arsyetojë edhe me vepra, si në planin kombëtar shqiptar, ashtu edhe në palnin kishtar. Në planin kombëtar, papa Klementi XI cakton Vinçenc Zmajeviqin, arqipeshkvin e Tivarit (1701-1713), që në cilësinë e vizitorit të gjithë gadishullit Ballkanik, të organizonte dhe të udhëhiqte Kuvendin e Arbënit, që mbase do të jetë ngjarja më e rëndësishme kombëtare e shekullit XVIII. / Material nga Interneti: <http://www.forumikatolik.net>. Për më shumë mbi origjinën dhe veprimtarinë e papës Klementi XI shih Vincenz Malaj, vep.cit. f. 41-43. Një tjetër libër me rëndësi, me të dhëna të rëndësishme, rreth Papës dhe Kuvendit të Arbënit, është dhe ai i Engjëll Sedajt, *Papa Shqiptar Klementi XI –Albani dhe Kuvendi i Arbënit*. Prishtinë. 1988.

<sup>37</sup> Material në internet: <http://www.forumikatolik.net>.

Klementi XI – Albani. Interesimi i Papës për Shqipërinë ishte i madh, pasi siç u tha më sipër, ishte me origjinë shqiptare.

Kështu, më 18 prill 1701, Papa Klementi XI caktoi Vinçenc Zmajeviçin, një nga intelektualët e dalluar të kulturës kroate të kësaj kohe, si arkipeshkv në Tivar. Si një njeri që punonte dhe që gëzonte besimin e Papës Zmajeviçi, më 8 qershor 1702 u emërua nga Papa vizitator apostolik i të gjitha dioqezave dhe misioneve françeskane.<sup>38</sup>

Zmajeviçi iu kushtua me zell ripërtëritjes fetare e morale të klerit dhe të popullit, duke u bërë një figurë e rëndësishme në historinë e popullit shqiptar. Veprimtaria dhe shërbimi në Kryeipeshkvinë e Tivarit e lidhi ngushtë me trojet shqiptare dhe me interesat e këtij populli. Si kryeipeshkv në Tivar, lidhi miqësi me pashën e Shkodrës, Hodaverdi Pasha Mahmutbegoviç, për të cilin flet mjaft mirë. Vitet 1702, 1703, 1704 janë vite të punës intensive të Zmajeviçit në trojet shqiptare. Ai, bashkë me prefektin e Misionit të Shqipërisë Exhidio d'Armento dhe sekretarin e tij Raimund Galanin, nisen për në Shqipëri me një mision të veçantë. Mund ta quajmë kështu, sepse me urdhër të Papës Klementi XI-Albani, u thirr Kuvendi i Arbënit, tubim i rëndësishëm për kohën, drejtimi i të cilit këtij iu besua priftit kroat.

Nga Kurbini, Zmajeviçi dërgoi një letër për parinë kishtarë shqiptare, duke i ftuar të merrnin pjesë në Kuvendin që do të mbahej të dielën e dytë pas Epifanisë, pra më 14 dhe 15 janar 1703, në kishën e Shën Gjonit, në Mërq, tre kilometra në veri të Lezhës.<sup>39</sup> Në të morën pjesë krerët katolikë shqiptarë të të gjitha viseve, priftërinj dhe famullitarë, përfaqësues të urdhrave të ndryshme katolike, si dhe mbi 200 persona të tjerë besimtarë. Tubimi kishte si qëllim të krijonte një marrëveshje, së cilës do t'i përmbaheshin të gjithë. Prelatët e lartë kishtarë diskutuan gjërësisht lidhur me gjendjen e katolicizmit në këto troje, me rregullimin e kishave dhe forcimin e propagandës.<sup>40</sup> Në organizimin kishtar rëndësi të veçantë kishte dukuria e konvertimit të katolikëve në muslimanë dhe ortodoksë. Pra asimilimi, si dhe rreziku i zhdukjes së katolicizmit ishte i pranishëm në shoqërinë e asaj kohe. Për këtë arsye, vendimet e Kuvendit në këto drejtime duhet të ishin shumë të rëndësishme dhe të prera. Këto vendime ne i njohim vetëm përmes akteve të Kuvendit, të hartuara nga Vinçenc Zmajeviçi dhe të redaktuara e të lejuara për botim nga Propaganda Fide.

---

<sup>38</sup> Për më shumë mbi personalitetin e Zmajeviçit shih Ismajli, *vep.cit.f.* 21-26

<sup>39</sup> Po aty, f. 24

<sup>40</sup> Po aty, f. 24 Në kuvend ishin të pranishëm: *Pjetër Zymi*, kryeipeshkv i Durrësit, *Pjetër Karaxhiq*, kryeipeshkv i Shkupit, *Gjergj Theodhori*, ipeshkv i Sapës, *Anton Babi*, ipeshkv i Shkodrës, *Nikollë Vladanji*, ipeshkv i Lezhës, *Marin Gjini*, ipeshkv i Pultit, *Atë Exhidio d'Armento*, prefekt apostolik i misioneve në Shqipëri, *Atë Françesko Maria da Leçe*, prefekt apostolik i misionit në Maqedoni, *atë Martini da Xhonima* dhe *Atë Rajmund Gallani*, sekretar.

Të gjitha vendimet e Kuvendit të Arbënit Zmajeviçi ia parashtrori Papës për miratim dhe një komision i ngritur vendosi që libri të botohet nga shtypshkronja S. C di Propaganda Fide në Romë, më 1706 në dy versione, në gjuhën latine dhe atë shqipe.

Mbajtja e këshillit fetar të parë kombëtar në vitin 1703 dhe vendimet e mara në të shënuan ndryshimet rrënjësore në veprimtarinë e klerit për çështje dogmatike, morale e kanunore, të cilat duhet të respektoheshin nga të gjithë. Në të shtrohen çështje të ndryshme të jetës shpirtërore shqiptare të kohës, duke u shndërruar kështu në burim të rëndësishëm për historinë e popullit shqiptar, veçanërisht ajo e fillimit të shekullit XVIII.

## **II. 2 Vendi i tekstit të Kuvendit të Arbënit në kuadër të teksteve të vjetra dhe rëndësia e tij e vendimeve të marra në të.**

*Kuvendi i Arbënit* zë një vend të rëndësishëm në historinë e shkrimit të shqipes, krahas teksteve të vjetra të shqipes. Edhe pse është përkthim i një teksti të shkruar fillimisht në gjuhën latine, ky tekst shënon një hap përpara në përdorimin e shqipes së shkruar me funksione të reja e të rëndësishme, shkruan Ismajli.<sup>41</sup> Më tej Ismajli në lidhje me tekstin e Kuvendit të Arbënit shprehet duke thënë: “*Deri tani nuk njohim ndonjë përdorim të shqipes në funksion të ndonjë traktati që i kapërcen kufijtë e traktatit fetar dhe shtrihet edhe në trajtime të marrëdhënieve shoqërore midis institucioneve të ndryshme fetare dhe midis vetë banorëve të truallit shqiptar. Në këtë kuptim ai shkon më larg se të gjitha tekstet e autorëve të mëparmë*”.

Me të drejtë studiues,<sup>42</sup> kanë pohuar se pas Budit, vepra më e plotë e shqipes së shekullit XVII është vepra fetare –filozofike “*Çeta e profetëve*” e Pjetër Bogdanit. Vepra e Bogdanit, si nga gjuha ashtu dhe nga përmbajtja, i kapërcen kufijtë e një teksti thjesht fetar. Prandaj me të drejtë thuhet se me të, merr zhvillim shqipja letrare e vjetër duke vazhduar më tej deri në shekullin XIX, shekull që shquhet për ndryshime të rëndësishme shoqërore, pra dhe gjuhësore. Siç u tha më sipër, shqipja letrare mbetet e mbyllur në rrethin e ngushtë të së folmes së secilit autor, i cili merrte përsipër të shkruante shqip. Buzuku e kufizoi me të folmen e Krajës dhe të rrethit të Shkodrës, Bardhi me të folmen e Zadrimës, te Budi kemi atë të Matit, te Matrënga

---

<sup>41</sup> *Gjuha shqipe e Kuvendit të Arbënit*, vep. cit. f. 11

<sup>42</sup> Ismajli, po aty, f. 12, Anila Omari, vep. cit. f. 3 etj.



arbërishtja e Sicilisë, ndërsa te Bogdani me origjinë nga Hasi, vërehet afrimi i dy varieteteve të gegërishtes veriore.

Sipas K.Topallit<sup>43</sup> dhe R.Ismailit<sup>44</sup>, duke cituar këtë të fundit “*teksti i Kuvendit të Arbënit ndjek një rrugë të përafërt me atë të Bogdanit, madje për shumë gjëra edhe modelin e tij. Gjuha e Kuvendit jo gjithnjë qëndron në nivelin e Çetës së profetëve, megjithatë, me fjalinë e gjatë, me tipin e shkrimit shumë të përhapur në botën latino - romane të kësaj kohe, ai është vazhdues i denjë i rrugës së Bogdanit. Edhe nga funksioni i shkrimit ky tekst konsiderohet i gjërë për faktin se nuk është tekst thjesht fetar, po përmban elemente të organizimit shoqëror, elemente të rrëfimit, etj.. Në këtë drejtim tekstit të Kuvendit i takojnë dy merita të rëndësishme që i takojnë edhe tekstit të Çetës: merita për kontributin në qëndrueshmërinë (stabilizimiin) e shkrimit të shqipes duke ndihmuar stabilizimin e shqipes letrare të periudhës së hershme në kuadrin e variantit verior dhe merita tjetër për ndihmesën në zgjerimin e përdorimit të kësaj gjuhe në nivel standardi”.*

S. Mansaku<sup>45</sup> tekstin e Kuvendit të Arbënit e sheh si një hallkë të rëndësishme të historisë kulturore dhe gjuhësore që lidh fundin e mesjetës shqiptare me fillimet e Rilindjes Kombëtare. I të njëjtit mendim duket se është dhe studiuesi K.Topalli, i cili e konsideron këtë tekst si urë lidhëse ndërmjet shqipes së vjetër dhe së re.<sup>46</sup> Sh. Demiraj<sup>47</sup> pohon, se përkthyesi i tekstit të Kuvendit është ndikuar shumë nga gjuha e shkrimtarëve të Veriut të shekullit XVII, si nga gjuha e Budit dhe veçanërisht nga ajo e Bogdanit. Për një ndikim të tillë të fuqishëm, sipas Demirajt, dëshmojnë përdorimi i të njëjtit alfabet, shenjimi i zanoreve të gjata me të njëjtën mënyrë, d.m.th me dyfishimin e shkronjave përkatëse e shumë veçori të tjera të cilat do të vërehen më imtësisht në vijim të punimit tonë, në një kapitull të veçantë mbi grafisë dhe alfabetin.

Krahasuar me tekstet e tjera të vjetra, teksti i Kuvendit të Arbënit, si më i rëndësishmi në gjysmën e parë të shekullit XVIII, dhe i vendimeve të marra në të kanë rëndësi pikë së pari historiko – kulturore. Tërësia e materialeve të tekstit ka të bëjë kryesisht me gjendjen e kishës katolike në fillim të shekullit XVIII. Në dekretet e Kuvendit janë vendosur materialet që merren me çështje të propagandës së fesë, gjë që duhej të ishte e përqëndruar dhe e organizuar për t’i bërë ballë islamizimit dhe për të frenuar procesin e asimilimit të plotë.

---

<sup>43</sup> *Kuvendi i Arbënit*, vep.cit.f. 115

<sup>44</sup> Ismajli, vep. cit. f. 13

<sup>45</sup> Vep.cit.f. 105

<sup>46</sup> Vep.cit.f. 127

<sup>47</sup> *Kuvendi i Arbënit 300 – vjetori*, Lezhë 2007. f. 21

Teksti i Kuvendit mbetet një burimi rëndësishëm për historinë e gjuhës shqipe, zhvillimin e leksikut dhe në veçanti për historinë e huazimeve në tekst, sidomos përse i përket shkallës së integritit të huazimeve turke, orientale e ato sllave.

Për historinë e kulturës shqiptare teksti në fjalë ka rëndësi për faktin se në të thuhet diçka edhe për funksionet sociale të shqipes, për nevojën e përdorimit të shqipes në ushtrimin e detyrave kishtarë, gjëra që ishin shkruar edhe më herët nga priftërinjtë shqiptarë, por që këtë herë marrin formën dhe forcën e fjalës së një *Kuvendi* të miratuar dhe të botuar nga Propaganda Fide. Për këtë arsye ky tekst pati përhapje të gjerë dhe duhet të ketë ndikuar në mënyrë të ndjeshme në historinë e kulturës dhe gjuhës shqipe. Sipas Malajt<sup>48</sup> dhe R. Ismajlit, mbi bazën e dokumenteve të kohës kanë zbuluar se teksti i Kuvendit, me nismën për botimin latinisht e shqip, ka shërbyer si libër mësimi për shkollat e Kurbinut, Pedhanës si dhe për nxënës e studentë të Kolegjeve të Romës që përgatishnin misionarë për Shqipëri. Pikë së pari synohej ardhja në ndihmë klerikëve katolikë shqiptarë të kohës, pasi siç u tha dhe më lart kisha katolike nën sundimin osman kishte pësuar dëme të mëdha, duke përfshirë dhe prapambetjen kulturore të vetë klerit. Ai madje depërtoi dhe te famullitarët, e në këtë mënyrë edhe te ata pak njerëz që dinin shkrim e lexim. Ishte fillimi i shekullit XVIII, idetë e ndritura të Rilindjes Evropiane, kishin depërtuar dhe në dheun e Arbënit. Dihet tashmë se humanistët i kushtonin rëndësi të veçantë dijes dhe shkollimit për të ndriçuar mendjen e njerëzve, duke ndihmuar kështu në ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare, si dhe në predikimin e besimit e krishterë, jo vetëm në gjuhën latine si gjuhë e Kishës, por dhe në gjuhët amtare. Të gjitha këto ide tipike humaniste përshtojnë të gjitha veprat e autorëve të vjetër që nga Buzuku deri te Kazazi, duke përfshirë dhe Kuvendin e Arbënit. Çdo hap që hidhej, çdo masë që merrej për të ndihmuar popullin e krishterë, ndonëse në funksion të forcimit të pozitave të krishtërimit, çonte në ruajtjen e besimit, gjuhës dhe zakoneve të të parëve.

Lidhur me nevojën e përkthimit të akteve të Kuvendit në gjuhën shqipe kemi disa të dhëna, shkruan Malaj.<sup>49</sup>

Në një letër Zmjeviç shkruan: *“Injoranca e Klerit është rrënimi i popullit. Njëri dhe tjetri vihen në provë në Shqipërinë e varfër. Me celebrimin e Koncilit, vizitatori ka rregulluar aq sa ka patur mundësi, por meqë pak e kuptojnë gjuhën latine, e ka përkthyer dhe në gjuhën shqipe për t'i ardhur në ndihmë injorantëve. Pas*

---

<sup>48</sup> Vincenz Malaj, *Kuvendi i Arbënit, 1703*, botimi i dytë, Shoqata “Don Gjon Buzuku, Ulqin-Tuz, 1999. Në fakt ky punim është përkthim nga Tonin Zadeja, i *Concilio nazionale Albanese del 1703. Inquadramento storico, testo Albanese e glossario*. Università di Roma, Facoltà di lettere e filosofia, Corso di laurea in lettere, tesi di laurea, anno accademico 1971- 1972.

<sup>49</sup> Vep.cit.f. 100

*redaktimit të nevojshëm, ëshët e domosdoshme të botohet dhe ekzemplarët t'u dërgohen të gjithave kishave ët Shqipërisë dhe të Serbisë*". Por, nga ana tjetër me botimin i këtij teksti fillimisht latinisht e më pas edhe në gjuhën shqipe vazhdonte më tej tradita e vjetër për të botuar libra fetarë në gjuhën shqipe, traditë e nisur me Buzukun dhe e zhvilluar më tej me Budin e Bogdanin, Bardhin, Kazazin etj.

Teksti i *Kvendit*, sipas Ismajlit<sup>50</sup> duke mbajtur vulën e një traktati që ka për qëllim pajtimin e palëve të grindura të katolikëve shqiptarë, vulën e mjetit që bart mendimin dhe idetë e Papës së shenjtë lidhur me të mirën e shqiptarëve, duke pasur firmën e Zmajeviçit, pati mundësi të përhapet shumë dhe mbase më shumë se vetë Çeta e Profetëve dhe kjo falë rëndësisë jetike të këtij teksti.

### **II. 3 Botimi dhe ribotimet e tekstit të Kuvendit të Arbënit**

Siç u tha më sipër, vendimet e Kuvendit të Arbënit, u përmblohdhën në një tekst të vetëm, të botuar në Romë në vitin 1706. Teksti u botua në dy versione, në gjuhën latine dhe në gjuhën shqipe. Botimi latinisht mban titullin:

***Concilium Provinciale sive Nationale Albanum  
Habitum anno MDC CIII. Clemente XI Pont. Max. Albano.***

*Marca Tipografica Romae Typis Sac. Congregationis de Propaganda Fide.  
Anno MDCCVI. Superiorum Permissu.*

Versioni shqip i materialeve të Kuvendit të Arbënit u botua në të njëjtën kohë, po në Romë, me këtë titull:

***Koncilli provincially o Kuvendi i Arbënit Mbljeçune nde vjet gnai  
mije stat cind e tre Ndene Klementit i Gnimiçetmi Pape pretemaçit.***<sup>51</sup>

Si versioni shqip dhe ai latin përmban jo vetëm dekrete të ndarë në kapituj, për të cilët do flasim në veçanti, por dhe letra e Zmajeviçit dërguar Papë Klementit XI. Në këtë letër *Scruem nde Perastit nde çiet ditt Korricchit. Mbe Viette Criscit gnaj mije sctat cint e trë: Maa te Lumit Atit Clementit XI. Pape Pretemaçit. Visk Zmajevicchi Archiupesckup i Ntivarit. Me te prugnete ndighimi chi i duhet,*

---

<sup>50</sup>Vep.cit.f. 19

<sup>51</sup> Një përshkrim të hollësishëm të botimit të parë të akteve të Kuvendit ka bërë Ismajli, vep.cit. f. 29-34, kështu që nuk po ndalemi më gjatë.

shprehet qartë dhimbja dhe hidhërimi për gjendjen e mjeruar të krijuar në Arbëri nga sundimi i gjatë osman si dhe ndihma që i kërkohet papës për të shpëtuar nga vuajtja ata që kanë të njëjtën origjinë me Papën.<sup>52</sup> Në vijim po japim pjesën e parë të letrës, atë që Ismajli e quan si pjesa që mbart atmosferën e besimit, të dashurisë dhe të emocionalitetit.<sup>53</sup>

*Urçenove o i lumscimi Ati, Kinese me teviëituemit Apostolike te vee roe mbii kisciat t Arbeniise Provintiese sime. Ndighiova urçenit: Suoła çene; Kercova Ruëulimin; pae plagat e tii. Pae (uh te çimbtunit) vum ndene haraccin atà , chi gni here kiè Dispoti i Provintiavet. Sognene e grindevet ngremuem me t'izunit se çimbtunit: Schi tin e Trimavet sciaa.: murin, e meteriein e forzese sane reenuem. Pae gindete hiim nde vend te sceninimite H it: Kisciate feligete; literet pegaam: mei pae vend ku te mundehi Populi meu mblicune nde panegi ri. Pae plecchiete tue ulleruem; Mescetaret scerbetoret e H it tue gimuem; Ciobante vuram; tretune çente, tue u perdaam d uçave: murtaine, chi paa misceriere corovitin giçç, e plassien e mortaissune, chi per te ghiane, e per te ghiat trimenohei. Ketò pae, e gimova. Uperziine sckafete e mii per te çimbtuni populit tim, e me'uschiuerin nd'atò travaja te biivet, chi pò mb teicine.*

Është një tekst interesant si për sa i përket organizimit ashtu dhe përmbajtjes. E gjithë letra përshkohet nga tensioni dhe emocionaliteti i i lartë që shprehet me anë të mjeteve stilistikore aq mirë të shfrytëzuara nga Zmajeviçi.

Megjithatë, ndërmjet tekstit latin dhe atij shqip vërehen ndryshimet e mëposhtme:

- 1) në tekstin shqip indeksi është vendosur në fund, kurse në atë latin në fillim.

- 2) në tekstin shqip mungojnë dy letra lidhur me çështjet e kufijve të ipeshkive dhe famullive. *Litterae Instrumentales decisivae Confinium inter Episcopatum Alexiensem, et Archiepiscopatum Dirrachienseni* dhe *Littereae Instrumentales decisivae Confinium inter Episcopatum Sappatensem et Alexiensem*.

- 3) po në tekstin shqip mungojnë firmat e pjesëmarrësve në Kuvend dhe disa fragmente të cituara nga veprat e autorëve.

Vendimet e temave të diskutuara në Kuvend, ndryshe dekretet përbëjnë boshtin kryesor të botimit. Ato janë ndarë në katër pjesë të mëdha dhe vetë këto pjesë ndaheshin në kapituj të vegjël secili me përmbajtje të ndryshme.<sup>54</sup> Pjesa e parë

---

<sup>52</sup> Për më shumë mbi përmbajtjen e letërs dërguar Papës, një letër e organizuar mirë dhe stilistikisht koherente, shih Ismajli, *Kuvendi i Arbënit*, vep.cit. f. 212-214

<sup>53</sup> Ismajli, po aty. f. 213

<sup>54</sup> Mbi përmbajtjen dhe problematikën e secilit kapitull të shihet Malaj, vep.cit. f. 113-128

përmban çështje që lidheshin drejtpërdrejt me forcimin e propagandës, rregullat e ushtrimit të fesë. Një tjetër çështje me rëndësi mbetet dhe ajo e trajtimit të sjelljes së katolikëve, të cilët, nën presionin e vazhdueshëm të rrethanave nuk ruanin më ritet katolike gjithnjë e më shumë rrezikoheshin nga procesi i islamizimit. Siç shkruan dhe Ismajli<sup>55</sup>, pjesa ka ngjyrë dhe shprehje shumë të fuqishme ideologjike fetare.

Në pjesën e dytë ngrihen probleme të rëndësishme të administrimit dhe respektimit të jetës kishtare dhe kryerjen në mënyrë sa më të saktë të ceremonive e riteve fetare, rregullimin e marrëdhënieve mes myslimanëve, ortodoksëve dhe katolikëve. Pjesa e tretë mbetet më e rëndësishmja, pasi në të ngrihen çështje që i përkasin pronave të kishës, kufijve midis dioqezave dhe problemeve që lindnin me shkollimin e fëmijëve. Kjo pjesë siç u tha më lart ka rëndësi, sepse na njeh dhe na jep informacion jo vetëm mbi gjeografinë kishtare, por dhe mbi gjeografinë dhe toponiminë si një burim i rëndësishëm dhe i saktë për historinë. Pjesa e katërt i kushtohet detyrave që u takonin krerëve fetarë, organizimit dhe administrimit të mirë të klerit. Kjo pjesë është e njohur dhe për faktin se në të përmenden dhe dy shkollat fetare të Kurbinit dhe të Lezhës.

Teksti i Kuvendi të Arbënit është shumë kompakt për nga përmbajtja, pasi kemi të bëjmë me tekst fetar e ideologjik dhe mbi të gjitha normativ. Në të u morën vendime të rëndësishme që duhet të respektoheshin nga të gjithë. Për këtë arsye Ismajli e quan tekstin që përmban dekretet, si të natyrës normative-taksative. Megjithatë, të kësaj natyre nuk konsiderohen fjalët e Zmajevičit, dy letrat dhe fjala e mbajtur në kuvend, duke dalluar një lloj tjetër teksti, atë me karakter personal dhe të natyrës ndërkomunikuese. Ky tekst shënoi një kthesë të madhe historike të popullit dhe pati rëndësi për historinë kishtare shqiptare, pasi në të janë shtruar çështje të jetës shpirtërore shqiptare. Nga ana tjetër në të gjejmë emra klerikësh të

---

Pjesa e parë e përmban dhjetë kapituj: De professione fidei; De apostatis; De Christi fidelibus qui licet Fidem non eiurarunt, publice tamen Mahometicam sectam, et secreto christianam religionem profitentur; Per quid dignosci debent fideles ab infidelibus? De fidei rudimentis; De verbi Dei predicatione; De festorum observantia; De sacris ieiuniis, eorumque observantia; De Quadragesimali ieiunio; De iuramento falso. Pjesa e dytë përmban nëntë kapituj: De sacramentis; De baptismo; De confirmatione; De poenitentia; De eucharistia; De extrema unctione; De sacramento ordinis; De sacramento matrimonii; De eliminandis illicitae coniunctionis abususibus. Pjesa e tretë përmban dymbëdhjetë kapituj: De episcopis; De visitatione; De modo certiorandi sacram Congregationem de Propaganda Fide de statu propriae diocesis; De confiniis Diocesum sappatensis, alexiensis, et albanensis; De finibus episcopatus pullatensis; De regione posterippensis; De famillis fidelibus, ex una in alteram dioecesim proficiscentibus; De ecclesiis eorumque cultu; De altaribus sub dio positis; De missa parochiali; De sacra supellectili; De coemeteriis et sepulchris. Pjesa e katërt përmban gjashtë kapituj: De parochis, De curatorum proventibus eorumque recta et oeconomica administratione; De alumniis sacrae congregationis de Propaganda Fide; De patribus missionaribus; De schola corbinensi et alexiensi; De consulendo communibus provinciae necessitatibus.

<sup>55</sup> Vep.cit.f. 43-44.

njohur për kohën, njihemi me gjendjen e kishave e të manastireve të rrënuara, vuajtjet e besimtarëve katolikë.

Në këtë mënyrë shihet qartë, se tekstet e vjetra nuk i shërbejnë vetëm historisë së gjuhës, por mbi të gjitha ato janë burim i rëndësishëm për historinë e popullit shqiptar. Në to përfshihen letërsi, kulturë, etnografi, art, filozofi dhe politikë.

Kuvendi i Arbënit, për rëndësinë që pati u ribotua disa herë duke njohur disa botime të mëvona, si në gjuhën shqipe ashtu dhe në atë latine. Sipas disa dokumenteve që përmend Malaj, arkipeshkvi i Tivarit ka kërkuar një herë 200 kopje në gjuhën shqipe dhe 150 në gjuhën latine dhe një herë tjetër 200 kopje në gjuhën latine, 200 në gjuhën shqipe. Dokumentet përmendin një kërkesë për librat shqiptarë si dhe studentët e Shën Pjetrit në Montorio dhe të Shën Bonaventurës në Isola të Romës.<sup>56</sup>

Materialet e Kuvendit të Arbënit u botuan për herë të dytë më 1868 nga Propaganda Fide në Romë.

Botimi i dytë latinisht ishte më se i nevojshëm. Botimi i tij ka të bëjë me interesimin e Propagandës për gjendjen e katolicizmit në trojet shqiptare. Kjo gjë duket në dekretin e botuar që në fillim:<sup>57</sup>

*“Cum exempla Concilii Provincialis Albani, quod celebratum fuit anno 1703 edita iussu Sacrae huius Congregationis anno 1706 iam pene defecerit, eaque ad Ecclesisticam disciplinam in Epiri Ecclesiis conservandam, valde conducere videantur, Sas, Congregatio, referente Emmo ac Rmmo D. Cardinali Borgia Praefecto, censuit ac decrevit, eadem Albanam Synodum typis ac sumptibus Sacrae Congregationis iterum esse excudendam.*

*Datum ex Aedibus dictae Sac. Congregationis die 26 Martii 1803.*

*S. Card. Borgia Praef. Dominicus Archiep. Myren Secr. ”*

Që nga data e dekretit, viti 1803 e deri në 1868 u deshën pra 65 vjet që ky urdhër të zbatohet. Ky botim del i plotësuar me disa shtesa ku përmbahen materiale të ndryshme.<sup>58</sup> Këtij botimi, mendojmë t'i bëjmë një përshkrim të hollësishëm, pasi është dhe botimi tek i cili jemi mbështetur dhe do të shfrytëzojmë materialin gjuhësor.

Botimi i dytë i versionit shqip të materialeve të Kuvendit të Arbënit doli në të njëjtin vit në Romë nga Propaganda Fide. Këtë herë nën kujdesin e priftit

---

<sup>56</sup> Malaj, po aty. f. 155

<sup>57</sup> Shuh botimin e dytë latinisht të Kuvendit.

<sup>58</sup> Këtu nuk po ndalemi më shumë pasi janë dhënë me hollësi nga Ismajli. Vep.cit.f. 35-37

katolik nga Shkodra, Atë Engjëll Radoja, një figurë e dalluar në qarqet fetare katolike të shekullit XIX. Ky botim doli me titullin:

*Concilli Provintiaali o Cuvendi i Arbenit*, ndërsa në faqen e brendshme me pak ndryshime nga botimi i parë:

*Cuvendi i Arbenit o Concilli Provintiaalli mbelieçune viettit mije stcat cint e tre ndene Schiptarin Clementin XI Pape pretemaçin. E d ta sctamp. Nde Rome prei Cuvendit sceit te Propagandes t'çhi runit prei hortakut Eotniis Pietrit Marietti 1868.*

Sipas Ismajlit ndryshime ka si në radhitjen e titullit, ashtu edhe në disa elemente të tjera grafike, ortografike dhe gjuhësore.<sup>59</sup>

Faqja IV është bosh, ndërsa në faqen V botohet Dekreti i vitit 1703 latinisht. Tekstet e letrave të Zmajevicit fillojnë me letrën drejtuar Papë Klementit XI, e cila është në faqen VII. Këto letra vijojnë deri në faqen XVI, ndërsa *Dekreti o ligja* fillon me faqen 1 dhe vazhdon deri në faqen 85. Këto faqe përbëjnë të gjithë tekstin e vendimeve të Kuvendit të Arbënit. Faqja 86 është e zbrazët, ndërsa në faqet 87- 162 janë përfshirë *Dissaa emernaame dallun prei Romet mas Concillit ci perkassin Kiseve t'Scci pnüs i kaa citt scci p Don Egnell Radoja, prift' i Diocesit Sckodrs.*

Në fund është dhënë *Tefteri* (tryza e lëndës) dhe imprimatura e Fr.Raph.Arch.Salini Ord.Praed.S. P.A.Mag.Socius dhe e Ioseph Angelini Vicesgerens.

Për botimin e dytë që vendosur më 1867, kur Engjëll Radoja kishte nisur ta përkthente përsëri tekstin latinisht të Zmajeviçit, por këtë herë e botoi përkthimin e parë, duke shtuar edhe emërnamet, përkthyer prej tij. Bie në sy se edhe në botimin e dytë në gjuhën shqipe, Radoja ka bërë disa ndryshime të vogla në grafi, ortografi e në fund të faqeve ka dhënë shpjegime për fjalë të pakuptueshme ose huazime. Drejtshkrimi i Radojës fut shumë më tepër qartësi në shkrimin e shqipes me këtë alfabet dhe duke sjellë risi. Kështu Radoja në përkthimin e emërnameve, sidomos në përkthimin e ri të Kuvendit të Arbënit, përdor shenja diakritike për hundorësinë, për grupin bashkëtingëllor *nd* të reduktuar, i veçon qartë fonemat /q,gj/ nga /ç,xh/, bën dallimin e çifteve të anësoreve dhe të dridhëseve, etj. Disa nga risitë e tij grafiko - ortografike pasqyrohen edhe në botimin e dytë të përkthimit të parë të Kuvendit. Me këtë u fut pak qartësi në leximin e tekstit, por duke qenë se është përkthyer mbi bazë të së folmes së Shkodrës, teksti arrin të bëhet i pakuptueshëm nga ata të cilët i përkasin të folmeve të tjera.<sup>60</sup>

---

<sup>59</sup> Po aty.f. 37

<sup>60</sup> Ismajli, vep.cit.f. 38

Në vitin 1872 Engjëll Radoja botoi përkthimin e ri të materialeve të Kuvendit të Arbënit me këtë titull:

***Concillii çeut Scii pniis baamun n'viet 1703 n' coh t'Paps Scii ptarit Clementit t'gnimçetit. Disaa emernaame dallun prej Romet mas Concillit, ci perkassin kiseve t' Arbniis. I kaa citt scii p Don Egnell Radoja, Prift i Diocesit Sckodrs. N'Rom, në Sctamp t' Cuvenit S.t Propagands, 1872.***

Hollësi të mëtejshme për këtë botim jepen nga Prof. Rexhep Ismajli në librin e tij.<sup>61</sup> Në faqen 5 Radoja boton një letër drejtuar lexuesit: *Knuessit Mikut t'dasctunit, jet t'gjiat, e scnet prei sotit*, ku shpjegon arsyet e përkthimit të veprës duke vënë në dukje vështirësitë që dilnin nga përkthimi i parë. Kështu, ai vendos ta përkthejë në të folmen e Shkodrës duke dhënë arsyet pse ka zgjedhur pikërisht këtë të folme. Më shumë detaje lidhur me këtë, gjenden në veprën e Ismailit.<sup>62</sup>

Më poshtë R. Ismajli vazhdon me rëndësinë e botimit dhe përkthimit të ri të materialeve të Kuvendit të Arbënit nga Engjëll Radoja më 1872. Sipas tij kanë rëndësi për disa arsye:

1. Radoja njihte shumë mirë latinishten. Pra, nuk ekzistonte mundësia e keqinterpretimit të tekstit.
2. Si folës i shqipes ishte plotësisht burimor, madje njohës i mirë i shqipes së folur popullore, prandaj tekstin latinisht e kthen në gjuhën shqipe me saktësi të madhe. Si i tillë, teksti mund ta kryente funksionin e vet, sepse i përshtatej shtresave të ndryshme të besimtarëve.
3. Edhe pse me kulturë të lartë gjuhësore, ai jep një pasqyrë shumë të qartë të përdorimit të turqizmeve në gjuhën popullore, madje dhe në terminologjinë fetare.
4. Ndhimesa e tij shihet në përsosjen e alfabetit të shqipes së vjetër, e bashkë me të edhe të drejtshkrimit.

Ky version i ri i tekstit të Kuvendit nga E. Radoja rëndohet nga synimi shkodranizues. Jo vetëm Radoja, por dhe Bogdani e të tjerë autorë të mëvonshëm, përfshirë këtu dhe autorë të shekullit XIX dhe fillimi i shekullit XX shkruanin në gjuhën e vendit të origjinës, duke u munduar të përshtasnin një gjuhë sa më popullore duke penguar zhvillimin e gjuhës letrare. Shkak për këtë bëhej dhe qëllimi i shkrimit të këtyre veprave, qëllimi fetar. Ndërsa lëvizja tjetër, ajo e Rilindjes, që me të vërtetë ndihmoi në zhvillimin e gjuhës letrare, ofronte një program shumë më të gjërë, të shkëputur nga interesat fetare.

---

<sup>61</sup> *Gjuha shqipe e Kuvendit të Arbënit* (1706), vep.cit. f. 39

<sup>62</sup> Po aty, f. 39



Fakti që materialet e Kuvendit të Arbënit njohën shumë botime, sipas Ismajlit, tregon se kërkesa për libra shqip ishte shumë e madhe dhe se pati rëndësi për zhvillimin e shqipes letrare, megjithëse funksioni i tij ishte mjaft i kufizuar, ai fetar. Kjo nuk mund të thuhet për shumë tekste të vjetra që u botuan vetëm një herë dhe që nuk gjendeshin lehtë, me gjithë vlerën gjuhësore e letrare.<sup>63</sup>

## II. 4 Studimet e deritanishme të tekstit

Duke qenë ngjarje me rëndësi për historinë shqiptare të shekullit XVIII dhe njëherësh materialet e tij të rëndësishme në kuadër të teksteve të vjetra të shqipes, *Kuvendi i Arbënit*, është bërë objekt studimesh të ndryshme. Në pjesën më të madhe të studimeve objekt kanë qenë çështje të karakterit historik, si rrethanat e mbajtjes së Kuvendit, pjesëmarrësit, objektivat e kuvendit, rrethanat e tjera historike e kulturore të kohës, veçanërisht rrethanat kishtarë. Megjithatë, në një numër jo të vogël studimesh objekt hulumtimi ka qenë gjuha e Kuvendit të Arbënit dhe shkrimi i tij.

Në pjesën më të madhe të rasteve, teksti i Kuvendit të Arbënit nuk është parë nga studiuesit në tërësinë e tij, por vetëm mbështetur në ndonjë fragment të tij dhe jo të gjithë tekstin duke çuar në përfundime jo të sakta.<sup>64</sup> Nga ana tjetër gjëja e mirë në këtë rast, është se teksti ynë është parë në raport me tekstet e tjera të vjetra. Një përmbledhje të studimeve të deritanishme ka bërë R. Ismajli<sup>65</sup>, të paktën deri në vitin kur është botuar libri i tij.

Paraqitja e parë më e përmbledhur bëhet në tekstin "*Shkrimtarët shqiptarë*" I-II, të botuar në Tiranë më 1941, ku jepen shënime për botimin, për Kuvendin, për Zmajeviqin, për Klementin XI, etj. Disa shënime të vogla jepen për gjuhën, e kjo ndiqet dhe nga një fragment i transliteruar. Këto shënime janë të njohësit të mirë të autorëve të vjetër, Justin Rrota.<sup>66</sup>

Në fushën e historiografisë të rëndësishme mbeten studimet e Georg Shtadtmylerit<sup>67</sup> dhe të Peter Bartëlit<sup>68</sup>. Shtadtmyleri bën një paraqitje pozitive

---

<sup>63</sup> Po aty, f. 41

<sup>64</sup> Angela Cirrincione, *Sintassi degli antichi scrittori albanesi*, Roma, 1968  
E. Cabej *Meshari i Gjon Buzukut*, Tiranë 1968.

<sup>65</sup> Vepër e cituar më parë f. 48

<sup>66</sup> *Shkrimtarët shqiptarë, I, II*, Tiranë 1941, f. 61-64.

<sup>67</sup> G. Stadtmüller "*Das Albanische Nationalkonzil vom Jahre 1703*" në *Orientalia Christiana Periodica* 22, 1956 f.68-91.

lidhur me kuvendin dhe rëndësinë e tij në historinë kishtarë të shqiptarëve, por nga ana tjetër nuk është shprehur mbi qëndrimet e kishës kundrejt viseve shqiptare. Bartëli ka merita të veçanta për botimin e materialeve të ndryshme sidomos për botimin e dy vëllimeve të letrave dhe të dorëshkrimeve të Zmajevičit. Këto botime përmbajnë të gjitha shënimet e nevojshme dhe origjinalin italisht me nga një parathënie të autorit. Një pjesë e mirë e këtyre shënimeve janë shfrytëzuar më parë nga Malaj, si dhe nga të tjerët që janë marrë me tekstin, por ato kanë qenë të panjohura për publikun dhe epër studiuesit që nuk kanë pasur mundësi t'që punojnë në bibliotekat e Vatikanit.<sup>69</sup>

Kolë Ashta më 1957 botoi një studim të vogël për gjuhën dhe alfabetin e materialeve të Kuvendit të Arbënit.<sup>70</sup> Ky studim përmban përshkrime të sipërfaqshme të grafisë së autorit, pa bërë përpjekje për t'i parë çështjet thellë-thellë, sidomos kur vjen puna te disa grafi problematike, të cilat kërkojnë më shumë qartësi.

Më 1978 i njëjti autor nisi të botojë punimin me rëndësi: “*Leksiku i nxjerrë nga Kuvendi i Arbënit (në botimin e parë më 1706)*”, në revistën *Buletin shkencor të Shkodrës*.<sup>71</sup> Në këtë studim thjesht leksikologjik Ashta nuk është marrë thjesht me nxjerrjen e leksikut të veprës dhe në radhitjen e tij sipas alfabetit, po shtrihet edhe në analiza e shpjegime të ndryshme për origjinën e fjalëve dhe përdorimin e tyre në tekst. Autori bën dhe diçka me rëndësi, atë të nxjerrjes së shtresave leksikore në tekst. Ai veçon mirë fjalët shqipe dhe fjalët me burim nga gjuha sllave, ajo turke, greke etj.<sup>72</sup> Pastaj, nxjerr shembuj me kontekst bashkë me origjinalin latinisht, duke dhënë ndonjëherë edhe ndonjë koment për grafinë. Si përfundim mund ta konsiderojmë si një punim serioz e shterues, por mbi të gjitha me rëndësi, sepse në të është hedhur një vështrim i përgjithshëm mbi gjuhën e Kuvendit nga aspekti leksikor, duke na lejuar të bëjmë bëjmë krahasime me leksikun e Buzukut e të autorëve të tjerë studiuar dhe këta në të njëjtën mënyrë po nga Ashta.

Dizertacioni i Vinçenc Malajt,<sup>73</sup> mbetet pa dyshim një nga studimet më serioze lidhur me *Kuvendin e Arbënit*. Sipas Ismajlit<sup>74</sup> ky studim është i ndarë

---

<sup>68</sup> *Quellen und Materialien zur albanischen Geschichte im 17 und 18 Jahrhundert* eiesbaden 1975, I dhe II 1980

<sup>69</sup> Ismajli, vep.cit.f. 49

<sup>70</sup> *Shenjime mbi vokalizmin në veprën Kuvendi i Arbënit*, Buletin i Institutit Pedagogjik, Shkodër 1/1957 f. 45-54

<sup>71</sup> Kolë Ashta, *Leksiku i plotë i veprës Kuvendi i Arbënit*, Buletini shkencor, Shkodër, 1978 Nr. 1-2, 1979 Nr. 1-2, 1980 Nr.1-2, 1981 Nr.1-2.

<sup>72</sup> Për më shumë mbi huazimet në tekstin tonë do të flitet në kapitullin VI të punimit tonë.

<sup>73</sup> *Kuvendi i Arbënit, 1703*, vep.cit.

në dy libra. Në librin e parë bëhet inkuadrimi i Kuvendit kombëtar ku studiohen rrethanat historike– kulturore e letrare të *Kuvendit* dhe para mbajtjes së tij, përmbajtja e tekstit, vendimet e Kuvendit, jeta dhe veprimtaria e Papës dhe sidomos e Zmajeviçit, botimet dhe ribotimet e materialeve të Kuvendit, përmbajtja në mënyrë të detajuar, çështja e autorit të versionit shqip, etj. Në këtë pjesë autori është marrë edhe me gjuhën e këtyre materialeve dhe është përpjekur që në rreth 50 faqe të japë një pasqyrë të plotë të grafisë, të sistemit fonetik pa harruar të përmendim dhe disa vëzhgime të rëndësishme gramatikore jo vetëm në rrafshin fonetik, por dhe në atë morfologjik, ndonëse jo në mënyrë shteruese.

Po sipas Ismajlit, në pjesën e dytë autori ka bërë transliterimin e tekstit të plotë dhe ka nxjerrë leksikun e tekstit të *Kuvendit*.

Dizertacioni i Malajt është studimi i parë që sheh Kuvendin e Arbënit në tërësi si tekst dhe si ngjarje historike. Për këtë gjë autori ka shfrytëzuar një material jashtëzakonisht të pasur dhe të gjërë në arkiva jo fort të lehta ku mund të kërkosh. Me shumë origjinalitet ka përshkruar rrethanat e mbajtjes së Kuvendit dhe rrethanat e botimit të tij. Pjesa ku analizon gjuhën, ndonëse jo me shumë hollësi, mbetet me rëndësi për analizat fonetike me karakter sinkronik dhe atë diakronik .

Dizertacioni i Malajt ka rëndësi për ata që merren me studimin e tekstit të Kuvendit të Arbënit, sepse sjell një bibliografi të bollshme, materiale arkivore të rëndësishme.

Me gjithë punën e bërë, teksti i Kuvendit të Arbënit kërkonte hulumtime të mëtejshme në rrafshin historik, kulturor, e gjuhësor. Për ta thelluar më tej njohjen e këtij teksti në këto drejtime, Rexhep Ismaili si studiues i teksteve të vjetra, ka ndërmarrë një studim filologjik e gjuhësor në veprën e tij “Gjuha shqipe e Kuvendit të Arbënit (1706), vepër e cituar disa herë më lart.

Në punimin e R. Ismajlit, tekstit të Kuvendit i është bërë një analizë e shumëanshme filologjike, gjuhësore dhe historike, duke u kombinuar vështrimi historiko-filologjik me vështrimin e mirëfilltë gjuhësor.

Pasi flet për rrethanat historike e kishtare në të cilat u mbajt Kuvendi, autori bën një paraqitje të hollësishme të përmbajtjes së tekstit, në gjuhën latine dhe atë shqipe. Studiuesi nuk lë pa përmendur botimet e tjera të tekstit të

---

<sup>74</sup> Vep.cit.f. 50. Në fakt Ismajli i është referuar botimit origjinal të Malajt, *Concilio nazionale Albanese del 1703. Inquadramento storico, testo Albanese e glossario*. Universita di Roma, Facoltà di lettere e filosofia, Corso di laurea in lettere, tesi di laurea, anno accademico 1971-1972. Ne i kemi referuar përkthimit të këtij libri nga T. Zadeja dhe në të nuk është përfshirë libri i dytë.

Kuvendit, duke treguar dhe arsyet që çuan në ribotime, të cilat i sheh si pasojë e kërkesave të shumta për këtë tekst.

Në një kapitull të veçantë me titullin “Grafia”, mes të tjerash, krahas analizës së kushteve historike kur nisi të shkruhej shqipja, autori është përpjekur të tregojë arsyet që bënë të mundur që në shkrimet e vjetra të mbizotëronte alfabeti latin. Sipas autorit arsyet që përcaktuan përdorimin e alfabetit latin në tekstet e vjetra lidhen me destinacionin kryesisht fetar të këtyre teksteve.

Në kapitullin “Gjuha dhe alfabeti”, autori kalon në punën e mirëfilltë filologjike dhe duke sqaruar problemet që nxjerr grafia e teksteve të vjetra, ka dhënë në mënyrë të përmbledhur dhe sistemin fonetik të latinishtes, duke vënë përballë sistemin fonetik të shqipes. Duke analizuar sistemin e bashkëtingëlloreve dhe të zanoreve studiuesi vëren se sistemi fonetik i kësaj periudhe është pothuajse i njëjtë me atë të shqipes së sotme dhe *“se gegërishtja veriperëndimore i kishte krijuar tiparet themelore të sistemit zanor që ka edhe sot: tiparin sipas buzorësisë dhe tiparin sipas gjatësisë”*. Nga vështrimi i imtë i sistemit grafik të tekstit, Ismajli arrin në përfundim se shkrimi i shqipes në këtë tekst paraqet një stabilizimi të dukshëm. Në të vihet re prirja drejt mënjanimi të dyshkronjave. Ismajli në punimin e tij, pasi krahason sistemin grafik të tekstit të Kuvendit dhe me tekstet e tjera përfundon duke thënë se teksti i kuvendit të Arbënit shënon një hap përpara edhe lidhur me ndarjen e fjalëve njëra nga tjetra, sidomos të fjalëve proklitike dhe enklitike, të nyjave, të parafjalëve etj., duke lehtësuar kështu identifikimin e njësive leksikore dhe duke ndihmuar në procesin e stabilizimit të shkrimit të shqipes.

Në një kapitull tjetër “Teksti i Kuvendit të Arbënit, llojet e tekstit” bëhet një analizë e përmbledhur e ndërtimit të tekstit, e organizimit të lëndës gjuhësore në lidhje me përmbajtjen. Me interes janë të dhënat dhe vërejtjet për përdorimin e kohëve dhe të mënyrave të foljeve, për vlerat dhe funksionet e tyre si edhe për çështje të stilit. Po në këtë studim autori ndalet dhe në një çështje tjetër siç është ajo e shtresëzimit të leksikut, punë e bërë nga K.Ashta, veprën e të cilit e kemi cituar. Për këtë arsye autori nuk ndalet shumë këtu, por kufizohet vetëm duke dhënë arsyet e numrit të madh të huazimeve nga gjuhë të ndryshme sidomos nga latinishtja kishtare apo italishtja si rezultat i vetë përmbajtjes së tekstit.

Në kapitullin e fundit *“Shqipja e Kuvendit të Arbënit nga aspekti dialektor”*, autori, duke u mbështetur në veçoritë fonetike, gramatikore e leksikore të tekstit, arrin në përfundimin se gjuha e këtij teksti i përket gegërishtes veriperëndimore.

Me të vërtetë ky mbetet një punim mjaft serioz për gjërësinë e analizës, kapjen e të gjitha çështjeve që përbëjnë interes, si në aspektin historik ashtu dhe në atë gjuhësor, studim që rrallë është bërë më parë për ndonjë vepër të

autorëve të vjetër, qoftë dhe më e rëndësishme se teksti i Kuvendit të Arbënit.

Një autor tjerër që është marrë me tekstin e Kuvendit të Arbënit është dhe Engjëll Sedaj. Në vitin 1998 ky autor boton librin me titull: *Papa shqiptar Klementi XI - Albani dhe Kuvendi i Arbënit*. Libri është i ndarë në dy pjesë. Në pjesën e parë autori flet për jetën dhe veprimtarinë e një arbëreshi, i cili pasi u emërua Papë, urdhëroi organizimin e Kuvendit të Arbënit. Në këtë pjesë rëndësi të veçantë u jepet motiveve për thirrjen e Kuvendit të Arbënit në 1703, organizimit të Kuvendit nga arqipeshkvi i Tivarit Visk Zmajeviçi, i caktuar në këtë detyrë nga Klementi XI – Albani si dhe vlerës së madhe historiko – kulturore dhe gjuhësore të këtij kuvendi.

Në pjesën e dytë kemi të plotë botimin e Kuvendit të Arbëni, përkthyer nga Engjëll Radoja, prift i dioqezës së Shkodrës në 1872. Ky është një përkthim i ri, i dyti përkthim nga E. Radoja, me titull *Concilli i Eeut Scçiðpniis*.

Engjëll Sedaj shprehet duke thënë se teksti i Kuvendit, pikërisht në përkthimin e fundit nga prifti shkodran E. Radoja në 1872, do të zgjojë një interes të lexuesi sepse dhe gjuha e këtij përkthimi është gjithsesi më e afërt me kohën tonë.

Për Kuvendin e Arbënit dhe rëndësinë e tij historike janë mbajtur disa simpoziume dhe tubime shkencore – kulturore. Më i rëndësishmi prej tyre mbetet simpoziumi shkencor në 300 – vjetorin e mbajtjes së tij. Ky tubim u zhvillua më 13 shtator të vitit 2003, në një kishë të Mynihut.

Ligjëratat dhe diskutimet e bëra në këtë tubim janë përmbledhur në librin “Kuvendi i Arbënit 1703”, botuar në Prishtinë në vitin 2004. Në këtë tubim, kanë marrë pjesë me diskutimet e tyre studiues të njohur të albanologjisë si Prof. Dr. Bardhyl Demiraj, drejtues i degës së Albanologjisë në universitetin “Ludëig – Maximilian” të Mynihut, Prof. Dr. Peter Bartl (Mynih), Prof. Dr. Zef Mirdita (Zagreb), Dr. Anton Berisha (Kozencë) etj..

Në ligjëratat e mbajtura është folur për Kuvendin, si faktor vendimtar në ngritjen e vetëdijes kombëtare shqiptare, për rëndësinë kulturore e letrare të akteve të Kuvendit në studimet albanologjike. Nuk është lënë mënjanë dhe aspekti teologjik, dogmatik, juridik e moral i Kuvendit.

Në simpozium nuk janë lënë pa u përmendur dhe dy ribotimet e akteve të Kuvendit: njërin të bërë nga Konferenca Ipeshkvore Shqiptare (Prishtinë 2003) ku janë përfshirë katër versione të akteve të kuvendit: versioni latinisht, përkthimi i parë shqip, përkthimi i dytë shqip, i botuar më 1872 nga At Engjëll Radoja, si dhe versioni i përshtatur në shqipen e sotme nga Anton Nikë Berisha. Botimi tjetër është ai i shtëpisë botuese “Shpresa”

(Prishtinë 2003), ku është përfshirë vetëm përshtatja e përkthimit të E. Radojës në shqipen e sotme.

Mbajtja e Kuvendit të Arbënit si një ngjarje me rëndësi në historinë kishtare, por dhe si tekst për historinë e gjuhës shqipe e tregon dhe simpoziumi tjetër ndërkombëtar me rastin e 300 –vjetorit të Kuvendit të Arbënit (1703-2003) organizuar nga Konferenca Ileshkvnore e Shqipërisë. Në këtë kuvend morën pjesë me kumtesat e tyre, studiues të fushave të albanologjisë, historisë së Shqipërisë, historisë kishtare, gjuhësisë dhe letërsisë nga Universiteti i Tiranës, Akademia e Shkencave e Republikës së Shqipërisë, nga Universiteti i Prishtinës, Universiteti i Shkodrës “Luigj Gurakuqi” studiues nga Gjermania, Kroacia dhe përfaqësues të selive ipeshkvnore të trojeve shqiptare.

## Kreu II

### Grafia dhe vërejtje gjuhësore në rrafshin fonetik

#### II.1 Alfabeti dhe veçoritë grafike të tekstit.

Në historinë e alfabetit të shqipes rëndësi të veçantë ka përshtatja e alfabetit latin në libra të shkruar në gjuhën shqipe. Përshtatja e alfabetit latin mendohet se i përket shekullit XIV dhe se në këtë periudhë ka fillimet tradita e shkrimit të librave në gjuhën shqipe.<sup>75</sup>

Përdorimi i alfabetit latin është vënë re dhe në dokumentet e para të shkrimit shqip si, “*Formula e pagëzimit*” e vitit 1462 dhe “*Meshari*” i Gjon Buzukut i vitit 1555. Sipas studiuesve, shekulli XVI ka rëndësi, sepse në këtë kohë kemi alfabetin e parë të plotë, që pasqyron sistemin fonetik të gjuhës shqipe. *Meshari* i Buzukut mbetet një vepër, që për shumë studiues<sup>76</sup>, krijon bindje për ekzistencën e një tradite më të gjatë shkrimi se ajo që njihet. Me këtë libër do të hapej rruga e një tradite shkrimi, e cila do të ndiqet me botime të tjera të kësaj natyre. Sa e kanë njohur pasardhësit grafinë e Buzukut nuk kemi ndonjë të dhënë, por ngjashmëria e sistemit grafik me atë të Buzukut tregon jo vetëm se e kanë njohur, por dhe që në Shqipëri kishte kohë që ekzistonte një traditë e tillë shkrimi. Alfabeti latin u përdor nga pothuajse të gjithë autorët e vjetër në vijim. Në këtë situatë, me të drejtë Ismajli shtron një pyetje me rëndësi për historinë e shkrimit të shqipes: Pse dominoi alfabeti latin në shkrimin e shqipes në fillimet e saj dhe më pas u përvetësua përfundimisht në gjuhën shqipe? Sipas Ismajlit,<sup>77</sup> arsyet pse dominoi alfabeti latin janë të natyrës historiko-kulturore e konfesionale. Përdorimi i këtij alfabeti në shkrimet e shqipes, lidhej me faktin se karakteri dhe destinacioni kryesor i këtyre teksteve që ai fetar, pra në bazë të tyre nuk qëndronte kultura autentike shqiptare, por në themel ishin kultura të tjera që shkriheshin e bëheshin një me të shqiptare.

Në zonat ku pozitat e katolicizmit ishin akoma të forta u lejua përdorimi i shqipes në shërbesat fetare, u hapën shkolla për mësimin e fesë në gjuhën shqipe, u botuan libra shqip etj. Që këtu filloi të krijohet tradita e përdorimit të grafisë latine ose më saktë latino-italiane. Në përdorimin e grafisë latino-

---

<sup>75</sup> Një dëshmi e qartë për këtë çështje është dëshmia e G.Adaes në 1332, për të cilën është folur në kapitullin e parë. Lidhur me historinë e alfabetit të shqipes shih Tomor Osmani, “*Histori e alfabetit të gjuhës shqipe*” Tiranë, 1987.

<sup>76</sup> E.Çabej, vep.cit. f. 59; M.Domì “*Libri i parë shqip dhe fillimet e letërsisë shqipe*”, BSHSH”, Nr.1, f. 7; Dh.Shuteriqi “*Shkrimet shqipe në vitet 1332-1850*”, Tiranë, 1976.

<sup>77</sup> Vep.cit.f. 56

italiane ndikoi dhe fakti se pjesa më e madhe e teksteve të vjetra janë kryesisht përkthime nga latinishtja e italishtja dhe se autorët e këtyre teksteve ishin formuar dhe shkolluar në Itali.

Dhe në tekstin e Kuvendit të Arbënit, si një përkthim i një teksti shkruar në gjuhën latine, në bazë qëndron grafia latino-italiane. Të këtij mendimi janë dhe studiuesit Ismajli<sup>78</sup> dhe Malaj<sup>79</sup>. Sipas këtij të fundit autori është mbështetur në veprën e Budit, “*Doktrina e Krishtenë*” dhe veçanërisht në atë të Bogdanit, “*Çeta e profetëve*”.

Alfabeti<sup>80</sup> i përdorur në këtë tekst është i përbërë nga këto shkronja:

a b c d ç e f g h i k l m n o p q r s t çç  
u x z ε.

Për të parë në mënyrë të përmbledhur dhe për të krijuar një ide më të qartë mbi këtë alfabet dhe kombinimet e mundshme të njësive, po japim një tabelë krahasuese të alfabetit të përdorur në tekstin e Kuvendit të Arbënit me alfabetin e sotëm të shqipes dhe alfabetin e përdorur nga Buzuku. Sipas T.Osmanit<sup>81</sup>, në këtë tekst është ndjekur sistemi grafik i Bogdanit, me ndryshime të vogla dhe me veçori gati të njëjlojta me alfabetin e Bogdanit.<sup>82</sup>

Alfabeti i sotëm	Alfabeti i Buzukut	Alfabeti i Kuvendit	Shembuj
a	a	a	suola,atà,maa,giàa
b	b	b	bierre
c	ε,c, t	z, t	forzohen, devotion
ç	c	c,cc,cci,ci	conciλit,pacc,gieccin,ciuem
d	d	d	dera
dh		ç	urçenove
e	e	e	kiè,vend,ndeer

<sup>78</sup> Vep. cit. f. 74

<sup>79</sup> Vep.cit. f. 135 -147

<sup>80</sup> Shih Ashta në *Buletin* 1957, vep.cit; Malaj, vep.cit, 280 e më tej.

<sup>81</sup> vep.cit.f. 38

<sup>82</sup> Të shihet tabela përmbledhëse e alfabetit të përdorur nga Bogdani përbri së cilës qëndron dhe alfabeti i shqipes së sotme. A.Omari.vep.cit.f. 81



ë	e	e	urçenit,t'Arbeniçe
f	f, ph	f	deftuem.
g	g,	g, gh	goje, nghignune,lenghimi
gj	, g, i,gi	g,ghi,gi	giç,ndighiova,giumi,giak
h	h	h	hire,mpsohet
i	i,j,y	i,j	lumit,mbii,sctepijavet,kiè
j	i,y,J,ih	j, i	muoje,jane,feeja, mbaitune
k	c,ch,qu	k, c, ch	kisce, korrichit
l	l,ll	l,ll,λ	larg,gial,duoli
ll	ll, l	ll,λ ,l	ndriculavet, diaλit, mbiell
m	m	m	mos, harruem
n	n	n	kane, scind
nj	gn, n	gn	nieriju, cuitogn, gni
o	o	o,	kercova, mos, ketò
p	p	p	provincia
q	h̄,g	c,ci,cc,ch,,chi	cint,cie,cacc,chioft.
r	r	r	turchiet, sckruem, sicuur
rr	rr	rr,r	ejarr, marrene, refimi, reee
s	s,ss,ε	s, ∫,	suola, kine∫e, ve∫∫evet,
sh	s,ss,sc	sc,sci,	∫chip, kisciat, ∫ciaam,
t	t	t,tt	te vihet, fortevet
th		çç	giçç, ççomi,
u	u, ,v	u, v	asctu,lufton,puçcive,guur
v	v, u	v, u	viett, vece
x	z	z, ε	ranza, guzogn
xh	g ε	-	-
y	u, ,y	,	At , H it, s t
z	s,ε	ε, s, z	εognene, ruzuem, visitatueri
zh	s,	-	-

Siç shihet, në bazë qëndron alfabeti latino - italian i përdorur më parë nga autorët e vjetër të Veriut si Buzuku, Budi, Bardhi e Bogdani<sup>83</sup>. Sipas Çabejt,<sup>84</sup> të shkrimet e vjetra, si dhe në tekstin tonë, vazhdimisht shihen shenja grafike të njëta: *c* dhe *ch* për *k*; *gi* për *gj*; *gn* për *nj*, *qu* për *ku*; *s* për *sh*, *z*; *i* për *j*. Gjithashtu, vërejmë zanoret e dyfishta për të treguar zanore të gjata dhe bashkëtingëlloret e dyfishta.

Por, meqë alfabeti latin nuk i mbulonte të gjithë tingujt -fonemat e shqipes, të gjithë autorëve të vjetër, duke nisur që me Buzukun, u është dashur të shfrytëzonin shenja të veçanta të alfabeve të gjuhëve të tjera për tinguj që nuk ekzistonin, as në alfabetin latin e as në atë italian: psh: *ç* për *dh*, *çç* për *th* nga greqishtja dhe për *y* nga sllavishtja. Çabej pohon, se shfrytëzimi i këtyre shenjave tregon se kemi të bëjmë me nismë individuale të autorëve dhe jo me një ndikim kulturor të mirëfilltë. Ky qëndrim i Çabejt, i bazuar mbi të dhënat e historisë së gjuhës dhe shkrimit të shqipes, është në kundërshtim të hapur me mendimin e Bariçit, kur ai pohon se në Shqipëri Veriore ka qenë përdorur alfabeti cirilik<sup>85</sup> Falë përdorimit të alfabetit, dhe pse jo i përsosur, autorët e vjetër arritën të shprehnin më së miri strukturën fonetike të shqipes.

## II.1.2 Përshkrimi i shenjave grafike

Tradita e përdorimit të grafisë latino-italiane në shkrimet shqipe ishte krijuar që me librin e parë shqip të Buzukut (1555). Për Buzukun, Eqrem Çabej shprehet, se ai në kohën kur shkroi veprën e tij ishte nën ndikimin venecian.<sup>86</sup> Shkrimtarët e mëvonshëm të shekullit XVII ndodheshin nën ndikimin e italishtes si rezultat i formimit të tyre në kolegjet fetare të Romës<sup>87</sup>. Në fakt, i pari që vazhdoi më tej traditën e shkrimit shqip qe Pjetër Budi, veprat e të cilit njiheshin nga autorët e mëvonshëm, duke u shndërruar pa dyshim në model, të cilin e ndoqën dhe përsosën më tej, veçanërisht Bogdani.<sup>88</sup> Me të drejtë Bogdani me veprën e tij *Cuneus prophetarum*, si vepra më e plotë e shqipes së shekullit XVII, mbetet autori më i rëndësishëm, i cili kontribuoi ndjeshëm në konsolidimin dhe stabilizimin e shkrimit të shqipes. Për këtë arsye, me Bogdanin, studiuesit vendosin kufirin e ndarjes së historisë së

---

<sup>83</sup> Për të bërë krahasimin me alfabetin e Bogdanit me të cilin ka ngjashmëri shih A.Omari, vep.cit. f. 81

<sup>84</sup> Çabej, *Meshari*, vëll. I. f. 59

<sup>85</sup> Çabej, *Meshari*, f. 60.

<sup>86</sup> Për më shumë shih E.Çabej, "Hyrtje" në "*Meshari*" i Gjon Buzukut, vep.cit., f. 50

<sup>87</sup> A.Omari, vep.cit. f. 17

<sup>88</sup> Për një përshkrim të shkronjave të veçanta shih Pjetër Bogdani, "*Cuneus Prophetarum*" (*Çeta e profetëve*), Vep. cit. f. 17- 83

shkrimit shqip. Sipas Rizës<sup>89</sup>, autorët më të vjetër dhe që ndihmuan në lëvrimin e shqipes janë: Gjon Buzuku, Pjetër Budi, Lekë Matrënga, Frang Bardhi dhe Pjetër Bogdani, pra me vitin 1685.

Sipas R. Ismajlit<sup>90</sup> ky kufi duhet të shtyhet duke përfshirë dhe veprat *Kuvendi i Arbënit* (1796), *Osservazioni grammaticali nella lingua albanese e da Lecces* (1716), Dorëshkrimi i Grottaferratës (1710), Doktrina e Kërshtenë e Gjon Kazazit (1743) dhe mbase edhe në botimin e dytë të Kuvendit të Arbënit (1868) të botuar nga Engjëll Radoja<sup>91</sup>. Më tej Ismajli vijon me arsyet që e çojnë atë në këtë përfundim. Sipas Ismajlit:

1. Shkrimi i shqipes ka kryesisht të njëtin funksion në të gjitha tekstet.
2. Alfabeti bazë, madje dhe plotësimet, në kod janë të njëjta në të gjitha këto tekste;
3. E gjithë kjo traditë zhvillohet në kontinuitet, prandaj dhe grafia e ortografia vjen gjithnjë duke u përsosur;
4. Gjuha e këtyre teksteve është kryesisht gegërishtja;
5. Këto tekste shërbenin ose në praktikën fetare, ose në mësimin e shqipes për këto qëllime;
6. Ky alfabet dhe ky shkrim vazhdon të ekzistojë si i tillë sporadikisht, por i pastruar nga elementet hetero-alfabetike me të madhe, edhe në periudhën e Rilindjes.

I dhamë të plota këto pika për të shprehur qëndrimin e Ismajlit mbi këtë çështje. Ato mbartin vërtetësi dhe vërtetojnë vazhdimësinë e shkrimit të shqipes. Ismajli ka të drejtë dhe me të jemi të një mendimi, kur në historinë e shkrimit të shqipes përfshin dhe veprat e sipërpërmendura. Për mendimin tonë të paktën duhet përfshirë botimi i parë i tekstit të Kuvendit të Arbënit, si teksti më i plotë pas Çetës së Profetëve të Bogdanit. Sipas tij dhe me të drejtë “vetëm duke e parë çështje në vazhdimësi dhe në kontekstin e shkrimeve shqipe nga autorë shqipfolës joburimorë, dhe në të njëjtën kohë ta kapim ndërlidhninë midis shkrimit të shqipes nga autorët burimorë dhe nga të huajt, mund të shihet në dritë të plotë shkrimi dhe drejtshkrimi i Kuvendit të Arbënit në raport me veprat e shkruar si para ashtu dhe mbas tij”.

Në sythin “Përshkrimi i shenjave grafike” nuk do të ndalemi gjatë pasi një kapitull të veçantë grafisë dhe alfabetit të tekstit të Kuvendit i ka dedikuar Ismajli në librin

---

<sup>89</sup> S.Riza, *Pesë autorët më të vjetër të shqipes*, Tiranë 1966

<sup>90</sup> R. Ismajli, vep.cit. f.73-74

<sup>91</sup> Bëhet fjalë për botimin e dytë të Kuvendit të Arbënit.

e tij<sup>92</sup> tashmë të cituar disa herë, duke përbërë dhe boshtin e punimit të tij. Autori përmes një analize kontrastive ka vënë përballë njëri –tjetrit dy sistemet fonetike, atë të latinishtes dhe të shqipes, me ndryshimet që ekzistojnë dhe ndryshimet ose përshtatjet që autorët e vjetër duhet të bënin për të sjellë në shqipen e atëhershme përkthime e vepra të tjera të ngjashme. Në kapitullin mbi grafinë dhe alfabetin sistemi grafik është vështruar në tërësi falë një analize të hollësishme grafike. Kështu, përballë kësaj situatë po bëjmë një përmbledhje të vlerave të grafive zanore dhe të grafive bashkëtingëllore sa për të krijuar një ide sa më të qartë mbi grafitë e përdorura, të krahasuara herë-herë dhe me grafitë e teksteve të mëparshme. Të gjitha shembujt janë përzgjedhur nga fondi i fjalëve të paraqitura në punimin e tij nga vetë Ismajli.

Grafia e tekstit tonë, siç do të shihet, është e bazuar në traditën shqipes nga një anë dhe në traditën e latinishtes nga ana tjetër ashtu si të gjitha shkrimet para tij. Grafia e këtij shkrimi, e ngjashme deri diku me grafinë e autorëve të vjetër, karakterizohet nga grafema polivalente dhe me grafema të përbëra, duke na dhënë një grafi të rënduar dhe rrjedhimisht të vështirë për ta lexuar. Sipas Ismajlit<sup>93</sup> grafemat polisemike apo shumëvlerëshe siç i quan ai, janë ato që në varësi nga pozita në radhën grafike u referohen fonemave të ndryshme, ndërsa grafemat e përbëra janë ato sekuenca të njëpasnjëshme që kanë një referencë të vetme tingullore kur kombinohen bashkë. Në tekst nuk mungojnë dhe grafemat e thjeshta dhe njëvlerëshe. Te Kuvendi i Arbënit monograme të vërteta janë pak: *p, m, b, h, o, ç* dhe *çç*. Të tjerat ndryshojnë sipas konteksteve dhe hyjnë në grafema të tjera të përbëra. Dhe Malaj në veprën e tij<sup>94</sup> bën një analizë të hollësishme të njësive tingullore, vetëm se nuk ka ndjekur të njëjtën procedurë si të Ismajlit duke sjellë më shumë njësi tingullore pasi nga ana e tij janë konsideruar si të përdorura si hundore të gjitha zanoret dhe se sikur në tekst kanë dalë të gjitha bashkëtingëlloret, kur realisht nuk është kështu.

### *Zanoret*

#### Grafia *a*

Në këtë tekst grafia *a* është përdorur me këto forma të ndryshme:

*a* (*feeja, dera, trimavet, haracci*). Në tekst zanorja *a* pa shenja të tjera shënon gjithmonë tingullin e patheksuar *a*. Po kjo zanore del dy herë e kombinuar me *e* duke u kthyer në togun zanor - *ae* (*pae, hae*).

---

<sup>92</sup> Vep.cit.f.52 -209

<sup>93</sup> Po ai, po aty. f. 76

<sup>94</sup> Vep. cit. f. 280 e tutje.

*à* (*atà, ketà, dasciàs*)

*aa* (*gaati, gaaa, paaditunit, baam*)

*àa* (*pràa, màa, giàa*)

Variantet *aa*, *àa* janë grafi të dyfishuara, dukuri që del te të gjithë autorët e vjetër për të treguar gjatësinë e zanores, si një ndikim i latinishtes për shënimin e bashkëtingëlloreve geminate. Këto forma jo vetëm për tingullin *a*, por dhe për tingujt e tjerë janë të kushtëzuara nga natyra e zanores dhe theksi. Siç vërehet në sistemin e tij grafik, autori ynë ka vënë në përdorim edhe theksin, si ndikim nga italishtja për të shënuar gjatësinë e shkurtër të theksuar. Kjo grafi del dhe para bashkëtingëllores hundore ose ku mund të supozohet hundorësia e zanores, pasi në tekstin tonë hundorësia nuk jepet me anë të ndonjë shenje. Mendohet të kemi zanore hundore në fjalët e mëposhtme: *urandue, ranza, te laane, bahemi, kanga, gian, cambe, ngand*

Grafia *e*.

Kjo mbetet një nga grafitë më të ndërlikuara me vlera të ndryshme tingullore dhe funksionale, në pozicion të theksuar e herë të patheksuar, duke shfrytëzuar të njëjtat shenja si dhe për grafinë *a*. Kjo grafi ka dalë me këto forma:

*e* (*kiene, tiereve, Clementit, kech, ende, nuk jet*)

*ee* (*vee, beecueme, ndeer, jee, çee, te leemit, nee*)

*è* (*kiè, persè, biè, sè*)

Si grafia më e rënduar *e*-ja shënon disa tinguj, ndër këta dhe tingullin *ë*, duke sjellë probleme. Sipas Ismajlit<sup>95</sup> për të zbuluar nëse kemi të bëjmë me *e* apo *ë* mjafton të bëjmë krahasimin me Bogdanin<sup>96</sup>, si i pari ndër autorët e Veriut që nëpërmjet theksit të rëndë mbi grafemën *e* dhe duke marrë parasysh elementet ku mund të qëndrojë *ë*-ja. Bëhet fjalë për mbaresat, prapashtesat etj.

Shembuj me *e* për [ë] bazuar mbi interpretimin historik e gjuhësor kemi në fjalët: *pape, kercova, here, nde, niereze, çene, gindete, pegaam, urçenit, viette, persè, hiécune, jete* etj.

Probleme të tjera dalin dhe me *e*-në hundore, pasi dhe këtu autori për të treguar hundorësinë<sup>97</sup>, e zanores nuk përdor ndonjë shenjë të veçantë për ta dalluar, sikurse vepron Bogdani. Ky autor, aty kur mendonte se zanorja ishte hundore e shenjonte

---

<sup>95</sup> Vep.cit.f. 89

<sup>96</sup> Të shihet A.Omari, vep.cit, f. 38

<sup>97</sup> Nëse nuk kemi ndonjë shenjë të veçantë për të treguar hundorësinë, nuk do të thotë se gjuha e kësaj kohe nuk kishte *â* dh *ê* hundore. Për këtë të shihet Çeta e Profetëve e Pjetër Bogdanit.

duke e nënë pranë grafemës hundore *n*. Megjithatë, sipas Rizës<sup>98</sup> dhe kjo nuk është zgjidhje, pasi shqipja në strukturën fonetike të saj lejon që një zanore gojore të ndiqet nga bashkëtingëllorja *n*, si *kthen*, *shan*, *ndan* etj. Kështu sipas Ismajlit<sup>99</sup> *e* hundore kemi në fjalët: *vend*, *mend*, *reenuem*, *peendeçe*, *çcende*, *εembre*.

Grafitë *u* dhe *v*.

Këto dy grafi në tekstet e vjetra përbëjnë problem pasi shpesh herë grafia *v* merrej si variant i *u*-së. Kjo dukuri shihet si ndikim i latinishtes<sup>100</sup> në të cilën grafia *u* ishte grafemë shumëvlerëshe. Në tekstin tonë kemi pak qartësi në këtë drejtim. Sipas Ismajlit<sup>101</sup> qartësi mbi këtë grafemë vendoset vetëm në shekullin XIX te E.Radoja. Grafia *u* del në tri forma:

**u** (*lunit*, *duhet*, *suola*, *murin*, *luftavet*, *creu*, *giegiunit*, *Cunvendit*, *uçe*) Grafia *u* në këto fjalë del si në pozicion të theksuar ashtu dhe në pozicion të patheksuar.

**ù** (*keçctù*, *nùk*, *cù dò*, *praçctù*, *cù*)

**uu** (*vuum*, *guuri*, *sicuur*)

V-ja nuk del me forma të tjera dhe në tekst del si polifunkionale pasi del me vlerën e *u*-së si në fjalët në vijim. (*ameçciveme*, *me civem*, *vinat*, *farveçi*, *deçcerve*, *puçcivem*). Megjithatë, në tekst në shumicën e rasteve *v* -ja me vlerë bashkëtingëllore del më shpesh se me vlerë zanoreje. (*luftavet*, *vuum*, *i vertetscim*, *virtyt*). Grafema *u* është në përbërje të grupit të rëndësishëm grafik *ue*, një tipar i të folmeve veriore jo vetëm të kohës së atëhershme, por dhe të sotmes. Mbi këtë grup do të flitet në vijim, pasi këtë e kemi parë si tipar të rëndësishëm të shkrimeve të vjetra dhe meriton vëmendje të veçantë.

Grafia

Kjo grafi, të cilën e gjejmë në të gjitha tekstet e vjetra, nuk mund të mungonte dhe në tekstin tonë. Siç dihet, kjo grafi e marrë nga alfabeti sllav është përdorur deri vonë për të dhënë zanoren buzore *y*. Në tekstin tonë del në këto dy forma: dhe .

( *at* , *ket ne*, *meu ref em*, *e t ne*, *mend re*)

( *s t*, *k* , *d* , )

---

<sup>98</sup> Vep.cit.f. 57

<sup>99</sup> Vep.cit. f. 94

<sup>100</sup> Mbi këtë dukuri shih A.Traina, *L'alfabeto e la pronunzia del latino*, Bologna, 1973, f. 48

<sup>101</sup> Vep.cit.f. 104

Kjo e fundit shërben për të shënuar zanoren *y* të gjatë, megjithatë nuk mungojnë dhe raste kur kjo shënohet dhe me kombinimin *i* si në fjalët në vijim. ( *i d iti, se diti* ) Sipas Ismajlit<sup>102</sup> jo të gjitha rastet me *yi* duhet të lexohen si *y* e gjatë. Psh; *H it, kënd j*.

### Grafitë *i* dhe *j*

Sipas traditës latine dhe në traditën e shkrimit të hershëm të shqipes<sup>103</sup> grafia *j* del si variant i *i*-së por që me kalimin e kohës fillojnë të dallohen nga njëra –tjetra. Sipas Ismajlit<sup>104</sup> në shkrimet e shqipes këto grafi duhet të paraqesin tinguj të ndryshëm, njëra si zanore e mirëfilltë *i* dhe e theksuar, ndërsa tjetra me karakter gjysmëzanor në pozicion të patheksuar. Me vlerë gjysmëzanoreje e gjejmë te disa bashkëtingëllore për të shënuar tiparin qiellzor.

Grafia *i* në këtë tekst del në këto forma:

**i** (*visk, giçç, apostolik, si, çcind, gnimiçietmi, ndighiova mbaitunit, viette, vinat, nevoscima, cuituem*) Në këtë formë grafia *i* del si zanore e mirëfilltë dhe si gjysmëzanore në pozicione të ndryshme )

**ii** (*mbii, e tii, hiim, famuliine, diitune, Mrii, rriim*) Dhe në këtë rast dyfishimi i zanores shërben për të treguar gjatësinë e saj.

**ij** (*sctepijavet, nieriju, dijen, urtije, davija, dobije, as dijet, bien kecchija*) Dhe kjo grafi shërben për të shënuar tingullin e gjatë *i*: në pozicion të theksuar.

Si element ndihmës zanorja *i* del në këto grupime; *ci, sci, ki, chi, gi, ghi, ti* për të shënuar qiellzorizimin e tyre, gjë që do të shihet më vonë kur të flitet për bashkëtingëlloret. Të vërehen rastet me *i* për palatalitet.

(*provintieçe, kisciat, Gioni, acchie, mescia, fuscjavet, lighioime, sciaam*)

### Grafia *o*

Kjo është një nga zanoret më të qarta të tekstit tonë, pasi ajo shënon vetëm zanores e ngritjes së mesme *o*. Kjo grafi del në dy forma

**o** (*kercova, te fort, goje, krou, gioni, ndighiova, ligioime, ççomi, teneone, mos, postafat, ceremonia, miççionaare, forzuem, muoj*) . Grafema *o* del në pozicion të theksuar dhe në pozicion të patheksuar. Kur është e theksuar ajo shënon zanoren e gjatë, zanoren e shkurtër dhe të mesmen.

---

<sup>102</sup> Vep.cit.f. 102

<sup>103</sup> Riza, po aty. f. 8- 14

<sup>104</sup> Po aty .f. 95

ò (*pò, ndò, atò, prò, kiò*) Në të gjitha këto raste kemi të bëjmë me *o* të shkurtër dhe në rrokje të hapur.

Zanorja *o* është pjesë përbërëse e grupit zanor *oe* me *o* të theksuar në fjalët *roe, voe, droe* për shqiptimin e të cilave jemi të sigurtë.

### *Bashkëtingëlloret*

Disa bashkëtingëllore si *b, d, f, p, t, ç, çç* janë grafi të thjeshta dhe që shënojnë një tingull, rrjedhimisht nuk përbëjnë problem në lexim dhe mendojmë të mos ndalemi më gjatë.

### Grafema *c*.

Kjo grafemë është më e ndërlikuar, siç e vë në dukje dhe Ismajli<sup>105</sup> jo vetëm në tekstin e Kuvendit të Arbënit, por në të gjitha tekstet e vjetra të shqipes. Kjo shënon disa tinguj duke u kombinuar dhe me grafema të tjera si: *k, ci, ch, cchi* etj. Kështu kemi grafemën *c* që shënon *ç* në fjalët: *leecitgne, vece, mos muicin, nde mbaicin, concilit, miedicine, c'katerruem*.

Po grafemën *ç* e shënon grafema *cc* në fjalët: *pacc, haraccin, viecc, gieccin, viecc, i diccimi*.

Shembuj me grafemën *ci* për të shënuar përsëri *ç* në fjalët: *ciobante, ciohemi, per ci do, pacimuem, civem, ciohemi, te ciognene, cirachie*.

Grafemat *ci, cc, cci* vlejné dhe për të shënuar bashkëtingëlloren *q* në fjalë si: *cint, cacc, tue certvem, cisc, cacc, ciuçç, ciè*

Një çështje të vështirë përbëjnë grafemat *ch, cch, chi, cchi*. Funkzioni kryesor i këtyre grafemave të shënojnë bashkëtingëlloren qiellzore të shurdhët *q* si në fjalët *plecchiete, kach, fucchij, cacchie, çchip, nderech, kecchie, berecchiatti, merchieri, turchiet, me kanacchiune* etj. Gjithashtu po këto grafema shënojnë dhe bashkëtingëlloren velare *k*, ndonëse në pak raste. Një tjetër funksion është ai i shënimit të velares *k*, sidomos kur kjo formon grup me gjysmëzanoren *i*: *te çchievet, chiaam, chiuhet, chaine, çcichiuem, chioft, kiè, me kiene, ka te kiene, Schiaut*.

### Grafema *g*.

Kjo grafemë para bashkëtingëlloreve dhe para zanoreve të prapme shënon bashkëtingëlloren velare *g*. Problemi qëndron se kur qëndron para zanoreve *i, e* dhe në fund të fjalës kjo grafemë shënon *gj* dhe për të shënuar *gj* autori përdor disa grafema, të cilat do të shihen më poshtë me shembujt përkatës.

---

<sup>105</sup> Vep.cit.f. 118



**gi** sipas Ismajlit<sup>106</sup> mund të konsiderohet si grafema kryesore për të shënuar qiellzoren e zëshme si në fjalët: *giumi, gaaa, giak, giauri, giuhat, scen Giergit, giucuem, te vogielit giaksi.*

**g** gjithashtu shërben për të shënuar *gj* si në fjalët: *lig, gindet, gimova, feligete, geniya, sacrilegit giçç*

**ghi** po ashtu shënon *gj* në fjalët; *voghieliet, me ghiete, Gierghi, felighiet, ghiaa, eghiere, derghiet, gieghiene.* Çështja ndërlikohet kur në tekst gjejmë dhe raste kur *gh* e ndjekur nga *i, e* shënon *g*, siç vërehet në fjalët në vijim: *nghignehen, ghiçcti, eghiçune, traçcighimi, lenghimi, ndighimi.*

Në këtë grup grafemash bën pjesë dhe grafema e përbërë *gn*, e cila shënon vetëm bashkëtingëlloren hundore *nj* dhe nuk përbën ndonjë vështirësi. Ajo që bie në sy është jotizimi në fund të rrokjes, gjë që vërehet sidomos në mbaresat e foljeve dhe që në të njëjtën kohë tregon se shqipja e fillimit të shekullit XVIII ishte më afër formave më të reja gjuhës letrare.

#### Grafema **l** dhe **λ**.

Për të shënuar grafemën *l* autori shfrytëzon dy variantet: *l* dhe *ll*. Sipas Ismajlit<sup>107</sup> në të dyja rastet është grafemë bifunksionale, por që ka prirje për t'u qartësuar. Ajo që vërehet është përdorimi i alternuar i këtyre dy grafive, i cili ndërlikohet dhe më shumë kur në lojë futet dhe grafema *λ* e hasur dhe te Buzuku, po për të shënuar *l*.

Grafema **l** qëndron në shumicën e rasteve për të shënuar *l* si në fjalët *larg, leecitune, luanin, larguem, lighet, laane, bulet, lumniya, dielte, balte* dhe gjithashtu për të shënuar *ll*, duke ndërlikuar pak çështjen, ndonëse kjo dukuri haset rrallë. Psh; *ndriculavet, chielçcimi, palanke, gial, nguçcelimi.*

Grafema **ll** si në shqipen e sotme shërben për të shënuar tingullin anësor velar *ll*: *ciellene, pçctielle, i holli, collahi, gialle, mahalla, paralla*

Grafema **λ** në tekstin tonë ka prirje drejt specifikimit pasi në shumicën e rasteve, sipas Ismajlit<sup>108</sup> gati tri herë më shumë del me funksion të *ll* sesa me funksion të *l*. Shembuj *λ = ll* *volundete, culotune, me siele, duoli, Barbulusci, batal, diaali, filon, vetula*

Shembuj *λ = l* *duoli, mbeluem, vele, lulesohet, Ritual, ççemeli, Paalit, Selise.*

---

<sup>106</sup> Vep.cit. 127

<sup>107</sup> Po aty, f. 131

<sup>108</sup> P aty, f. 132

#### Grafema s

Kjo grafemë na del gjithashtu mjaft e ndërlikuar. Grafikisht del me dy forma, siç ndodh në shkrimet me alfabet latin të kohës: s dhe ꝛ.<sup>109</sup> Grafema s në tekstin e Kuvendit të Arbënit del si e thjeshtë s ose ꝛ, me vlerën e s në fjalët: *visk, kineꝛe, apoꝛtolike, t'Arbeniꝛe, sime, suola, diꝛpoti, aꝛso*.

Po s dhe ꝛ qëndron dhe për z herë midis dyzanoreve gjë që e shohim si ndikim të grafisë latino-romane. Të vërehen fjalët: *viꝛitatuꝛe, Jeꝛu, ꝛdiine, Dioceꝛve, me ꝛchiꝛune*

Ndikim të traditës romane vërejmë dhe te dyzimi i grafemës ꝛ në pozicion intervokalik, duke shënuar kështu dallimin mes të zëshmes dhe të pazëshmes: *veꝛꝛ evet, pieꝛꝛa, eꝛꝛapin, bessogn,, paꝛꝛune, refꝛeꝛꝛit, peendeꝛꝛe, aꝛso*.

Kur s është pjesë e grafemës së përbërë *sc, sci* ose ꝛc, ꝛci atëherë këto qëndrojnë për të shënuar *sh* në fjalë si: *archiupesckup, i lumscimi, kisciat, keꝛctu, aꝛct, ꝛciaam, kꝛcil, puꝛctueꝛcimi, ꝛcende, ꝛcen, ꝛcpirtit*.

#### Grafema z.

Kjo grafemë nuk është shumë e përdorur dhe qëndron për c si në fjalët: *i forzeꝛe, forzuem, ndrizzuem, forzohen, conꝛcienzen*. Gjithashtu qëndron për z në fjalë si: *ranza, ruzuem, me nzierrre, te guzogn, nzeti, me lezuem*. Të pakta janë fjalët në të cilat z qëndron po për z në fjalë si: *ruzuem, perziem, zaaccin, zmajevicchi*.

#### Grafema ꝛ.

Kjo grafemë është e thjeshtë dhe gjithmonë shënon bashkëtingëlloren fishkëlluese fërkimore z. E gjejmë në fjalët: *te viꝛituemꝛit, eognene, meꝛi, Tineeot, eottiniive, Ruꝛulimin, emajevicchi*.

“Në përgjithësi në tekstin e Kuvendit të Arbënit bie në sy një stabilizim i dukshëm i shkrimit të shqipes në raport me shkrimet e tjera, madje dhe në raport me Bogdanin” shkruan Ismajli<sup>110</sup> duke e vështuar në krahasim dhe me grafinë e teksteve të tjera të vjetra, duke vënë në dukje karakteret e përbashkëta dhe dallimet. Në të vihet re prirja drejt mënjanimi të dyshkronjave, prirja drejt specifikimit të shkronjave të veçanta për të shënuar tinguj të veçantë, sidomos në ato raste kur nuk ekzistojnë në gjuhët romane, tek të cilat është mbështetur mjaft. etj. Gjithashtu teksti i Kuvendit të Arbënit

---

<sup>109</sup> Ismajli, po aty. f. 141. Sipas tij, ky dallim vjen si ndikim i modelit grek të shkrimit të  $\sigma$  dhe ꝛ. Kjo e fundit qëndron kryesisht në fund të fjalës, ndërsa në fillim të fjalës të paktën në shkrimet shqipe nuk del fare.

<sup>110</sup> Vep.cit. f. 146

shënon një hap përpara edhe lidhur me ndarjen e fjalëve njëra nga tjetra, sidomos të fjalëve proklitike dhe enklitike, të nyjave, të parafjalëve etj., duke lehtësuar identifikimin e njësive leksikore dhe duke ndihmuar në procesin e stabilizimit të shkrimit të shqipes. Kjo dukuri nuk vërehet te Budi autorë të tjerë para tij, të cilët nuk e kishin këtë veçori ku shkruanin. Por në ndonjë pikë të veçantë, grafia e tekstit të Kuvendit të Arbënit kthehet prapa në krahasim me ndonjë tekst të mëparshëm. Në të nuk bëhet dallimi i *e*-së nga *ë*-ja, të cilën Bogdani kishte filluar ta bënte duke përdorur theksin e rëndë mbi grafemën *e*. Megjithatë, dhe ky autor nuk ka qenë i kujdesshëm në zbatimin e këtij rreguli, dhe “ky inovacion, sipas Rizes<sup>111</sup>, tepër pak do t’u ketë ndihmuar lexuesvet të atëhershëm, e ende më pak mund t’u shërbejë filologëve të sotëm”. Një e metë tjetër që mund të veçohet është se ndryshe nga Buzuku dhe Bogdani, tek të cilët vërehet tendenca për të dalluar zanoret hundore, në tekstin tonë, kjo dukuri nuk vërehet fare. Megjithatë, teksti ynë ka merita pasi siç e vë në dukje dhe Ismajli nuk bie në sy vetëm stabilizimi i shkrimit, por një hap përpara teksti shënon në shkrimin e fjalëve me gërma të mëdha, kryesisht emrat e përveçëm, fjalët në krye të njësisë sintaksore pas pike dhe disa fjalë të fushës fetare, që kështu marrin edhe një theks stilistiko-grafik në funksion të tërësisë së tekstit”<sup>112</sup>.

### **Theksi.**

Në tekstet e vjetra theksi mbetet një mjet ndihmës me funksione të ndryshme. Kështu, është krijuar ideja se shumica e autorëve të vjetër e përdor për të shënuar zanore të theksuar. Por funksioni i theksit nuk kufizohet me kaq. Bogdani, theksin e rëndë e përdori për të dalluar fonemën *ë* nga *e* –ja. mirëpo këtë theks e vendos dhe mbi zanore të tjera për të treguar gjatësinë e shkurtër të saj dukuri të cilën studiuesit e shohin si ndikim nga grafia italiane<sup>113</sup>. Dhe në tekstin e Kuvendit të Arbënit, theksi është vendosur për të shënuar jo vetëm zanoret e shkurtra të theksuara, por edhe ato të patheksuara duke krijuar probleme në interpretimin e tekstit.

Kështu ndonjëherë theksin e gjejmë në fjalë njërrokëshe si në jalët: *dò, mbà, pò, ndò, cù, sì* etj..

Një pozicion tjetër ku shfaqet theksi, është ai në fjalë dyrrrokëshe si: *ketù, atà, ketà, asctù, persè* etj. Nganjëherë e gjejmë theksin gabimisht mbi zanore të patheksuar: *drappenì, hippì, Festà*

---

<sup>111</sup> Vep.cit. f. LVIII

<sup>112</sup> Vep. cit. f. 147

<sup>113</sup> Për më shumë mbi theksin e përdorur shih A.Omari, vep.cit f.20

Sipas Ismajlit<sup>114</sup> rastet e rralla të përdorimit të sirkonfleksit dhe të dypikëshit, të cilëve Malaj<sup>115</sup> u jep rëndësi grafike – ortografike, duhet të shihen si gabime.

### **Apostrofi.**

Këtë shenjë fillimisht e përdori Bogdani për të shënuar rënie të një tingulli<sup>116</sup>. Po me këtë funksion është përdorur dhe në tekstin e Kuvendit të Arbënit. Mund të sjellim mjaft shembuj të përdorimit të drejtë të apostrofit me këtë funksion, si psh rënien e *ë*-së te nyjet e mëparme:

*t' arbenijeçe, t' Visituemit, te çeut s'Arbeniiçe, ss'Eucaritijeçe.*

Pas pjesëzës mohuese *s* e ndjekur nga foljet: *s'vjen, s'asct.*  
Te parafjalët të përdorura para emrave që fillojnë me zanore:

*nd'Arbenii, pr'ata, n'besse,po tû k'asct*

te fundi i fjalëve me *ë* të patheksuar, siç është pjesëza *të* e lidhore:

*ciobant' e Scpirtinavet, Prefett' i sciurbije si t'u mengogn, t'assaj kisce  
nd'atà,*

Në tekstin tonë, ashtu si dhe te Bogdani, ka raste kur tingujt nistorë *c*- ose *n*- interpretohen gabimisht, duke i marrë si parashtesë: *c'tile, c'peç, c'peit*. Për këto dukuri dhe shumë ngjashmëri të tjera, studiuesit e shohin gjuhën e Kuvendit mjaft të afërt me *Çetën* e Bogdanit.

Gjithashtu, në tekstin tonë dhe fillimisht në *Çetën* e Profetëve të Bogdanit, siç është vërejtur nga Riza<sup>117</sup> dhe Omari<sup>118</sup> hasim përdorimin e pazakonshëm të apostrofit në ndarjen e parafjalëve *n, m* nga emri a përemri në rrjedhore, psh:

*Drittene n' drittet (KA f. 2);*

*aty lahemi n' fajjesc (KA f. 25);*

*tue kene delirune n' mcatesc (KA f. 30),*

*leem n' prindesc chi skane passune ....(KA f. 36)*

### **Shenjat e pikësimit.**

---

<sup>114</sup> Vep. cit. f. 148

<sup>115</sup> Vep. cit. 150 e tutje.

<sup>116</sup> Për më shumë shih S.Riza, vep.cit. f. LVI; S.Mansaku, “*Pjetër Bogdani dhe vepra e tij*”, Tiranë, 1991, f. 152

<sup>117</sup> Vep. cit. f. LVIII

<sup>118</sup> Vep. cit. f. 21

Ashtu si në të gjitha veprat e autorëve të vjetër dhe në tekstin e Kuvendit të Arbënit nuk vërehet rregulla të fiksuara të pikësimit. Këtë gjë e ka pohuar dhe studiuesi V.Malaj në punimin e tij<sup>119</sup> duke thënë se pikësimi i përdorur në tekst është personal. Sipas Ismajlit<sup>120</sup> duke qenë se pikësimi ka si funksion themelor përcaktimin e kufijve të njësive sintaksore dhe modalitetin e fjalisë së shprehur dhe duke qenë se kemi të bëjmë me përkthim të një teksti në gjuhën latine, autori mund të ketë ndjekur sistemin e pikësimit të latinishtes. Shenjat e pikësimit janë: pika (.); presja (,); dy pika (:); dhe kllapat harkore dhe vijat e pjerrëta //, thonjëzat (“”), pikëpyetësja (?) dhe pikëçuditja (!). Në tërësi në tekst, pikësimi është mjaft i rregullt, sidomos përsa i përket presjes dhe pikës. Kështu pika është përdorur për të shënuar fundin e fjalisë, dhe pse në ndonjë rast ka përdorime jashtë këtij rregulli. Presja përdoret më rrallë në radhitjen e elementeve me funksione të ngjashme dhe më shpesh në ndarjen e fjalive të nënrenditura nga kryesorja ose në rastet kur kemi të bëjmë me rastet e thirrorit. Megjithatë, në raste të numërimit të njësive sintaksore, kur veçohen në kuadër të njësive më të mëdha kemi përdorim të shpeshtë të dy pikave dhe pikëpresjes në veçanti. Kllapat shënohen kur autori ka dashur të shtojë ose të plotësojë mendimin ose siç do të vërehet në shembujt e mëposhtëm, për të shprehur gjendje emocionale të folësit. Të vërehet më poshtë përdorimi i shenjave të pikësimit.

*Ksctu, sicuur ççot Scen Gioni gojeaarti: “Asct dritta e Scpirtit, dera e Ietese, ççemelì i Scelbimit, ranza e viryvet, e krou i veperavet mirave, acchie saa, paa Fee smundet me pelchijem giacafsce Hyit.” (f. 1)*

*Ndigiova urçenit: Suola çene; Kercova ruelimin: pae plagat e tii. Pae (uh te çimbtunit) vuum ndene haraccin atà, chi gni here kiè Dispoti i Provintiavet. (f .1)*

*A asct cusc nder tà i beganiscimi ndaj Turit? (f. 34)*

*Kinëse mbasndaj Ciobanete e scpirtinavet te veperognene màa me mende, e me urtii; persè smund jete me scerbyem hyit, e Baalit, ndò Drecchit; s’duhet me duruem nder te Feescimit te Criscitit ndogni scengn, chi mos të jete secundrese asct Feeja jone. (f. 8)*

---

<sup>119</sup> Vep. cit. f. 300 .

<sup>120</sup> Po aty, f. 150

## II. 2 Dukuritë më të rëndësishme fonetike vështruar në ciklin e shkrimeve të tjera

Në këtë kapitull deri tani hodhëm vështrimin mbi alfabetin e përdorur, veçori grafike të tekstit, si dhe përshkrimi i grafive më të rëndësishme e problematike në të njëjtën kohë.

Krahas këtyre çështjeve që lidhen drejtpërdrejt me alfabetin dhe grafinë qëndrojnë dhe dukuritë më të rëndësishme fonetike të tekstit shqip të Kuvendit të Arbënit, të cilat nuk mund të mos kishin një vëmendje të veçantë. Mendojmë se këto dukuri do të shihen më qartë duke i krahasuar dhe me ato të autorëve më të vjetër si Buzuku, Budi, Bogdani etj..

1. Në rrafshin fonetik, në fushën e vokalizmit, ajo që bie në sy në këtë tekst, duke përbërë një tipar, i cili bashkon këtë tekst me shkrimet e tjera të vjetra, është është ruajtja e dallimit ndërmjet zanoreve të gjata dhe të shkurtra. Sipas Çabejt<sup>121</sup> kjo dukuri, ndonëse shumë interesante, është më pak e studiuar gjer më sot dhe pse vërehet që nga Buzuku<sup>122</sup> e deri në tekstin tonë. Ashtu si në të gjithë tekstet e vjetra gjatësia e zanoreve kryesisht është shënuar me dyfishim të shkronjës së thjeshtë. Nga autorët, vetëm Budi është treguar më i kujdesshëm në shënimin e gjatësisë, ndërsa Bogdani siç vëren dhe Çabej « nuk i shquante mirë të gjatat nga të shkurtrat ». <sup>123</sup> Gjurmët e saj vërehen dhe sot e kësaj dite në gegërishte, e cila vazhdon t'i ruajë më shumë se toskërishtja. Autori i tekstit tonë duket se është treguar mjaft i kujdesshëm në shënimin e gjatësisë së zanoreve, si në rastin kur kemi të bëjmë me zanore të theksuara ashtu dhe në ato të patheksuara, siç mund të shihet në shembujt e mëposhtëm.

<i>te keene Parrochit...</i>	(f. 20)
<i>per descimii t' atyne...</i>	(f. 61)
<i>per ndeere te Hyiit</i>	(f. 80)
<i>sikundrese i kaa dhane</i>	(f. 13)
<i>..chi paa lig mbane giaa e huoj</i>	(f. 29)

---

<sup>121</sup> E.Çabej, "Studime gjuhësore, VI, Prishtinë 1977, f. 87-93

<sup>122</sup> Te Buzuku: *pestunih enbeh dheet XLI/2; o e sene Merii XXXVII 2. biir perseh muo meh bane cheta? Luka 2,48*

Te Budi DC 36 *asctu ende mbedheet; e mosna lemeraan maa ndetekech. Te Bardhi ndeer, leem, me fluuruem, deet. Në veprën e Bogdanit shih A.Omari, Pjetër Bogdani, Cuneus prophetarum, Botim kritik, Tiranë, 2005, f. 44. Te Bogdani reenimnë, gaatuem, ndeeruem, baajtekescine, nierij, mrijmanga.*

<sup>123</sup> Po aty. f. 93

<i>tuk maa fort Nieriju</i>	(Letrat)
<i>me te mbaruemit se peendessese</i>	(f. 30)
<i>Σognese Beecueme</i>	(f. 20)
<i>Ndiere te peendohen</i>	(f. 24)

2. Çështja e hundorësisë mbetet një problem gjatë leximit të tekstit tonë. Edhe pse, Bogdani në veprën e tij *Cuneus prophetarum* (1685), vepër të cilën autori nuk mund të mos e njihte, shënoi grafikisht hundorësinë e zanoreve<sup>124</sup>, në tekstin e Kuvendit të Arbënit (1706) nuk gjejmë ndonjë shenjë të veçantë për të treguar këtë tipar. Pra, këtu për hundorësinë nuk ndiqet praktika e Bogdanit, ndonjëherë dhe e Buzukut, të cilët në shumë raste me grafinë zanore  $a + n$  shënojnë zanore hundore. Sidoqoftë te autorët e vjetër të Veriut, zanoret hundore edhe pse nuk janë shënuar, janë shqiptuar pa asnjë dyshim, sepse hundorësia ka qenë dhe është një tipar i gegërishtes. Për sa u përket rasteve me zanore  $a + n$  te Bogdani, por dhe te Buzuku, duhet thënë siç është shprehur dhe Çabej<sup>125</sup> nuk mund të thuhet me siguri nëse duhen lexuar me  $a$  hundore apo me zanore + bashkëtingëllore  $n$ . Kjo çështje është shtruar dhe nga A.Omari<sup>126</sup> në punimin e saj kritik mbi veprën e Bogdanit, ku pranon opozicionin hundore/johundore. Sipas Omarit pasiguria e shprehur nga Çabej justifikohet të paktën kur flitet për Mesharin e Buzukut ku trajtat me zanore +  $n$  dalin më rrallë, rrugë e ndjekur si nga Budi ashtu dhe nga Bardhi. Nga ana tjetër Bogdani, duke ndjekur shqiptimin hundor të së folmes së tij e shihte më se të domosdoshme shënimin e zanoreve hundore. Dallimi i hundorësisë në tekstin tonë mund të arrihet vetëm duke parë pozicionin dhe mbi bazë të rindërtimit në mbështetje të teksteve të vjetra. Kështu janë konsideruar si hundore zanoret, të cilat janë përpara një bashkëtingëllore hundore.

Kështu mund të supozojmë se kemi zanoren hundore  $\hat{a}$  në fjalët:

*asct, gian, ranza, kanga, ngand, urandue, bahemi, cambe, e paangand, te laane, pegahen, çane*

---

<sup>124</sup> Omari, vep.cit.f. 50 e tutje. Bogdani e shënon hundorësinë e zanores me anë të pranëvënies së grafemës hundore  $n$ .

<sup>125</sup> Hyrje në historinë e gjuhës shqipe II, Tiranë, 1976, f. 232. K.Topalli, *Për historinë e hundorësisë së zanoreve në gjuhën shqipe*, Sh.B. Enciklopedike, Tiranë, f.27.

90 Omari, vep.cit. f. 50 e tutje. *Te Bogdani e ju bante spelene kussareuet* (CP II 88 16); *Bora e akulli banhene nde nji ren fort të njetë* (CP I 37,26)

91 *Te Buzuku se sene merisse* (XIV), *mire* (VIII), *tenezone* (XX/2):

Budi *fyalla e pare chi ththote*: (DC 13)

Bardhi në parathënie *dite e perdite*:

Bogdani *chi te ththote nuk anscte Hyj* (I 1/2).

Zanoren hundore *ê* e gjejmë në fjalët: *reenuem, mend, vend, cunvend, peende, creniine, [cenine, eembre, [cent*

3. Një nga tiparet e shqipes së vjetër nga të cilat është larguar jo vetëm gegërishtja, por dhe toskërishtja, është ruajtja e *ë*-së pastheksore.<sup>127</sup> Të gjitha fjalët me *ë* në pozicion pastheksor nuk e ruajnë më këtë *ë* më vonë, pasi ajo bie sidomos në gegërishte.

Një ndihmesë të veçantë për të kuptuar se deri kur ëshëtrruajtur *ë*-ja pastheksore na jep teksti ynë. Tingullin *ë* në pozicion pastheksor e gjejmë dhe te Kuvendi, kryesisht në pozicion fundor. Nuk janë të pakta dhe rastet kur *ë*-ja pastheksore ruhet dhe në ato fjalë të cilat në shqipen e sotme shkruhen pa *ë*.

*krou i veperavet mirave* (f. 1)

*bessogn mbe gnia te vetemin Hyi* (f. 2)

*urçenogneme te bahet* (f. 5)

*Chi ni merret paa mende te Kiscese as veperon* (f. 26)

Një tjetër tipar është dhe ruajtja e *ë*-së në pozicion paratheksor në fjalë si: *lumeni, dereijte, nderecchiune, calezuem* dukuri e vënë re dhe te autorët e tjerë.<sup>128</sup>

*ççemel i Scelbimit amescivem* (f. 1)

*..prej Eretikisc, me arresye larguem* (f. 4)

Tingullin *ë*, dhe pse në shumicën e rasteve ka rënë si në fjalët *Zotyn, asct, ksctu* etj, përsëri e gjejmë në pozicion fundor si në fjalët:

*duorete, te tieret, Archiupescupignete, Mescetaarete, te dereiten.*

*ezija nde kisce scende te Romese* (f. 1)

*te thone mescene* (f. 62)

*mbi guur te ngullune* (f. 1)

*per gni te refyem te gojese* (f. 1)

*acchie saa, paa Fee smundet* (f. 1)

4. Grupi grafik *ae* dhe *oe*. Këto dy grupe zanoresh nuk kanë karakter diftongor.

---

<sup>128</sup> Te Buzuku XVII, Psalm 37,20 *Mah anemiqte emi mahene endeh gazemend*; Te Budi (Dc 11) *Achjesianje merecullij*; Bogdani (I 7/3) *achia gazëmënd, e scijè*



Ato në librin e Buzukut nuk janë shkurtuar në zanore të gjata si dëgjohej sot në disa të folme të gegërishtes. Kështu në gegërishten veriperëndimore, më vonë togu *ae* dëgjohej si *e* e hapur, ndërsa togu *oe* si tingulli ndërmjetëm ndërmjet *o*–së dhe *e*-së.<sup>129</sup> Këto grupe vokalike i gjejmë si të tillë dhe te Budi, Bogdani. për të vazhduar më tej dhe në tekstin tonë, ku lexohen përkatësisht me *a*, *o* të theksuar gjë që vërehet në shembujt e mëposhtëm.

*jane vece per hae* (f. 68);

*sctat croena te Scelbuesit* (f. 19);

*Këtu asht të zgjedhunit e armëvet; këtu paa droe asht dobija;* (f. 15)

*se vece mbe Religione Cattolike droe s'asct meu scelbyem; e me droe jane te githe te reneguemit* (f. 13)

*me voese te diersve* (f. 47)

*te veene roe Parrachianete* (f. 26)

*mos te derdhen voesen e dheut* (f. 61)

*sì per te mire, e ngae te vete vece, jò per detyre* (f. 75)

5. Diftongjet *uo*, *ue* \ *ua*. Falë studimeve të studiuesve mbi këtë çështje është arritur në përfundimin se diftongu *ue* për gegërishten dhe *ua* për toskërishten e kanë burimin të diftongu më i hershëm *uo* dhe ky i fundit nga më i hershmi akoma *ou*. Sipas dhe Çabejt<sup>130</sup> dhe kjo *ou* e vjetër rrjedh nga një *o* përpara një lëngëzoreje ose hundoreje në rrokje të mbyllur<sup>131</sup>. Në shqipen e dokumentuar, të Buzuku dhe Budi,<sup>132</sup> pra, deri në shekullin XVII gjejmë shkallën *uo*, e cila është më e vonë se faza *ou* gjithashtu e dokumentuar<sup>133</sup>. Kështu, transformimi përfundimtar në *ue* ka ndodhur te Bardhi e Bogdani dhe më tej.<sup>134</sup> Sipas Çabejt faktori kohë dhe sidomos ndryshimet krahinore janë dukuritë që kanë ndikuar në zhvillimin e *uo* në *ue* te Bardhi dhe Bogdani. Në tekstin e Kuvendit të Arbënit, i cili në shumë pika ndjek rrugën e Çetës së Profetëve të Bogdanit është mjaft përhapur diftongu *ue*, i gjetur më shumë të foljet dhe sipas Ismajlit<sup>135</sup> teksti ynë e kishte të plotë si diftong fonetik. Më vonë,

<sup>129</sup> Lidhur me këtë çështje shih Çabej, *Studime gjuhësore VI, Prishtinë, 1977*, f. 127.

K.Topalli, *Disa veçori gjuhësore të tekstit Kuvendi i Arbënit*, SF 3-4 f. 81

Buzuku XLIX/2, Gjenezë 27,28 *en voesset se qiellet eteh maim en dheut*; Budi SC 144: *chi gjiththe cusc lij, e pa ndognie frike, o ndroe*. Bogdani *voesa anscte aj Auule*, I 37,25

<sup>130</sup> Po aty, f. 121

<sup>131</sup> Psh: nga lat. *capreolus* kemi *kapruall/kapruell* - kaprolli.

<sup>132</sup> Te Buzuku vërejmë: *tuehe enbeliedhune gjith Crenete e priftenet e scruosite e popullit* (XLVII, Mateu 20,19). Te Budi *nde krahanuort* (DC 83). Bogdani; *denjuem* (f 11, nr 9), *menguem* (f 25.nr 14)

<sup>133</sup> Për më shumë shih Çabej, vep.cit. f.122

<sup>134</sup> Mbi këtë çështje shih Çabej, po aty, f. 123

<sup>135</sup> Vep.cit.f. 109

në dorëshkrimin e Grottaferratës të Diego da Desio nuk del grupi *ue*, por shkalla më e vonshme e tij *uu* e shndërruar kështu në këtë fazë të shqipes në zanore të gjatë.

*me i paguem* (KA 37);

*meu forzuem* (KA 34);

*nde t'empsuemi* (KA 81)

*nde vepera te dhuunuescima* (KA 68);

*t'assaj bisce te malecueme* (KA 66)

*chi pa cuituem mire* (f. 30)

*io vece te Pagheuemevet, e te Kreemuevet* (f. 27)

*chi tue pusciuem scpirtenat atyne raccomandanduem punesc* (f. 62)

Megjithatë, siç vëren dhe Ismajli, mbeten për t'u sqaruar disa raste me *uo*. Grupin *uo* e gjejmë në fjalët: *suola, duoli, duoresc, muoj, huoj, duore, huoj, ruoigneme, cuotene, ruoitune, mbuoli, muorne, muoit etj.*

Në të gjithë tekstin janë gjetur rreth 40 fjalë që kanë në përbërje diftongun *uo*. Sipas R. Ismajlit<sup>136</sup>, kemi të bëjmë me një ndikim nga autorët e vjetër, konkretisht Budi.

6. Diftongjet *ie, ye*.<sup>137</sup> Këto diftongje kanë marrë dy rrugë të ndryshme në gjuhën e sotme shqipe sepse në gegërishte janë tkurrur në *i, y*, të gjatë, ndërsa në toskërishte ruhen si *ie, ye*. Duke u nisur nga studimet vërehet se *ie, ye* te autorët e vjetër ruhen të pandryshuara të paktën gjer te Bogdani.<sup>138</sup> Më poshtë do të shohm se këto grupe zanoresh ruhen dhe në tekstin e kuvendit të Arbënit, duke na sjellë një dëshmi të qartë se të paktën deri në fillim të shekullit XVIII, tkurrja në *i, y* nuk kishte filluar ende. Dhe në tekstin tonë vërehet një gjendje e tillë;

*paa fee smundet me pelchiyem* (f. 1)

*e hippi mbe chielit* (f. 2)

*lighiat, e te nkryemite t'assaj Kisce duo te marr* (f. 2)

*cundra ketyne prej Eretikisc, me arresye larguem* (f. 4)

*kinese et mpsognene Dielte* (f. 32)

7. Në fushën e konsonantizmit po ndalemi në ato raste të cilat kanë rëndësi për t'u njohur me një fazë më të hershme të shqipes.

---

<sup>136</sup> Ismajli, vep.cit, f. 122

<sup>137</sup> Faktikisht disa studiues si Çabej i konsideron si grupe zanore dhe jo diftongje.

<sup>138</sup> Te Buzuku: *ehigne uilli qi patne paate ende dalet the dielet* XXXVII Mateu, 2,9 : Budi Budi DC 26 *Christij mescerierscim; eme dritete chiellet; chijsc dita e Diell. Bardhi miel, Dieli, crye, Refyes. Bogdani: I 36?17 Ujètè prej se nzetit se diellit.*

*q-j* Sipas Çabej<sup>139</sup> kjo *q* ndërrohet në *j* para një *t*, por dhe para një *n, m, v, ç*. Kështu, në tekstet e vjetra<sup>140</sup> të paktën deri te Bogdani vërejmë ndërrimin e kësaj *q-je* në *j* në fjalë si: *pleite për pleqtë, zoite për zogjtë, mijte për miqte* etj. Në tekstin e Kuvendit vërejmë një stad të ri të zhvillimit të kësaj *q-je*. Shohim se *q-ja* ruhet e tillë, sidomos para një *t*:

*pae plechiete tue uleruem* (f. 1).

*E forza e Turchiet asct e paa uçe* (f. 33)

Megjitatë ndonjë relike nga autorët e vjetër vërehet te fjala *Turit për turqit*.

*...se ss' ii laane Turit* (f. 33)

*A jane Turit nder tà...* (f. 51)

7. Grupet *nd, mb, ng*. Një nga pikat karakteristike të ndarjes së sotme dialektore është shqiptimi i grupeve *mb, nd, ng*. Siç dihet, këto ruhen si të tilla në toskërishte, ndërsa në gegërishte kanë shkuar drejt asimilimit. Në shkrimet e autorëve të vjetër, deri te Bogdani i gjejmë format e plota. Sipas Çabej<sup>141</sup>, asimilimi i sotëm nuk ishte kryer gjer aty nga shekulli XVII e mundet gjer në kohë të Bogdanit (1685).<sup>142</sup>

Mendimi i Çabejt gjen mbështetje, madje kufiri kronologjik mund të shtyhet, pasi këto grupe bashkëtingëlloresh i gjejmë të plota dhe në tekstin e Kuvendit të Arbënit, pra dhe në fillim të shekullit XVIII, siç mund të vërehet në shembujt e mëposhtëm:

*duhet meu baam, e mbaruem* (f. 5)

*me ndighiuem Papess* (f. 4)

*mbe vend beecuem* (f. 21)

*po ngremognene te fescimit* (f. 40)

*mos te nderrohet forma* (f. 20)

*lodrat o kangat* (f. 60)

*tascti asct per t'u nderecchiune scpata* (f. 57)

*chi te cuntenten me ndegnune giççi i silli...* (f. 56)

---

<sup>139</sup> Vep.cit.f. 139-141

<sup>140</sup> Te Buzuku *a aih teh zotenogne pisqite edheut e zoit eqiellet* (Gjeneza 1,26) dhe Bardhi *ndaj Turit, Pleitee cuendit, me mijte*; Bogdani 4/18 *plejt'e parë, I3/10 ndojnë – Ndoqnë, 35/13 zojte – zogjtë..*

<sup>141</sup> Vep.cit. f. 144

<sup>142</sup> Te Buzuku gjejmë *Tue clene iezu enduu enmbedhiete, uietes* (XXXVII/2, Luka 2,42; XXXVIII, Gjoni 2,9 egrisi dhanderine e hi thah. Te Budi *temadhe ndeer* (DC 203); Bardhi *me mbastuem, Ndeer, me ngyem*:Bogdani *Andërratë, mballe fachie* (CP I 35/11, mbe Chiellt 35/12 .

*te cunvessene cafschia te Scenda* (f. 62)

8. Bshkëtingëllorja hundore qiellëzore *nj*. Kjo bashkëtingëllore ruhet kudo në veprat e vjetra të gegërishtes dhe del e shënuar me grafënë italiane *gn*.<sup>143</sup> Se deri kur ka vijuar ruajtja e *nj*, duke u nisur nga trajta *Merqinja*, fshati ku u mbledh Kuvendi i Arbënit (1706) dhe te gramatika e da Lecces (1716), mund të themi se në dialektin gegë ka qenë e përdorur të paktën pas fillimit të shekullit XVIII. Këtë e dëshmojnë dhe shembujt e shumtë të gjetur në tekstin tonë, madje dhe në ato raste ku i ka humbur dhe vetë toskërishtja.

*pr'ata urženogneme* (f. 32)

*chi ndigiognene* (f. 42)

*mbas se te hiigne* (f. 29)

*cu bagnene essapet* (f. 49)

*te sundognene rajat* (f. 47)

9. Grupet *kl, gl*. Për sa u përket grupeve *kl* e *gl* mund të themi se këto kanë pësuar ndryshime rrënjësose gjatë periudhës së shkrimit të shqipes. Kështu përfundimisht në shqipen e sotme, në shumicën e të folmeve të në dialektit gegë dhe atij toskë këto dy grupe janë shkrirë në tinguj të vetëm, në *q, gj*.<sup>144</sup> Megjithatë, në disa të folme për shembull në krahinën e gegërishtes veriperëndimore këto grupe janë reflektuar në *k-j, g-j*. Kjo shkallë është konsideruar si shkallë e ndërmjetme midis *kl, gl* të hershme dhe *q, gj* të sotme. Në disa të folme, si në gegërishten verilindore e lindore<sup>145</sup> *kl* e *gl* kanë shkuar deri në reduktim të *l*-së dukë dhënë *k* dhe *g*. Në tekstet e vjetra këto grupe bashkëtingëllorësh i gjejmë të kthyer në varësi të të folmes së secilit autor.<sup>146</sup>

Në tekstin e uvendit të Arbënit i gjejmë të reflektuar në *kj* dhe *gj*.

*as me dije kecchi tane giuhat* (f. 45)

*giaksi i te vobecchiet* (f. 72)

*Ament asctu chioft* (f. 2)

---

<sup>143</sup> Te Buzuku *Chanca e zognesse* (XIII/2); LXIII, Mateu 26,48 *u banih segn atune*; Budi *descerogn* (DC 17), *upesckepign* 67; *brigne* (DC 76); Bardhi *vlcogna, sheign, lagnene*: Bogdani 2/5 *kopesctigne, e kroena, 31/52 me bunjtune*, Plechienia e Sctepisse Bogdanagnet.

<sup>144</sup> Çabej, vep.cit. f.156

<sup>145</sup> Po aty, f.159

<sup>146</sup> Këto grupe i gjejmë të plota te Buzuku XXXVIII/2 Mateu 8,1 *Hen date mot tue clene Jezu diergune en malit*. VIII/2, *O zot endiglo uratene teme*. Te autorët gegë që vijnë më pas shohim format e reja; kështu te Budi gjejmë *k-j, g-j*, SC 48 *nde perralle, ender giomezij*: te Bogdani gjejmë velaret përkatëse *k* e *g* *psh*: I 101/18 *Përse ndegon atynë chi teththonë. 3/9 gni shëmbëlltyrë fort mbë gascètë t'bijrt*

*a priscne **giaan** e kiscese* (f. 52)  
*nd' u **giet** cusc* (f. 11)  
*tue **kiene** urçenimi i Tinëeot* (f. 62)  
*percassene corpne e **giakne** e Tinëeot* (f. 63)

10. Një dukuri interesante për t'u parë mbetet dhe dyfishimi, jo vetëm i zanoreve, të cilin e pamë më sipër, por dhe i bashkëtingëlloreve në mes të fjalëve, madje dhe në raste të panevojshme. Përdorimi i bashkëtingëlloreve dyfishe vërehet jo vetëm në tekstin tonë, por dhe në sistemin grafik të Bogdanit<sup>147</sup>, sidomos grafemat *t* dhe *s*. Sipas studiuesve, dyfishimi i bashkëtingëlloreve ka vetëm vlerë grafike. Çabej<sup>148</sup> këtë dukuri e justifikon me ndikim të grafisë latino-italiane. Në tekstin tonë në disa raste autori është detyruar të dyfishojë bashkëtingëlloren, sidomos kur ajo të tjera shënonte dy tinguj njëkohësisht. Një rast është bashkëtingëllorja *s*, e cila do të ngatërrohej me *z*, në qoftë se do të shkruhej një herë pasi me një *s* shpesh autori ka shënuar dhe *z*. Për raste të tjera, si dyfishimi i *t* nuk kemi gjetur ndonjë shpjegim.

*jane **stolissune*** (f. 48)  
*e **begattiavete** huoja* (f. 29)  
*e per mend8ra te lettravet* (f. 81)  
*essapi i **missionarevet*** (f. 76)  
*dispensat e **martessevet*** (f. 45)  
*mbe vend te **ndejessese*** (f. 60)  
*cù **afferohe**mi nde per scteku ..* (f. 31)  
*pràa **tue ezzune** paa puscium nde per venescti* (f. 80)  
*mb'at faji te prittesse, chi gnittet te feescimevet* (f. 31)

11. Një tjetër dukuri fonetike e vënë re në tekstin tonë është përdorimi i shpeshtë i protezës, dukuri e përbashkët në tekstet e vjetra.

*me **nkeççyem** vessete mbe **essap** te mire* (f. 15)  
*Feeja Katolike e **paa ngand** mbahet* (f. 1)  
*Te falla chi **mbaræohen** me vobeie* (f. 9)  
*Me te lutunat **mbasck** luss Hyin* (f. 9)

Këto veçori dhe të tjera akoma që mund të vërehen në rrafshin fonetik, jo vetëm në tekstin e Kuvendit të Arbënit, si teksti më i gjërë e më i rëndësishëm i shekullit

---

<sup>147</sup> Omari, vep.cit.f. 55 *dritta, vettëhe, ndritten, assi motti, dissa, me bessuem* etj.

<sup>148</sup> Vep.cit f.49

XVIII, por dhe në të gjitha tekstet e tjera të vjetra, çojnë në përfundimin se tekste të tilla kanë rëndësi të madhe për historinë e alfabetit të gjuhës shqipe, pasi na ndihmon të vërejmë zhvillimin dhe konsolidimin e sistemit grafik të shqipes së vjetër.

## Kreu III

### Shqipja përballë latinishtes në rrafshin morfo-sintaksor

Dihet tashmë se studiues të shumtë kanë provuar në mënyrë të pakundërshtueshme karakterin indoevropian të gjuhës shqipe. Ata, në studimet e tyre kanë vërtetuar se shqipja ka trashëguar nga gjuha indoevropiane elementet themelore të strukturës së saj. Gjuha shqipe gjatë historisë së saj ka pasur kontakte me gjuhë të tjera duke qenë vazhdimisht në ndikim të këtyre gjuhëve. Një nga këto gjuhë ka qenë latinishtja me të cilën ka qenë në kontakt për më shumë se pesëqind vjet, vite të zotërimit romak në Shqipëri. Kultura dhe gjuha latine la gjurmë të thella në gjuhën shqipe, sidomos në leksik. Disa studiues, gjatë fundit të shekullit XIX mendonin se latinishtja kishte ndikuar jo vetëm në leksik, por madje dhe në struktura morfologjike duke nxjerrë përfundimin e gabuar se shqipja është gjuhë gjysmëromane<sup>149</sup>. Por këto teori kanë rënë dhe studiues si G.Meyer, H. Pedersen, C.Tagliavini e të tjerë kanë pohuar se ndikimi i latinishtes mbi optimin është i barabartë me zero dhe ndikimi mbi strukturën gramatikore të shqipes në përgjithësi është minimal.

Teksti shqip i Kuvendit të Arbënit si tekst i rëndësishëm për historinë e gjuhës shqipe na jep një pasqyrim të plotë të strukturës së shqipes së atëhershme.

Gjuha e Kuvendit të Arbënit është e kushtëzuar pikë së pari nga veçoritë sintaksore e morfologjike të së folmes, së cilës i përkiste autori i përkthimit të akteve të dala nga Kuvendi i Arbënit. Jo vetëm kaq. Duke qenë se kemi të bëjmë me një përkthim nga një gjuhë e huaj, në rastin tonë nga latinishtja, disa veçori të tjera do të lidhen me shkallën e ndikimit të tekstit burimor në strukturën morfo-sintaksore të tekstit shqip të Kuvendit. A kemi të bëjmë me një shkallë të lartë të ndikimit latin e cila ka çuar në një pasqyrim jo real të strukturave të mirëfillta të shqipes?

Për këtë arsye do të ishte me interes të vendosnim tekstin shqip të Kuvendit përballë tekstit latin dhe si e ka përballuar shqipja e shekullit XVIII strukturën gramatikore dhe leksikun e pasur të latinishtes.

---

<sup>149</sup> Për më shumë shih C. Tagliavini, *Le origini dell' lingue neolatine*, Bologna, 1964.

### III. 1 Sistemi emëror

Sistemi eptimor i shqipes i trashëguar nga indoevropianishtja<sup>150</sup> ka pësuar ndryshime të rëndësishme. Me gjithë këto ndryshime dhe risi të shumta, struktura morfologjike e shqipes vazhdon të ruajë karakterin eptimor sintetik të indoevropianishtes. E njëjta gjë mund të thuhet dhe për latinishten, e cila gjithashtu i është larguar indoevropianishtes, duke pësuar ndryshime të rëndësishme, ndryshime që lidhen si me sistemin emëror ashtu dhe me atë foljor.

Sistemi emëror i shqipes në të cilin bën pjesë emri, mbiemri dhe përemri, i dokumentuar në librin e parë të shqipes, Meshari i Buzukut (1555), na paraqitet me risi të shumta, të cilat e kanë burimin që në periudhën parashkrimore të shqipes, kohë në të cilën shqipja kishte humbur disa nga tiparet e indoevropianishtes. Gjatë evolucionit historik të sistemit emëror janë vërejtur ndryshime të rëndësishme në kategorinë gramatikore siç është thjeshtimi i sistemit tre gjinish duke mënjanuar përdorimin e gjinisë asnjane dhe thjeshtimi i sistemit tre numrash me mënjanimin e dyjësit. Zhdukja e dyjësit<sup>151</sup> vërehet dhe në gjuhën latine, në të cilën gjejmë binomin *njëjës – shumës*, por nga ana tjetër dyjësit e gjejmë në gjuhën greke të vjetër. Edhe në kategorinë e rasës vërejmë ndryshime siç është reduktimi i numrit të rasave, ndryshime që sigurisht kanë ndodhur në fazën parashkrimore të shqipes, duke qenë se në tekstin e Buzukut gjejmë po atë numër rasash, që përdoren dhe në shqipen e sotme. Një risi e shqipes është dhe krijimi i kategorisë së shquarsisë dhe i pashquarsisë, gjë që nuk ekziston në gjuhën latine, por është krijuar në gjuhët romane që burojnë prej latinishtes. Lidhur me këtë çështje do të flitet në vazhdim në mënyrë më të zgjeruar.

Në vazhdim përballë sistemit emëror të latinishtes do të vendoset sistemi emëror i shqipes së Kuvendit të Arbënit, duke na nxjerrë në pah mundësitë reale të shqipes dhe njëkohësisht veçori të këtij sistemi, në një fazë të ndërmjetme të shqipes, siç është ajo e shekullit të XVIII.

---

<sup>150</sup> Të mos harojmë se “indoevropianishtja” nuk është një koncept historiko-gjuhësor: kurrë nuk ka ekzistuar një gjuhë indoevropiane, por një tërësi dialektesh, të karakterizuara nga një sistem fonetik i përbashkët, por me tipare të dallueshme në morfologji, sintaksë dhe sidomos në leksik.

<sup>151</sup> Sipas studiuesve dhe latinishtja si gjuhë indoevropiane duhet të kishte trashëguar sistemin prej tre numrave, por te vërtetimi i ekzistencës së dikurshme nuk është arritur.



### III. 1.1 Gjinia.

Latinishtja si gjuhë indoevropiane ka trashëguar sistemin tri gjinish: *genus masculinum*, (gjinia mashkullore), *genus femininum* (gjinia femërore) dhe *neutrum* (gjinia asnjënjë). Por, ndërsa për latinishten studiuesit nuk kanë hedhur dyshime mbi ekzistencën e këtij sistemi tri gjinish, duke pohuar se e ka trashëguar nga indoevropianishtja, për gjuhën shqipe disa studiues si Hahn, Bopp dhe Meyer kanë hedhur mendime se gjinia asnjënjë nuk ekziston në gjuhën shqipe. Të tjerë studiues si Da Lecce, autor i së parës gramatikë të shqipes, Pedërseni, Weigandi, Jokli, Myderrizi<sup>152</sup>, Demiraj<sup>153</sup> Çabej<sup>154</sup> kanë pranuar ekzistencën e gjinisë asnjënjë dhe karakterin indoevropian të saj. Madje disa prej tyre si I.Ajeti<sup>155</sup> mendojnë se emrat asnjënjë të latinishtes dhe greqishtes së vjetër kanë hyrë me të njëjtën gjini, por që me kalimin e kohës e kanë ndryshuar. Fundoren ë këta studiues e lidhin me mbaresën – *a* të shumësit të emrave asnjënjë<sup>156</sup>.

Këta studiues bazuar në etimologjinë e fjalëve nxjerrin përfundimin se disa emra me burim latin, kanë qenë të gjinisë asnjënjë, pasi dhe fjalët përgjegjëse latine janë në gjininë asnjënjë. Bëhet fjalë për emra konkretë, kryesisht emra lëndë si: *brumë, drithë, dhjamë, grurë, vaj, ar, rrjetë* shumica e të cilëve në shqipen e sotme mbaron me zanoren ë. Këtë ë Çabej<sup>157</sup> e sheh si refleks të –*a* së së gjatë të emrave asnjënjë të indoevropianishtes dhe veçanërisht të latinishtes. Po Çabej në studimin *Karakteristikat e huazimeve latine në gjuhën shqipe*, SF 2, 1974, 18, vë në dukje se “*ruajtja e neutrave të latinishtes në shqipen na dëfton për një periudë më të vjetër huazimesh, në të cilën neutri ishte ende i gjallë në latinishten*”. Është e vërtetë që këta emra tani në gjuhën e sotme shqipe po përdoren si mashkullorë *gruri, vaji, brumi, djathi, uji* etj., por në tekstin e parë të shqipes, meshari i Buzukut i gjejmë si asnjënjë të mirëfilltë dhe pse të paktë në numër. Kështu, te Buzuku gjejmë *damtë, drithëtë, vojtë, fajtë, muojtë* të cilat dhe përgjigjëset e tyre në gjuhën latine përkatësisht *damnum, triticum, oleum, fallium*, janë gjithashtu emra të gjinisë asnjënjë të lakimit të dytë që mbarojnë me mbaresën – *um*.

Në tekstin e Kuvendit të Arbënit i botuar në vitin 1706, emrat e mirëfilltë të gjinisë asnjënjë, të sipërpërmendur janë zhdukur, duke shënuar një hap përpara në

<sup>152</sup> Osman, Myderrizi, *Gramatika e parë e shqipes*, Tiranë, 1944

<sup>153</sup> Një përmbledhje mbi qëndrimet e studiuesve shih Sh.Demiraj *Gramatikë historike e gjuhës shqipe*, f. 184- 205

<sup>154</sup> E.Çabej, “*Karakteristikat e huazimeve latine në gjuhën shqipe*”, SF, 1974/2

<sup>155</sup> I.Ajeti, *Historia e gjuhës shqipe* (Morfologjia historike), Prishtinë, 1969

<sup>156</sup> Lidhur me burimin e fundores ë shih Mahir Domi, *Morfologjia historike*, Tiranë 1961; Sh.Demiraj vep.cit. f. 187-189

<sup>157</sup> Po aty, f. 18

krahasim me tekstet e tjera të vjetra, pasi siç u tha më lart këta emra, në tekstin tonë, kanë kaluar në gjininë mashkullore. Të vihen re shembujt e mëposhtëm.

*ut cauta provisione revocetur ad praxim, quod pernicioosa ignorantia intermissum est ad damnum* (f. 36)

*te hicchiet prej Arbenit c **dammi**, e t'mbarogn puna, e lighia e scendeccemeja* (f. 27)

*pias Fidelium oblationes in **tritico, vino, et caseo**, sub districti censura rigoris, et pernicioosa Sacramentorum privatione non extorqueant* (f. 52)

*Mos te ngremognene Tefeescimi me jinati te censurevet, e me privimi te Sci sacramentavet per pune te lemoscenavet te **driççit**, te venese, ndo **diaççit**, chi appene Upesckupignevet* (f. 46)

*ut quicumque in hoc unico signo deficit, **ab** Ecclesia se divellat* (f. 21))  
*Pr'atà ai chi s'ëpp ketà scegnajite Feese, paa rreene banet i paa Fee, e dahet ' n kiscet* (f. 9)

Përrjashtim bën shembulli i fundit në të cilin, mendojmë se kemi gjetur një emër të gjinisë asnjane. Ajo që na çon në këtë përfundim, është fundorja –të / të shenjajtë, tipike e emrave asnjane, si dhe përgjegjësja e saj në latinishte *signum*, po emër i gjinisë asnjane.

Nga sa u tha më sipër, gjinia asnjane që nga Buzuku duke vijuar me tekstet e mëvonshme e deri në shqipen e sotme ka ardhur duke u rrudhur<sup>158</sup>, duke u kufizuar në disa grupe emrash të nyjshëm prejfoljorë, si rezultat i emëzimit të pjesoreve. Emra të tillë asnjane janë të shumtë në tekstin shqip dhe në tekstin latin u përgjigjen emra të gjinisë femërore ose mashkullore dhe në të shumtën e rasteve shpesh herë me gerundin latin<sup>159</sup>.

*prestantissimum **docendi** munus* (f. 23)

*ëaanati i nderscimi i të **mpsuemit*** (f. 12)

*verba factis compleant* (f. 51)

*fialla te i mbarognene **me të baamitë*** (f. 45)

*fidei conservandae propagationem* (f. 15)

---

<sup>158</sup> Për më shumë mbi emrat asnjane të shqipes së sotme shih *Gramatika e gjuhës shqipe I*, Tiranë, 1995, f. 93

<sup>159</sup> Lidhur me gerundin latin dhe atë shqip ndryshe *përcjellore* do të flitet më shumë në kapitujt pasardhës.

*per te mbajtunit, të sciumuemit të feese (f. 1)*

*...quam conversionem Ecclesia Transubstantiationem appellat. (f. 17)*  
*e ketà te nkçç emit e chiuen Kiscia Kattolike, Transubstantioni ... (f. 3)*

*haec pollutio egressa est (f.48)*  
*ketà te fełigiunit duoli (f. 41)*

*nisi in oratione, et ieiunio, quo dum corpus atteritur, anima caelestis gratiae pinguedine saginatur (f. 26)*  
*Se kiò dore Diemenisc nuk largohet, vece me Urat, e me agninim." Me te sillt ende se lighet corpi; Scpirti pò majet me te maimite hiiit chiełscim. (f. 15)*

*Ne, senescente iam mundo, charitas quoque refrigescat, cum omnes... (f. 76)*  
*Tue u mplakune Sceculi, mos te ftofet end te dasciunit... (f. 74)*

*At ubi abundant nostra calamitas, ibi superabundat et charitas Sacrae Congregationis de propaganda fide... (f. 44)*  
*Por tu ku asct maa nevoja jona, aty maa fort asct tedasciunit e Cunvendit Scind te propagandese... (f. 37)*

*Quia vero summa divinarum ignorantia cōfītendi modum .... (f. 37)*  
*P ò persè prej se paditunit se cafsciavet Hyinuescime.... (f. 28)*

*Sic enim quod corrigendum est, corrigent et quod sanum est, divino zeli fervore costodient. (f. 50)*  
*se ksctu kane me nderecchiune ci dò asct i screme, e kane me rueitune ci dò asct Scendosc me te nzetit te eelit (f. 43)*

*quo possint reprobare malum, et eligere bonum (f. 38)*  
*chi munden me eghieçune temiret, e me larguem te kecchit (f. 29)*

Të vërehet në shembullin e fundit përkhimi i asnjësës *malum/ bonum* e latinishtes, po me emër të gjinisë asnjësë, të *kecchit/të mirët*.

Në tekstin shqip të Kuvendit dhe jo vetëm këtu, por dhe te autorët e vjetër veriorë, vërejmë përdorimin në gjininë femërore të disa emrave jofrymorësh, të cilët në shqipen e sotme përdoren si mashkullorë. Bëhet fjalë për emrat të tillë si : *shëndet-ja, qytet-ja, vollundet-ja, pusctet-ja*. të cilët janë njëkohësisht huazime nga

latinishtja përkatësisht *sanitas/ sanitatis, civitas/civitatis, voluntas voluntatis, potestas, potestatis, virtus, virtutis*.<sup>160</sup> Këta emra të lakimit të tretë dhe në gjuhën latine janë të gjinisë femërore, me përjashtim të emrit *honor*, i cili është i gjinisë mashkullore. Kështu gjejmë *ndereja*, gjë që mund të shpjegohet si ndikim të grupit të emrave të mësipërm. Kështu në tekstin tonë emrin *ndereja* e gjejmë si emër të gjinisë femërore dhe megjithëse përgjegjësja e tij në gjuhën latine është i gjinisë mashkullore *honor, honoris*.

*Speciosa germina a potestate tenebrarum eruta (f. 22)*

*Te hijescimat biimate Criscitit nzierre prej **pusctetejese** terretit mcatit (f. 10)*

*divinus honor in terris (f. 26)*

***ndereja** e Hyit mbe çeeete (f. 15)*

*Episcopalis **honor** dignitatis, magno ministerii oneri Angelicis... (f. 50)*

***Ndereja** e pusctetese se maçe t' Upesckupignenijese per pune te rande... (f. 44)*

*ne parochorum incuria, vel defectu, **virtus**, et efficacia Sacramento deficiat (f.30)*

*mos u mengoft Sciecrementit **vert teja**, e viimi per faii, e prittese te Parrocchianevet (f. 20)*

*quia nobiscum est magnus Dominus, et magna virtus eius (f. 350)*

*persè me nee asct i maçi Σot, e **virt teja** e **maçeja** etii (f. 26)*

*qui Albanæ Synodo legitime inetrant, consilio et assensu (f.15)*

*chi ndoçen mbe Conciλ me **volundete**, e me ksciλtit (f. 1)*

*et nostri iuris praecipua fundatur **auctoritas** (f. 23)*

*nde ketà kàa ççemelne **puscteteja** e essapit tiine (f. 12)*

*Potest quidem a privata persona, quae omni caret **auctoritate** (f. 21)*

*mund jete se te pyete cusc, ci s'kà **pusctene** (f. 9)*

*Nihil nobilius, nihil pretiosius, nihilque ad aeternam **salutem** consequendam magis necessarium habet Ecclesia.... (f. 29 )*

*As giaa maa te beganiscim, as giaa maa të paçomueshime, as giaa maa te*

---

<sup>160</sup> Sipas Demirajt, këta emra dhe në gjuhën shqipe dikur kanë qenë të gjinisë femërore, *Gramatikë historike*, vep.cit. f. 205.

*nevoisimee kaa Kiscia per t'u passune scendeteja e paa sossune....(f. 19)*

### III.1.2      **Kategoria gramatikore e rasës.**

Në fushën e morfologjisë me interes mbeten trajtat e ndryshme gramatikore që merr emri sipas rasave. Duke qenë se kemi të bëjmë me një përkthim nga latinishtja, qëllimi ynë do të jetë ballafaqimi i sistemit rasor të shqipes me atë të latinishtes. Do të vërehen përputhjet a mospërputhjet që mund të ekzistojnë ndërmjet dy sistemeve, nëse ka ndikime të tekstit latin në atë shqip dhe si e ka përballuar shqipja këtë dukuri.

Siç dihet latinishtja ka ruajtur sistemin prej gjashtë rasash, nga tetë që kanë njohur gjuhët e hershme indoevropiane.

Rasat e latinishtes janë: *nominativus* (emërorja), *genitivus* (gjinorja), *dativus* (dhanorja), *accusativus* (kallëzorja), *ablativus* (rrjedhorja) dhe *vocativus* (thirrorja).

Në gjuhën shqipe, numri i rasave paraqitet i reduktuar. Ato janë pesë: *emërorja*, *gjinorja*, *dhanorja*, *kallëzorja* dhe *rrjedhorja*. Ky numër rasash vërehet dhe në tekstin e Kuvendit të Arbënit.

Kështu, sistemi rasor i latinishtes ka edhe thirroren<sup>161</sup>, e cila në fillim qëndronte jashtë sistemit rasor. Bashkë me emëroren dhe kallëzoren tradicionalisht janë quajtur *rasa të drejta (casus recti)*. Nga këndvështrimi morfologjik thirrorja e latinishtes ndryshon nga emërorja vetëm në emrat e gjinisë mashkullore të lakimin e dytë. Për këtë arsye shpesh ka ndodhur që këto dy rasa të zënë vendin e njëra tjetrës.

Dhe në gjuhën shqipe gjuhëtarët<sup>162</sup> nuk e kanë pranuar si rasë më vete. Trajtat e njëjta me rasën emërore si të emrit, të mbiemrit dhe të ndonjë fjale tjetër përcaktuese janë arsyet e një qëndrimi të tillë.

Nga ana tjetër në tekstin e parë të shqipes, *Meshari* i Buzukut dhe në tekstin tonë bien në sy disa forma rasore, që sot kanë dalë nga përdorimi ose përdorimi i tyre është kufizuar në disa të folme. Këto forma rasore janë të shqipes dhe janë formuar gjatë evolucionit të brendshëm gjuhësor.

Ndër to mund të përmendim të ashtuquajturën *rasë vendore* ose *kallëzore parafjalore*, rrjedhoren e shumësit me *-shit*, rrjedhoren e shquar në numrin njëjës të tipit *prej shtëpiet*, gjinoren e shumësit të tipit *e malevet* ku mbaresës së shumësit *-ve* i prapavendoset mbaresja e trajtës së shquar *-t*.

---

<sup>161</sup>Thirrorja, falë autonomisë sintaksore, ishte jashtë sistemit rasor. Më vonë u njoh si rasë më vete nga gramatikanët grekë me emrin *κλητικη πτωσις* [kletike ptosis], shprehje e përkthyer nga latinishtja si *vocativus casus*.

<sup>162</sup>*Gramatika e gjuhës shqipe*, Tiranë 1995, f.107

*pastores animarum* (f. 21)  
*ciobanete e scirtinavet* (f. 8)

*nostrarum Ecclesiarum faciem* (f. 43)  
*fet ren e kisciavet tona* (f. 35)

*dispensationes matrimoniales* ( f. 51)  
*dispensat e martessavet* (f. 45)

Kemi dhe raste të gjinore së vjetër me *-et* në vend të *-vet*. Këtë gjinore e gjejmë dhe te Buzuku, Budi, Bardhi e Bogdani, por në përdorim më të madh dhe jo kaq të rrudhur, siç e gjejmë në tekstin tonë.

*in corrigendis parochorum defectibus* (f.51)  
*me castiguem faijet e parochiet* (f.46)

*Apostolico ritu Villullas suae subditas...* (f. 81)  
*me essapi t'Apostuijet te sckognene nde per katunde* (f. 80)

### **Rasa emërore.**

Rasa emërore, si në gjuhën shqipe, ashtu dhe në atë latine është rasa e kryefjalës dhe e të gjitha elementeve që i referohen asaj: kallëzuesori i kryefjalës, gjymtyra emërore e kallëzuesit emëror, si dhe ndajshtimi. Në shqipe shërben dhe si thirrur.

Duke pasur parasysh funksionet e pastra të rasës emërore, si te latinishtja ashtu dhe në gjuhët e tjera indoevropiane, kuptohet që nuk është i nevojshëm përdorimi i parafjalëve për këtë rasë. Por shqipja ka ndjekur një rrugë tjetër, të ndryshme nga latinishtja, duke njohur përdorimin e rasës emërore me parafjalët: *nga*, *te*, *tek* dhe duke formuar kështu rrethorët e vendit që tregojnë pikënisjen e lëvizjes ose pikëpërfundimin e saj.<sup>163</sup> “Me këtë veçori, shqipja është e vetmja gjuhë indoevropiane, ndoshta e vetmja gjuhë e gjallë në botë, që njeh përdorimin e emërores me parafjalë. Nisur nga kjo nuk është e vështirë të arrihet në përfundim se përdorimi i emërores me parafjalë nuk

---

<sup>163</sup> *Gramatika e gjuhës shqipe*, Vëllimi II, Sintaksa, Tiranë, 1997, f. 271

mund të jetë dukuri e trashëguar, por është shfaqur gjatë evolucionit historik të gjuhës shqipe”.<sup>164</sup>

Që kemi të bëjmë me një dukuri të hershme e vërteton dhe fakti se përdorimin e emërores me parafjalë e gjejmë dhe në librin e parë të shqipes *Meshari* i Buzukut.<sup>165</sup> Më shumë mbi parafjalët e rasës emërore do të flitet në kapitullin mbi parafjalët.

### ***Rasa gjinore***

Kjo rasë që nga Buzuku e këtej është përdorur në funksionin e përcaktorit të një gjymtyre tjetër emërore. Gjinorja në trajtën e shquar, në numrin njëjës del me mbaresën *-së* për emrat e gjinisë femërore dhe *-t* për ato të gjinisë mashkullore. Në këtë rasë, në numrin shumës emrat e gjinisë mashkullore me temë në zanore dalin me mbaresën rasore *-ve* në shumicën e rasteve, por dhe *-vet*, ndonëse në përdorim më të rrallë. Siç dihet kjo *t* që i bashkangjitet mbaresës së shumësit për rasën gjinore e dhanore gjatë shekujve të fundit ka rënë, dhe përdorej pikërisht për të treguar shquarsinë.

*E mba kiscia e Romese* (f. 32)

*ciobanete e scpirtinavet* (f. 8)

*fet ren e kisciavet tona* (f. 35)

*dispensat e martessavet* (f. 45)

*Mirefil puna e maçe e kach misterievet dō* (f. 20)

Kemi dhe raste të gjinore së vjetër me *-et* në vend të *-vet*. Këtë gjinore e gjejmë dhe te Buzuku, Budi, Bardhi e Bogdani, por në përdorim më të madh dhe jo kaq të rrudhur, siç e gjejmë në tekstin tonë.

*me castiguem fajet e parochiet* (f. 46)

*me essapi t'Apostuijet* (f. 80)

*Pò cù silla, e forza e Turchiet asct e paa uçe* (f. 33)

Përveç veçorive morfologjike të gjinore në shqipen e Kuvendit të Arbënit, duhen vënë në dukje edhe funksionet përcaktuese të gjinore latine dhe si kanë ardhur në shqipen e Kuvendit të Arbënit.

---

<sup>164</sup> Demiraj, vep.cit. f. 641- 643.

<sup>165</sup> Për më shumë mbi përdorimin e emërores me parafjalë dhe funksionin sintaksor të këtyre parafjalëve shih Karagjozi, vep.cit. f. 79. 108

Në fjalinë latine kjo rasë mbulon një sërë funksionesh. Gjinorja në gjuhën latine luan rol në përcaktimin a saktësimin, jo vetëm të një emri, por dhe të një foljeje dhe të një mbiemri. Kështu kemi:

1) Gjinore që varet nga emri, si në gjuhën shqipe.

( *flores horti* - lulet e *kopshtit* )

a) *gjinorja e pronësisë.*

b) *gjinorja epeksegetike (e përcaktimit).*

c) *gjinorja e përkatësisë.*

d) *gjinorja që tregon një pjesë nga e tëra. (partitive)*

e) *gjinorja e cilësisë.*

2) Gjinore që varet nga mbiemri:

( *cupidus potestatis* - i etur *për pushtet* )

a. *gjinore me mbiemra.*

b. *gjinore me pjesore.*

3) Gjinore që varet nga folja.

( *magistri interest* - i intereson *mësuesit* )

a) *gjinore që varet nga foljet që tregojnë vlerësim, si aestimo, vendo, accuso, condemno;*

b) *gjinore që varet nga foljet e kujtesës, si: memini, obliviscor;*

Secila nga këto gjinore kryen funksione të rëndësishme në fjali dhe do të ishte me interes të shihnim se si kanë ardhur në gjuhën shqipe disa nga këto funksione të gjinore latine.

1. *Gjinorja e pronësisë*, si *gjinorja më e përdorur*, shërben për të treguar të përkitur. Në shqipe gjithashtu, e njohim këtë përdorim dhe në tekstin tonë është dhënë kryesisht me togfjalëshin *emër + emër*, tek i cili gjymtyra e varur është në rasën *gjinore*.

Versioni latin

Versioni shqip:

a) *sit lumen animae* (f. 15)

b) *radix virtutum* (f. 15)

c) *dispensationes matrimoniales* (f. 51)

ç) *factorem Caeli et Terrae* (f. 15)

a) *asct dritta e Scpirtit* (f. 1)

b) *ranza e virt tevet* (f. 1)

c) *dispensat e martesavet*  
(f. 45)

ç) *Criiuessin e chielse, e te çeut*  
(f. 2)



Në këta katër shembuj rasa gjinore në tre prej tyre është përkthyer me togefjalëshin emër + emër, si në latinishtë.

Në shembullin e tretë autori është larguar nga togefjalëshi latin, duke dhënë mbiemrin *matrimoniales* me një emër në gjinore.

Në gjuhën shqipe togefjalëshat *emër + mbiemër* këmbehen shpesh me një togefjalësh të përbërë nga një *emër + emër* tjetër në rasën gjinore. Psh: *njeri besnik = njeri i besës, punëtor –njeri i punës, i ditur - i dijes*.

2. *Gjinorja e përkatësisë*. Kjo gjinore është në raport të ngushtë me atë të pronësisë dhe në shqipen e Kuvendit vjen me anë të shprehjeve “*është detyrë.., apo i përket..., i takon*” .., dhe emri shkon në rasën dhanore.

*tenet sancta Mater Ecclesia, cuius est iudicare de vero sensu, et interpretatione Sacrarum Scripturarum*. (f. 16)

*mba scendeja Ama Kiscia, cui perket me giucuem, e me dischiaruem te vertetene e Ungilit, e te Sckruemit scind* (f. 3)

Në këtë rast, duke qenë se kemi të bëjmë me një fjali të nënrenditur përcaktore, në rasën dhanore shkon përemri lidhor *cui*.

3. *Gjinorja epeksegjetike ose e përcaktimit*. Kjo gjinore tregon specifikon një emër të një koncepti të përgjithshëm.

*legendi, ed etiam scribendi habeat peritiam* (f. 44)

*te diine me lezuem e me sckruem* (f. 36)

Në këtë shembull autori ka bërë një përkthim të lirë duke i përkthyer me paskajore, gjinoret e shprehura me gerund.

Gjinorja latine, siç u tha më lart varet dhe nga mbiemri. Një përdorim i tillë në tekstin shqip është dhënë me një emër në gjinore, ashtu si në latinishtë.

*An turpis lucri cupidi?* (f. 58)

*A jane lakmuessi te giaase turpe.* (f. 52)

### ***Rasa dhanore.***

Dhanorja, ashtu si gjinorja, në trajtën e shquar, në numrin njëjës tek emrat e gjinisë femërore ka dalë me mbaresën rasore –*së* dhe tek ato të gjinisë mashkullore ka dalë me *-t*. Ndërsa në shumës, emrat në dhanore dalin me

mbaresën –*vet* ose –*et* pa bashkëtingëlloren antihiatizuese *v*, ashtu si dhe në gjinore.

*omnibus Episcopis commendamus* (f. 20)

*giçç Upesckupignevet raccommandoime* (f. 8)

*praelibatae Sacrae Congregationi conferant* (f. 59)

*te i deftoqnene pretemirit Cunvendit Scind* (f. 53)

*Mandamus praeterea Confessariis omnibus...* (f. 39)

*urçënognome ende giççeve Ref esset...*(f. 30)

*Praecipimus, ne Parochi sub poena suspensionis...* (f. 68)

*Urçënognome pràa Parrochiet ndene castighimi të suspendimit....* (f. 64)

Dhanorja në shqipe përdoret zakonisht me folje të cilat mund të jenë kalimtare ose jokalimtare dhe është rasa e kundrinorit të zhdrejtë. Dhe në latinishte dhanorja njih këtë përdorim, por ndryshe nga shqipja varet jo vetëm nga folja, por dhe nga mbiemri.

Ashtu si në shqipe dhe në latinishte, dhanorja përdoret me foljet kalimtare që kërkojnë dhanoren e personit apo të sendit drejt të cilit është drejtuar veprimi, d.m.th kundrinorin e zhdrejtë.

Në latinishte forma të veçanta të dhanores janë:

- a) *dhanorja e qëllimit*
- b) *dhanorja e interesit*
- c) *dhanorja e pronësisë*
- d) *dhanorja etike*
- e) *dhanorja e marrëdhënies.*
- f) *dhanorja e vepruesit*

a) *Dhanorja e qëllimit.* Kjo dhanore tregon se cilit i drejtohet veprimi i shprehur nga folja kalimtare. Veprimi mund të jetë në dobi ose në dëm të personit apo gjësë së shprehur në dhanore. Ndryshe njihet si *dativus commodi dhe incommodi*) Kjo e fundit saktësohet nga kundrinori i drejtë. Në gjuhën latine kjo dhanore shoqërohet me folje si: *dare, committēre, tribuēre, reddēre.*

*necessarii officii rationem Divinae iustitiae esse reddendam* (f. 24)

*se nuk scpetton, paa çane aresye Gi chit Tinesot* (f. 12)

*sicut Sponsa ornata Viro suo circumamicta monilibus aureis .... (f. 20)*  
*stolissune sicuur Nusseja **Burrít vet**, buccure reççuem me ciaprasse t'areta...*  
(f. 7)

b) *Dhanorja e interesit*. Këtë dhanore e kërkojnë dhe disa folje që në latinishte janë jokalimtare, ndërsa në shqipe përkthehen me folje kalimtare që kërkojnë rasën kallëzore. (*suadeo- këshilloj, persuadeo-bind, faveo- favorizoj, ignosco- fal, satisfacio- kënaq e të tjera*).

*Dominus non ignoscet illis (f.48)*  
*Σοτύνι nuk po ndijen **at ne** (f. 42)*

Folja *ndiej* me kuptimin *fal*, në gjuhën shqipe e kërkon kundrinorin në rasën kallëzore, por në shembullin që cituam është përdorur me rasën dhanore. Me sa duket kemi të bëjmë me ndikim të tekstit latin.

*parochis quoque omnibus praecipimus et mandamus (f.24)*  
*parrochianevet ende giççeve ççome e urçenoime (f. 12)*

Në gjuhën latine foljet *praecipere* dhe *mandare* kërkojnë dhanoren. Ruajtja e rendit të fjalëve të tekstit latin dhe përkthimi i tij *ad litteram* bën që dhe folja *urdhëroj* në shqip të kërkojë dhanoren

*hanc non sibi, sed Ecclesiae, vel pauperis erogent (f.51)*  
*at giaa t' a daagnene **kisciavet ndo te vobechiet** (f.46)*

*pastores non desinant miserrimae providere calamitati (f. 37)*  
*mos te laane Bariite paa goditune kete **nevoje** (f. 28)*

*alius illi Parochus substtuatur, cum quo cunctos fructus dividat, et propriae necessitati **provideat** (f. 76)*  
*te vihet mbe vend te tii tieteri Paroku, i silli te daan me atà giaan, e t'a **mdimon** nde nevoje (f. 74)*

Në shembullin e fundit vërejmë se autori nuk është ndikuar nga teksti latin dhe folja *providere*, e cila në latinishte kërkon dhanoren, në shqipe është dhënë me një folje kalimtare që kërkon kundrinor të drejtë.

Meqënëse më lart përmendëm përdorimin e disa foljeve me dhanore, kryesisht kalimtare, të mos lëmë pa përmendur se në gjuhën latine dhanorja përdoret me folje

të cilat mund të jenë dhe jokalimtare. Me foljet kalimtare nuk ka ndonjë ndryshim me shqipen, prandaj dhe nuk po ndalemi. Ndryshe qëndron puna në rastin kur disa folje jokalimtare përdoren me dhanore, gjë që u vu re dh emë lart te dhanorja e interesit. Megjithatë, ka dhe folje të tjera jokalimtare të cilat ndërtohen me dhanore. Bëhet fjalë për folje si: *oboedio, pareo, obsequor, resisto, repugno, obsisto, provideo, placeo, caveo* etj. Të shihen shembujt e mëposhtëm dhe të vërehen gabimet që bën përkthyesi duke ruajtur dhe në shqipe po ato funksione të emrit në dhanore të latinishtes.

*Apostolico **parendum est** consilio* (f. 43)

*..e me ndighiuem Kscilit e Scen Paaalit* (f. 35)

*Iussis **parui**, circuivi terram, praeambulavi universam, vidi contritiones eius.*

*Ndighiova urçenit; Suola çene; Kercova Ruεulimin: pae plagat e tii.*

*Vel alia dona cuiuscumque generis non verebuntur pro execrabili functione exigere*  
....(f. 69)

*Nde mos **ndogiofscin** Parochit Ketyne lighiave, e nde marscin giaà prej sctepije ...*  
(f. 65)

Në të dyja rastet e mësipërme vërejmë se autori nuk përkthen drejt. Në tekstin shqip, duket sikur folja jokalimtare *pareo* e latinishtes është përkthyer me fojen *ndigjoj* me kuptimin *i bindem*, por si kalimtare, pasi nuk përdor trajtën e shkurtër *i* tipike të dhanores së shqipes por nga ana tjetër e vendos emrin në dhanore, ashtu si në latinishte. Rrjedhimisht nuk kemi të bëjmë me një përkthim të mirë, si rezultat i përkthimit të morfemave të shqipes me funksione të morfemave të latinishtes.

c) *Dhanorja e pronësisë*. Në këtë rast nuk del në pah zotëruesi, siç ndodh në shqipe, por gjëja që zotërohet. Në tekstin shqip është dhënë njësoj si në tekstin latin, duke vënë emrin në dhanore.

*Deo igitur soli, cui servire, regnare est per externam, et publicam Fidei confessionem ....* (f. 21)

*Vece **H it** pràa, “cui me scerb em, asct me εotenuem:” te truhet, e te fallet i Feescimi...* (f. 8)

Më lart u tha se në gjuhën latine, rasën dhanore e gjejmë të përdorur jo vetëm me folje, por edhe me mbiemra. Ja disa shembuj në të cilët gjejmë përdorim të dhanores me një mbiemër.

*An Sacramentorum **participationi** reverenter **devoti** ? (f. 59)*

*A afferohen **me devotione** Sc sacramentavet ? (f. 53)*

*Qui ambiunt quidem ad Sacerdotium promoveri, sed non student **digni** fieri **Sacerdotio** fieri (f. 42)*

*Atà chi lakmognene mirefiil meu baam Mescetare, pò nuk luftognene meu baam te degne per tà (f. 35)*

Në këto shembuj vërehet se si mbiemrat *devoti dhe digni* kërkojnë dhanoren e emrave përkatësisht *participationi* dhe *sacerdotio*. Në shqipe autori ka bërë një përkthim të lirë, madje duke na e dhënë me pjesë të tjera të ligjëratës.

d) *Dhanorja e relacionit*. Kemi të bëjmë me dhanore të relacionit kur kjo e fundit përdoret veçanërisht me pjasore ët së tashmes të emëruar, dhe tregon personin në raport me ët cilin vlerësohet ajo që kumtohet në fjalinë kryesore. Ndryshe njihet dhe si dativi i këndvështrimit ose latinisht *dativus iudicantis*.

*Ambulantibus namque in praviatete cordis sui, Dominus non ignoscet illis (f. 48)*

*Σοτ8ni nuk pò ndijen at ne, chi ezzene me mcat nde eembre (f. 42)*

Siç shihet *dativus iudicantis* e dhënë me pjesore të së tashmes, është zberthyer me një fjali të nënrenditur përcaktore.

### **Rasa kallëzore.**

Përdorimi i emrave në rasën kallëzore në trajtë e pashquar nuk paraqet ndonjë ndryshim nga ai i shqipes së sotme, gjë që vërehet dhe në shembujt e mëposhtëm. Një ndryshim relativisht i vogël vërehet në rasën kallëzore të shquar njëjës, ku disa emra dalin me mbaresën e vjetër –*në*, siç vërehet në pothuajse të gjitha tekstet e vjetra.

*marre kane gni **εαacon** (f. 21)*

*nde **kisce** scende (f. 1)*

*mbi **malle**, mbi **driççe**, mbi **vene**, mbi **voj** (f. 61)*

*tue kiene me **lig** (f. 19)*

*kaa **ççemelin** mbi guur te ngullune se vertetese ..(f. 1)*

*te pyete cusc , ci skà **pusctene** (f. 9)*

*pò persè percassene **corpne** e **giakne**... (f. 63)*

*motne e beganiscime, e dittate scendettesse* (f. 17)

*cur te ççone M escene....* (f. 14)

*tue gimuem l pen Bukne, te luftoine te giangn c gielne* (f. 12)

Në fjalinë latine rasa kallëzore është rasa e kundrinorit të drejtë dhe i elementeve që i referohen atij. Kjo rasë ndryshe nga dhanorja gjen përdorim me folje kalimtare. Në latinishte kjo rasë ndërtohet:

a) me folje kalimtare.

*fugere, deficere, abdicere, desperare*

b) folje që shprehin ndjenjë. (*verba affectuum*)

*dolere, flere, horrere, lamentari, fastidire*

c) foljet jokalimtare me kundrinë të brendshme, d.m.th që e kanë emrin në kallëzore të prejardhur nga vetë rrënja e foljes.

*vivere vitam, pugnare pugnam, cenare cenam*

d) folje që tregojnë lëvizje.

*circumvenire, convenire, ingredi*

Një përdorim të veçantë përbën dhe *kallëzorja e pasthirrmës*. Kemi kallëzore të paraprirë ose jo nga pasthirrmat *o, heu*.

*Me miserum ! I mjeri unë!*

Me kallëzore në gjuhën latine shprehet:

1. Rrethanori që tregon moshë. Në gjuhën latine jepet me anë të numërorit rreshtor, ndërsa në shqipe numërori paraprihet nga parafjala *ndë* e rasës kallëzore.

*qui vigesimum primum aetatis annum compliverint* (f. 27)

*a ta chi jane rriim nde gniëet e gnai viet plot* (f. 16)

2. Në gjuhën latine me kallëzore jepet rrethanori i vendit me përcaktimin e lëvizjes drejt një vendi. Quo? = Për ku? Zakonisht shoqërohet me folje që tregojnë lëvizje dhe shprehet me parafjalët *in + kallëzore*. Në shqipe është dhënë kryesisht me emër të paraprirë me parafjalët *ndë, mbi + kallëzore*.

*quem effudit in nos abunde per Iesum Christum* (f. 30)

*tesilln' e derçi mbi nee mejaft per Iesu Christum* (f. 20)

*ne in opprobrium incidant, et in laqueum Diaboli Sathanae* (f. 36)

*mos te bijene mbe çune, e mbe lacchi te Diaalit* (f. 27)

*et consumet eos in perditionem* (f. 48)

*e kaa me i sossune nde te sciuemit* (f. 42)

*Credo in unum Deum Patrem Omnipotentem* (f. 15)

*Bessogn mbe gnia te vetemin Hyi Atin e Pusctuescim* (f. 20)

*ut Christianorum proles in viam mandatorum Domini dirigatur* (f. 22)

*e me luftuem te nderecchiet famija e Tekersctenevet nde per uçe t' urçenimevete Tinezot* (f. 10)

Por në në tekstin e Kuvendit të Arbënit, si në mbarë tekstet e vjetra të shqipes, vërehen forma të prapanyjzëuara të tipit në *mal-t*, të cilat janë ndërtuar duke i prapangjitur formën nyjore *-t* formës së kallëzores së pashquar. Forma të tilla përdoren me parafjalë si: *ndë, për, mbë*, që drejtojnë rregullisht rasën kallëzore. Për këtë arsye njihet më shumë si **kallëzore parafjalore** ose **e ashtuquajtura rasë vendore**.<sup>166</sup>

Me këtë rasë, pra me kallëzore parafjalore në tekstin latin janë përkthyer kryesisht rrethorët e vendit që tregojnë lëvizje (zhvendosje) drejt një vendi, të dhëna me parafjalën *in + kallëzore*.

*et ascendit in Caelum, sedet ad dexteram ...* (f.16)

*E hippi mbe qiellt, rri mbe te diaççzet* (f. 2)

*in vineam Domini translata* (f. 22)

*mbeltuem nde veesct te Tinezot* (f. 10)

*et glorificent patrem, qui in caelis est* (f. 510)

*e te levdognene Atin e Pusctetuescim mbe Chiejit* (f. 45)

*in carne enim ambulantes, non secundum carnem militamus* (f. 70)

*tue ezzune nde misct, nuk uscterogneme si temiscit* (f. 67)

*...ut divinus honor refloreat in terris* (f. 26)

*...chi te luleohet perseri ndereja e H it mbe çeete* (f. 15)

---

<sup>166</sup> Kjo formë rasore gjen përdorim të dendur te Buzuku: *mbë malt të ullinjet...* (f. 347) *U në mos pasha mbi duort të tī vendnë e gozhëvet* (f. 319); Te Budi: *e tue ecunë pr urdhëni- të sāj* (RR.11); te Bardhi: *mbë gjuhët t arbëneshe, ndënë qillt ende mbi qiellt* (parathënia); te Bogdani: *prej guri ndë Hast, ..e ndë të kujët dhë jemi* (parathënia)

Kjo formë rasore e cila siç u tha ndeshet dhe te Buzuku, madje e hasim dhe sot në disa të folme të gegërishtes e më pak të toskërishtes, është trajtuar mjaft. Çështjet themelore që duhen sqaruar lidhur me këtë formë rasore janë dy: vlera e saj rasore dhe rruga e formimit. Disa prej studiuesve e marrin si rasë vendore<sup>167</sup>, disa të tjerë si rrjedhore e shquar me kuptim lokativ, e disa si kallëzore parafjalore të shquar.<sup>168</sup> Në fillim dhe Selman Riza<sup>169</sup> e njeh si rasë më vete me termin *rasë parafjalore*. Më vonë po ky studiues<sup>170</sup> mendimin e të cilit e mbështet dhe Sh. Demiraj<sup>171</sup>, arrin në përfundimin se kemi të bëjmë me një “*trajtë sekundore të kallëzores së shquar*”. Një trajtim të veçantë kësaj rase i ka bërë Kolec Topalli, i cili në librin e tij më të fundit<sup>172</sup>, këtë formë e njeh si *kallëzore parafjalore*.

Latinishtja ka disa folje që tregojnë lëvizje dhe përdoren pa parafjalë, në ato raste kur kemi të bëjmë me emra qytetesh, ishujsh ose me emrat *domus* – shtëpi dhe *rus*- fshat.

*Ivi Romam , Athenas....*

*Shkova në Romë, Athinë ...*

*Eo domum meam*

*Shkoj në shtëpinë time.*

3. Rrethanori i vendit që shpreh gjendje apo lëvizje në afërsi të një vendi dhe ndërtohet me parafjalët *ad, apud + kallëzore*. Në tekstin shqip ky rrethor vendi është dhënë me emër në dhanore, duke mos u ndikuar nga teksti latin, ose me kallëzore parafjalore, siç mund të shihet në shembullin e dytë.

*a sordibus peccatorum emundati ad Eucharistiam accedimus* (f. 39 )

*Tue kiene deliirune nmcatesc...t'affrohemi Sci sacramentit Eucharistijese* (f. 30)

*sedet ad dexteram Patris et iterum venturus est...*(f.16)

*rri mbe te diaççet Atit, e persrii ka me arçune .....* (f. 2)

*in se habens et omnis saporis suavitatem, in cuius fortitudine ambulamus usque ad montem Dei, nimirum ad futuram gloriam, et aeternam felicitatem* (f. 39)

---

<sup>167</sup> Osman Myderizi, *Gramatika e re e shqipes*, Tiranë. 1944, f.37

<sup>168</sup> Për më shumë shih Sh.Demiraj, *Gramatika historike e gjuhës shqipe*. Tiranë, 1986, f. 377 - 379 .

<sup>169</sup> Selman Riza, *Nyjat e shqipes*, BUSHT, SSHSH.1958/4 f. 45

<sup>170</sup> Selman Riza, *Emrat në shqipe. Sistemi i rasavet dhe tipet e lakimit*. Tiranë, 1965, f.44.

<sup>171</sup> Vep. e cituar f. 379.

<sup>172</sup> Kolec Topalli, *Sistemi rasor i emrave të shqipes*, Tiranë, 2009, f. 331



*e giçç te hante te Sciese, me vert t te cui ezzime ndier **nde malli** te Hyit, i silli asct labdi i t'arçunit, e lumnija e pa sossune* (f. 31)

***Ad** ieiuniorum **observantiam** ea, qua par est, devotione...* (f. 26)

***Per te mbaitunit** t' agnimevet te keete Nierii ciallastijen e devoccime..*  
(f. 15)

4. Rrethanori i vendit që tregon lëvizje përmes një vend të caktuar. Emri i vendit përmes të cilit kalohet, në gjuhën latine jepet me anë të parafjalës *per* + *kallëzore*. Në shqipë është dhënë me parafjalën *ndë për* + *kallëzore*.

*non tantum sonet in Ecclesiis, sed **per rura, per campos, per privata pauperum domicilia*** (f.81)

*pr' ata te ndiet eani jo vece **nde per Kiscia, po nde per katunde, nde per basctina, nde per fuscia, nde per sctepija** te vorfeniise* (f. 80)

5. Rrethanori i mjetit zakonisht jepet me anë të një emri në rasën rrjedhore, por kur veprimi kryhet nga njerëzit, ky rrethanor jepet me anë të parafjalës *per* + *accusativus*.

*effudit in nos abunde **per Iesum Christum*** (f. 30)

*e derdhi mbi nee mejaft **per Jesu Crictne*** (f. 20)

*Omnes autem **per Parrochos** admoneantur* (f. 46)

*Giçç i silli te jete avisuem **prej Parocut*** (f. 39)

Nuk mungojnë dhe raste kur me *kallëzore* shprehet dhe mjete nëpërmjet të cilit kryefjala kryen veprimin, si me poshtë. Lidhur me përdorimin e kësaj parafjale në shembullin e mëposhtëm vërejmë se kur kjo parafjalë shpreh mjetin me anë të së cilit kryhet veprimi, atëherë përdoret dhe me rasën *kallëzore*, me trajtën tjetër të saj *për*<sup>173</sup>, me funksionin e kundrinorit me parafjalë, për të shprehur mjetin me anë të të cilit kryhet veprimi.

*.....ne dum **per scientiae viam, sed per semitam** quoque pietatis gradiendum est*  
(f. 44)

*.....iò vece **per scteku te dijese, pò endè per urome** te scendeniise e et miscerierese duhet me zzune* (f. 37)

---

<sup>173</sup> Këtë përdorim e gjejmë dhe te Buzuku: *Nd'ato dit foli Zotynë për gojë të Ezaisë regjit Akax tue i thashune...* (f.89) Jo më kot parafjalët *për* dhe *prej*, nuk ndaheshin nga studiuesit Meyer-i dhe Pedersen-i. Për ta *prej* është identike me *për* dhe *prej* shihet si zgjerim i parafjalës *për*.

*et debacchiantium scelerum multitudine repressa, furor domini cervicibus nostris imminens per Festorum sanctificationem avertatur ..... (f. 26)*

*e tue ndalune mbe sciummizzet fajjet e te hutuemet ; prej scendeniise Festavet te largohet prej nesc menija e Tinezot (f. 15)*

Autori në dy rastet e para e ka përdorur këtë parafjalë me rasën kallëzore, si në latinishte, për të shprehur mjetin me anë të të cilit kryehet veprimi. Ndërsa në shembullin tjetër rrethanorin e mjetit e kemi të dhënë me parafjalën prej+ rrjedhore.

Në tekst kemi gjetur një rast në të cilin rrethanori i mjetit, në tekstin shqip na është dhënë me kallëzore parafjalore.

*Ea est humanae naturae fragilitas, ut quamvis tot munita per Baptismum*

(f. 36)

*Kacchie elighe asct nat8ra e nierijut, ndonese te jete forzuem me Pagheimit*

(f. 27)

6. Me anë të kallëzores me parafjalën *propter*, në gjuhën latine jepet dhe rrethanori i shkakut. Në tekstin shqip na është dhënë me parafjalën *per* + emër në kallëzore, duke menduar se e ka dhënë me kuptimin e shkakut. Megjithatë në këtë shembull duket sikur përkthyesi na e sjell me kuptimin e qëllimit.

*Et propter nostram salutem descendit de Caelis (f. 16)*

*E per scelbimin tane sdripi prej Chijescit (f. 2)*

### ***Rasa rrjedhore.***

Format rasore të rrjedhores janë në disa raste të njëjta me ato të shqipes së sotme, sidomos në numrin njëjës.

Te autorët e vjetër e në të folmet gege gjejmë dhe rrjedhoren e shquar të emrave femërorë të tipit *doret*<sup>174</sup> të shoqëruar ose jo me parafjalët e rasës rrjedhore *n, prej*.<sup>175</sup> Këto forma nuk mungojnë as në tekstin e Kuvendit të Arbënit, në versionin shqip

*Hic plane est fons ille vitae de domo dei egrediens (f. 30)*

---

<sup>174</sup> Për më shumë shih Demiraj, *vep e cituar* f. 384.

<sup>175</sup> Te Buzuku; *..e madhe turmë ish me të prej qytetjet* (f. 181). Te Budi. *..e te vdesmë friket...; ..që fort të ruhemi kusëriet e grabëtit* (RR 13). Te Bogdani: *tue tepëruem diku një fjalë njanet giuhë (Parathënia e veprës)*

*K88 mirefiil asct gurra e jetese, chi rieç prej shtepijet* (f. 20)

*...ad tempus pollent Episcopi ex indulgenti benignitate...* (f. 51)

*...per te zijat kane pusctene upesckupignete jo per giççeve, pò vece per dissa prej miscieriere se bute ...*(f. 46)

*Deum de Deo, lumen de lumine...* (f. 16)

*H8in prej H8it, drittene n' drittet...* (f. 2)

*lineam frequenter abluere...*(f. 67)

*Atò robba, chi jane n'liniit me i laa c'pesc* (f. 63)

*Post obitum Parochi Ecclesiae Benefactoris ...* (f. 75)

*Mbas mordiet se Parokut baasit mir Kiscese* (f. 73)

*In quibus visitavit nos oriens ex alto* (f. 29)

*Nde tezijat erç se naltiit me na vicituem..* (f. 19)

*ut segregando triticum a zizania...* (f. 21)

*me daam gruunin prej eghieret....* (f. 9)

*ut quicumque in hoc unico signo deficit, ab Ecclesia se divellat* (f. 21))

*Pr'atà ai chi s'epp ketà scegnajite Feese, .... e dahet 'n kiscet* (f. 9)

Raste të përdorimit të rrjedhores pa parafjalë e tipit *doret*, nuk mungojnë as në tekstin tonë.

*per Baptismi lavacrum non deleatur certa memoria.....* (f. 33)

*Kinese per Pagheimi mos te na dal mendiet....* (f.23)

*qui licet turcico solemnii ritu Fidem non eiurarunt....* (f. 20)

*Endè atà, chi nuk jane dalle fejet...* (f. 7)

Në numrin shumëshohim rrjedhoren arkaike me mbaresën – *sh*. Kjo rrjedhore është ndeshur mjaft në tekstet e vjetra,<sup>176</sup> por në shqipen e sotme është më e kufizuar në përdorim. Vendin e saj e ka zënë përdorimi me mbaresën -*ve*, ndikim ky i rasës dhanore.

---

<sup>176</sup> Te Bogdani: *...ndo pa mos lefuem me xane libersh o letteraresh* (Parathënie e veprës).  
*...me e nxjerre rranjësh* (Budi, DC 154).

*aty lahem i n' fajesc* (f. 25)

*ibi ab iniquitatibus mundemur* ( f. 35)

*leem n' prindesc chi skane passune per* (f. 36)

*illegittimo thoro procreati* (f. 43)

*tue kene delirune n' mcatesc* (f. 30)

*a sordibus peccatorum emundati* (f. 39)

*prej popujisc se tieresc* (f.37)

*a caeteris Populis* (f.44)

*jane per t'u larguem prej kisciase* (f .60)

*ab ecclesiis eliminantur* (f.64)

Po në numrin shumë s gjejmë dhe rrjedhoren e vjetër me *-shit*, megjithëse jo shumë të përdorur, siç vërehet në tekstet e tjera të vjetra.<sup>177</sup>

*ndo prej fruitescit se basctinavet* (f. 72)

*ex praediorum fructibus* (f. 74)

*sdrippi prej Chijeiscit* (f. 2)

*descendit de Caelis* (f. 16)

Kjo rrjedhore e shquar e shumësit është e rrallë te Kuvendi. Është e ndërtuar nga format rasore të rrjedhores së pashquar, të cilave u është shtuar nyja *t*, që sipas Demirajt duhet të burojë nga një gjinore e dhanore.<sup>178</sup>

Në fjalinë latine rrjedhorja është rasa që kryen më shumë funksione krahasuar me rasat e tjera.

Në latinishte rrjedhorja ka mbuluar përdorimin e dy rasave të humbura shumë herët: të mjetit (*instrumentalis*) dhe të vendit (*locativus*)<sup>179</sup>

*Instrumentalis* ka lënë gjurmët te ablativi i mjetit, ndërsa *locativus* është përdorur për të treguar gjendje a lëvizje në një vend të caktuar. Lokativi

---

<sup>177</sup> Te Buzuku: ...*përzemë pors i një n trimashit së tush* (f. 149) ; Te Budi *sdrippi n'qiellshit* (DC 147); Bogdani ..*tue nalcuem prej urtishit* (Parathënia)

<sup>178</sup> Shih Sh.Demiraj, *Morfologjia historike e gjuhës shqipe*, 1973, Tiranë, f. 94

<sup>179</sup> V.Tantucci, *Urbis et orbis lingua*, Bologna, 1985, f. 290. Latinishtja njih përdorimin e lokativit që nuk duhet ngatërruar me *genitivus locativus*, një term ky jo i saktë, pasi lokativi është një rasë e vjetër mbarese e së cilës është *-i* dhe ndryshon nga gjinorja. Forma *Romae* rrjedh nga *Roma-i*. Kështu janë forma lokativi: *domi* (në shtëpi), *ruri* (në fshat), *humi* (në tokë).

përdoret në ato raste kur emri tregon një qytet, fshat dhe mund të jetë i lakimit të parë dhe të dytë në numrin njëjës.

*Eum Romae vidi*. E pashë në Romë.  
(*Comprendere e tradurre*, N.Flocchini, f. 413)

Për emrat e lakimeve të tjera si në njëjës e në shumës, dhe për emrat e lakimit të parë e të dytë, por në shumës, përdoret rrjedhorja pa parafjalë.

*Vixit Athenis, Syracusis*  
(*Urbis et orbis lingua*, V. Tantucci f. 290)

Rasa rrjedhore mund të përdoret edhe me folje a mbiemra prejfoljorë, edhe me emra. Rrjedhorja pranëfoljore ngërthen në vetvete kuptime të ndryshme, si ato të shkakut, të mjetit, të vendit, të kohës etj...

Në gjuhën latine rrjedhores i njihen tre funksione themelore:

- a) rrjedhorja e origjinës dhe e largimit (*ablativus originis et separationis*)
- b) rrjedhorja e mjetit (*ablativus instrumentalis*).
- c) rrjedhorja e vendit (*ablativus locativus*)

1. a) Rrjedhorja e origjinës dhe e largimit shpreh origjinën dhe largimin (zhvendosjen) nga një vend i caktuar. Në këtë funksion përdoret shpesh me parafjalë si *a/ab/e/ex/de*, të cilat saktësojnë origjinën e lëvizjes. Në shqipen e Kuvendit janë dhënë me anë të *prej+ rrjedhore*.

*descendit de Caelis* (f. 16)  
*sdrippi prej Chiejscit* (f. 2)

*quae ex eorum Parrochiae finibus egressae* (f. 63)  
*te zijat jane dalle prej cunfignese se Parrochiese e t8ne* (f. 58)

*et puras ab omni Simoniaca labis suspicione habeant* (f. 51)  
*te keene duerete e delira, e te paa hille prej cujtimesc se faiit e Simoniase* (f. 45)

*Iustissimo Dei iudicio de eorumdem manibus repetendae* (f. 77)  
*Hyi me te dereitscimi giychi kaa me lypune prej duoresc se t ne* (f. 76)

*In quibus visitavit nos oriens ex alto* (f. 29)  
*Nde tezijat erç se naltit me na vieituem..* (f. 19)

*et tulerit de eis animam...sanguinem autem eius de manu speculatoris requiram* (f. 24)

*te marr scpirtin prej ssisc...giakun e popullit prej dorese kapetaanit kam me lypune* (f. 13)

Në gjuhën latine *ablativus separationis* mund të jepet dhe me anë të emrit të thjeshtë pa parafjalët tipike që përmendëm më lart,<sup>180</sup> siç vërehet në shembullin e mëposhtëm. Në tekstin shqip është dhënë me emër në rrjedhore por të shoqëruar me parafjalën *prej*.

*Parochialibus etiam non eximantur officis* (f. 33)

*Chi kane eannaatin e parrocchianeve mos te largohen prej e rasc* (f. 23)

b) Rrjedhorja e privimit. Në latinishte ndërtohet me folje që tregojnë mungesë (privim) apo nevojë për diçka ose dhe nga mbiemra që kanë prejardhjen prej këtyre foljeve. Në shqipe është dhënë me kallëzore pa parafjalë dhe me folje në mohore.

*Potest quidem a privata persona, quae omni caret auctoritate* (f. 21)

*mund jete se te pyete cusc, ci s'ka pusctene* (f. 9)

*ac privilegio huiusmodi careant obligatione* (f.80)

*skane det8re me ndighiuem Upesckupigneve* (f.79)

*ideoque Parrochi Parrochialibus carent Ecclesiis* (f. 22)

*e pratà te sciumte e priftniise skane Kiscia* (f. 11)

*Ne autem pueri... hoc pretiosissimo divinitatis thesauro priventur* (f. 40)

*E mos te jessene Dielte paa u cunquem e paa u refyem per scium mot* (f. 32)

c) Rrjedhorja e origjinës varet nga folje si: *nascor*, “ lind”, *orior* “kam origjinë” si dhe me pjesore ose mbiemra si *genitus*, *procreatus*, *natus*.

*Credo in unum filium Dei unigenitum. Et ex Patre natum ante omnia saecula* (f. 16)

*Bessogn mbe Biirin e vetem t'H it. E leem prej Atit perpara giçç Scecujet* (f. 2)

---

<sup>180</sup> Bëhet fjalë për parafjalët *a/ab/ex./e* etj. Të mos harrojmë dhe ato pak raste ku dhe në tekstin shqip kishim rrjedhore pa parafjalë.

*Omnia bona Ecclesiae, vel ex decimarum solutione, vel ex praediorum fructibus, vel ex alio quocumque capite in Parochiales proventus proficiscentia* (f. 74)

*G ičč giaa te Kiscese, chi del prej së mblicëunit, ndo prej ake, ndo prej fruitescit se basctinavet, ndo kadò te dall dobija mbe Parrochie...* (f. 72)

*Illegitimo thoro procreati, infames publico crimine notati, homicidae voluntarii, apostate excommunicati ...*(f. 43)

*Atà chi jane leem n'prindesc, chi skane passune per lighie meu marre. Ata chi per fajie te maçakane bierre ndren mbe facchie te çeut* (f. 36)

d) Rrjedhorja e vepruesit (*dativus agentis*) përdoret me folje pësore dhe në shqipe është dhënë me anë të një kundrinori me parafjalë të rasës rrjedhore prej.

*Potestatem, a Christo in Ecclesia relictam fuisse esse affirmo* (f. 17)

*As mohogn, se puscteteja asct lane Kiscese prej Cristit* (f. 4)

*Quicumque in manu potenti....aut ab Ordinario suspensus....*(f. 73)

*Gičč i slli, chi forzohet me dore te fortevet....ndo me kiene suspenduem prej Upesckupit, o Ordinarit* (f. 70)

*Cum nihil magis animarum saluti, quam ab illis gubernari* (f. 7)

*Persè as dogn puna nuk maa kecchie, se meu guvernuem prej assisc* (f. 71)

e) Rrjedhorja e argumentit shprehet në latinisht me *de + rrjedhore*. Në shqipe është dhënë me parafjalën për + emër në kallëzore.

*capitulis de animarum curatoribus praescripsimus* (f. 80)

*nde capitui cu flasme per essapi chi kane Ciobant e scpirtinavet* (f. 79)

*Ut autem de singulis agamus, omnium primus occurrit, Sacramentorum ianua, Baptismus* (f. 30)

*Tue passune per te folle per gičč Sciecramenta kaa gnià, maa pare...*(f. 20)

Ablativi i argumentit në gjuhën latine gjendet shpesh në tituj kapitujsh, gjë që vërehet dhe në tekstin latin të Kuvendit. Këtë rrjedhore te disa autorë të vjetër veriorë<sup>181</sup> e gjejmë të dhënë po me rrjedhore, gjë që e shohim si ndikim të

---

<sup>181</sup> Budi:Zmirit e rese ncë keqe. Përteset e ncë pakujesit.

latinishtes. Në tekstin e Kuvendit na duket se vjen përsëri me rrjedhore, por ndryshe nga tekstet e tjera vërejmë dhe praninë e një nyjeje, gjë që vërehet në shembujt e mëposhtëm. Nuk mund të përjashtohet dhe fakti se kemi të bëjmë ndoshta dhe me gjinore.

*De professione fidei* (f.15)

*Se bessuemit e fees* (f. 1)

*De apostasis* (f. 18)

*Se reneguemisc* (f. 5)

*De verbi Dei praedicatione* (f. 23)

*Se predikimit e fillese H8it* (f. 12)

2. a) Rrjedhorja e mjetit tregon personin apo sendin me ndihmën e të cilit kryhet një veprim. Në latinishte shprehet me rrjedhore të thjeshtë pa parafjalë. Në shqipe vjen me kallëzore dhe parafjalën *me*.

*Non solum corde creditur ad iustitiam, sed ore etiam* (f. 18)

*Nuk mbaston vece me embre me bessuem te dereitene, po duhet ende rrefimi i gojes* (f. 5)

*venturus est cum gloria iudicare vivos et mortuos* (f. 16)

*ka me arçune me labdin me giucuem te giallete, e te bdecunite* (f. 2)

*cum Baptismo regeneremur ad vita, Confirmatione praemunimur ad pugnam: ibi ab iniquitatibus mundemur, hic virtutibus roboremur* (f. 35)

*chi me Pagheimi legnme per sedyiti mbe jete t'amesciume, e me kreemimi bahemi gatii per lufte, aty lahemi n'fajesc, ketu ferzohemi me virtyte* (f. 25)

*Hinc omni conatu reiicendus est abusus.....* (f. 31)

*Kendej me giçç forze asct per t'u larguem eaconi ...* (f. 21)

*.....quo dum corpus atteritur, anima caelestis gratiae pinguedine saginatur* (f. 26)

*....Me te sillt ende se lighet corpi; Scpirti pò majet me te maimite hiiit chielscim.* (f. 15)

*Confirantione praemuniamur ad pugnam* (f. 35)

*e me kreemimi bahemi gatii per lufte* (f. 25)



*ut totis viribus in hanc curam cumbentes* (f. 19)

*chi me giçç fucchi te vete, te vene cryet me ndalle keta te maçe lenghim..*

(f. 6)

*sicut Sponsa ornata Viro suo circumamicta monilibus aureis, et gemmis pretiosis*  
(f. 20)

*stolissune sicuur Nusseja Burrit vet, buccure reççuem me ciaprassse t'areta, e 'n biscerisc se pacimueme* (f. 7)

b) Rrjedhorja e shoqërimit përdoret me ose pa parafjalën *cum* për të shprehur personin apo gjënë me të cilën lidhet kryefjala. Në shqipe është dhënë me kallëzore e paraprirë nga parafjala *me*.

*cum Christo regnantes* (f. 17)

*chi reginoine mbasck me Kriscne* (f. 4)

*cum Patre et Filio adoratur* (f.16)

*i silli me Atin, e Birin mbasck açorohet* (f. 2)

c) Rrjedhorja e kufizimit që tregon kufijtë apo fushën në të cilën shprehet një koncept. Në shqipe është dhënë me emër me parafjalë *me* + kallëzore.

*in omnibus se ipsos praebentes exemplum bonorum operum, in doctrina, in integritate, et gravitate* (f. 51)

*u paascim mbe giçç cafschia essapi, e tempsuemit e veperavet mire, me dije, e me te paa hile, e me te maçete* (f.44)

*nisi in oratione, et ieiunio, quo dum corpus atteritur, anima caelestis gratiae pinguedine saginatur* (f. 26)

*Se kiò dore Diemenisc nuk largohet, vece me Urat, e me agninim.” Me te sillt ende se lighet corpi; Scpirti pò majet me te maimite hiirit chielscim.* (f. 15)

ç) Rrjedhorja e shkakut tregon arsyen e kryerjes së një veprimi. Shkaku shprehet me ablativ të thjeshtë ose me parafjalën *prae* + *ablativus* në fjali mohore, ndërsa me parafjalë si *de*, *ex*, ose pa parafjalë në fjali pohore. Në shqipe kjo lloj rrjedhoreje është dhënë me kallëzore të paraprirë nga parafjala *për*+ kallëzore ose *n*, *prej* + rrjedhore..

*saepius tamen orta inter eos contentione, quis eorum in aeconomica administratione videatur esse maior* (f. 75)

*scium here prò nder tà asct dalle **sciamate**, tue u marre per tesìln dì màa fort me mbaitune sctepiine, (f. 72)*

*nequeunt **prae timore** aedificari (f. 22)*

*s'munden meu vum mbe cambe nde **per frighe** të Turchise (f. 31)*

*Ecclesiis temporum iniuria collapsis, et **vetustate** consumptis (f. 66)*

*Mbas Kisciasc se ruzueme **n' moccimijet**, ndo prej termekut reenuem (f. 61)*

*Quia vero summa divinarum **ignorantia** cinfítendi modum .... (f. 37)*

*P ò persè **prej se paditunit** se cãfsciavet Hyinuescime.... (f. 28)*

*miramur sane rei **novitate** perculti .. (f. 330)*

*fort pò mreculohemi **prej pune se ree** ... (f. 24)*

*ibi **ab iniquitatibus** mundemur, hic virtutibus roboremur (f. 35)*

*aty lahemi **n'fajjesc**, ketù ferzohemi me virtyte (f. 25)*

d) Rrjedhorja me foljet *utor, fungor, fruor*. Këto folje ndiqen gjithnjë nga rrjedhorja e mjetit.

*quae continentur in Symbolo Fidei, **quo** Sancta Romana Ecclesia **utitur** (f. 15)*

*chi deftohen nde te Bessuemit, chi chiuhet simbul i Feese, **chi** scerbenet scendeja kisce e Romese (f. 2)*

Në shqipe është dhënë me folje në pësore ashtu si në latinishte. Në këtë rast nuk kemi një përkthim të drejtë, sepse folja *utor* = *përdor, shfrytëzoj* në latinisht është deponente, në formë pësore, por me kuptim vepror. Kështu prisnim të kishim të paktën një përkthim me folje në formën veprorë.

*et quamvis **fungantur officio** Sacerdotum (f. 43)*

*e ndonese e bagnene **essapin** e Priftinet (f. 35)*

*neque permittendum est, ut Turcae, vel Schismatici, Patrini fungantur **munere** (f. 36)*

*As jane per te laane Turit, ndò Schismaticichi me mbaitune cand (f. 26)*

Ndërsa në shembujt e tjerë folja *fungor*, dhe kjo deponente na është dhënë saktë, me folje me kuptim vepror dhe kalimtare njëkohësisht, duke mos u ndikuar nga latinishtja. Një rast i ngjashëm, ku autori ka bërë një përkthim të lirë, duke na dhënë me përcjellore foljen deponente *fruor*, e cila siç u th amë lart kërkon rasën rrjedhore.

*In abscondito tantum facta abiuratione coram fidelibus, secreta Sacramentorum participatione fruuntur* (f. 19)

*Basndaj tue u sgiçune tineeisct, ndò perpara dissa te feescimevet, refehen, e cunghohen, tue ubaam piessetarete Scecrementavet* (f. 6)

*Quod tamen attinet ad conferendum Baptismi Sacramentum Turcarum filiis, miramur sane rei novitate perculti..* (f. 33)

*Per sàa perket me pagheeuem te biite e Turchiet, fort pò mreculohe mi prej pune se ree....* (f. 24)

e) Rrjedhorja e përdorur me mbiemrat *dignus* (= i denjë) dhe *indignus* (=i padenjë). Në shqipe është dhënë me emër të shoqëruar më parafjalën *për + kallëzore*.

*Sacerdotio digni fiant* (f. 43)

*te bahen te degne per Priftinije* (f. 36)

3. a) Rrjedhorja vendore (lokative). Kjo rrjedhore shërben për të formuar rrethanorin e vendit kur tregon levizje apo gjendje në një vend. Ubi? = Ku? Fjala që tregon vendin vendoset me *in + rrjedhore*, ndërsa në shqipe është dhënë me *parafjalët mbë, me + emër* në kallëzore dhe me kallëzore parafjalore, siç është rasti i fundit.

*Etenim cum nomen Domini invocandum sit in veritate, et in spiritu, ac omnimoda certitudine adorandum* (f. 28)

*Prasctù tue kiene Emenit e Tineesot per tu permendune me te vertete, e per tu açoruem me scpirt, e me te vertetunit* (f. 18)

*ut sic ambulent omnes cum consensu in domo Dei* (f. 25)

*kinese mbe scstepii te H it te sckognene giçç me gni volundete* (f.14)

*ut in Matris gremio* . (f. 30)

*kinese mbe preheni t'Amese..(f. 21)*

*in carne ambulantes (f. 70)*

*nde misct tue ezzune (f. 67)*

*situm edocentes, an in planitie, vel montibus constituta (f. 56)*

*tue calæuem vendn, à asct nde fusce, nde mall, ndo mbe kotre. (f. 50)*

*..invaluit, proh dolor! abominatio desolationis in loco sancto Templorum Domini*  
*.. (f. 22)*

*... (uh embre plasme) hippi nde kete çee Kisciavet Tinëëot....(f. 11)*

b) Rrjedhorja e kohës përdoret për të treguar kohën kur kryhet një veprimi caktuar, duke formuar kështu rrethorët e kohës. Kjo ndërtohet me parafjalën *in*, ose me rrjedhore të thjeshtë, pa parafjalë<sup>182</sup>: *nocte* (= *natën*), *hieme* (= *dimrit*), *vere* (= *verës*) Dhe në shqipe, megjithëse ka karakter mbeturinor, e kemi një ndërtim të tillë, të rrjedhores së shquar pa parafjalë në funksionin e rrethorit të kohës si: *dimrit*, *verës* apo dhe rrethorit të vendit si: *rrugës*, *fushave*.

Në tekstin tonë rrjedhorja që tregon kohë ndërtohet me parafjalët *in* ose *nde*, gjë që vërehet në shembujt e mëposhtëm.

*ne Fideles festis diebus laborent (f. 62)*

*chi mos te punognene te Feescimit mbe dit te Festevet (f. 66)*

*semel in anno (f. 81)*

*gni here nde viett (f. 80)*

*et resurrexit tertia die (f. 16)*

*e u ngiall te trettene ditte (f. 2)*

### III.I.3 Kategoria e shquarsisë dhe mungesa e saj në gjuhën latine.

Në gjuhën shqipe emri ka kategorinë gramatikore të shquarsisë dhe të pashquarsisë, me kundërvënien formale *trajtë e shquar* ~ *trajtë e pashquar*. Lakimi i emrit në këto dy trajta arrihet nëpërmjet nyjave, të cilat mund të vendosen para ose prapa emrit. Të vihet re kundërvënira *trajtë e shquar* ~ *trajtë e pashquar* në

---

<sup>182</sup> Evalda, Paci, *De casuum nominum usu dissertatio in latina et albaniensi lingua*. Classica et Christiana, 3, Iași, 2008, f. 214.

fjalët e mëposhtme. (*një*) *mik* ~ *miku*; (*disa*) *miq* ~ *miqtë*. Një kundërvënie e tillë nuk ekziston në gjuhën latine. Në fakt në gjuhën latine nuk ekzistojnë nyja, të cilat luajnë një rol vendimtar për të shprehur shkallën e përcaktimit, dukuri e hasur në gjuhët neolatine.<sup>183</sup> Megjiithatë dhe latinishtja nuk ishte tërësisht e privuar nga këto ndërtime, pasi ajo shfrytëzonte rrethanorët e ndryshëm të shoqëruar nga parafjalë. Emri përcaktohej dhe nga një emër tjetër në rrjedhore apo një ndajfolje. Emri lakohet sipas rasave të caktuarar dhe sipas dy numrave, njëjësit dhe shumësit. Kështu fjala *puer* mund të jepet në shqip dhe në trajtën e shquar *djali* dhe në të pashquarën *djalë*. Dallimi do të arrihet vetëm në sajë të kontekstit. Të krahasohen fjalitë e mëposhtme.

*Cato vir clarus erat.*

*Katoni ishte burrë i shquar.*

Në fjalinë latine kryefjala *Cato* është në rasën emërore, njëjës, po kështu dhe *vir clarus* pjesa përbërëse e kallëzuesit emëror. Në fjalinë shqipe *Katoni ishte burrë i shquar*, kryefjala *Katoni* duke qenë i përveçëm është i dalluar dhe rrjedhimisht është në trajtën e shquar, ndërsa *burrë i shquar* si pjesë përbërëse e kallëzuesit emëror, vendoset në të pashquarën.

Në shqipen e sotme si dhe në tekstin tonë emrat janë në trajtën e shquar në ato raste kur emri në një kontekst të caktuar përmendet për të dytën herë, kur shënon sende dhe emërtime unike, kur ndiqet nga fjalë përcaktuese si përemri pronor, emër tjetër në gjinore, apo dhe te emrat e përveçëm. Të krahasohen fjalitë e mëposhtme:

*sit lumen animae, ostium vitae, fundamentum aeternae salutis, cunctarum radix virtutum et fons bonorum operum* (f. 15)

*Asct dritta e Scpirtit, dera e Ietese, ççemelî i scelbimit amescivem, ranza e virtytevet, e krou i veperavet mirave* (f. 1)

*Profiteor quoque septem esse vere, et proprie Sacramenta novae legis, a Iesu Christo Domino nostro instituta* (f. 16)

*Ende refegn se gnimend jane vece sctat te verteta Scecramenta te ligiese urçenue, e çane prej Christit Σotit tine.* (f. 4)

Emri vendoset në trajtën e pashquar kur është pjesë përbërëse e kallëzuesit emëror, kur shoqërohet me përemra dëftorë, me disa parafjalë të rasës kallëzore, numërorë etj ..

---

<sup>183</sup> Tëmos harrojmë që greqishtja e vjetër i ka nyjet shquese: ó,ή,τò, falë të cilave kishte mundësi që emri të ndiqej nga nga një rrethanor kohe ose ndajfolje.

*Ego N. Firma Fide credo* (f. 15)

*Une N. me Fee te ngullune bessogn* (f. 2)

*Hanc veram Catholicam Fidem, quam in praesenti sponte profiteor..*(f. 18)

*Kete Fee Kattolike, chi une tascti vet percuna* (f. 4)

*Profiteor pariter, in Missa offeri Deo verum* (f. 17)

*Bessogn ende, se nde Mesce truhet H it i vertetscim* (f. 4)

### III. 2 Përcaktorët e emrit. Vendi dhe përshtatja e tyre në fjali.

Në gjuhët indoevropiane një dukuri gjuhësore që përbën interes për një studiues është vendi dhe përshtatja e përcaktorëve me emrin që përcaktojnë. Kështu, ka gjuhë në të cilat gjymtyrët e fjalisë kanë një rend të ngulitur dhe disa të cilat kanë rend të lirë të fjalëve. Një nga këto gjuhë, e cila “gëzon” liri të gjymtyrëve në fjali është latinishtja dhe deri diku dhe shqipja. Në gjuhën latine folja në përgjithësi qëndron në fund, ndërsa përcaktorët mund të qëndrojnë dhe para dhe pas emrit që përcaktojnë. Kështu mbiemri cilësor vendoset para emrit *pulchra domus*, ndërsa mbiemri përcaktor funksioni themelor i të cilit është përcaktimi, qëndron pas emrit, po kështu dhe përemri pronor, psh: *civis romanus, pater meus*.<sup>184</sup>

Përemrat dëftorë *hic puer – ky djalë, ille homo – ai njeri*, përemrat pyetës *quae causa? – cili shkak ?* kryesisht gjenden para emrit. Në gjuhën shqipe gjithashtu, përcaktorët vendosen dhe para dhe pas emrit. Kështu, mbiemrat, numërorët rreshtorë, apo përemrat pronorë, kryesisht vendosen pas emrit si: *libri im, djalë i mirë, rreshti i dytë, etj*<sup>185</sup>. Për qëllime të caktuara stilistike shqipja pranon dhe vendosjen e tyre para emrit.<sup>186</sup>

Përcaktorë të tjerë si numërorët themelorë, përemrat dëftorë, pyetës vendosen para emrit: *dy fëmijë, ky djalë, cili libër?* etj. Të vihet re rendi i përcaktorëve në shembujt e mëposhtëm si në tekstin latin dhe në atë shqip të Kuvndit të Arbënit.

*quam ne vulpecula parvulae demoliantur, et Ferus succrescentem segetem depascatur* (f. 19)

*te silln mos te derremognene çelpenezat evoghela e Biscia evetemeja e mallit mos ta culos* (f. 6)

---

<sup>184</sup> Lidhur rendin e fjalëve në gjuhën latine shih Alfred Ernout, François Thomas, *Syntaxe latine*, Paris, 1953, f. 161

<sup>185</sup> Për më shumë shih *Gramatika e gjuhës shqipe*, Tiranë, 1995, f. 233

<sup>186</sup> Shih po aty, f.

*praestantissimum docendi munus saluberrima Verbi Dei...* (f. 23)

*εaanati i nderscimi i te empsuemit forzohet me te scendeccimin predikim te fiallese H it* (f. 12)

*Inter regnantium hac tempestate scelerum multitudinem* (f. 28)

*Nder sciumizza te fajevet, chi nde keta' kohe mbaλογnene çene....* (f. 18)

*keta' te feligiunit duoli* (f. 41)

*haec pollutio egressa est* (f. 41)

*a Iesu Christo Domino nostro* (f. 16)

*prej Chrisctit Zotit tine* (f. 3)

*Inter execrabiles Montani nostri Populi consuetudines* (f.48)

*Per saa εaaconi kaa populi ni* (f. 4)

*credo in unum deum Patrem Omnipotentem* (f. 1)

*bessogn mbe gnia te vetemin Hi Atin e Pusctuescim* (f. 2)

Në tekstin shqip mbiemrin e gjejmë kryesisht pas emrit, dukuri që vërehet dhe në shqipen e sotme, edhe pse në tekstin latin shpesh herë ndonjë përcaktor siç është mbiemri cilësor, e gjejmë para emrit. Prapavendosja e mbiemrit dhe e përcaktorëve të tjerë duhet të jetë dukuri e vjetër. E gjejmë te Buzuku e në të gjithë autorët e tjerë të vjetër. Megjithatë disa studiues mendojnë se në fillimet e shqipes përcaktorët sidomos mbiemri vendosej pas emrit<sup>187</sup>, të tjerë shprehen se shqipja në fillimet e saj shquhej për paravendosje të mbiemrit<sup>188</sup>.

Të vihet re prapavendosja e mbiemrit në fjalitë e mësipërme si një dukuri e pranishme dhe në shqipen e sotme.

Por, në tekst nuk janë të pakta rastet e paravendosjes së mbiemrit, e të përëmrut. Këtë nuk e shikojmë si dëshmi në të mirë të tezës se dikur shqipja shquhej për paravendosje të mbiemrit, por si pasojë të ndikimit të tekstit latin në të cilin mbiemri është vendosur para emrit, gjë që vërehet në shembujt e mëposhtëm.

---

<sup>187</sup> Për këtë çështje janë shprehur E.Çabej, BUSHT, SSHSH 3, 1963

Gjithashtu të shihet Demiraj, vep. cit. f. 34, B.Bokshi, *Rruga e formimit të fleksionit të sotëm nominal të shqipes*, Prishtinë, 1980

<sup>188</sup> S.Riza, BUSHT, SSHSH,1959 ; B.Bokshi, "*Rruga e formimit të fleksionit të sotëm nominal të shqipes*, Prishtinë, 1980. Studiues të tillë mendojnë se nisen nga disa përdorime në shqipen e sotme si *i gjori plak, e mjera grua* etj.

*Dolemus quidem referre **miserrimam** nostrarum Ecclesiarum **faciem***

(f. 43)

*Per te vertete kecch kemi me deftuem **te mieren fet ren** e Kisciavet tona (f. 35)*

*quaemadmodum omnes huius Sacramenti **summa** premimur necessitate..*

(f. 37)

*e sicuur giçç kemi **te madhe** nevoje per ketà... (f. 28)*

*Solent infelices et **miseri** parentes (f. 48)*

*Kane eaconin, teëii, e **temierete** Prinde (f. 41)*

*Et Romanae Sedis **infallibilis** auctoritas (f. 19)*

***E paa fijescime** puscteteja e Selise Romese (f. 6)*

*..images Christi, ac Deiparae semper Virginis, nec non **aliorum Sanctorum** habendas... (f. 17)*

*....se figurat e Criscitit, Σognese beecueme, e **te tierevet Scendet** jane per t'u passune...(f. 4)*

***ad summos deinceps**, ac vere Apostolicos labores, ...excitantur. (f. 78)*

***mbe te nalte essape**, e mundime t'Apostuijet,. eembrohen. (f. 77)*

*Hinc omnes **pia mentis trepidatione** perpendant...(f. 69)*

*Kend8j giçç **me te maçe frighe** te mendese per saa jane... (f. 66)*

Për sa i takon përshtatjes së përcaktorëve me emrin, mund të themi se në gjuhën latine si një gjuhë indoevropiane mjetet gjuhësore, me të cilat është shprehur përshtatja e përcaktorëve me emrin, kanë qenë të një tipi me atë të emrave. Ata lakoheshin duke marrë mbaresat e emrit. Të vërehet përshtatja e përcaktorit në togfjalëshat *filius meus, puella pulchra dhe donum meum*, në rasën gjinore *fili mei, puellae pulchrae, doni mei*, në dhanore *filio meo, puellae pulchrae, dono meo* e me radhë<sup>189</sup>. Gjuha shqipe gjatë evolucionit historik për përshtatjen e përcaktorëve ka krijuar një element që qëndron në ballë të fjalës. Bëhet fjalë për nyjen dhe klasifikimin e mbiemrave në të nyjshëm dhe të panyjshëm, gjë që nuk ndodh në latinishtë. Kështu në shqipen e sotme mbiemri përshtatet në gjini e numër e rasë

---

<sup>189</sup> Por te disa përcaktorë janë përfutuar mbaresa, të cilat nuk ndeshen te emri. Të krahasohet *huius* (*hic, haec, hoc*), *ullius* (*ullus, ulla, ullum*), *illius* (*ille, illa, illud*)ui



me emrin duke ndryshuar nyjen. Ndryshe ka ndodhur në tekstet e vjetra ku përshtatja e përcaktorit bëhet dyherësh, edhe me ndryshimin e nyjes, por dhe me mbaresat rasore në fund. Në gjuhësi kjo dukuri njihet me emrin *biflektivizëm*. Në historinë e gjuhës shqipe vërejmë këto dy prirje, njëra për ruajtjen e biflektivizmit në togfjalështa *emër + përcaktor* ose *anasjelltas* dhe tjetra për mënjanimin e lakimit të mbiemrit.

Të vihet re biflektivizmi në shembujt e mëposhtëm.

*emudent conscientias suas ab operibus mortuis peccatorum* (f. 73)

*te deliren conscientien, ò Scpirtin prej veperasc becunascit e mcati* (f. 70)

*ab hostium impetu, a facie tribulantis Divini Verbi gladio tueri debent* (f. 23)

*teziat duhen me ruitune me scpat te fialese H it prej anemichiesc e prej Niereëisc se kecchüisc* (f. 12)

*radix virtutum, fons bonorum operum* (f. 15)

*ranza e virtytevet, krou i veperavet mirave* (f. 1)

*Dolemus quidem referre miserrimam nostrarum Ecclesiarum faciem* (f. 43)

*Per te vertete kecch kemi me deftuem te mieren fetÿren e Kisciavet tona* (f. 35)

*qui nostris iniquitatibus offensus, hactenus in puppi dormitasse* (f. 84)

*chi kiè fiyem prej mcatesc sonasc, chi tascti duket se fle mbe bisct te barkese...* (f. 84)

*ne dederis somnum oculis tuis, nec dormitent palpebrae tuae.* (f.54)

*Mos ep gium syve tuve, as mos te ncoten vetula te tua* (f. 49)

*ke raa nde dore t'affrimit tit* (f. 49)

*incidisti in manus proximi tui* (f. 54)

*Parrochi quoque omnibus* (f. 24)

*Parrochianevet ende giççeve* (f. 12)

*ut a propriis, et alienis liberemur defectibus* (f. 54)

*e kinesc te scpetoime prej fajiesc ssone e se huojasc* (f. 48)

Nga shembujt që dhamë, vërehet se prirja e biflektivizmit ka qenë e gjallë. Kjo dukuri vërehet dhe te Buzuku, Budi, Bardhi e Bogdani.<sup>190</sup> Sipas Demirajt,<sup>191</sup> prirja e ruajtjes së biflektivizmit në togefjalëshat e tipit *emër + përcaktor* dhe prirja e dytë për të mos lakuar njërin gjymtyrë të togefjalëshit nxjerrin çështje të vështira për t'u sqaruar. Studiuesit mendojnë se e para është mjaft e hershme, qysh në shkrimet e para, ndërsa e dyta është më e vonë. Këtë dukuri nuk e shohim si ndikim të tekstit latin, në të cilin vërejmë mbiemra e përemra me mbaresa të emrave, por si një dëshmi konkrete që biflektivizmi pa dyshim është një dukuri e hershme, e trashëguar e gjuhës shqipe<sup>192</sup>.

Përveç trajtave të sotme, në tekst shfaqen dhe disa trajta të vjetra të cilat dalin dhe te Buzuku. Këto janë trajta të vjetra të përemrit pronor si *em, tinë, sinë, taj*, të cilat në rasën rrjedhore, në numrin shumës dalin rregullisht me mbaresën rasore *-sh*. pronorët e vetës së dytë e të tretë shumës në ndonjë rast përdoren me mbaresën rasore *-ve* apo trajta e vjetër *tinë apo tanë* për *tonë, tit* për *tat* ose *tend*.

*Vere et propeie Sacramenta novae legis, a Iesu Christo nostro instituta* (f. 16)

*Te verteta Scecramenta te ligiese urçenue, e çane prej Christit tine* (f. 3)

*...vestra sapientia* (f. 20)

*me dije te maçe taj* (f.15)

*ut a propriis, et alienis liberemur defectibus* (f. 54)

*e kinese te scpetoime prej fajiesc ssonne e se huojasc* (f. 48)

*et propter nostram salutem descendit de Caelis* (f. 16)

*e per scelbimin tane sdrippi prej Chijeiscit* (f. 2)

### III.2.1 Përemrat dhe llojet e tyre.

#### *Përemrat vetorë.*

---

<sup>190</sup> Krahaso: Buzuku: *...të lanjë gishtnë mā të vogëlinë nd ujë* (f. 143)..e zemërenë e fortë të tynenë... (f. 261) Budi: *...e kundra shintit yrdhënit e ligj-së tī* (f. 62); Bogdani: *me pasë shpëresë e të penduem fajeshit së vetsh* (I/VII/20)

<sup>191</sup> Vep e cituar f. 558

<sup>192</sup> Për më shumë shih Demiraj, vep. cit f. 545 -546

Në gjuhën latine të gjitha format foljore përmbajnë në **vetvete** një **kryefjalë** dhe janë mbaresat vetore të foljes që shënojnë vetën: *lego* do të thotë *unë lexoj, legis - ti lexon*, etj. Dhe në tekstin latin të Kuvendit përemrat nuk dalin dhe po kështu dhe në tekstin shqip. Prania e përemrave vetorë në shqipen e Kuvendit është vetëm në ato raste kur për arsye të ndryshme shfaqet dhe në latinishte.

*Ego N. Firma Fide credo* (f. 15)

*Une me fee të ngullune bessogn* (f. 2)

*confitebor et ego eum coram Patre meo, qui in Caelis est* (f. 20)

*Une kam me refyem atà perpara tim Et, chi asct mbe chiel't* (f. 8)

Siç shihet përemri i vetës së parë njëjës, del me formën e re të gjuhës së sotme *unë*, dhe jo *u*<sup>193</sup> siç e kemi parë te Buzuku dhe autorët të tjerë, përveç Bogdanit. Po kështu, në disa raste për nevoja theksimi ka dalë dhe përemri i vetës së parë shumës *nos*, i cili është dhënë me *na*, formë kjo më e vjetër se *ne* e sotme dhe tipike e dialektit gegë.

*Nos Dei gratia, statuimus, decernimus, et sancimus* (f. 15)

*Na per hiir te Hyiit ligioime, nkrÿegnme, e ççomi* (f. 1)

*Hanc autem Fidei professionem, quam nos, et Coepiscopi nostri...*(f. 170)

*Urçenogneme, te bahet, e ndicchiet ky essap, chi baame na me Upesckupigne tane* (f. 5)

### ***Përemrat e pacaktuar.***

Në gjuhën latine duke qenë se mungon nyja joshquese, përemrat dhe mbiemrat e papërcaktuar janë të shumtë dhe gjejnë përdorim të madh në fjali. Secili prej tyre shpreh papërcaktim me gradë dhe nuanca të ndryshme. Pothuajse të gjithë përemrat lakohen, por duke marrë mbaresa të cilat nuk i gjejmë te mbiemrat, gjë që u tha dhe për përemrat dëftorë<sup>194</sup>. Funkzioni kryesor i përemrit është zëvendësimi i emrit, por në latinishte disa përemra të pacaktuar shoqërojnë emrin duke u përshtatur në gjini, numër e rasë me të dhe njihen si mbiemra të papërcaktuar Psh : *aliquis, aliquid* njihen si përemra pasi nuk shoqërohen nga emri, ndërsa *aliqui, aliqua, aliquod* të shoqëruar nga emri marrin më shumë rolin e mbiemrit.

---

<sup>193</sup> Për burimin e përemrit vetor *u* shih Demiraj, vep. cit. f. 448

<sup>194</sup> Khs, format *cuius (quis, qui), alicuius (aliquis, aliquid)*

Të krahasohen: *Vidi aliquid*. – Pashë diçka. *Vidi aliquos pueros* - Pashë disa djem. E njëjta dukuri ndodh dhe në shqipe me disa lloje përemrash,<sup>195</sup> të tillë si përemri i pacaktuar *çdo* që tregon frymorë a sende të veçuar të një grupi, *çdo njeri*, apo përemri *tjetër, djali tjetër*, përemrat që tregojnë sasi të pacaktuar si *disa, ca, pak, shumë, gjithë, tërë* etj. Të shihen shembujt e mëposhtëm.

*Caetera item omnia a sacris canonibus, oecumenicis Conciliis* (f. 17)

*Giçç te tiera lighia, chi jane lane mbe te tiere Sinnodete Cattolike* (f. 4)

*Ab illis praesertim, quibus alios docendi munus iniungitur, ad verbum, sequendam iniungimus* (f. 18)

*E maafort assisc duhet meu baam, e mbaruem, ci kane per lig, e jane detuer me mpsuem te tierete* (f. 5)

*Omnes igitur, qui tantum, ac tanti obsequi onus sustinet, et fastigium, totis visceribus hortamur* (f. 50)

*Giçç pràa, chi e baine cacchie barre te nderscime i ndisckoime me giçç sckaffete* (f. 44)

*An in ea se quisquam per vim intruserit* (f. 57)

*A hiini cusc nder tò per forse ?* (f. 51)

Përemrat e pacaktuar të latinishtes dhe në shqipen e Kuvendit janë përkthyer po me përemra, trajtat e të cilëve në përgjithësi, janë të njëjta me ato të shqipes së sotme, me ndryshimin e vetëm se përemrat e përngjitur apo të përbërë të përfutur nga bashkimi i dy ose tre elementeve, në shqipen e sotme shkruhen bashkë, ndërsa në tekst shkruhen veçmas.

*Hanc veram Catholicam Fidem, extra quam nemo salvus esse potest* (f. 17)

*Kete Fee Kattolike, pa ate sillene as kusc mund scelbohet* (f. 4)

*omnis, qui confitebitur me coram hominibus* (f. 20)

*giçç i silli ci ka me rrefjëm mue perpara Nierzet* (f. 8)

*nihil nobilius, nihil pretiosus nihilque ad aeternam salutem* (f. 29)

*as giàa maa të beganiscim, as giàa maa te pacimueme, as giàa màa te nevoiscime kàa Kiscia per t'u passune scendetja* (f. 19)

---

<sup>195</sup> Shih Gramatika, f. 251 e tutje.

*quicumque huiusmodi incertitudine iusiurandum violaverit, Iudici Deo, qui accipit ..., merito est rationem redditurus.* (f. 28)

*Giçç i silli praa, chi te fijegn beese me droe asct per te çane arresye Hyit Giucatesit, i silli merr....giychin e vertete paa nderdym* (f. 18)

*Sic enim quod corrigendum est, corrigent et quod sanum est, divino zeli fervore costodient.* (f. 50)

*se ksctu kane me nderecchiune ci dò asct i sctreme, e kane me rueitune ci dò asct Scendosc me te nzetit te eelit* (f. 43)

*Deo igitur soli, cui servire, regnare est, per externam, et publicam Fidei confessionem sit devotus fidelis* (f. 21)

*Vece H8it praa, "cui me scerbyem, asct me sotenuem:" te truhet, e te fallet i Feescimi, e mballafacchie te cui dò te refegn acchie saa as gni scegn te keete* (f. 8)

**Përemrat dëftorë.**

Në klasën e përemrave dëftorë gjithashtu, janë ruajtur trajtat e vjetra. Kështu, shfaqet shpesh përemri asnjansës **këtà**, përemër që del shpesh dhe te Buzuku, të cilit i përgjigjet përemri i gjinisë asnjansëse i latinishtes **haec** apo **hoc**.

Dendur përdoren dhe trajtat e rasës rrjedhore si *këso, kësoje, aso, asisc, asosc* etj. Si në gjuhën latine dhe në atë shqipe përemrat dëftorë kanë një rend të ngulitur. Ata qëndrojnë kryesisht përpara emrit që përcaktojnë, gjë që vërehet dhe në shembujt e gjetur.

*in hoc crediti nobis gregis securitas, et nostri iuris praecipua fundatur auctoritas* (f. 23)

*nde keta na forzohet eembra, nde ketà kaa ççemelne puscteteja e essapit tiine, e me ketà largohet droeja prej Grigiet* (f. 12)

*sic me Deus adiuvet, et haec Sancta Dei Evangelia* (f. 18)

*asctù me ndimoft Hyj, e ketà ungiil te Scend te Tinecot* (f. 5)

*Honorabile coniugium, quo illicita destruuntur connubia* (f. 45)

*Enderscemeja asct Martessa, e me ketà priscet ci do te mbasckuemit te paa lighie.* (f.38)

*per haec nostra Decreta excitantur...* (f. 78)

*prej kessosc decretasc eembrohen ...* (f. 77)

*venerit gladius, et tulerit de eis animam* (f. 13)

*e tue arçune scpata, te marr scpirtin prej ssisc* (f. 8)

*et propinqui, nihol audeant, de impensi sumptus ratione ....*(f. 75)

*ò fissi mos te guzogn me lakmuem piessene assò giaaje....*(f. 73)

*Sacra Congregatio conceptae spei expectatione fraudata...* (f. 82)

*Cunvendi Scind kiè maisctruem assò dobije ...* (f. 81)

*...magis animarum saluti, quam ab illis gubernari* (f. 73)

*nuk maa kecchie, se meu guvernueu prej assisc ...*(f. 71)

### III. 3 Sistemi foljor

Folja (*verbum*) në gjuhën latine ashtu si dhe në gjuhën shqipe, është elementi më i rëndësishëm i fjalisë. Te të dyja këto gjuhë indoevropiane folja si pjesë e ndryshueshme e ligjëratës ka kategorinë gramatikore të: vetës, diatezës, numrit, mënyrës dhe të kohës.

Si në gjuhën latine dhe në gjuhën shqipe foljet ndahen në folje kalimtare dhe në folje jokalimtare.

Quhen kalimtare ato folje të cilat emërtojnë veprim që bie mbi një emër në rasën kallëzore, pra kur merr kundrinor të drejtë. Psh: *lego librum – lexoj librin*.

Quhen jokalimtare ato folje të cilat shprehin një veprim a gjendje pa marrë kundrinor të drejtë, por mbetet te ai që kryen veprimin dhe njëkohësisht mund të marrin kundrinor të zhdrejtë, me parafjalë ose jo. Psh: *curro – vrapoj* dhe *curro ad urbem – vrapoj drejt qytetit*. Gjithashtu, në gjuhën latine e atë shqipe një folje mund të jetë si kalimtare ashtu dhe jokalimtare. Përkatësia e saj varet nga kuptimi leksikor në kontekstin ku është përdorur<sup>196</sup>. Psh: *lego librum – lexoj librin / lego in horto – lexoj në kopsht*.

Nga sa u tha më lart u fol për përputhje midis dy gjuhëve. Por ka dhe raste në të cilat vërehen mospërputhje mes foljeve kalimtare e jokalimtare ndërmjet latinishtes dhe shqipes. Të vërehet mospërputhja mes dy foljeve në shembullin e mëposhtëm.

*Dominus non ignoscet illis* (f.48)

*Zotyni nuk po ndijen at8ne* (f. 42)

---

<sup>196</sup> *Gramatika*. Vep e cit. f. 265-167; *Syntaxe latine*, vep.cit, 211- 214

Në shembullin e mësipërm marrë nga teksti latin dhe ai shqip i Kuvendit të Arbënit vërejmë se folja *ignoscere* – *fal* në gjuhën latine ndërtohet me rasën dhanore, pra është jokalimtare, ndërsa përgjegjësja e saj në gjuhën shqipe *fal* ka dy drejtime rasore, me rasën kallëzore, pra kalimtare, gjë që duhej vënë re dhe në këtë kontekst, dhe me rasën dhanore, i *fal gabimin dikujt*.

Në këtë rast kemi të bëjmë me ndikim të tekstit latin, pasi dhe në shqipe është dhënë vetëm me rasën dhanore. Në gjuhën latine si folja *ignoscere* janë *suadere*, *persuadere*- *bind*, *invidere* – (*e*) *kam zili*.

### III.3.1 Kategoria gramatikore e vetës dhe e numrit.

Kategoria gramatikore *e vetës* te folja si në gjuhën latine dhe në atë shqipe shprehet me anë të mbaresave të veçanta, të cilat shprehin dhe kategorinë gramatikore të numrit.

Te folja dallojmë tre veta (*persona*) dy numra (*numerus*), njëjësi dhe shumësi (*singularis, pluralis*). Shumica e foljeve përdoren në tri vetat. Folja duke pasur mbareta të veçanta për secilën vetë si në gjuhën shqipe dhe në atë latine nuk e sheh të nevojshme shprehjen e kryefjalës kur kuptohet nga konteksti, sidomos kur mund të shprehet me anë të përemrit vetor. Në të gjitha rastet ku përemri vetor nuk është shprehur në tekstin latin po kështu ka ndodhur dhe në tekstin shqip.

*Credo in unum Deum Patrem omnipotentem* (f. 15)

*Bessogn mbe gnia te betemin Hyi Atin e Pusctuescim* (f. 2)

*Parrochis quoque omnibus praecipimus, et mandamus* (f. 24)

*Parrochianevet ende giççeve, ççome, e urçenoime* (f. 12)

*Ego idem N. spondeo, voveo ac iuro* (f. 18)

*Une vet N. permetogn, e bagn bee* (f. 5)

### III.3.2 Kategoria gramatikore e diatezës

Në gjuhën latine dallojmë tre diateza; *diateza veprore*, *pësore* dhe *mesore*.

Në gjuhën shqipe dallohen katër diateza, të cilat janë: 1) *diateza veprore*; 2) *diateza pësore*; 3) *diateza vetvetore*; 4) *diateza mesore*.

Në gjuhën latine, pranë diatezës veprore dhe pësore qëndronte diateza mesore (*diatezi media*), e pranishme dhe në greqishten e vjetër, e cila shprehte një veprim të bërë dhe të pësuar nga kryefjala.

Diateza mesore me kalimin e koës u zbeh sepse latinishtja, për të shprehur një veprim të kryefjalës, filloi të shfrytëzonte foljen në formën veprore të shoqëruar nga përemri vetor (psh për të thënë “thyhem” përdorej shpesh *me frango*, në vend të *frangor*, *me excrucio* në vend të *excrucior* ) Kjo diatezë përfshin diatezën vetvetore dhe atë mesore të shqipes. Të bëhet krahasimi mes tre diatezave në gjuhën latine në shembujt e mëposhtëm në të cilët një folje dallon tre diatezat. Më pas do të jepen shembuj nga teksti i Kuvendit të Arbënit.

Diateza veprore	Diateza pësore	Diateza mesore
<i>frango - thyej</i>	<i>frangor – thyhem</i> (nga një tjetër)	<i>frangor – thyhem</i>
<i>lavo – laj</i>	<i>lavor - lahem</i>	<i>lavor – lahem</i>

*Cum Fides Catholica, quae in Sancta Romana Ecclesia, stabilis et incorrupta servatur...* (f. 15)

*Tue kiene Feeja Katolike, e zija nde kisce te Romese, e paa ngand mbahet...* (f.1)

*Praestantissimum docendi munus saluberrima Verbi Dei praedicatione fulcitur* (f. 23)

*Eanati i nderscimi i te mpsuemit forzohet me te scendëccimin predikim te fiallese Hyit* (f. 12)

*Confirmatione praemuniamur ad pugnam; ibi ab iniquitatibus mundemur, hic virtutibus roboremur* (f. 35)

*E me kreemimi bahemi gatii per lufte, aty lahem i n'fajjesc, ketu ferzohemi me virtyte* (f. 25)

*quoniam hoc genus Daemoniorum non eiicitur, nisi in oratione, et ieiunio, quo dum corpus atteritur, anima caelestis gratiae pinguedine saginatur* (f. 26)

*pr'atà thot Scen Mattee Apostuli; “Se kiò dore Diemenisc nuk largohet, vece me Urat, e me agninim.” Me te sillt ende se lighet corpi; Scpirti pò majet me te maimite hiiit chiełscim.* (f. 15)



Ndërtimin e ri, për të cilin u fol më lart dhe që shpreh një veprim të kryefjalës, me folje në veprorë të shoqëruar me përemër vetor, e kemi gjetur dhe në tekstin tonë, gjë që vërehet dhe në shembujt e mëposhtëm.

*publice Turcarum more se gerunt, et alii quidem moscheas, ut vocant, more patrio frequentat* (f. 18)

**mbahen** si Turrin: *disa nuk jessene paa vot meu falle Mecittavet*<sup>197</sup> (f. 5)

**Non immisceant se negotiis saecularibus, mercaturis potissimum ....** (f. 72)

**Mos te perzihen** nde eura te Scecularevet, e màa fort nde rescperije... (f. 69)

*quod si speculator viderit gladium venientem et non intonuerit buccina, et populus se non custodierit* (f. 24)

**nde paat Capetaani scpaten, chi po vien, e mos te bii Boriis, e Populi mos u rueiiti vete vetehen.** (f. 13)

*Nemo autem se excuset temporum angustiis ; angustia enim constringitur...*(f. 41)

**Mos të shkacohet cusc,** se esctingon motti i munduescimi : *pro me te kecchie te mendese.....*(f. 33)

Në disa raste përkthyesi ka bërë një përkthim të lirë duke na dhënë një folje në formën joveprorë me një folje në formën veprorë, siç mund të vërehet në shembullin e mëposhtëm:

**Monentur Episcopi,** *ut institutionem Parochorum ipsis scripto adhibeant* (f. 73)

**Te mbane mend** *Upesckupignete, chi t'appene sckruem Parochiet te vënduemit e tyne* (f. 71)

Një grup të veçantë foljesh përbëjnë foljet deponente dhe gjysmëdeponente. Kemi të bëjmë me folje të cilat kanë formë pësore por vlerë apo kuptim vepror<sup>198</sup>. Ndërsa foljet gjysmëdeponente zgjedhoheshin në formë veprorë për kohët e *infectum*-it dhe në formën pësore për kohët e *perfectum*-it. Ashtu si deponentet dhe gjysmëdeponentet kanë kuptim vepror. Në tekstin shqip të KA kryesisht janë dhënë me folje në trajtën veprorë, me përjashtim të shembujve të mëposhtëm në të cilët gjejmë folje në trajtë joveprorë:

---

<sup>197</sup> *Giamijve – Xhamijave*

<sup>198</sup> Kemi të bëjmë me folje të cilat kanë vetëm formë veprorë, jo diatezë pësore: psh *utor, usus sum, uti; gaudeo, gavisus sum, gaudere*

*ut quae maxima unitate gaudet, omnem intellectum redigens...* (f. 15)  
*e ajo chi gheohet<sup>199</sup> me kiene gni evetemia chi siell ....*(f. 1)

*quae continentur in Symbolo fidei, quo Sancta Romana Ecclesia utitur*  
(f. 15)

*chi chiuhet simbul i Feese, chi scerbenet scendeja kisce e Romese*  
(f. 2)

*in abscondito facta abiuratione coram fidelibus, secreta Sacramentorum participatione fruuntur* (f. 19)

*basndaj tue u sgiçunetineeisct, ndo perpara dissa te feescimet, refehen, e cungohen, tue u baam piesetarete Scecramentavet* (f. 19)

### III. 3. 3 Kategoria gramatikore e kohës.

Në latinishte në formimin e kohëve flitet për sistemin e së tashmes (ose *infectum*), për të emërtuar veprim në kryerje e sipër dhe sistemi i së kryerës (ose *perfectum*), për veprim të përfunduar<sup>200</sup>.

Në sistemin e *infectum* - it bëjnë pjesë: *praesens* (e tashmja), *imperfectum*, (e pakryera), *futurum* (e ardhmja).

Në sistemin e *perfectum* - it futen: *perfectum* (e kryera dhe e kryera e thjeshtë), *plusquamperfectum* (më se e kryera e cila mbulon dhe të kryerën e tejshkuar) dhe *futurum secundum* (e ardhmja e përparme)

Në gjuhën shqipe folja ka gjithashtu kategorinë gramatikore të kohës. Por, ndërsa në gjuhën latine njohëm dy sisteme, në gjuhën shqipe kohët themelore të foljes janë tri; e tashmja, e shkuara dhe e ardhmja. Kështu në shqipe dallojmë të njëjtat kohë të cilat janë: e tashmja, e pakryera, e ardhmja, e kryera e thjeshtë, e kryera, më se e kryera dhe e kryera e tejshkuar. Si në gjuhën latine dhe në atë shqipe të gjashta këto kohë i ka mënyra dëftore. Mënyra lidhore ka katër kohë si në shqipe ashtu dhe në latinishte, ndërsa urdhërorja në gjuhën latine ka forma gramatikore të kohës së tashme dhe të së ardhmes, për vetën e dytë dhe të tretë. Në gjuhën shqipe urdhërorja ka forma gramatikore vetëm për vetën e dytë, njëjës dhe shumës të kohës së tashme.

Në librin e tij mbi gjuhën shqipe të Kuvendit të Arbënit Rexhep Ismajli në një kapitull të veçantë “Teksti i kuvendit të Arbënit, llojet e tekstit” krahas analizës së

---

<sup>199</sup> Të vihet re ndërtimi i formës joveprore, i njëjtë me atë të shqipes së sotme. Ka dhe pa raste ku në zgjedhimin jovepror folja merr *n* në vend të *h*. Këtë trajtë më të vjetër e vërejmë dhe te *Meshari* i Buzukut.

<sup>200</sup> Termat janë në latinishte: *infectum* nga *in* – privuese), *perfectum* “që ka përfunduar). Këto terma janë përdorur dhe nga Varroni, gramatikani i parë i gjuhës latine.

ndërtimit të tekstit, bën vërejtje gjuhësore për përdorimin e kohëve dhe të mënyrave të foljeve dhe funksionet e tyre në lidhje me përmbajtjen e tekstit. Sipas Ismajlit<sup>201</sup>, kemi të bëjmë me një tekst të qartë dhe me struktura të rregullta. Studiuesi vijon më tej duke e ndarë tekstin në dy lloje:

1. Tekst i natyrës ndërkomunikuese, tekst i drejtuar të tjerëve. Këtu përfshihen letrat e Zmajeviçit dhe fjalimi i tij në Sinod.
2. Tekst i natyrës normative- taksative, i cili përmban urdhra dhe vendime të cilat duhen respektuar dhe të merren parasysh nga krerët katolikë dhe nga besimtarët. Duke qenë autori ka zgjedhur këto dy lloje tekstesh për të dhënë mesazhin në mënyrë sa më të qartë ai ka shfrytëzuar kohë të ndryshme të foljeve, përdorimi i të cilave është bërë për qëllime stilistike. Për t'i dalluar më qartë përdorimin e këtyre kohëve autori është nisur nga tri kriteret që sipas studiuesve të tekstit quhen boshte të informacionit:

1. Qëndrimi i folësit.
2. Perspektiva e të folurit
3. Relievizimi i tekstit.

Sipas kriterit të parë duke cituar Weinrich<sup>202</sup> Ismajli dallon kohët e komentit dhe kohët e rrëfimit. Në kohët e komentit, po sipas Weinrich hyjnë e tashmja, e kryera dhe e ardhmja e thjeshtë, kohë të cilat janë përdorur si në tekstin latin dhe në atë shqip.

Kohët sipas kriterit të dytë ndahen në kohë të së tashmes, të së kryerës dhe të së ardhmes, për të dalluar një veprim të mbaruar nga një veprim të pambaruar. Funksionet e këtyre kohëve në tekstin shqip dalin po me ato funksione që ka dhe shqipja e sotme.

Lidhur me relievizimin e tekstit Ismajli<sup>203</sup> pohon se autori i tekstit nuk e arrin relievizimin e tekstit me anë të kombinimit të aoristit, përgjegjësja e saj në shqipe e kryera e thjeshtë, me imperfektin, e pakryera, por duke nxjerrë në plan të parë rrëfimin dhe duke futur në plan të dytë komentin.

Në tekstin latin të Kuvendit, si një tekst i shkruar në latinishten mesjetare, koha e shfrytëzuar për të arritur rrëfimin është perfekti sintetik. Për këtë arsye këtë perfekt të latinishtes e shohim më shumë në pjesën e parë të tekstit që përbëhet nga letrat e Zmajeviçit drejtuar Papës Klementit XI. Të vërehen shembujt e mëposhtëm duke krahasuar dy tekstet.

---

<sup>201</sup> Vep.cit. f. 211

<sup>202</sup> Harald Weinrich., *Le temps*. Paris,1973. f. 30

<sup>203</sup> Vep. cit. f. 219

Teksti latin	Teksti shqip
- <i>Iussisti Beatissime Pater</i>	- <i>Urdhënove, o I Lumshmi Atë</i>
- <i>Iussis parui</i>	- <i>Ndigiova urdhënit</i>
- <i>Circuivi terram</i>	- <i>Suolla dhenë</i>
- <i>Vidi contritines eius</i>	- <i>Pae plagat e ti</i>
- <i>Vidi, proh dolor!</i>	- <i>Pae (uh të dhimbunit)</i>

Që kemi të bëjmë me një tekst rrëfimor duket dhe nga përdorimi i mënyrës dëshirores që ndërhyt në ndonjë fjali duke shprehur gjendjen emocionale të folësit. *Ament asctu chioft: Largofta Σotyni*

Lloji tjetër i tekstit ai normativ – taksativ karakterizohet nga komenti i veçantë. Në këtë tekst të dytë të zhveshur nga qëndrimet emocionale dhe të konkretizuar nga një “frazë e gjatë dhe e ftohtë latine tipike të periudhës mesjetare”<sup>204</sup> qëndrojnë dekretet të cilët më së shumti përmbajnë vendime e urdhra për besimtarët. Me të drejtë në këtë pjesë të tekstit mbizotërojnë foljet pavetore, format e pashtjelluar a si pjesorja, paskajorja apo përcjellorja.

Për sa i takon përdorimit të kohëve, vërehet koha e kryer, *perfectum -i* dhe e ardhmja e domosdoshmërisë, *futurum necessitatis*. Gjithashtu, nuk mund të lëmë pa përmendur dhe përdorimin e shpeshtë të lidhës me funksion të urdhërores, dukuri që siç do të shihet në vijim është e përbashkët si për shqipen ashtu dhe për latinishten. Për të gjitha këto kohë që u përmendën do të flitet në vijim të punimit. Në fakt do të ndalemi në ato kohë të cilat paraqesin interes kryesisht për historinë e gjuhës shqipe, pasi do të ishte me interes të njiheshim dhe me gjendjen e atëherëshme të sistemit foljor jo vetëm në planin e formimit, por dhe në atë të funksioneve të këtij sistemi. Nga vënia përballë e dy teksteve do të shihen përputhjet apo dallimet mes kohëve dhe përdorimit të tyre në latinishte dhe në gjuhën shqipe dhe njëkohësisht të na krijojë një ide të qartë mbi format e shqipes së atëherëshme të shekullit XVIII dhe dallimet me ato të shqipes së sotme.

### III.3.4 **Kategoria gramatikore e mënyrës.**

Mënyra shpreh qëndrimin dhe këndvështrimin e folësit, veprimi i të cilit mund të jetë real, i mundshëm, mund të jetë thjesht një pohim, urdhër, lutje.

---

<sup>204</sup> Ismajli, vep. cit. f. 222

Gjithashtu mund të jetë dhe dëshirë apo shpresë etj. Latinishtja dallon forma të shtjelluara dhe të pashtjelluara, gjë që ndodh dhe në gjuhën shqipe. Format e shtjelluara janë ato forma foljore që ndryshojnë sipas vetës dhe numrit, *verbum finitum*. Format e pashtjelluara (*verbum infinitum*) nuk i kanë këto kategori. Në mënyrë më të zgjeruar mbi format e pashtjelluara të latinishtes do të flitet në kapitujt në vijim.

Gjuha latine njih këto mënyra: *indicativus* (dëftorja), *coniunctivus* (lidhorja), *imperativus* (urdhërorja).

Shqipja nga ana tjetër na shfaqet me më shumë mënyra duke ruajtur ato të indoevropianishtes, por dhe duke i zhvilluar më tej, shqipja dallon këto mënyra: mënyra *dëftore*, *lidhore*, *urdhërore*, *kushtore*, kjo falë prirjes së shqipes për t'i dalluar sa më qartë kuptimet modale. Kështu si mënyra të reja janë ajo *habitore* dhe *dëshirore*. Në pamje të parë duket se latinishtja është është më e varfër në mënyra, rrjedhimisht dhe më e varfër për dallimin e kuptimeve modale. Kështu, mund të vërejmë se në latinishte sistemi foljor nuk ka tre mënyrat e fundit (*mënyrën kushtore*, *habitore* dhe *dëshirore*). *Coniunctivus*, (lidhorja) e latinishtes kryen dhe funksionet e dy mënyrave që kanë qenë të pranishme në gjuhët indoevropiane dhe të ruajtura në greqishten e vjetër dhe në shqipe. Bëhet fjalë për lidhoren *coniunctivus* - *lidhore* (për të shprehur mundësi apo dyshim) dhe *optativus* - *dëshirore* (për të shprehur dëshirë). Mënyra lidhore gjithashtu, është mënyra më e përdorur, veçanërisht në fjalitë e nënrenditura, të cilat në gjuhën latine janë të llojeve të ndryshme.

### III. 3. 4. 1 Modus indicativus / Mënyra dëftore e foljes.

#### Praesens / Koha e tashme

Foljet në kohën e tashme janë përdorur kryesisht në atë pjesë të tekstit që përmban dekretet, të cilat janë një tekst i mirëfilltë komentues i llojit të veçantë të tekstit normativ. Prezenti, siç pohon dhe Ismajli, përbën bazën e ndërtimit të tekstit të dekreteve.

Folja në kohën e tashme në gjuhën latine dhe në atë shqipe tregon një veprim ose gjendje që ndodh në momentin që flasim. Si latinishtja dhe shqipja janë të pasura në forma gramatikore. Në gramatikën e gjuhës shqipe thuhet se me anë të këtyre formave shprehen jo vetëm kuptime kohore, por dhe ngjyrimet aspektore<sup>205</sup>.

---

<sup>205</sup> Termi *aspekt* shenjon mënyrën e paraqitjes së zhvillimit të veprimit. Ekziston kjo kundërvënie: *veprim i kryer*: *veprim i pakryer*. Për më shumë shih *Gramatika*, vep.cit. f. 274.

Në gjuhën latine kemi të bëjmë me aspekt foljor kur flasim për veprim të foljes duke iu referuar zgjatjes së kohës së veprimit për të përcaktuar kështu nëse veprimi i shprehur nga folja është duke ndodhur apo ka përfunduar. Kategoria gramatikore e aspektit nuk është zhvilluar në sistemin foljor të shqipes dhe të latinishtes ku sistemi foljor bazohet në kategorinë gramatikore të kohës. Përrjashtim këtu bën greqishtja e vjetër, e cila tërë sistemin foljor e bazon te aspekti foljor. Le të përmendim këtu aoristin, i cili në sistemin foljor të greqishtes ka funksionin e të shprehurit të aspektit absolut.

Në latinishte kundërvënja *infectum/perfectum* (fillimisht aspektore), merr vlerë kohore. Por latinët, për të përcaktuar zgjatjen ose përmbushjen apo kryerjen e një veprimi, shfrytëzonin mjetet të tjera gjuhësore:<sup>206</sup> psh *venio – vij, po vij* është në kundërvënie me *pervenio – mbërrij; facio – bëj* përballë *perficio – përfundoj*. Foljet në kohën e tashme në tekstin latin të Kuvendit të Arbënit janë përkthyer po me folje në kohën e tashme dhe në tekstin shqip vërehen mbaresat vetore të mëposhtme: *-nj, -n, -, -n, -nj(ë)më, -ni, -nj(ë)në*.

Psh:

*Credo in unum Deum Patrem Omnipotentem* (f.15)

*Besogn mbe gnia te vetemin Hyi Atin e pusctuescim* (f. 2)

*Ego idem N. spondeo, voveo ac iuro* (f. 18)

*Une vet N. permetogn, e bagn bee* (f. 5)

*Omnibus igitur provinciae nostrae, caeterisque Albaniae Parochis, nec non Patribus missionaribus praecipimus* (f. 31)

*Urçenogneme praa giççeve Priftineve e Fratinevet chi jane Parochi nde Arbenii* (f. 21)

*Ut immunes fiant tribute Caesaris, denegant etiam, quae sunt Dei..*(f.18)

*Kinese te scpettoine prej haracit Meretit, mbohognene ende cafsiat e Hyit* (f. 5)

Të vërehet në shembujt e mësipërm prania e *nj –së* në foljet me temë në zanore, dukuri që vërehet në gjuhën e Buzukut dhe autorëve të tjerë të Veriut<sup>207</sup>. Në këtë rast teksti shqip i Kuvendit të Arbënit na ndihmon për të hedhur dritë se gjer kur ka vazhduar në dialektin gegë shqiptimi i *nj-së*.

---

<sup>206</sup> Bëhet fjalë për vendosjen e parafjalëve para foljes.

<sup>207</sup> Një punim mbi mënyrën dëftore të foljes në veprën “*Cuneus prophetarum*” të Pjetër Bogdanit është ai i Eljana Paços. Studime albanologjike, 1997/2. f. 77.

Kjo *nj* e hasur te libri i parë i shqipes së shkruar *Meshari*, ka vazhduar të shqiptohet të paktën deri në fillimin e shekullit XVIII, pra 1706, vit kur u botuan aktet e Kuvendit të Arbënit. Megjithatë nuk mungojnë dhe format më të reja – *j*, *-jmë*, *-jnë* ku *nj* del e jotizuar në *i*, gjë që mund të vërehet në shembullin e mëposhtëm.

*Parochis quoque omnibus praecipimus, et mandamus...* (f.24)

*Parrochianevet ende giççeve, ççome e urçenoime...* (f. 12)

*Omnibus igitur Archiepiscopis commendamus* (f. 20)

*Pràa giçç Upesckupignev, raccomandandoime* (f. 8)

*Omnes igitur, qui tantum, ac tanti obsequi onus sustinet, et fastigium, totis visceribus hortamur, ut Apostolicis ....*

(f. 50)

*Giçç pràa, chi e baine cacchie barre te nderscime i ndiscoime me giçç sckaffete, Kinese tue ndiecune sundete...*(f. 44)

### III.3.4.2 Futurum / Koha e ardhme

Sipas të dhënave qysh në kohët e vjetra në gjuhët indoevropiane ideja e së ardhmes së kryerjes së një veprimi jepej kryesisht me anë të lidhore. Në fakt futuri i latinishtes ka burimin nga lidhore të hershme<sup>208</sup>. Me vlerën e së ardhmes e tashmja e mënyrës lidhore përdoret dhe në gjuhën shqipe<sup>209</sup>. Ky përdorim dëshmohet qartë që te Buzuku.

Gjuha latine ka dy lloje të së ardhmes: një lloj më – *am*, *-es*, me burim nga lidhorja, për folje në bashkëtingëllore, dhe lloji tjetër më i vonë, më –*bo*, për foljet në zanore. Konkretisht kemi *narrabo*, *narrabis...*, *legam*, *leges...*, *audiam*, *audies* etj. Në sistemin e *inflectum*-it mund të vërehen të njëjtat mbaresa si në futur ashtu dhe në të tashmen e lidhore, veta e parë njëjës. Bëhet fjalë për foljet e zgjedhimit të tretë e të katërt. Po kështu e ardhmja e përparme dhe perfekti i lidhore dallojnë vetëm në vetën e parë njëjës. : *amavero/-erim*, *legero/-erim*, etj.

Në gjuhën latine futuri i thjeshtë shpesh zë vendin e lidhore, veçanërisht të lidhore ekzortative, lidhoren deliberative, atë të dëshirës etj.<sup>210</sup>

Nga shembujt e shumtë që u dhanë mund të shihet se futuri në gjuhën latine njeh ndërtim sintetik, gjë që nuk mund të thuhet për gjuhën shqipe. Shaban Demiraj<sup>211</sup>

---

<sup>208</sup> Antonio Traglia, *La flessione verbale latina*, Trattato di morfologia storica, Torino, 1950, f. 21

<sup>209</sup> Shih Demiraj, SF 3, 1970, 72 e tutje. Bëhet fjalë veçanërisht për lidhoren e së tashmes kur shpreh modalitetin e mundësisë, të detyrimit ose të dëshirës. (khs *Të shkosh! Ku të vete?*)

<sup>210</sup> Të vërehet përdorimi i së ardhmes në vend të lidhore ekzortative. *Ergo post nonam venies – Të vish pra pas orës tre!*

pohon se ndonjë formë sintetike e posaçme me vlerën e së ardhmes nuk ndeshet gjëkund në shqipen e dokumentuar.

Në fazën e dokumentuar të shqipes për të shprehur kuptimin e së ardhmes përdoren kryesisht disa forma analitike. Më të përhapura janë ato të ndërtuara me anë të pjesëzës foljore *do* (*do të punoj*), me anë të foljes ndihmëse *kam* (*kam me punue*, *kam për të punuar* dhe *kam të punoj*). Në tekstin tonë përdorim më të madh gjen ndërtimi *kam + paskajore* e tipit *me punue*. Kjo gjë pritej sepse kemi të bëjmë me një tekst të shkruar në dialektin gegë, më saktë në gegërishten veriore. Dihet që ky formim i së ardhmes përdoret mjaft dhe sot e kësaj dite në të folmet veriore. Por gjithashtu mbetet dhe i vetmi tip i së ardhmes te Budi dhe tipi mbizotërues te Buzuku, Bardhi e Bogdani.<sup>212</sup> Lidhur me burimin si dhe për shtrirjen e përdorimit në gjuhë, janë hedhur shumë hipoteza, te të cilat nuk po ndalemi gjatë. Sipas disa gjuhëtarëve mes tyre Sh. Demiraj, S.Mansaku<sup>213</sup> ky ndërtim mund të shpjegohet fare mirë brenda shqipes dhe përfundojnë tezën e tyre duke pohuar se kjo e ardhme është përfutur nga gramatikalizimi i togfjalëshit të tipit *kam + paskajore*. Folja *kam* ka humbur tërësisht kuptimin e saj leksikor duke u shndërruar në një mjet gramatikor, në rastin tonë në folje ndihmëse. Në fillimet e tij togfjalëshi i lirë përdorej për të shprehur kuptimin e së ardhmes me ngjyrim modal të domosdoshmërisë apo detyrimit, por që me kalimin e kohës ngjyrimi është zbehur. Në shumicën e rasteve ky ndërtim, te autorët e vjetër përdoret si një e ardhme e zakonshme, pa ndonjë nuancë modale të domosdoshmërisë apo detyrueshmërisë, ndryshe njihet si *futurum necessitatis*. Por, siç vëren Mansaku, ka raste kur nuanca e domosdoshmërisë është aq e theksuar sa është e vështirë të përcaktohet nëse kemi të bëjmë me një formë të së ardhmes apo me ndërtim të lirë.

---

<sup>211</sup> *Gramatikë historike*..., vep. cit. f. 816

<sup>212</sup> Demiraj në punimin e tij f. 836 pohon: “*po të kemi parasysh dendurinë e përdorimit të formës analitike, pra kam + paskajore, nuk mund të mos nxirret përfundimi se ky nënëtip i së ardhmes është zhvilluar në të folmet veriore para shekullit të Bbuzukut, pas gjithë gjasash, disa shekuj më përpara: Te Buzuku: Përse aj porsi flaka kã me dalë nde e dalë të diellët (f.315); te Budi: ...thom se s dī a ka me qenë gja pr ata I pādijtunë ... (SC, f. 1e parathënies); te Bogdani: Andaj kanë me u dukunë zgedhësit disa fjalë të shkurtëna (parathënia e veprës)*

Një tjetër fakt që na çon në përfundimin se ky është një ndërtim i shqipes vërehet dhe nga të dhënat e shqipes së dokumentuar, ku ndeshemi me kallëzues të ndërtuar nga togfjalësha me foljen *kam* dhe folje tjetër në një formë të pashtjelluar ose në të tashmen e lidhores. Midis këtyre gjymtyrëve mund të vendosej ndonjë fjalë tjetër, konkretisht një kundrinor i drejtë që kërkohej nga folja kalimtare *kam*, duke shprehur kuptimin modal të detyrueshmërisë. Për më shumë shih Demiraj, po aty, f. 839.

<sup>213</sup> *Paskajorja e shqipes dhe kategoritë gramatikore të saj*, Studime filologjike, Tiranë, 1982/ 1



Një gjë e ngjashme ka ndodhur dhe në gjuhët neolatine, në të cilat futuri i italishtes *avrò, j'aurai* i frëngjishtes e kanë burimin nga konstrukti i latinishtes vulgare *habere habeo*. Për këtë arsye, disa studiues kanë guxuar të pohojnë dhe të shohin burimin e këtij ndërtimi futurit të shqipes pikërisht te ndërtimi i sipërpërmendur i latinishtes popullore.

Në tekstet e vjetra përfshirë dhe atë të Kuvendit të Arbënit gramatikalizimi është arritur, sepse përdoret për të shprehur një veprim të ardhshëm të zakonshëm, pa ndonjë nuancë të veçantë. Kjo gjë vërtetohet dhe për faktin se dhe në tekstet përgjegjëse latine folja është në futur të thjeshtë dhe jo me ndërtime tipike të latinishtes që përdoren për të shprehur domosdoshmëri të kryerjes së veprimit, për të cilat do të flasim në vijim.

*furor eius fumabit, et sedebunt super eos omnia maledicta, et delebit nomen eorum et consumet eos in perditionem* (f 48)  
*kaa me timuem furija, kane me raam mbi ata giçç*  
*malekime e kaa me prisciune emenat e tyme e kaa me i*  
*soossune nde te sciuemit* (f 42)

*sanguinem autem eius de manu speculatoris requiram* (f 24)  
*giakun e Populit prej dorese kapetaanit kam me lypune* (f 13)

*eritis enim mihi sancti (ait Deus)* (f 44)  
*kini me kiene mue Sceneni* (ççot H8j) (f. 37)

*Sic enim quod corrigendum est, corrigent et quod sanum est, divino zeli fervore costodient.* (f 50)  
*se ksctu kane me nderecchiune ci dò asct i sctreme, e kane me rueitune ci*  
*dò asct Scendosc me te nzetit te eelit* (f. 43)

*Si quis enim domui suae praeesse nescit, quomodo Ecclesiae Dei diligentiam habebit ?* (f. 53)

*Pro nde mos di cusc me sunduem sctepiin e vete, si praa kaa me diitune me*  
*mbaitune kiscene e Hyit* (f. 47)

*nomenque Domini, qui in veritate vivit, falsitatis testimonio poluentes,*  
*implebuntur iniquitate, et non discedet a domo eorum plaga* (f. 28)  
*tue fełigune Emenit e Tinesot, chi jeton nde te dereite ; kane meu nghignune*  
*assosc, e kane meu mbusciune me te kecch e ska me dalle plaga prej*  
*Sctepiise tune* (f. 18)

Një ndërtim tjetër për formimin e së ardhmes në tekstin tonë, megjithëse jo shumë i përdorur, është dhe ndërtimi tjetër analitik i tipit *kam për të bërë*. Krahasuar me tipin *kam me punue*, ky tip është më i ri; ai është i mbarë shqipes, por më shumë ndeshet në dialektin jugor dhe në gegërishten e mesme. Ky ndërtim ndeshet ndonëse rrallë, qysh në veprën e Bogdanit, pa e hasur në veprën e parardhësve të tij Buzuku, Budi dhe Bardhi. Ky ndërtim është përfutur pas krijimit të formës së pashtjelluar të tipit *për të punuar*. Në këtë fazë të shqipes ky ndërtim ka zbehur kuptimin e domosdoshmërisë dhe ka fituar nuancë të pastër të së ardhmes dhe kjo duket nga teksti latin ku foljet janë në kohën e ardhme. Psh:

*..jeten e Scekulit chi kaa per t' arçune* (f. 2)  
*...vitam venturi saeculi* (f. 16)

Në rastin e mësipërm, me të ardhmen e tipit *kam për të bërë* është përkthyer participi futur i tekstit latin, *venturus, a, um*.

Në tekst kemi gjetur dhe dy raste të tjera të formimit me *kam + për të bërë*. Po të vërehet me kujdes me këtë tip të së ardhmes është përkthyer ndërtimi i një prej foljeve « *servile* » apo ndihmëse siç njihet në gramatikat të latinishtes. Po flasim për foljen si *debere*, e cila ndiqet gjithmonë nga infinitivi. Të krahasohet varianti shqip e ai latin:

*praevaricantis iniquitatem viri portare debet.* (f. 9)  
*kaa per te bartune barrene e të paa uçe të burrit* (f. 43)

*ita illi...saltem competetnti ministerii sui debent vigere intellegentia* (f. 37)  
*atà, cuive i perket puscteteja, kane per te passune dijene* (f. 28)

Në këto dy raste, nuk mund të kuptohet qartë nëse autori e ka përdorur ndërtimin *kaa per te bartune* me kuptimin e së ardhmes duke bërë një përkthim të lirë pa u ndikuar nga teksti latin apo me kuptimin e domosdoshmërisë së veprimit, duke qenë se në tekstin latin i përgjigjet një ndërtimi me foljen modale *debere* dhe paskajoren e foljes kryesore. Ne mendojmë se autori është ndikuar nga teksti latin dhe ka përdorur këtë ndërtim për të treguar një veprim që duhet kryer.

Një gjë që mbetet për t'u sqaruar, është fakti që në tekstin shqip nuk gjejmë raste, qoftë dhe një a dy të ndërtimit të së ardhmes volitive të tipit *do të punoj*. Kjo gjë nuk mund të justifikohet me faktin se kemi të bëjmë me ndërtim të ri dhe jo i njohur në shqipen e shekullit XVIII, pasi atë e gjejmë te Buzuku, dhe pse në librin e tij kemi të bëjmë me në rast të vetëm.

Megjithatë, në një rast të vetëm në tekstin latin kemi foljen në të ardhme ndërsa në tekstin shqip nuk është dhënë po me folje në të ardhmen, por me foljen *due* + paskajore të tipit *me ba* dhe *duo* + *lidhore*.

Të vërehet me kujdes ky shembull në të cilin gjejmë dy rastet e mësipërme. Shembulli është disi i gjatë pasi autori ka bërë një përkthim të lirë. Për mendimin tonë këtu nuk kemi të bëjmë me të ardhme të tipit volitiv, pasi mendojmë se në kohën kur është shkruar Kuvendi duhet të kishte arritur faza e gramatikalizimit, pra kur folja *dua* humb kuptimin e saj. Megjithatë, është një rast i vetëm i cili afrohet në ndërtim me futurin e ri volitiv të shqipes. Po flasim për rastin e mëposhtëm në të cilin gjejmë ndërtimin ***duo të marr***. Megjithatë, nuk mendojmë se kemi të bëjmë me futur të pastër, por më shumë mendojmë se kemi të bëjmë me një përkthim të lirë nga ana e autorit.

*Apostolicas, et Ecclesiasticas traditiones, reliquasque eiusdem Ecclesiae observationes, et constitutiones firmissime **admitto** et **amplector**....nec eam unquam, nisi iuxta unanimum consensum patrum, **accipiam** et **interpretabor***  
(f. 16)

*Me giççe eembre, e paa davii perëaa, e **due me mbaitune** giçç fiallete moccima lane prej Apostuisc.... te nkryemete t'assaj Kisce **duo te marr**, e fort sctrengogn mbe eembre as ketà **due me marre vesct**, e me c'tiele, vece assò mendyre, e essap, sicuundrese mendeja e Scendevet Patreve.* (f. 2)

Faktin që nuk gjejmë të ardhmen e re volitive e shpjegojmë vetëm me arsyetimin se në ndjenjën gjuhësore të përkthyesit kjo trajtë nuk ishte e njohur, madje ndoshta në gegërishte një trajtë e tillë nuk ishte e zakonshme. Një ndikim mund të ketë pasur dhe nga vepra e Bogdanit, të cilën autori yne me siguri e ka njohur. Te vepra e Bogdanit përdorim më të madh gjen ndërtimi tipik i gegërishtes i tipit *kam me punue*.

Sidoqoftë, ndërtimet me foljen *dua* + *lidhore* dëshmojnë se kushtet sintaksore për krijimin e një forme të së ardhmes volitive me *do* kanë ekzistuar edhe në gegërishte.

### III.3.4.3 *Perfectum* / *Koha e kryer e thjeshtë dhe e kryera*

Në gjuhën latine perfekti sintetik shpreh aspektin absolut në të shkuarën për të treguar një veprim të përfunduar dhe në shumicën e rasteve vjen në gjuhën shqipe dhe në shqipen e Kuvendit me anë të së kryerës së thjeshtë. Në tekstin latin tonë

folje në perfekt kemi kryesisht në pjesën e parë të tekstit, më saktë në letrat e Zmajevicit. Të vërehen shembujt e mëposhtëm.

*nulla debet esse macula criminis, nulla ruga simulationis, utpote quae **descendit** a Deo parato* (f. 19)

*as lye, o faii, a ndogni ruçe e te sctirunit duhet me kiene, per sè kiò **sdrippi** prej Hyit* (f. 7)

*Quoniam vero ingravescente turcarum impietate **invaluit**, abominatio desolationis in loco sancto Templorum Domini* (f. 22)

*E persè urandue e paa misceriereja e Turchiet **hippi** nde kete çee Kisciavet Tineëot* (f. 11)

*Et propter nostram salutem **descendit** de Caelis, et **incarnatus est** de Spirito Sancto, ex Maria Virgine, et homo **factus est...passus et sepultus est.*** (f. 16)

*E per scelbimin tane **sdrippi** prej Chijescit, e **u miscenue** per virt t te Scpirtit Scind prej Virginet Mrii, **eu baa** Nierii....pessoj, e u vorrue* (f. 2)

Dhe në raste, si në shembullin e mëposhtëm, kur kemi perfekt pasiv të ndërtuar me anë të foljes ndihmëse *esse* + *pjesore*, një ndërtim ky analitik tipik i latinishtes, përsëri në tekstin shqip është dhënë po me të kryerën e thjeshtë të zgjedhimit jovepror.

*Populus quidem in iniquitate sua **captus est**....* (f. 24)

*Populi me te kecchie te vett **u euu**....* (f. 13)

Por perfekti i latinishtes mund të shprehë një veprim të përfunduar pasojat e të cilit janë në të tashmen dhe në këtë rast kryesisht jepet me anë të së tashmes ose me anë të së kryerës. Një rast i tillë është shembulli i mësipërm, i cili mund të ishte përkthyer më mirë me të tashmen sesa me të kryerën e thjeshtë.

Nga ana tjetër në shembujt e mëposhtëm të gjitha foljet në perfekt janë dhënë me të kryerën e shqipes, e cila, ndërtohet me foljen ndihmëse *kam* + *pjesore* të së kryerës, trajtë analitike, ndryshe nga perfekti latin, i cili ka trajtë sintetike,.

*qui **derelinquerunt** legem Domini Dei sui* (f. 24)

*chi **kane chittune** mbas scpinese vete ligene e Σotit Hyite tyne* (f.13)

*faciem terrae nostrae calamitatum fluctibus, quibus pene obruimur, merito **operuerunt*** (f. 28)

*e gatii **kane mbeluem** facchien e çeu tine, pak pa u farue.* (f. 18)

*Abusus Sacramenti Baptismi, quem Turcae... introduxerunt... (f. 34)*

*Zaacnin e kech, chi kane vum Turit me lypune...*

*incidisti in manus proximi tui (f.54)*

*ke raa nde dore t'affrimit tit (f.49)*

Meqënëse po flasim për të kryerën e shqipes dhe ndërtimin analitik të saj dhe dallimi i saj nga perfektin latin mendojmë se do të ishte me interes të paraqisnim qëndrimet dhe hipotezat që shumë studiues kanë hedhur lidhur me burimin e së kryerës së shqipes. Njëri prej tyre është Çabej<sup>214</sup>, i cili sheh një ndikim të perfektit *factum habeo* të latinishtes ballkanike. Ndërsa Demiraj ka pohuar tezën e prejardhjes së ndërtimit të së kryerës brenda shqipes, më saktë nga gramatikalizimi i togjeve të lira, *kam + pjesore*, duke pohuar se folja *kam* e ka humbur plotësisht kuptimin e saj leksikor duke u shndërruar në folje ndihmëse<sup>215</sup>.

Megjithatë, në tekstin shqip të Kuvendit kemi gjetur një rast të së kryerës ku pjesorja e foljes kryesore qëndron para foljes *kam* dhe në tekstin latin korrespondon me perfektin sintetik. Te Buzuku ky ndërtim është më i shpeshtë. Në fakt te ky rend i përmbysur i së kryerës studiuesit pohojnë se ka lindur dhe trajta e habitores, mënyrë e re e formuar brenda shqipes<sup>216</sup>, psh: *marrë + kam = marrkam*

*Communis quippe mos invaluit, ut Infantes inter domesticos parietes aquae ablutione (f. 31)*

*marre kane ketà gni eacon me pagheuem famijat mbe sctepi te vete (f. 21)*

Duke parë këtë vendosje me të drejtë lind pyetja. A është kjo një veçori reliktoze e shqipes së hershme, ku pjesorja qëndronte para foljes ndihmëse, duke lëkundur kështu tezën e Demirajt mbi prejardhjen e së kryerës së shqipes, apo kemi të bëjmë me një ndonjë gabim a preferencë në përdorim, nga autori ynë?

Për sa i takon formave të atëhershme të së kryerës së thjeshtë të shqipes mund të themi se ato nuk dallojnë nga format e shqipes së sotme. I vetmi ndryshim nga shqipja letrare është në vetën e parë të numrit shumës, trajtat e së cilës janë të ngjashme me ato të së folmes së Lezhës e Shkodrës, si *u lodhme, u plasme* etj. Këto forma e të tjera që do të shihen në një kapitull të veçantë na çojnë në

---

<sup>214</sup> Kontributi i shqipes në formimin e lidhjes gjuhësore ballkanike, Studime filologjike, 1974, f. 41

<sup>215</sup> Vepër e cituar f. 800

<sup>216</sup> Demiraj, *Gramatikë...* vep.cit. f. 911 e tutje.

përfundimin se baza dialektore e gjuhës së autorit të përkthimit të tekstit latin vendoset në kuadrin e gegërishtes veriperëndimore.

*et aliis sequentibus capitulis de animarum curatoeibus praescriptimus*

(f. 80)

*chi kemi urçenuem per siperi nde capitiu cu flasme per essapi, chi kane Ciobant e Scpirtinavet* (f. 79)

Në tekstin shqip gjejmë gjithashtu trajtën asigmatike *pae* për *pashë*. Trajatat *si pae, dhae* janë të pranishme dhe në tekstin e Buzukut.

*Vidi senes ululantes* (f. 4)

*Pae plecchiete tue uleruem* (f. 1)

*Iussis parui, circuivi terram, preambulavi universam, vidi contritiones eius*

(f. 4)

*Ndighiova urçenit : Suola çene ; Kercova Ruεulimin: pae plagat e tii* (f. 1)

### III.3.4.2 *Modus coniunctivus / Mënyra lidhore.*

*Coniunctivus* është mënyra e cila është zhvilluar kryesisht në fjalitë e nënrenditura. Njihet ndryshe dhe si mënyra e nënrenditjes duke marrë kështu emrin *modus subiunctivus*, emërtim i cili më vonë u ndryshua nga gramatikanët latinë me emrin *coniunctivus*<sup>217</sup>.

Shumë studiues, lidhur me kuptimet dhe përdorimin e lidhores në shumë gjuhë, kanë shprehur mendimin se lidhorja shpreh disa kuptime ndër të cilat si kuptim themelor të lidhores, nga i cili janë zhvilluar kuptimet e tjera të saj, ka qenë kuptimi *voluntatis*, ai volitiv, pra kuptimi i të shprehurit të vullnetit të folësit. Një tjetër kuptim i lidhores është kuptimi prospektiv, d.m.th kuptimi i së ardhmes. Mënyra lidhore, thënë në mënyrë të përmbledhur, është mënyra që shpreh modalitetin e mundësisë, rrjedhimisht foljet në këtë mënyrë shprehin një veprim si të mundshëm, të detyruar, të dëshiruar apo të hamendësuar<sup>218</sup>.

Si rrjedhim, mund të themi se çështja e kuptimit themelor të lidhores dhe burimit të saj në indoevropianishte mbetet e paqartë. Dhe kjo ka ndodhur si

---

<sup>217</sup> Termi latin *coniunctivus* do të thotë “bashkëlidhës”, ndërsa *subiunctivus* “nënëlidhës” a “nënërenditës”

<sup>218</sup> Një përmbledhje të mendimeve të studiuesve mbi kuptimet e lidhores ka bërë Demiraj, *Gramatika historike*, vep. cit. f. 866

shkak i evolucionit historik gjatë të cilit është nënshtruar kjo mënyrë si nga ana e funksioneve sintaksore dhe e kuptimeve modale, ashtu dhe nga ana formale.

Për sa i takon gjuhës latine mund të themi se në këtë gjuhë mënyra lidhore mbetet mënyra më e përdorur dhe më funksionalja, pasi kjo mënyrë ngërthen në vetvete disa kuptime modale.

Siç është pranuar nga gramatikanët, latinishtja e ka humbur mënyrën dëshirore, ndryshe me emrin *modus optativus* të gjuhës indoevropiane, mënyrë e cila është e pranishme në gjuhën greke të vjetër<sup>219</sup> dhe në atë shqipe<sup>220</sup>.

Siç u përmend më lart në gjuhën latine dhe atë shqipe lidhorja përdoret kryesisht në fjali të nënrenditura me anë të lidhëzave, por edhe pa këto. Të dyja këto gjuhë karakterizohen nga kjo prirje, e cila kushtëzohet nga disa faktorë. Për shembull, në gjuhën shqipe lidhorja e ka gjallëruar përdorimin e saj, pas mënjanimit të vazhdueshëm të formës së pashtjelluar të paskajores, dukuri që ka ndodhur kryesisht në disa gjuhë ballkanike, pohon Demiraj<sup>221</sup>. Si rezultat lidhoren e gjejmë dhe pas foljeve gjysmëndihmëse me vlerë modale, për përdorimin dhe formimin e të cilave do të flitet veçmas, por dhe në fjali të nënrenditura kur kryefjala është po ajo e fjalisë kryesore.

Ndryshe ndodh me latinishten, një gjuhë krejt e ndryshme për sa i takon strukturave gramatikore. Në latinishte, por jo vetëm, por dhe në gjuhët neolatine foljet gjysmëndihmëse me vlerë modale nuk ndiqen nga folja në lidhore, por nga forma e pashtjelluar e infinitivit, pra paskajores.

Në tekstin shqip nuk kemi gjetur përdorime të shpeshta të lidhores pas foljeve më të rëndësishme modale si *mund* e *duhet*, pasi kemi të bëjmë me tekst të shkruar në dialektin gegë, dialekt të cili paskajorja gjen dhe sot e kësaj dite përdorim të gjërë. Megjithatë, në tekstin shqip të Kuvendit kemi hasur përdorimin e lidhores në gjuhën shqipe pas foljeve gjysmëndihmëse modale. Në fakt i kemi konsideruar si forma të lidhores edhe pse nga ana formale mund të duken si forma të dëftores, pasi në shumicën e rasteve mungon pjesëza *të*, pjesë e pandashme e foljes në lidhore.

Të vërehen shembujt e mëposhtëm të cilët mendojmë se kemi të bëjmë me ndërtimin e ri të shqipes, atë të foljeve modale të ndjekura nga lidhorja, gjë që nuk vërehet në gjuhët neolatine në të cilat foljet gjysmëndihmëse modale ndiqen nga paskajoret e foljeve.

*Possunt tamen, immo et debent ea, quae pacis sun, procurare iurgia, rixas, contentiones more patrio componere....., et idoneitatis penuria, agere et contractare* (f. 72)

---

<sup>219</sup> Forma të kohës së tashme të dëshirores së greqishtes janë *λόοιμι, λóοις, λóοι...*

<sup>220</sup> Forma të dëshirores janë *punofsha, punofsh, punoftë...*

<sup>221</sup> Vep. cit. f. 868

*Pò mundene, endè i perket, me luftuem per atò cafschia chi jane per pacchie ; e ciarta, davi8jat, sciamatat.....e te tiera fialla te buta, tue luftuem à mund mpaccognene me te mire det8rene e haraccit (f. 70)*

*Hanc veram Catholicam Fidem, extra quam nemo salvus esse potest (f. 17)*

*Kete Fee Kattolike, paa te sillene as cusc mund te scelbohet (f. 4)*

Si në gjuhën shqipe ashtu dhe në latinishte mënyra lidhore ka katër kohë: *të tashmen*, *të pakryerën*, *të kryerën* dhe *më se të kryerën*. Në të dyja këto gjuhë lidhorja ndryshon si për sa i takon formimit ashtu dhe përdorimit apo më saktë funksionit të lidhore në fjali.

Kështu, në gjuhën shqipe dhe në rastet e mësipërme të vjela nga teksti i Kuvendit të Arbënit i vitit 1706 vërejmë formimin analitik të lidhore të kompletuar me pjesëzë e pandryshueshme *të + folje* në të gjitha kohët kundrejt ndërtimit sintetik të latinishtes. Të krahasohen *të jap*, *të japësh*, *të japë* të shqipes kundrejt *dem*, *des*, *det* apo *të kem dhënë*, *të kesh dhënë* kundrejt *dederim*, *dederis* etj...

Më sipër thamë se përdorimi i lidhore si në gjuhën shqipe ashtu dhe në atë latine vërehet më shumë në fjalitë e nërenditura të cilat janë të llojeve të ndryshme. Kështu në tekstin latin foljet të përdorura në këtë mënyrë janë të shumta, pasi vetë teksti ynë duke qenë i natyrës taksative - normative e komunikuese nuk mund të ishte i varfër në përdorimin e kësaj mënyre, pasi siç do të vërehet në vijim, koniuktivi latin me modalitetet e tij e kryen më së miri funksionin e përcjelljes së mesazhit nga autori. Të vërehet toni urdhërues e sugjerues i autorit në shembujt e mëposhtëm. Si në tekstin latin dhe në atë shqip foljet i gjejmë po në mënyrën lidhore.

*confessariorum munus sit, parentes hortari, ne deside, et socordes ad praefacta exercitia filios mittere negligant..... (f. 23)*

*te keete prifti i Famullise per esap me ndisckuem te priindet e t8ne mos te prittognene me i derguem me eaane urattet... (f. 11)*

*meminerint Alumni, instituti sui celsitudinem, nullius Parrochiae finibus circumscripam (f. 78)*

*te mbane mend Alumnete, se essapi i chielscimi i tyne nuk matet me cunfigne te Parocchievet (f. 76)*

*Cum autem aequum sit, ut sancta a sanctis tractentur (f. 29)*

*Yue kiene me lig, Kinese cafschia të scenta, prej Scentesc te jene precune (f. 19)*



*Avaritiam, pecuniaeque cupiditatem, quasi omnium criminum radicem, evitent* (f. 72)

*Te ruhen prej lakmie se paa ngihgnune si prej murtajet, tue kiene ranza e giçç fajevet* (f. 70)

*Nemo Parrochos, vel Clericos ad Turcica tribunalia citare audeat* (f. 73)

*A scusc te guzogn me paditune, o me ççirre mbe Giacogne, mbe Parochit, ndò mbe tieteri Kiscetaari perpara Giychit e Turcut* (f. 70)

Në gjuhën latine si dhe në tekstin e Kuvendit mënyrën lidhore e gjejmë të përdorur si në fjali kryesore, ashtu dhe në fjali të nënrenditura të llojeve të ndryshme. Më poshtë do të shihet përdorimi i lidhores në fjali kryesore me në të së cilave mund të shprehet vullnet, dëshirë, dyshim, mundësi të kryerjes së një veprimi.

## Shprehja e vullnetit

### 1. Lidhorja nxitëse

Lidhorja në këtë rast përdoret për të shprehur thirrje, urdhër apo dhe ndalim të kryerjes së një veprimi. Pikërisht mënyra e duhur e zgjedhur nga autori në pjesën më të madhe të tekstit, pasi i gjithë teksti është urdhër, dhe denduria e kësaj lidhoreje është e madhe. Koha e përdorur është ajo e tashmja. Dhe në tekstin shqip kjo lidhore është dhënë po me folje në lidhore. Në këto raste kur shpreh urdhër kjo lidhore përdoret duke zëvendësuar dhe mënyrën urdhërore.

*Clament ergo et non cessent Pastores, et quasi tuba exaltent vocem suam, anunciando populo....* (f. 24)

*Te predicognene pràa me eaa te maçe Ciobante e mos te puscio gnene, pò si burri te keene eaanin, tu kalæuem Populit...* (f. 13)

*Illam pariter eliminandam curent pastores Deo iniuriosam consuetudinem* (f. 47)

*Të luftognene Bariit e Scpirtinavet me larguesm, e me hiecune eaconin e çuunuescimi* (f. 40)

*Discant omnes, praesertim Parochi, hanc Catholicae Fidei regulam* (f. 19)

*Te sctiene nde mend giççe, e maa fort Atenit e scpirtinavet, o Parocchianite kete lighie te feese Cattolike* (f. 6)

Kur kemi një fjali mohore folja në lidhore paraprihet nga pjesëza mohore *ne*, gjë që vërehet në shembujt e mëposhtëm.

Në tekstin shqip na është dhënë me pjesëzën mohuese *mos* të ndjekur nga folja në lidhore.

*Ne autem pueri... hoc pretiosissimo divinitatis thesauro **priventur*** (f. 40)  
*E mos te **jessene** Dielte paa u cunquem e paa u refyem per scium mot*  
(f. 32)

*Caveant, **ne** alieni sibi **adscribantur** excessus* (f. 52)  
*Te ruhen fort **mos t' a nchiessene** veti fajiet e tierevet* (f. 47)

*Et **ne** in posterum sacrilega reiteratione, maxime adultis, hoc Sacramentum **administretur*** (f. 31)  
*E kinese mbasndaj **mos te pagheognene** te d itene here, e maa mposs te meçegnete me mcat te Sacrilegit* (f. 22)

Në disa raste kur pjesëza mohuese nuk është e pranishme atëherë mohimi arrihet me anë të përemrave të pacaktuar të cilët mbartin në vetvete mohimin dhe folja është pohore. E njëjta dukuri vërehet dhe në tekstin shqip.

***Nemo ponat** falcem in messem alienam, nec in viuatis Pastoribus Ecclesiis*  
(f. 53)  
*A **scusc te scijere** drapenin nd'are te huoje, as te guzogn me venduem ndogn*  
*Parocchian nde kisce te huoje* (f. 47)

## 2. Urdhërorja mohore

Për të shprehur ndalim të kryerejes së një veprimi në vetën e II (urdhërorja mohore) në frazat përgjegjëse të shqipes «*mos thuaj!*», «*mos bëj!*», latinishtja shfrytëzonte ndërtime të ndryshme mes të cilëve mjaft e njohur është ai i gjuhës letrare e gjetur dendur në shkrimet e Ciceronit dhe Çezarit, e formuar nga lidhëza *ne* e ndjekur nga folje në përfekt të mënyrës lidhore<sup>222</sup>; psh ***ne dixeris, mos thuaj !, ne feceris, mos bëj !***

Në tekstin shqip ky ndërtim, dhe pse nuk është shumë i përdorur, vjen si në shqipen e sotme me urdhërore mohore të ndërtuar nga pjesëza mohore *mos* + folje në

---

<sup>222</sup> Perfekti i lidhores i përdorur me vlerën e urdhërores mohore ka vlerë të aoristit, d.m.th shpreh veprim pa ndonjë përcaktim të kohës, duke ndjekur ndoshta konstruktin e greqishtes së vjetër, që shpreh urdhëroren mohore me lidhore në aorist μή φυτόσης

urdhërore të kohës së tashme madje dhe në lidhore gjithnjë në kohën e tashme dhe jo si në latinishte.

*ne dederis somnum oculis tuis, nec dormitent palpebrae tuae.* (f. 54)

*Mos ep gium s ve tuve, as mos te ncoten vetula te tua* (f. 49)

## Shprehja e dyshimit

### 1. Lidhorja *dubitative* ose *deliberative*

Mënyra lidhore përdoret dhe për të shprehur në formë pyetëse, një dyshim të vërtetë ose të pavërtetë lidhur me një veprim që duhet marrë në të tashmen ose në të ardhmen. Kjo lloj lidhoreje në gjuhën latine ndërtohet me folje në të tashmen për të shprehur një dyshim në të atshmen ose në të ardhmen dh eme folje në të pakryerën për një dyshim në të shkuarën. Lidhorja dyshuese mohore ndërtohet me anë të pjesëzës *non*. Në gjuhën shqipe mund të jepet me dëftore në të tashmen ose në të ardhmen. Mund dhe të shoqërohet dhe me foljet gjysmëndihmëse *mund* dhe *duhet*.

Në pjesën e tretë të tekstit, e cila jep informacion mbi marrëdhëniet dhe problemet ndërmjet dioqezave katolike, si dhe për çështje të tjera të rëndësishme, kemi hasur shumë lidhore dubitative dhe të gjitha janë dhënë me folje në dëftore në kohën e tashme.

*Quo titulo, cuiusve invocatione decoretur ?* (f. 56)

*Me cisc emene te Scendit emenohet ?* (f. 53)

*An bona Ecclesiae dilapident* (f. 58)

*A priscne, e sossene giaan e Kiscese ?* (f. 52)

*An sacra supellectilia diligentissime, et omni cultu, ac nitore conservent* (f. 50)

*A mbane me ndere, e te delira robet, e petikat e Kiscese ?* (f. 51)

*An pie, et sancte vivere studeant* (f. 58)

*A luftognene me jetuem Scendenisct, e devotscim* (f. 52)

*Nemo autem ad Subdiaconatus Ordinem recipiatur, qui breviarum romanum non teneat* (f. 44)

*Mb ' urçeni te Subdiaconatit a scusc te Sciacrohet, nde mos past Brevialin si urçenon kiscia e Romese* (f. 36)

*An pueros Fidei rudimentis informant* (f. 57)

*A mpsognene teriivet Doctrinene ?* (f. 52)

## Shprehja e dëshirës

### 1. Lidhësja e dëshirës.

Ngjashmëria kuptimore midis dëshirores e lidhësjes dhe përzjerja e hershme e këtyre dy mënyrave në shumicën e gjuhëve indoevropiane ka bërë që lidhësja të përdoret edhe me vlerën e dëshirores dhe përdorimet e saj të mbulojnë nga mënyra lidhësje. Gjurmë të dëshirores antike e karakterizuar nga morfema *-ie / i*<sup>223</sup> vërehen te format e disa foljeve me fleksion atematik, si për shembull te lidhësjet përkatëse *sim, edim, velim, malim, nolim* të foljeve *sum, edo, volo, malo, nolo*.

Prirja e përgjithshme përdorimit të lidhësjes edhe me vlerën e dëshirores në gjuhët indoevropiane ka vepruar dhe në gjuhën shqipe, megjithëse shqipja ka pasur dhe ruajtur forma të veçanta të dëshirores<sup>224</sup>. Mënyra lidhësje me kuptim volitiv përdoret dendur dhe në shqipen e hershme, në veprat e autorëve të Veriut, por jo vetëm. E gjejmë në të tëra të folmet e shqipes. Me anë të saj shprehet vullneti i folësit në formë urimi a mallkimi.

Në tekstin tonë si në versionin latin ashtu dhe në atë shqip, përdorimin e lidhësjes me vlerë të dëshirores nuk e gjejmë shpesh në fjali të pavaruar, pra kryesore, por kryesisht në fjali të nënrenditura.

Në fjalitë kryesore format e lidhësjes në tekstin latin janë përkthyer me forma të dëshirores të cilat shprehin kuptimin modal të dëshirueshmërisë (në formë mallkimi a urimi). Të vërehen shembujt e mëposhtëm në të cilat autori ka përdorur mënyrën lidhësje në tekstin latin për të shprehur mallkim apo urim, pa praninë e ndonjë pjesëze. Në tekstin shqip forma të lidhësjes optative janë dhënë me anë të dëshirores.

*Det te Deus in maledictionem, putrescere faciat femur tuum, et tumens uterus tuus **disrumpatur**. **Ingredientur** aquae maledictae in ventrum tuum, et utero tumuscente **putrescat** femur.* (f. 49)

---

<sup>223</sup> Demiraj në *Gramatikë historike*, vep. cit. f. 887, pohon tezat e pranuar nga studiues të tjerë se forma të dëshirores dalloheshin morfologjikisht nga mënyrat e tjera nëpërmjet prapashiteses – (*i*) *ie*: - *i* -, si psh: *s-(i)iet* – qoftë, *s-(i)-i-ent* – qofshin etj... Karakteristika morfologjike të dëshirores antike vërehen në tekstet e autorëve të periudhës arkaike si Plauti dhe Terenci, te të cilët gjejmë *siem, sies, siet*, të cilat nuk janë tjetër veç se format e hershme të lidhësjes së re *sim, sis, sit*. Për më shumë mbi prejardhjen e formave të lidhësjes në gjuhën latine shih Antonio Traglia, *La flessione verbale latina*, Trattato di morfologia storica, Torino, 1950, f. 25 e tutje.

<sup>224</sup> Për më shumë mbi dëshiroren dhe përdorimet e saj në plan historik të shihet Demiraj, *Gramatikë*, vep. cit. f.895- 902

*Scitit Hyj nde dore te malekimit, te baft me t'u kalbune cofsciat, e t'u plast barku, t'hifscin uinat te malekuem nde bark, t'u crumbscin cofsciat* (f. 43)

Në shembullin e mëposhtëm vërejmë se lidhorja nxitëse e latinishtes na është dhënë me formë të dëshirores mohore në fjalë të pavarura.

*ne Parochorum incuria, vel defectu, virtus, et efficacia Sacramento deficiat* (f. 30)

*mos u mengoft Sciementit vertyteja, e viimi per fail, e prittesse te parrochianevet* (f. 20)

*Ego idem N. Spondeo, voveo ac iuro. Sic me Deus adiuvet, et aec Sancta Dei Evangelia* (f. 18)

*Une vet N. permettozn, e bagn bee : asctù me ndimoft, e ketà ungiul te Scend te Tineeot* (f. 5)

Siç u tha më lart, autori në tekstin latin, për të shprehur një dëshirë shfrytëzon përdorimin e foljeve në lidhore. Por nga ana tjetër, latinishtja nuk mjaftohet vetëm me përdorimin e foljes në lidhore. Kështu për të shprehur një dëshirë të konsideruar si të realizueshëm në të tashme ose në të ardhmen, latinishtja shfrytëzon një pjesëz tipike e pranishme në lidhoren optative. Bëhet fjalë për pjesëzën *utinam* e ndjekur nga folje në kohë të ndryshme të lidhores. Pjesëza *utinam* vjen në gjuhën shqipe me anët të shprehjeve të cilat shprehin ndjenjën e madhe e të theksuar të dëshirës. *Ah sikur ! Dashtë Zoti !*

*Utinam hanc (domum) veris amicis impleam!* (Socrates)

*Ah sikur ta mbush këtë (shtëpinë) me miq të vërtetë!*

*Utinam Clodius viveret ?* (Cicero)

*Ah sikur Klodi të ishte akoma në jetë.*

Më lart u nënvizua se lidhorja optative ose ajo e dëshirës në gjuhën latine përdoret në fjali kryesore. Në gjuhën shqipe, nga ana tjetër format foljore të dëshirores përdoren gjithshu në fjali kryesore. Por, po këto forma kur shprehin kuptimin modal të mundshmërisë përdoren në fjali të nënrenditura kushtore dhe lejore. Në këtë rast kuptimi modal i mundshmërisë del jo vetëm nga konteksti dhe nga kuptimi i fjalisë, por dhe nga prania e lidhëzës nënrenditëse *ndë* që korrespondon me *në* - në e shqipes së sotme në fjalitë e nënrendituara kushtore dhe lidhëzës *edhe*

në në fjalitë e nënrenditura lejore<sup>225</sup>. Me këtë lloj fjalish të nënrenditura të shqipes janë dhënë fjalitë e nënrenditura hipotetike<sup>226</sup> me vlerë modale të mundësisë të tekstit latin të paraprira nga lidhëza *si* e cila kërkon foljen në lidhore. Kjo folje mund të jetë në kohën e tashme ose të kryerën. Të shihen shembujt e mëposhtëm në të cilët vërehen foljet në perfekt të lidhores në në tekstin latin dhe përgjegjëset e tyre në dëshirore me vlerë modale të mundshmërisë në tekstin shqip:

*quod si speculator viderit gladium venientem et non intonuerit buccina , et populus se non custodierit* (f. 24)

*nde paat Capetaani scpaten, chi po vien , e mos te biu Boriis, e Populi mos u rueiiti vete veteheh.* (f. 13)

*Quod si Parrochus in oculorum caecitatem, vel in senilem aetatem inciderit* (f. 76)

*Nde i raft Prokut gni te paa prittune (largofta Eotyni), nde u verboft, jnde u mplakt* (f. 74)

*si externis Fidei characteribus fuerint signata.* (f. 21)

*nde chiofscin scegnuem perjascta me scegna te feese* (f. 9)

*Quod si quis ex Parochis ipsis eodem animi languore laboraret, arbitrio Ordinarii puniatur* (f. 23)

*Nd'u giet cusc Prifinisc se famuliise i mpiit, ndo prittues, ta castigogn Upescupi si ka me iu ducune* (f. 11)

*Si quis enim domui suae praeesse nescit, quomodo Ecclesiae Dei diligentiam habebit ?* (f. 53)

*Pro nde mos di cusc me sunduem sctepiin e vete, si praa kaa me diitune me mbaitune kiscene e Hyit* (f. 47)

### III. 4 Foljet ndihmëse dhe gjysmëndihmëse në gjuhën latine dhe atë shqipe.

Shumica e foljeve që emërtojnë veprime përdoren në fjali me kuptim leksikor të plotë dhe të mëvetësishëm. Por ka dhe disa folje të cilat herë dalin me kuptim të

---

<sup>225</sup> Bëhet fjalë për fjalë të tilla të paraprira nga *edhe në si psh: edhe në punoftë, në mungoftë etj.*

<sup>226</sup> Në gjuhën latine dallohen tre tipe të periudhës hipotetike në varësi të paraqitjes së hipotezës nga ana e folësit. Tipi I ose i objektivitetit. Tipi II ai i mundësisë. Tipi III ai i pamundësisë. Për më shumë të shihet Nicola Flochini, *Comprendere e tradurre, Milano, 1999, f. 564.* e tutje.

plotë e herë konsiderohen si mjete gramatikore duke u shndërruar në folje ndihmëse. Në shumë gjuhë qofshin neolatine ose jo, folje ndihmëse konsiderohen ato folje që ndihmojnë për ndërtimin e formave analitike të foljes. Kështu konsiderohen si folje ndihmëse foljet *kam* dhe *jam* kur shërbejnë për formimin e kohëve të cilat në përbërje kanë pjesoren e foljes kryesore<sup>227</sup>.

Në gjuhën latine si folje ndihmëse (*verbum servile*) konsiderohet vetëm folja *jam* kur ndiqet nga pjesorja, e cila merr pjesë kështu në formimin e së kryerës, më se të kryerës dhe të së ardhmes së përparme në diatezën pësore dhe mesore.

Të kujtohen format foljore të këtyre kohëve në mënyrën dëftore. *laudatus, a, um sum, auditus, a, um eram, laudatus, a, um ero* etj dhe në mënyrën lidhore *scriptus, a, um sim, auditus, a, um essem*.

Për sa i takon foljes *habere* – *kam*, duhet të themi se në gjuhën latine kjo folje është një folje me kuptim të plotë leksikor dhe nuk gjen përdorim si folje ndihmëse, në të kryerën, më se të kryerës dhe të ardhmen e përparme në diatezën veprorë, të paktën në latinishten klasike.

Të kujtohet ndërtimi i njohur sintetik i këtyre kohëve në formën veprorë, *scripsi, dixeram, dixero, monuero, delevissim*

Dhe në gjuhën shqipe sipas funksioneve që kryejnë, për të formuar trajta kohore në bashkëvjajtje me folje të tjera, foljet ndahen në folje ndihmëse dhe gjysmëndihmëse. Në shqipe ndihmëse janë foljet *kam* dhe *jam*.

Për sa i takon foljeve gjysmëndihmëse një interes të veçantë përbëjnë foljet me vlerë modale *mund*, e cila në shqipen e sotme standarde ndiqet nga folje në lidhore;

*duhet* e ndjekur nga pjesorja e foljes ose folje në lidhore;

*do* + pjesore e foljes kryesore;

*kam* dhe *jam* të ndjekura nga forma e pashtjelluar e tpit *për të larë*<sup>228</sup>.

Këto folje e humbasin mëvetësinë e tyre si folje me kuptim të plotë leksikor dhe siç u tha më lart që të realizojnë kuptimin e tyre ndiqen nga folje tjetër që luan dhe rolin kryesor.

Në gjuhën latine përgjegjëset e foljeve gjysmëndihmëse të shqipes *mund* dhe *duhet* përkatësisisht *posse* dhe *debere*, nuk kanë formë të ngurosur si në

---

<sup>227</sup> Të krahasohen ndërtimet e sipërpërmendura në gjuhët neolatine, si psh në italishte *ho scritto, avevo scritto, avro scritto* etc. Në gjuhën frënge *j'ai écrit, j'avais chanté*. Këto ndërtime njihen dhe në gjuhë si anglishtja, gjermanishtja etj. *I have enjoyed, I had enjoyed, Ich habe gefreut*. Për gjuhët neolatine të paktën është pranuar se ky ndërtim lidhet drejtpërdrejt me modelin e latinishtes së vonë *habeo scriptum*. Lidhur me burimin e këtyre formave në gjuhën shqipe është folur në kapitullin mbi të kryerën e shqipes, për të cilin shumë studiues kanë pranuar dhe në shqipe ndikimin e gjuhës romane ballkanike.

<sup>228</sup> Për më shumë mbi këto folje shih *Gramatika egjuhës shqipe*, vep. cit. f. 260

shqipe<sup>229</sup>. Ato janë folje të cilat nuk qëndrojnë asnjëherë më vete dhe njihen si *verba servilia / folje ndihmëse* dhe kuptimi i tyre plotësohet vetëm kur ndiqen nga paskajorja e foljes kryesore, gjë që do të shihet dhe në shembujt në vijim. Në qoftë se në latinishtë, këto folje i gjejmë gjithmonë të ndjekura nga paskajorja, në shqipen e sotme, si u përmend më lart, këto folje përdoren të ndjekura nga një folje me kuptim të plotë në mënyrën lidhore. Në tekstin tonë këto folje ndihmëse në shumicën e rasteve nuk ndiqen nga folja në lidhore, pasi teksti i Kuvendit të Arbënit, siç është pranuar nga studiuesit, është shkruar në dialektin gegë, më saktë në të gjejmë të pasqyruar të folmen e gegërishtes veriperëndimore<sup>230</sup>. Duke qenë kështu pothuaj në të gjithë shembujt e gjetur, pas foljeve ndihmëse, ashtu si dhe në tekstin latin gjejmë paskajoren e tipit *me ba*, e cila përdoret me të gjitha funksionet karakteristike të paskajores së indoevropianishtes, rrjedhimisht dhe të latinishtes. Foljet ndihmëse në gjuhën latine luajnë rol të rëndësishëm në fjali, prandaj dhe përdorimi i tyre është i shpeshtë. Në tekstin tonë, duke qenë i natyrës normative mund të sillnim mjaft raste. Por ne po kufizohemi me disa prej tyre.

*nec ullo modo fingi possit* (f. 34)

*duhet meu scitune, ndo me rrejtune* (f. 25)

*An Infans datus a Turcis, ut baptizetur.....possit fecte baptizari?* (f. 34)

*A mundet meu pagheuem Famuli i Turchiet vece per pune chi mos te chielbet ....*  
(f. 25)

*possunt tamen, et debeant ea, quae pacis sunt, procurare* (f. 72)

*po mundene, ende i perket, me luftuem per ato cafschia* (f. 69)

*In christi fidelibus nihil non sanctum, ac religiosum, veraeque Fidei protestativum tollerare debent* (f. 21)

*S'duhet me duruem nder te Feescimit te Cristit ndogni scegn, chi mos te jete secundrese asct feja jone* (f. 8)

*Sed aperta Fidei coonfessione, instante quoque vitae periculo, respondere debet* (f. 21)

*Po i duhet celscim me refyem Feene e vete, ende se te jete per te i vot cryet..*  
(f. 9)

---

<sup>229</sup> Megjithëse dhe në shqipe folja mund kur përdoret me vlerën e së kryerës së thjeshtë dhe kohëve të përbëra të së shkuarës, zgjedhohet sipas vetës e sipas numrit, psh: *munda të vija, nuk kemi mundur të mbarojmë etj..*

<sup>230</sup> Mbi gjuhën e Kuvendit dhe veçoritë e saj do të flitet në një kapitull të veçantë.



Nga ana tjetër, në tekstin tonë ka dhe jo pak raste ku foljet gjysmëndihmëse ndiqen nga një folje, që sipas mendimit tonë, megjithëse nuk është shfaqur ende pjesëza *të*, është në mënyrën lidhore. Përdorimi i lidhores pas këtyre foljeve përbën një risi të rëndësishme në strukturën sintaksore të shqipes. Këtë ndërtim e hasim dhe në të folmet veriore, siç e dëshmon edhe vepra e Buzukut.

Sipas Mansakut<sup>231</sup>, « në rreth 43 ndërtime me foljen modale duhet, Buzuku ka përdorur 32 herë paskajoren, 11 herë lidhoren dhe vetëm një herë pjesoren.»<sup>232</sup>

Tek autorët e tjerë të Veriut pas foljeve modale *duhet* dhe *mund* vjen më shpesh paskajorja e tipit *me ba*, gjë që siç u përmend ndodh dhe në tekstin tonë, tekst i cili është ndikuar mjaft nga veprat e autorëve të Veriut, veçanërisht *Çeta e Profetëve* e Bogdanit. Megjithatë, dhe tek këta autorë hasim përdorime të lidhores gjë që mund të shihet në shembujt e mëposhtëm.

*possunt tamen, .....et idoneitatis penuria agere et contractare....* (f. 72)

*....e et tiera fialla te buta, tue luftuem a mund mpaccognene me te mire det8ren e haraccit ...*(f. 70)

*nemo salvus esse potest* (f. 17)

*as cusc mund te scelbohet* (f. 4)

*An cum sacerdotes coguntur a Turcis, ut baptizent eorum filios, non ut Christianos efficiant, sed pro corporali salute ....* (f. 34)

*A mund scitren Mescetarete (tue i ngremuem Turit) me pagheuem famijat e tyne, io chi te i bagnene* (f. 25)

*Sic enim abiectis operibus tenebrarum, induet arma lucis, ut possit resistere in die malo...* (f. 32)

*Asctu mbas se elarguene prej vetehi vepera terretat, te vviscene armete e se dereitese, kinese te mund chiendrognene nde ditte ....* (f. 22)

*Quia vero in mala tempora incidimus, Sanctissimam Eucharistiam digno honore, publica, et cauta veneratione in Parrochialibus Ecclesiis conservari non posse dolemus* (f. 40)

---

<sup>231</sup> Seit Mansaku, *Ndërtimet me foljet modale mund dhe duhet*, Studime filologjike, 1979 /3

<sup>232</sup> *E këqyrni mos trembni; Përse duhetë gjithë këto kafshë të jenë, por nuk anshtë hera.* “ Videte ne turbemini; oportet enim haec fieri, sed nondum est finis (Buzuku, 347)

*Pò persè jemi raam nde kohe te kechie, na çimbet, se e Scendenuescimeja Eucaristia **smund ruhet** nde Kiscia te Parochiavet.. (f. 32)*

Shembujt e mësipërm përforcojnë tezën se dialekti verior nuk njih vetëm përdorimin e këtyre foljeve me paskajore dhe se përdorimi relativisht i dendur i lidhës pas këtyre foljeve saj në tekstet e vjetra tregojnë se kemi të bëjmë me një dukuri të hershme. Ngulitja e këtij përdorimi në shqipen e shekullit XVIII duket dhe në faktin se, megjithëse teksti njih një ndikim të madh të tekstit latin, përsëri arrijmë të shohim një strukturë të kristalizuar sintaksore të shqipes.

Në gjuhën latine folje ndihmëse konsiderohen dhe disa folje të parregullta, të cilave nuk përdoren në të gjitha vetat ose në të gjitha kohët. Bëhet fjalë për foljet si *queo - mund, nequeo - nuk mund, soleo - kam zakon*, të cilat gjejnë përdorim të madh dhe në tekstin tonë. Këto folje ndiqen nga paskajorja për të treguar një veprim si të mundshëm ose jo, në varësi të rrethanave. Të shihen shembujt e mëposhtëm. Si në tekstin latin dhe në atë shqip i shohim të ndjekura nga paskajorja.

*Quoniam vero in messi multa, Operarii pauci **nequeunt** in omni spirituali exultatione, et abundantia **metere** (f. 25)*

*E persè nd'are te maçe Corresit pak **smund cuotene**<sup>233</sup> me giçç gazimend te scpirtit, e me berechiet (f. 14)*

*quo minus sciscitandi iudici publica auctoritate suffulto **tacere**, aut ambigue tergiversari **queat** (f. 21)*

*Posi te pyes Nierii Sundetaa, sicuur Pascia, Kadiia, o tieteri, ci kaa pusctene, **s'mundet me hesctune, as me nderruem fiallete** (f. 9)*

*sacrilega postmodum reiteratione, ex ignorantia, ut **fieri solet**, violetur Sacramentum (f. 35)*

*mos te Kreemohen per se dyiti per harrimi, ndò per te paa diitun, si **here here banet**, aní biine mcat te Sciacrilegit, tue u Kreemuem perseriju (f. 26)*

Në gjuhën latine për të shprehur domosdoshmërinë e kryerjes së një veprimi përdoret një ndërtim i veçantë për të cilin do të flitet në kapitujt e tjerë. Bëhet fjalë për *coniugatio periphraistica passiva*, zgjedhimi perifrastik pësor i ndërtuar nga folja *esse + gerundivum* e foljes kryesore. Ky ndërtim në tekstin shqip është dhënë kryesisht me foljen modale *duhet + paskajore*, gjithnjë për të treguar domosdoshmërinë e kryerjes së veprimit.

---

<sup>233</sup> Corrin – Korrin

*ut sincero cordis obsequio, et devoto obedientiae candore ab omnibus sit colenda* (f. 34)

*paa lye, e paa ndogn faj, chi githeve i duhet mei beganissune me embre te barçe e me ndere te devoccimi.* (f. 24)

*ideo curandum est, ut homines in contrahendis Matrimoniis* (f. 45)

*prasctu duhet me sciucuem, kinese Njereee tue u martuem* (f. 38)

Zgjedhimi perifrastik pësor latin në tekstin shqip më shpesh është dhënë dhe me foljen *jam* të ndjekur nga forma e pashtjelluar e tipit *për të bërë*. Në gjuhën shqipe edhe foljet *jam* e *kam* mund të përdoren me vlerën modale të detyrimit<sup>234</sup>. Shembuj të tillë mund të gjenden shumë.

*ducunt in malis dies suos, nostra non cupiditate opprimendi, sed charitate sublevandi* (f. 52)

*e skognene gni jete te eese, nuk jane pra per t'u scirenguem, po per t'u ndimuem me te dasciunit* (f. 46)

*neque permittendum est, ut Turcae, vel Schismatici, Patrini fungantur munere, quod ad solos Fideles* (f. 36 -37)

*As jane per te laane Turit, ndo Schismatici me mbaitunecand; perse vece te kersctenevet, chi jane Cattolich i bie per lig* (f. 26)

*maiore cordis dolore deplorandum est* (f. 40)

*maa fort asct per tu chiaam me giak te embrese* (f. 32)

*Etenim cum nomen Domini invocandum sit in veritate, et in spiritu, ac omnimoda certitudine adorandum* (f. 28)

*Prasctu tue kiene Emenit e Tineeot per tu permendune me te vertete, e per tu açoruem me scpirt, e me te vertetunit* (f. 18)

### III.5 Nomina verbalia / Format e pashtjelluara të foljes dhe funksionet sintaksore të tyre.

Në gjuhën latine krahas formave të shtjelluara të foljes (*modi finiti*) për të cilat u fol gjatë më sipër, ekzistojnë dhe format e pashtjelluara (*modi infiniti*). Quhen kështu, pasi këto nuk kanë kategorinë gramatikore të vetës dhe të numrit.

---

<sup>234</sup> Për më shumë mbi këto folje të shihet *Gramatika e shqipes së sotme*, vep.cit. f. 262-164

Me fjalë të tjera nuk kanë mbaresa të caktuara për të treguar vetën dhe ndonjëherë dhe numrin. Për sa i takon ndërtimit mund të themi se format e pashtjelluara kanë ndërtim analitik ose sintetik . Në shumicën e rasteve këto forma kanë një formë të vetme dhe nga pikëpamja gramatikore, formale dhe funksionale, ngjajnë më shumë me një mbiemër. Me pak fjalë format e pashtjelluara në gjuhën latine marrin pak nga folja, sepse mund të shprehin raporte kohe, gjithashtu kanë dhe tipare emërore, pasi lakohen ; për këtë arsye njihen ndryshe edhe si emra foljorë (nomina verbalia)<sup>235</sup>. *Nomina verbalia* të latinishtes janë :

*Infinitum / paskajorja*. Paskajorja ka formë veprare dhe joveprare.

*Supinum / supini*. Emër foljor i ngurtësuar. Merr mbaresën **-um** për rasën kallëzore dhe mbaresën **-u** për rrjedhoren.

*Participium / pjesorja*. Pjesorja ka më shumë veçori emërore dhe ngjan më shumë me mbiemrin. Përdoret si në formën veprare ashtu dhe në atë joveprare.

*Gerundi / përcjellore*. Formë e ndryshueshme dhe nuk është gjë tjetër vec se lakimi i paskajores së tashmë të formës veprare.

*Gerundivi / gerundivi*. Mbiemër foljor i përdorur vetëm në formën joveprare.

Në gjuhën shqipe format e pashtjelluara, për nga tipi i ndërtimit, ndahen në dy grupe :

Në grupin e parë përfshihen pjesorja dhe ato që ndërtohen mbi bazën e saj : forma e pashtjelluar e tipit *pa bërë* dhe përcjellorja *buke bërë*. Në këtë grup bën pjesë dhe forma e pashtjelluar e të folmeve veriore e tipit *me ba*.

Në grupin e dytë përfshihen format e pashtjelluara të tipi *me të bërë* dhe *për të bërë*. Nga këto vetëm njëra, pjesorja, është sintetike, ndërsa të tjerat janë analitike.

Siç pohohet dhe në librin e gramatikës së shqipes<sup>236</sup> nga Demiraj<sup>237</sup> edhe nga pikëpamja gramatikore, format e pashtjelluara vijnë duke marrë tipare foljore dhe karakteristike për format e pashtjelluara, madje dhe në fushën e lidhjeve sintaksore. Këtu të dyja gjuhët largohen disi nga njëra tjetra, pasi siç u tha më lart format e pashtjelluara të latinishtes, ndryshe nga të shqipes kanë më shume karakteristika të sistemit emëror.

Gjuha shqipe, të gjitha format e pashtjelluara analitike i ka përfutur gjatë historisë së zhvillimit të saj. Të trashëguar nga indoevropianishtja ka vetëm formën sintetike të pjesores që për nga tipi i ndërtimit i përgjigjet pjesores së perfektit

---

<sup>235</sup> Për më shumë mbi këto forma shih *Syntaxe latine*, vep.cit. f.254 e tutje.

<sup>236</sup> Vep.cit. f. 298 – 301

<sup>237</sup> Gramatikë, vep.cit. f. 932 e tutje.

pësonor indoevropianishtes, rrjedhimisht dhe të latinishtes, gjë që do të shihet më poshtë.

### III. 5. 1 *Participium / Pjesorja.*

Në gjuhën latine pjesorja (*participium*)<sup>238</sup> është përkufizuar kështu nga gramatikanët antikë, sepse « *mer pjesë* » si nga veçoritë e emrit (nga trajta morfologjike është e ngjashme me një mbiemër, duke qenë se lakohet njësoj si emri dhe përputhet me të në numër, gjini dhe rasë), ashtu dhe nga veçoritë e foljes (shpreh raporte të kohës, ka kategorinë gramatikore të diatezës, mund të ndiqet nga një kundrinore i drejtë ose i zhdrejtë). Latinishtja në fakt nuk është aq e pasur në pjesore sa greqishtja e vjetër. Ndërsa greqishtja pasurohej me forma të ndryshme të participit, latinishtja vinte gjithnjë e më shumë duke rudhur përdorimin e participit dhe duke zhdukur nga shumë nga ajo që kishte trashëguar. Dhe gjuha shqipe ka ndjekur të njëjtën rrugë, madje ka shkuar dhe më tej. Shqipja njih vetëm pjesoren e shkuar me kuptim pësonor dhe është lehtësisht e krahasueshme me pjesoren e kryer pësonore të gjuhëve indoevropiane<sup>239</sup>. Në gjuhën shqipe pjesorja, si e vetmja formë e trashëguar nga indoevropianishtja, është formë e pashtjelluar që ka tipare kuptimore e gramatikore edhe foljore edhe mbiemërore. Ndryshe nga latinishtja, pjesorja e shqipes është një formë foljore e ngurosur, e cila nuk ka kategoritë gramatikore të mënyrës, të numrit e të vetës, as të diatezës e as të kohës<sup>240</sup>. Kjo pjesore në periudhën e dokumentuar të shqipes shfaqet me disa forma të ndërtuara nga këto prapashtesa:

- **r** (**ë**), si *punua-r* (**ë**), *bë-rë*
- **në**, si *qe-në*, *thë-në*
- **un**(**ë**) / **ur**(**ë**), si *hap-ur*, *mbyll-ur*.
- **ë** si *marr-ë*, *vjel-ë*
- **m** si *lee-m*, *ble-m*. Këtë prapashtesë pjesoreje e gjejmë kryesisht te Buzuku, Budi, por edhe në tekstin e Kuvendit të Arbënit dhe pse i botuar gati dy shekuj më vonë.
- **të** si *pi-të*, *vu-të*. Kjo pjesore është mjaft e vjetër dhe e gjejmë te Buzuku dhe në disa të folme në fshatra.

Në tekstin tonë pjesoret i kemi gjetur të veçuara dhe në përbërje të formave të pashtjelluara, të përhapura kryesisht në dialektin gegë të tipit *me punue*, *tue punue*,

---

<sup>238</sup> *Participium* i latinishtes është përkthim i *μετοχή* së greqishtes së vjetër.

<sup>239</sup> Për më shumë mbi origjinën e pjesores së shqipes shih Demiraj. *vep.cit.* f. 933 e tutje.

<sup>240</sup> *Gramatika e gjuhës shqipe*, Tiranë 1995, f. 331

*pa punue*. Krahas trajtës *me punue*<sup>241</sup> në tekstin tonë gjejmë dhe trajtën e re të tipit *për të punue*. Gjithashtu, pjesoren e gjejmë te përdorur në formimin e kohëve të përbëra dhe në formimin e mbiemrave prejpjesorë me anë të nyjave. Kur përdoret në funksion kallëzuesor, ajo afrohet në kuptim me mbiemrin prejpjesor, duke i zënë fare mirë vendin pjesoreve të veçuara<sup>242</sup>.

*cum autem aequum sit, ut sancta a sanctis tractentur* (f. 29)

*tue kiene me lig kinese cafschia të scenta, prej Scentesc te jene precune* (f. 19)

*Pastores non desinant miserrimae providere calamitati* (f. 37)

*mos të laane Bariite paa goditune kete nevoje* (f. 28)

*nec ullo modo fingi potest* (f. 34)

*as per ci do duhet meu sctirune, ndo me rreetune* (f. 25)

*divinae gratiae recepturi charismata*. (f. 46)

*te bahen gatii per te passune çuntiite e hiirit Hyinuescimi* (f. 39).

Pjesoret e foljeve me temë në bashkëtingëllore me trajtën prapashtesore *-un(ë) / ur(ë)* lidhen me pjesoren indoevropiane *-no*. Kjo prapashtesë siç pohon dhe Demiraj<sup>243</sup> ka qenë më prodhimtarja, pasi e gjejmë tek të gjitha foljet, si me temë në zanore<sup>244</sup> ashtu dhe me temë në bashkëtingëllore<sup>245</sup>. Pjesore të tilla gjejmë në tekstin tonë dhe të gjitha në trajtën *-unë* si tekst i shkruar në dialektin gegë.

*Deum verum, de deo vero; genitum non factum* (f. 16)

*Hyin e vertet prej Hyj se vertetit, Lindune io baam* (f. 2)

*as per ci do duhet meu sctirune, ndo me rreetune* (f. 25)

*nec ullo modo fingi potest* (f. 34)

*Si quis enim domui suae praeesse nescit, quomodo Ecclesiae Dei diligentiam habebit ?* (f. 53)

*Pro nde mos di cusc me sunduem sctepiin e vete, si praa kaa me diitune me mbaitune kiscene e Hyit* (f. 47)

---

<sup>241</sup> Për më shumë mbi paskajoren e tipit *me punue* do të flitet në vijim.

<sup>242</sup> *Gramatikë e gjuhës shqipe*, vep.cit. f.332.

<sup>243</sup> Po aty. f. 939

<sup>244</sup> Të kujtohen format *tue blenë, anshtë lanë, janë panë, pa pinë* te Buzuku (f. 63, 219,363,321):

Te Budi: *andëra e të pana te ditësë* (SC 33)

<sup>245</sup> Është fjala për pjesoret e tipit *hap-un(ë) / hap-ur(ë), bart-unë/ bart-urë, marrë, dalë*

Pjesorja me *-m(ë)* duket se lidhet me pjesoren tjetër indoevropiane më *-meno* të pjesores indoevropiane të perfektit me kuptim pësor. Kjo prapashtesë sipas studiuesve është zëvendësuar qysh herët nga prapashtesat *-no-*, përkatësisht *-to-*.<sup>246</sup> Ajo ndeshet jo vetëm në tekstet e vjetra si te Buzuku, Budi, Bardhi etj, por dhe në tekstin tonë të Kuvendit. Por sot, në dialektin e veriut kjo *m* ka rënë dhe del vetëm te mbiemrat prejpjesorë të tipit *i bam, i lexuem, i rrëfyem...* Bëhet fjalë për pjesore të tilla si *la-m: punue-m* ose *lee-m* siç do të shihet në shembujt e mëposhtëm vjelë nga teksti ynë.

*Credo in unum filium Dei unigenitum. Et ex Patre **natum** ante omnia saecula*  
(f.16)

*Bessogn mbe Biirin e vetem t'H it. E **leem** prej Atit perpara giçç Scecujet* (f. 2)

*Speciosa Christi germina a potestate tenebrarum **eruta**, et in vineam domini **translata***  
(f. 22)

*Te hijescimat biimate Criscitit **nzierre** prej pusctetejese terretit mcatit, **mbeltuem**<sup>247</sup>  
nde Vesct te Tinezot* (f. 10)

*titulo a Daniele **cohonestata**, supra montium vertice a Domino **collocata***  
(f.18)

*nderune prej Danielit, me te maçe emenite, **venduem** nde maje te mallit*  
(f. 5)

*Vidi senes **ululantes*** (f. 7)

*Pae plecchiete **tue ulleruem*** (f. 8)

*Abusus Sacramenti Baptismi, quem Turcae pro abluendo foetore purorum, et pro defendendis illis a brutis nequissime **introduxerunt*** (f. 34)

*Zaaconin e kecch, chi kane **vum** Turit me lypune, chi te paghezohen famijat e tyne io per tietr, vece meu i sckuem era e kecchie* (f. 24)

*Ideo in visitatione facienda is ordo servabitur* (f. 55)

*Prasctu nde vizitimi, chi duhet baam, ka me u **baam** ksctu* (f. 49)

*praecipuus visitationis scopus est, sanam, orthodoxamque doctrinam inducere, bonos mores tueri, pravos corrigere...* (f. 54)

---

<sup>246</sup> Në latinishtë *datus, a,um, lectus, a,um*, në anglishtë *done, worked*.

<sup>247</sup> Vuum. Shpjegim dhënë në tekst.

*passeyhyra e visitimit maa mpos asct : me forzuem dijene cattlike scendosc, meu mbaitune vesse te mire, me ndisckuem te kecchiite ..(f. 49)*

*Sunt Parochi aniamrum pastores, in partes vocati Episcopalis sollicitudinis, in crediti Dominici gregis custodia excubantes, laborantes, desudantes ..... (f. 69)*  
*Jane Parochit Bariit e Scpirtunavet vum mbe vend te piessese ruituni, e se mbaituni, chi bie Upesckupit me perghiuem nde stræe te grighiese (f. 66)*  
(f. 66)

Shqipja ka gjithashtu pjesoren me prapashtesën –të, që duket se lidhet me prapashtesën –to të indoevropianishtes. Këtë e gjejmë të reflektuar në pjesoren e perfektit pasiv të gjuhës latine (*lectus, lecta, lectum*)<sup>248</sup> për të cilën do të flitet në vazhdim. Sot kjo pjesore nuk gjen përdorim, madje as në tekstin shqip të Kuvendit, por vetëm në tekstin e Buzukut *kam batë, ka pitë, ka me u vutë*, dhe në disa të folme të izoluar.

Në gjuhën latine pjesorja zë një vend të rëndësishëm në morfologjinë dhe në sintaksën latine. Gjuha latine njeh këto pjesore:

1. **pjesorja e tashme** (*laudans, scribens*). Diateza e kësaj pjesore është ajo vepror.
2. **pjesorja e së kryerës** (*laudatus, scriptus*). Diateza e kësaj pjesoreje është ajo pësorë dhe veprorë për foljet deponente.
3. **pjesorja e së ardhmes** (*laudaturus, scripturus*). Diateza e kësaj pjesoreje është gjithmonë ajo veprorë dhe ka formë sintetike.

Më poshtë do të shihen se si kanë ardhur në shqipen e Kuvendit të Arbënit pjesoret e sipërpërmendura të latinishtes.

**1. Participium praesentis.** Gjuha shqipe nuk i ka ruajtur të gjithë tipat e pjesoreve të hershme indoevropiane. Një nga këto pjesore mendohet të jetë pjesorja më –nt e indoevropianishtes, e cila kishte kuptim vepror. Kjo pjesore është ruajtur në shumicën e gjuhëve indoevropiane, përfshirë këtu dhe gjuhën latine, *laudans, laudan-tis; sapiens, sapient-is*<sup>249</sup>. Pjesorja e së tashmes nuk shpreh raporte kohe, por shpreh një veprim të njëkohshëm, d.m.th që ndodh në të njëjtën kohë të foljes

---

<sup>248</sup> Për më shumë shih Nicola Flochini, *Compendere e tradurre*, Milano 1999, f. 113.

<sup>249</sup> Pjesorja e tashme formohet duke i shtuar temës me zanoren tematike, morfemën –nt; nominativi ka bashkëtingëlloren s pas rënies së bashkëtingëllores dhëmbore t: *lauda-nt-s > laudans* (gen. *laudant-is*).



së fjalisë ku ndodhet. Diateza e kësaj pjesoreje është ajo veprorë. Kjo pjesore lakohet rregullisht në të dy numrat si një mbiemër i lakimit të tretë<sup>250</sup>.

Për sa i takon çështjes së refleksit në gjuhën shqipe të pjesores së tashme janë dhënë mendime të ndryshme. Fjalë të tipit *lexues, mësues, hapës, këndës* pra që mbarojnë përkatësisht më *-ës* dhe *-és* disa studiues<sup>251</sup> i kanë konsideruar si pjesore të tashme<sup>252</sup>. Nga ana tjetër shumë studiues si Çabej, Pedersen, Jokli të tjerë e kanë kundërshtuar këtë tezë dhe me të drejtë, pasi në gjuhën shqipe siç pohon Demiraj<sup>253</sup> një *-s* me burim indoevriopian nuk mund të qëndronte në çfarëdo pozicioni fonetik. Përfundimisht është pranuar se shqipja e ka humbur pjesoren e hershme indoevropiane të tipit më *-nt*. Me funksionin e kësaj pjesoreje, shpesh në fjali, përdoret forma e pashtjelluar e tipit *duke bërë*.

Pjesorja e tashme latine në tekstin shqip të Kuvendit të Arbënit gjen përdorim të madh është e përdorur mjaft. në shumicën e rasteve, ashtu si dhe në shqipen e sotme është dhënë me formën e pashtjelluar analitike të tipit *duke bërë*, që njihet ndryshe si përcjellore. Në tekstin tonë, i shkruar në dialektin gëgë me të drejtë e gjejmë në trajtën e të folmeve veriore *tue bam*. Të vërehen shembujt e shumtë.

*cognoscens figmentum nostrum* (f. 36)

*tu gnoffune traitimin tane.* (f. 27)

*quod dolentes referimus* (f. 38)

*chi tue anecuem calεεognme* (f. 29)

*ut..omnem laborem, studium, et sollicitudinem in eo adhibeant, ut populus gemens, et quaerens panem, inveniatur cibum ad refocillandam animam* (f. 23)

*chi te vene roe mbe barre, ci kane, e giçç munde, e ciallastii ta keene mbe Populin, chi tue giemuem lypen bukne, te luftoine te giagne cuu gielne me kanacchiune Scpirtin e vete.* (f. 12)

*in partes vocati Episcopalis sollicitudinis, in crediti Dominici gregis custodia excubantes, laborantes, desudantes.* (f. 69)

---

<sup>250</sup> Më saktë pjesoret e së tashmes bëjnë pjesë në grupin e tretë të lakimit të tretë, pra ato mbiemra të cilët kanë një mbaresë të përbashkët për të trija gjinitë.

<sup>251</sup> Këtë tezë e kanë pranuar Franz Boppi në librin e tij *Über das Albanesische*, 1954; një mendim të ngjashëm ka dhënë dhe Gustav Meyer në librin e tij *Kurzgefasste albanesische Grammatik*, Leipzig, 1888.

<sup>252</sup> Për më shumë shih "Gramatikë historike e gjuhës shqipe" 1986, f. 935-936

<sup>253</sup> Po aty.

*vum mbe vend piessese ruituni, e se mbaituni, chi biè Upesckupit me perghiuem  
nde stræe te grighiese, tue mundum, e tue u perdiersune* (f. 66)

*Nos propterea tanto occurrere malo cupientes, Parrochis praecipimus....(f. 38)*  
*Pr'ata tue dasciune me ndalle kach te kech, urdhenogneme Parocchianevet*  
(f. 29)

*in carne enim ambulantes, non secundum carnem militamus* (f. 70)  
*tue ezzune nde misct, nuk uscterogneme si temiscit* (f. 67)

Në tekstin tonë pjesorja e tashme e latinishtes na është dhënë gjithashtu e zbërthyer me anë të një fjalie të nërenditur përcaktore, e paraprirë nga përemri lidhor që me foljen kallëzues në të tashmen ose në të kryerën e thjeshtë.

*Patres quoque Missionarii Montanae Albaniae incolentes, quo praecipue nefanda  
pestis irrepsit* (f. 19)  
*Asctù ende Atenit, o Fratinit Missionaare, chi jessene nde mall t'Arbeniise, cu maa  
fort hippi kiò murtaja e scpitinavet* (f. 7)

*Inter regnantium hac tempestate scelerum multitudinem, mendacia quoque, et  
periuria inundaverunt* (f. 28)  
*Nder sciummizza te fajevet, chi nde keta kohe mbalognene çene, rreenat, e  
beeate sctremena u sciocchienenue...* (f. 18)

*Pascant ergo fame morientem, quod si non paverint, occiderunt....* (f. 23)  
*T'uschiegnene pràa atà, chi bdes ùni, e nde mos e ndimofscin, vet u  
vuraane.* (f. 12)

*Hic plane est fons ille viate de domo Dei egrediens, irrigans universam  
superficiem terrae, a peccatorum sordibus emundans* (f. 30)  
*Kyy mirefiül asct gurra e jetese, chi rieç prej sctepijet se Hyit, e laghin giçç  
facchien e çeut, tue delirune prej fajesc se mcatevet* (f. 20)

Ka dhe raste të tjera, megjithëse më të pakta në numër, në të cilat pjesorja e së tashmes është dhënë me një folje në kohën e tashme ose me formën e pashtjelluar të tipit *me ba*, siç shihet në shembujt e mëposhtëm. Në këtë rast autori i përkthimit është larguar mjaft nga origjinali duke bërë një përkthim të lirë.

*Hanc quidem perniciosam erroneae opinionis pravitatem execrantes, detestantes, damnantes omnibus Missionaris...* (f. 46)

*Mirefjil kete damm, e kete mrapscti te mendese, siccur i habinogneme, i largogneme, e denogneme; asctù ...*(f. 39)

*In aliquibus locis solet Populus propriis sumptibus manducans, bibens, et ludens, nulloque spirituali pabulo recreandus convenire* (f. 72)

*Kaa ende Populi eaaconin, mbe dissa visse me ngrane, e me piim at8; e i sckon ditta me lodre....* (f. 69)

**2. Participium futuri.** Pjesorja e kohes së ardhme e tipit *laudaturus, a, um*<sup>254</sup> është mbiemër foljor me formë dhe kuptim vepror, ka kategorinë gramatikore të numrit, gjinisë dhe rasës. Kjo pjesore shpreh një veprim të ardhshëm dhe shërben për të shprehur qëllim apo paracaktim të kryerjes së një veprimi. Në gjuhën shqipe kjo pjesore nuk ekziston. Për këtë arsye në tekstin tonë është dhënë në mënyra të ndryshme, rrjedhimisht herë është zbërthyer me një fjali përcaktore lidhore me folje kallëzues në të ardhmen e tipit *kam për të bërë* në një fjali të nënrenditur përcaktore, gjë që vërehet në shembullin e mëposhtëm.

*...et Divinorum mysteriorum praestantiae dispensatorum quoque dignitas respondeat, sacrosancta tractaturi Sacramenta....* (f. 29)

*...e puscteteja e t8ne, chi appene te sckogn mbaras ne stole te Misterievet H8inuescim; atà chi kane per te precune Scrcramenta te scenta ....* (f. 19)

Rast tjetër është kur nga autori është bërë një përkthim i lirë me folje të plotë ose në paskajore të tipit *me ba*, por me kuptimin kohor të së ardhmes.

*iunior ad distatntia rura se conferat, Missae sacrificium celebraturus, et caetera exercitia peracturus* (f. 67)

*i riu te veen larg, e te mbarogn punen e vete, si i kaa çane Zotyni* (f. 63)

*graviores Ordinarii arbitrato poenas subituri, qui per summum simoniacaе iniquitatis piaculum pecuniam* (f. 69)

---

<sup>254</sup> Participi future formohet nga tema e supinit + mbaresat *-urus, -a, -um* dhe lakohet si një mbiemër i grupit të parë. Këtë formë e kanë të gjitha foljet kalimtare apo jokalimtare si dhe foljet deponente.

*te jene castiguem prej ordinariisc, sicuur te kiscegnine baam mcate te Simoniise* (f. 65)

*Ad Altare non accedant, Sacra **peracturi** mysteria, sine veste talari, quam vernacula lingua Dolamam vocant* (f. 71)

*Mos t' affrohen Lterit **me ççane** mescene paa dolami.* (f. 68)

Një tjetër rast është kur pjesorja e së ardhmes na është dhënë me folje të ndjekur nga forma e pashtjelluar e tipit *për të bërë*, në funksion qëllimor.

*et comunionis sacramento divinae gratiae meliora **recepturi** charismata, roborentur* (f. 46)

*kinese te forzohen me sciacramenti, e te bahen gatii **per te passune** çuntite e hiirit Hyinuescimi* (f. 39)

Latinishtja nuk e ka përdorur këtë pjesore para epokës së Augustit, pasi e konsideronte jo si pjesorë por si mbiemër, dhe si i tillë dilte e përdorur me foljen *esse* duke marrë merr pjesë në ndërtimin një zgjedhimi foljor të plotë, i nohur si **zgjedhimit perifrastik vepror** (*coniugatio periphraistica activa*)<sup>255</sup>. Ky ndërtim ekzistonte në shkrimet e periudhës së fundit të epokës së republikës dhe shërbente për të shprehur qëllim, synim të kryerjes së një veprimi, njësoj si participi futur. Kështu përdorej mjaft me vlerën e së ardhmes në vend të foljeve të plota<sup>256</sup>. Por në shkrimet dhe stilin e Tit Livit, Virgjilit dhe të poetëve të tjerë të epokës së Augustit<sup>257</sup>, participi futur më *-urus* zgjeroi përdorimin e tij, nuk përdorej më me foljen *esse*, dhe përshtatej me kryefjalën ose kundrinorin, dukuri që vërehej dhe në stilin dhe shkrimet e këtij autori, për të mos harruar dhe Senekën, te veprat e të cilit ky përdorim u zhvillua mjaft. Në tekstin tonë nuk kemi gjetur shembuj të shumtë të zgjedhimit perifrastik vepror, përveç rastit të mëposhtëm.

*et iterum **venturus est** cum gloria iudicare vivos* (f.16)

*e perserii **ka me arçune** me labdin me giucuem te giallete* (f. 2)

Në shqipen e Kuvendit një ndërtim i tillë është dhënë me anë të së ardhmes, së tipit *kam me ba*, ndërtim analitik i përdorur vetëm në dialektin gegë.

---

<sup>255</sup> Ky ndërtim korrespondon me ndërtimin e greqishtes *μέλλω γραφειν*

<sup>256</sup> *Non remisura est kundrejt non remittes*. Alfred Ernout, *Syntaxe latine*, vep.cit. f. 279.

<sup>257</sup> Po aty. Virgj. Eneida, *periturae ...Troiae – Trojës së destinuar të zhdukej*.

Por nga ana tjetër raste të përdorimit të pjesores pa foljen *esse* kemi hasur shumë, gjë që na çon në përfundimin se stili i autorit të tekstit latin është i ngjashëm me atë të Virgjilit, Senekës etj.

*quicumque huiusmodi incertitudine iusiurandum violaverit, Iudici Deo, qui accipit ..., merito est rationem redditurus.* (f. 28)

*Giçç i silli praa, chi te fijejn beese me droe asct per te çane arresye Hyit Giucatesit, i silli merr....giychin e vertete paa nderdyym* (f. 18)

*Praelibatae Sacrae Congregationi conferant, proprio debito, et Sanctae Sedis Apostolicae zelo satisfacturi* (f. 59)

*mir te i defto gnene pretemirit Cunvendit Scind, e ksctù te mbarognene detyren e vete, e te paitognene eel in e Seliese Scind Apostolike.* (f. 53)

Në një shembull tjetër gjejmë participin e futurit të dhënë me anë të përcjellores *tue* ba.

*In hac Catholicae doctrinae regula sistant omnes, solida in veritate vestigia posituri.* (f. 36)

*Nde ketà essap te dijese cattolike te centrògnene giççe, tue ngullune giurmat nde te vertete te forte* (f. 27)

*Agnum immacultum, qui pascitur inter lilia, immaculata recepturi conscientia, sacris Dominici Corporis Dapibus in sanctitate ...*(f. 39)

*tue passune me eembre te paa faii per te marre nde vetehen Chingin e paa pallavii, chi culotet nder lulla, tue passune per t'uschiðem me giella te sciacra te Corpit i Crisctit nde Scendenije....* (f. 30)

**3. Participium perfecti.** Pjesorja e perfektit ose e së kryerës në gjuhën latine lidhet me prapashtesën e mbiemrave prejfoljorë të indoevropianishtes më – *to*<sup>258</sup>, në përgjithësi me kuptim pësor dhe e përdorur me vlerë pjesoreje. Të krahasohet kjo prapashtesë me pjesoret latine *laudatus, laudata, laudatum; finitus, finita, finitum* etj.

Në gjuhën latine kjo pjesore shpesh përdoret si mbiemër dhe ka të njëjtat funksione në fjali. Ka të njëjtat mbaresa me mbiemrat e grupit të parë, të cilët mbarojnë me mbaresat –*us, -a, -um*. Të krahasohen format e mësipërme

---

<sup>258</sup> Krahas kësaj prapashtese me po të njëjtën vlerë ishte dhe prapashtesa – *no*. e cila nuk është e dokumentuar në latinishte, por e gjejmë në gjermanishte, anglishte etj. Të krahasohen: gjermanisht *gebe-n, gelese-n*: anglisht *do-ne, go-ne* .

me mbiemrat cilësorë *malus, mala, malum* etj. Dhe në shqipen e dokumentuar hasim disa forma sintetike pjesoresh me kuptim pësor të cilat për nga kuptimi dhe tipi i ndërtimit i përgjigjen pjesores së perfektit të indoevropianishtes, përkatësisht me burim prejfoljor<sup>259</sup>. Bëhet fjalë për formën e pashtjelluar sintetike të pjesores. Kjo pjesore në gjuhën shqipe është një formë foljore e ngurosur, pa kategorinë gramatikore të mënyrës, numrit e të vetës, as të diatezës, madje as kategorinë gramatikore të kohës. Një dukuri interesante është dhe kthimi i pjesores në mbiemër me ndihmën e nyjës<sup>260</sup>, duke ndjekur pak a shumë të njëjtën rrugë si dhe latinishtja. .

Në shumicën e rasteve, duke qenë se kemi të bëjmë me një përkthim *ad litteram*, një pjesore e perfektit pasiv latine na është dhënë po me një pjesore dhe në tekstin shqip, si në shembujt e mëposhtëm.

*Et ex Patre natum ante omnia saecula* (f. 16)

*E leem prej Atit perpara giçç Scecujet* (f. 2)

*Monarchiae titulo a Daniele cohonestata, supra montium vertice a Domino collocata* (f. 18)

*nderune prej Danielit, me te maçe emenite Monarkiise, venduem nde maje te mallit* (f. 5)

*utpote quae descendit a Deo parata, sicut Sponsa ornata Viro suo circumamicta monilibus aureis, et gemmis pretiosis* (f. 20)

*per se kio sdrrippi prej Hyit stolissune sicuur nusseja Burrit vet, buccure reççuem me ciaprasse t' areta, e n' biscerisc se pacimueme* (f. 7)

*Deum de Deo, lumen de lumine, deum verum, de Deo vero; genitum non factum* (f. 16)

*Hyin prej Hyit: Drittene n' drittet: Hyin e vertet prej Hyj se vertetit, Lindune io baam* (f. 2)

*Sunt Parochi animarum pastores, in partes vocati Episcopalis sollicitudinis, in crediti Dominici gregis...* (f. 69)

*Jane Parochit Bariit e Scpirtunavet vum mbe vend te piessese ruituni, e se mbaituni, chi biè Upesckupit me perghiuem ....*(f. 66)

---

<sup>259</sup> Bëhet fjalë për prapashtesat – *m, -n-, -to-* reflekset e të cilave I gjejmë në pjesorë të tipit *punue – m; dhë-në; pitë* (te Buzuku)

<sup>260</sup> Bëhet fjalë për mbiemrat foljorë prejpjesorë. Të krahasohen *hapur - i hapur*. Gramatika e gjuhës shqipe, 1995, f. 331

*Profiteor quoque septem esse vere, et proprie Sacramenta novae legis, a Iesu Christo Domino nostro instituta, atque ad salutem humani generis, licet non omnia singulis necessaria...* (f. 16)

*Ende refegn, e bessogn se gniment jane veçe sctat te verteta Sc sacramenta te ligiese urçenue, e çane prej Christit Σotit tine per scelbim te nierezet; ende se nuk jane giçç cui per nevoje te sctatta:* (f. 3)

### **Funksionet sintaksore të pjesores.**

*Funksioni atributiv.* Në latinishte pjesorja përdoret më shumë duke kryer po atë funksion që kryen dhe një fjali e nënrenditur atributive (përcaktore). Pra, pjesorja në rolin e një mbiemri cilëson një term të gjendur në fjali. Ndryshe, ky njihet dhe si përdorimi nominal (emëror) i pjesores.

Në tekstin shqip kjo pjesore jepet ose me një pjesore, për rastet e participit të perfektit, ose me një fjali të nënrenditur përcaktore për rastet e participit të tashëm<sup>261</sup>. Këtu nuk e shohim të nevojshme të japim shumë shembuj, pasi janë dhënë më sipër kur folëm për pjesoret në veçanti. Të shihet shenbullui i mëposhtëm kur e gjejmë si cilësor për të cilësuar më mirë një emër dhe të përkthyer me një fjali të nënrenditur përcaktore.

*Inter regnantium hac tempestate scelerum multitudo....* (f. 28)

*Nder sciummizza te fajevet, chi nde keta kohe mbalognene çene...*  
(f. 18)

*Quadragesimale ieiunium non tam Ecclesiastica constitutione inchoatum, quam divina Christi Domini conversatione, et exemplo consecratum* (f. 27)

*Agninimi i kerescmese duoli, e u zuu fiil, io veçe prej urdhënit se kishësë, po ende prej se mpsuemit së Krishtit, i silli agninoj kattër dhiet e kattrë dhiet nett*  
(f. 17)

*Hic est panis de Ccaelo descendens, omne delectamentum in se habens et omnis saporis suavitatem, in cuius fortitudine ambulamus usque ad montem Dei, nimirum ad futuram gloriam, et aeternam felicitatem* (f. 39)

---

<sup>261</sup> Të vërehen shembujt e dhënë më sipër, sidomos të pjesores së tashme. Pjesorja e futurit në funksion atributiv është e rrallë në gjuhën letrare të epokës klasike. Kjo pjesore do të përdoret gjithnjë e më shumë aty nga shekulli I pas erës sonë.

Disa pjesore luanin rolin e një mbiemri të mirëfilltë, si në këndvështrimin morfologjik, (si mbiemra pranorin shkallën krahasore ose atë sipërore) ashtu dhe në atë sintaksor (përcaktoheshin nga emra në rasë ët ndryshme nga ajo që kërkon vetë folja nga e kanë burimin). Psh: *discipulus obedientissimus/ cives amantes patriae*

*Kio asct buka chi sdrippi prej chielit, e kaa me vetehe giçç te canacchiunit, e giçç te hante te Sciese, me vertyt te cui ezzime ndier nde malli te Hyit, i silli asct labdi i t'arçunit, e lumniya e pa sossune* (f. 31)

Në shembullin e fundit vërejmë se njëra pjesore e tashme është dhënë me anë të fjalisë së nënrenditur përcaktore, ndërsa tjetra me folje të plotë në kohën e tashme.

*Funksioni predikativ.* Në fjali pjesorja, siç është thënë dhe më lart, përdoret në ndërtimin e kohëve të *perfectum*-it, së bashku me foljen ndihmëse *esse / jam...*, për foljet pësore dhe ato deponente<sup>262</sup>.

*et populus se non custodierit, veneritque gladius, et tulerit de eis anima, ille quidem in iniquitate sua captus est* (f. 24

*e Populi mos u rueiiti vete vetehen, e tue arçune scpata, te marr scpirtin prej ssis, Populi me te kechie te vett u euu* (f. 13)

*ut in superiore capitulo de Festis dictum est* (f. 26)

*sicundrese ççame termàa nde creu te Festavet* (f. 16)

Po me foljen *esse* përdoret dhe participi futur në ndërtimin e zgjedhimit perifrastik vepror, për të cilin është folur në mënyrë më të hollësishme më sipër.

Pjesorja gjithashtu përdoret dhe me folje të tjera. Pjesorja e tashme përdoret në funksion predikativ në rolin e përcaktorit kallëzuesor.

- me *verba sentiendi* (*video, audio, invenio.. etj*) përkrah fjalisë me paskajore, për të cilën do të flitet në vijim. Në këto raste theksohet veprimi i njëkohshëm me foljen e fjalisë kryesore: *vidi puellam scribentem* “pashë vajzën që shkruante,, ndërsa *vidi puellam scribere* “pashë që një vajzë po shkruante,,.

Në tekstin shqip ky përdorim është dhënë me formë të pashtjelluar të tipit *tue ba*, siç mund të shihet në shembullin e mëposhtëm.

*Vidi senes ululantes* (f. 7)

*Pae plecchiete tue ulleruem* (f. 8)

Më poshtë, vërejmë se pjesorja na është dhënë me një fjali të nënrenditur përcaktore.

*quod si speculator viderit gladium venientem et non intonuerit buccina* (f. 24)

---

<sup>262</sup> Folje *deponente* quhen ato folje të cilat kanë ndërtim pësor, por kuptim vepror.



*nde paat Capetaani scpaten, **chi po vien** e mos te bii Boriis* (f. 13)

*Funksioni rrethanor.* Me këtë funksion pjesorja përdoret për të saktësuar rrethanën në të cilën ndodh veprimi, pra me vlerën e një fjalie rrethanore (kohore, shkakore, lejore etj). Me funksionin rrethanor participi luan rol kryesor në dy ndërtime tipike të latinishtes, të cilat janë:

**1. Participium coniunctum**

**2. Ablativus absolutus**

- **Participium coniunctum** . Participi shtues, ndajshtimor, pasi është në rolin e një ndajshtimi dhe qëndron në vend të një fjalie të nënrenditur. Në këtë ndërtim participi përdoret për të treguar rrethanat dytësore në të cilat kryhet veprimi i fjalisë kryesore. Pra, *participium coniunctum* qëndron në vend të një fjalie dytësore:

a) me funksion kohor:

*qui froena **laxantes**, nefando concubitu copuluntur mulierculis ..* (f. 46).  
*kur ata **tue lescuem** freenin e Curveniise bagnene sctrane e dhunuescimi me grat ...*(f. 39)

e) me funksion qëllimor.

*et comunions sacramento divinae gratiae meliora **recepturi** charismata, roborentur* (f. 46)  
*kinese te forzohen me sciacramenti, e te bahen gatii **per te passune** çuntite e hiirit Hyinuescimi* (f. 39)

c) me funksion kushtor.

*his postmodum a Fide **naufrogantibus** et Maumetaneae sectae **adhaerentibus**, si Christianos ritus nulla Creatoris contumelia observant, ad participationem admittantur* (f. 49)

*nde u **daafscin** keta n' feje sone e te **marrene** essapin e Muhamettit, nde mbaiscin graat Feene pa dhune te Criuessit të përzihen, e përzehen nde Sciacramente* (f. 43)

*Hanc quidem perniciosam erroneae opinionis pravitatem **execrantes**, detestantes, damnantes* (f. 46)

*Mirefili kete damm, e kete mrapscti te mendese, siccur i **habinogneme**, i **largogneme**, e **denogneme** (f. 39)*

d) me funksion shkakor

*Nos propterea tanto occurrere malo **cupientes**, Parochis praecipimus, et mandamus, ut in posterum, .... (f. 38)*

*Pr' atà **tue dashune** me ndalle kach te kech, urdhenogneme parochianevet, kinese mbasndaj .... (f. 29)*

*Sic **contemnentis** divinae legis mandatum, **dum** suarum obtemperant illecebris voluptatum (f. 48)*

*Ani kscitù **tue chiestissune** urçenin e liise Hyinuscimee, fleene me eembre te mire... (f. 41)*

- **Ablativus absolutus**. I njohur si *ablativi absolut*, ky është një ndërtim mjaft i njohur e i përdorur në gjuhën latine. Ky ndërtim ka në përbërje një pjesore në funksion të kallëzuesit dhe një emër apo përemër në funksion të kryefjalës. Si emri dhe pjesorja vendosen në rasën rrjedhore.

Kushti është që pjesorja me emrin në rrjedhore të japë një shprehje absolute, e cila mund të shpëputet e të lihet jashtë fjalisë nga e cila varet, pasi nuk ka lidhje gramatikore me të. Ablativi absolut në varësi të kontekstit në të cilin përdoret, merr kuptimin e një fjalisë të nënrenditur implicite rrethore me vlerë kohore (në rastet më të shpeshta), shkakore, lejore, mënyrore, hipotetike etj.

Për të sqaruar më mirë këtë konstrukt mendojmë të shikojmë një shembull jo nga teksti i Kuvendit, në mënyrë që të shihen qartë lidhjet ndërmjet fjalisë së nënrenditur e ndërfutur në fjalinë kryesore.

*Dux, **incitatis militibus**, proelium commisit.*

*Komandanti, pasi nxiti ushtarët, filloi betejën.*

Në këtë fjali të përbërë dallojmë fjalinë kryesore

***dux commisit proelium** / komandanti filloi betejën, dhe fjalinë e nënrenditur rrethore me vlerë kohore kohore të dhënë me anë të ablativit absolut **incitatis militibus** / pasi nxiti ushtarët.*

Siç mund të shihet, ky ndërtim i thjeshtë nxjerr në pah një tipar të rëndësishëm të gjuhës latine, atë të lakonizmit, ku me pak fjalë thuhet shumë, një tipar që do e karakterizojë në të gjitha etapat e saj.

Në tekstin e Kuvendit të Arbënit, ablativi absolut gjen përdorim të madh. Zakonisht është i vendosur mes presjeve, rrjedhimisht pa lidhje gramatikore me pjesën tjetër të fjalisë. Në shumicën e rasteve ablativi absolut është përkthyer, por nga ana tjetër ka raste në të cilat ky ndërtim nuk është përkthyer në tekstin shqip, pa i prishur kuptimin fjalisë në të cilën bën pjesë, duke qenë se nuk ka lidhje me pjesën tjetër të fjalisë.

a) Ablativ absolut me pjesore të tashme, të cilin herë e gjejmë të përkthyer e herë jo. Të vërehen dy shembujt e mëposhtëm.

*et veraciter teneo, eandem integram, et inviolatam usque ad extremum vitae spiritum, Deo iuvante, retinere et confiteri, atque a meis subditis.* (f. 18)  
*e me te vertete mbà, due ndier nde e dall te Scpirtit tim ugnii, e paa ngand me mbaitune e me luftuem, ci kesctu ta mbane giçç atà...* (f. 4)

*Haec Fidei documenta divina veritate innituntur affirmante ipsomet Christo Domin: Omnis, qui confebitur me coram hominibus..* (f. 20)  
*Ketò të mpsuema te Feese janë pescettune mbe të dereite te Hyit tue i vertetuem Criscti i miscerierscimi me goje te vete, ksctu ççot i Beecuemi; Giçç i silli ci ka me refðem atà perpara tim Et....* (f. 8)

*Ne, senescente iam mundo, chariats quoque refrigescat, cum omnes...*(f. 76)  
*Tue u mplakune Secculi, mos te ftofet end te dasciunit...* (f. 74)

Në dy shembujt e mësipërm ablativi absolut me pjesoren e tashme është zbërthyer me anë të përcjellores të tipit *tue ba*.

*...Parochis praecipimus, et mandamus, ut in posterum, nullo suffragante praetextu, omnes utriusque sexus ad confessionem adstringant...* (f. 38)  
*....urdhenogneme parochianeve, kinese mbasndaj (pa sctiim cund mahane) te sctringognene asctù masckuit, si feminat meu refyem ....* (f. 29)

Ndërsa në shembullin e fundit ablativi absolut na është dhënë me anë të formës së pashtjelluar të tipit *pa bërë*<sup>263</sup> duke qenë se në përbërje është përemri mohor *nullo*.

*Quoniam vero ingravescente Turcarum impietate invaluit, proh dolor! abominatio desolationis in loco sancto Templorum Domini.....* (f. 22)

---

<sup>263</sup> Për më shume shih *Gramatika e gjuhës shqipe*, vep. cit. f. 333 – 336

*E persè urandue e paa misceriereja e Turchiet (uh eembre plasme) hippì nde ketè  
çee Kisciavet Tineot, e visseve te beecueme te nd ççmit ....(f. 11)*

Në shembullin e mësipërm vërejmë se ablativin absolut është zëbërthyer me fjali të nënrenditur shkakore.

*deficiente* *Agriculturarum diligentia, studio ac labore, et ingruente herbosa  
vitorum colluvie, facili ratione in silvestres arbores ....(f. 22)*  
*si tu mengogn cuidessi i te permiffunit, ciallastija, e fetiga e Punitorevet; tue i  
ngremuem silla e ferravet ... (f. 10)*

Në shembullin e fundit vërejmë ablativin absolut të shprehur me particip të tashëm të zëbërthyer me anë të një fjalie të nënrenditur kohore me marrëdhënie paskohësie, të paraprirë nga lidhëza si me folje kallëzues në lidhore.

b) Ablativ absolut me pjesore të perfektit pasiv. Në tekstin latin kemi gjetur shumë raste.

*Sic enim abiectis operibus tenebrarum, induet arma lucis, ut possit resistre in  
die malo adversus Principes, et Potestates..... (f. 32)*  
*Asctu mbas se elarguene prej vetehi vepera terretat, te vviscene armete e se  
dereitese, kinese te mund chiendrognene nde ditte te kech cundra Dispotevet, e  
Kadiivet .... (f. 22)*

*Ecclesiis temporum iniuria collapsis, et vetustate consumptis, nec vel ob  
debaccantem infidelium impietatem (f. 66)*  
*Mbas kisciasc se ruzueme n'moccimijet, ndo prej termekut reenuem, chi prej se  
paa lighie se Turchiet (f. 61)*

Në shembullin e dytë ablativi absolut i latinishtes është përkthyer në shqipe me një emër në rasën rrjedhore dhe një mbiemër prejpjesor të paraprirë nga parafjala *mbas*. Kemi të bëjmë me një përkthim të fjalëpërfjalshëm, pasi e gjithë sintagma duhet të ishte dhënë me vlerën e një fjalie të nënrenditur kohore me lidhëzën pasi të shoqëruar nga folja e plotë, dhe jo me mbiemër prejpjesor. Konkretisht: *Pasi kishat ishin rrëzuar nga ....*

*et debacchiantium scelerum multitudine repressa, furor domini cervicibus  
nostris imminens per Festorum sanctificationem avertatur ..... (f. 26)*

e **tue ndalune** mbe scimmizzet fajjet e te hutuemet ; prej scendeniise  
Festavet te largohet prej nesc menija e Tinezot (f. 15)

Cum autem ad infirmi domum pervenerit, **annunciata** prius **pace**, et lustrali  
aqua.. (f. 41)

Si te rriign mbe sctepi te semunit, te fallet : **tue ççane** ; **pacchia e giççeve**, chi  
riine nd'atà.... (f. 33)

Në shembujt e mësipërm vërejmë se autori ka bërë një përkthim të lirë, pa u  
ndikuar nga teksti latin. Në këtë rast ablativi absolut është dhënë me anë të  
përcjellores.

*Baptismi Sacramento Confirmatio succedit, eo rerum ordine copulata, ut, cum  
Baptismate regeneremur ad vitam....* (f. 35)

*Ndaj Sciacramentit e paghezimit vee Krezmimi, ksctù riescttune mbasck, chi me  
pagheëimi leeghme per sedëiti mbe jete t'amesciueme.....* (f. 25)

Në këtë shembull vërejmë se ablativi absolut është dhënë me pjesore, duke bërë  
një përkthim gati të fjalëpërfjalshëm. .

Në latinishte mjaft i përdorur është dhe ablativi absolut emëror, i cili gjendet  
në sintagma emërore, pa pjesore, i njohur si ablativi absolut emëror, i  
formuar vetëm nga një emër në rasën rrjedhore dhe nga një emër, a përemër,  
në funksion të kallëzuesit. Në këtë ndërtim nënkuptohet folja *esse*, e cila nuk ka  
particip të tashëm.

*Concilium Albanum Clemente XI. Pont. Max Albano* ( titulli latinisht)

*Cuvendi i Arbenit ndene Schiptarin Clementin XI Pape Pretemaçin* (titulli  
shqip)

Në tekstin tonë nuk kemi gjetur ablativ absolut me pjesore të futurit, pasi është  
mjaft i rrallë dhe më shumë haset në latinishten pasklasike<sup>264</sup>.

Në tekstin e Kuvendit të Arbënit pjesorja është mjaft e përdorur, duke marrë  
parasysh të gjitha funksionet e saj në fjali.

### III. 5. 2 *Gerundium / Gerundi*

---

<sup>264</sup> Ky përdorim gjendet më shumë te veprat e Tit Livit, si autor i epokës pasklasike.

Në gjuhën shqipe konsiderohen si forma të pashtjelluara ato forma foljore, të cilat nuk kanë kategorinë foljore të vetës dhe numrit. Këto trajta të pazgjedhueshme në vetë dhe numër kanë disa tipare të cilat janë tipike të formave të shtjelluara<sup>265</sup>. Sipas gramatikës së gjuhës shqipe forma të pashtjelluara në gjuhën shqipe janë *pjesorja*, dhe ato që janë ndërtuar mbi bazën esaj: *forma e pashtjelluar mohore* (pa bërë) dhe *përcjellorja* (duke bërë), pa harruar dhe formën e tipit (*me ba*), që përdoret si paskajore në të folmet e gegërishtes<sup>266</sup>.

Një ndarje tjetër interesante ka bërë dhe studiuesi Mehmet Çeliku në librin e tij<sup>267</sup>, ku sistemin e formave të pashtjelluara e sheh të përbërë nga tri forma të pashtjelluara: *gerundi* (që ka dy trajta: *të punuar, së punuari*), *përcjellorja* (që ka dy trajta: *duke punuar, pa punuar*) dhe *pjesorja* (*punuar, e punuar*). Pra, studiuesi Çeliku bën dallimin mes përcjellores me trajtën (*duke bërë*) dhe gerundit (*të punuar, së punuari*). Ai pohon se në gramatika të ndryshme disa nga gjuhëtarët tanë kanë përdorur termat *përcjellore* dhe *gerund*<sup>268</sup> për trajtën *duke bërë*. Po sipas Çelikut, termi *përcjellore* është i përshtatshëm, sepse shpreh një veprim që përcjell një veprim tjetër. Por nga ana tjetër, termi *gerund*, që është ndikim i gramatikave të gjuhëve neolatine<sup>269</sup> nuk është i përshtatshëm, sepse me këtë term emërtohet një formë e pashtjelluar që ka tipare të foljes dhe të emrit gjë që u pohua dhe pak më lart për gerundin e latinishtes, për të cilin do të flitet në vijim, për gerundin e anglishtes, e të shqipes etj.

Përcjellorja në gjuhën shqipe, pohon Çeliku, është e krahasueshme me gerundin e gjuhëve neolatine, dhe aspak me gerundin e latinishtes. Kështu, dallimi i parë është ndërtimi analitik i përcjellores së shqipes<sup>270</sup>, kundrejt atij sintetik të gerundit të latinishtes<sup>271</sup>.

Ndërsa në latinishte gerundi karakterizohet nga tipare emërore, në gjuhën shqipe përcjellorja ka tipare mbizotëruese foljore dhe ndërtohet nga pjesëza *duke*+*pjesore*. Nga ky aspekt po në gjuhën shqipe përcjellorja dallon dhe nga pjesorja, pasi foljet kalimtare të përdorura në këtë formë mund të marrin kundrina të drejta e të zhdrejta. Forma e pashtjelluar e tipit *duke bërë* dallohet prej pjesores nga veçori të tjera gramatikore si kategoria gramatikore e diatezës. Gjithashtu përcjellorja ka kuptim kohor të kushtëzuar nga folja drejtuese.<sup>272</sup>

<sup>265</sup> Disa forma të pashtjelluara njohin kundërvënien formale *veprorë – joveprorë*; te disa kemi dhe kundërvënien kohore, megjithëse jo shumë të përdorur.

<sup>266</sup> Forma të tjera të pashtjelluara të formuar jo mbi bazën e pjesores, janë dhe ato të tipit *me të bërë* dhe *për të bërë*.

<sup>267</sup> Mehmet, Çeliku, *Probleme të morfologjisë së gjuhës së sotme shqipe*, Tiranë, 1997, f. 114

<sup>268</sup> Shih Shaban Demiraj, *Gramatikë historike e gjuhës shqipe*, Tiranë, 1986, f. 970.

<sup>269</sup> Të krahasohen *gerundium* i latinishtes, *gerundio* e italishtes, *gérondif* i frëngjishtes.

<sup>270</sup> Lidhur me krijimin e kësaj forme analitike të shihet Shaban Demiraj, *Gramatikë historike e gjuhës shqipe*, Tiranë, 1986, f. 970 e tutje

<sup>271</sup> Të krahasohen *duke bërë / faciendi, faciendū, faciendum* ..

<sup>272</sup> Për më shumë shih *Gramatika e gjuhës shqipe*, Tiranë, 1995, f. 333 - 337

Duke qenë se teksti ynë është shkruar në dialektin gegë, në të, përcjelloren<sup>273</sup> e ndeshim të ndërtuar rregullisht me pjesëzën *tue* dhe pjesoren e foljes themelore gjë që vërehet në shembujt e mëposhtëm. Me përcjellore të shqipes me të drejtë nuk është përkthyer një gerund i latinishtes, por kryesisht një pjesore e së tashmes, ose një fjali e nënrenditur shkakore etj.

*Cum autem aequum sit, ut sancta a sanctis tractentur ...* (f. 29)

*Tue kiene me lig, kinese cafsca te scenta, prej Scentesc te jene precune* (f. 19)

*nomenque Domini, qui in veritate vivit falsitatis testimonio poluentes nomen* (faqe 28)

*tue feligiune Emenit e Tinecot, chi jeton nde te dereite* (f. 18)

*Deus autem, quia benignus, et misericors est, cognoscens figmentum nostrum...* (f. 36)

*Pò H8j persè asct i dasciuni fisnik, e miscierierscimi, tu gnoffune traitimin tane* (f. 27)

*Vidi senes ululantes* (f. 7)

*Pae plecchiete tue ulleruem* (f. 8)

Pra, siç u tha më lart, në latinishte gerundi ka kryesisht tipare emërore, pasi ai lakohet dhe kryen funksionet e paskajores për rasat e zhdrejta, pra është lakimi i paskajores kur është në funksion të emrit<sup>274</sup>. Gerund kanë të gjitha foljet në formën veprorë dhe foljet deponente: psh: *spes vincendi- shpresa për të fituar/ tempus tacendi - koha për të heshtur*. Kjo gjë mund shihet në rastet e mëposhtme ku jepet gerundi latin në të gjitha rasat e mundshme. Shembujt janë vjelë nga teksti i Kuvendit të Arbënit, përjashtuar shembullin e rasës dhanore e rrjedhore, të cilat nuk i gjetëm në tekstin tonë.

### *Nominativus*

*Quanta vita est confiteri Christum, tanta mors est negare Christum*” (f. 20)

“*Saa asct jeta me refyem Crscne; acchie asct mortçia e tyne, chi e mohognene*” (f. 8)

---

<sup>273</sup> Ndryshe dhe formë e pashtjelluar e tipit *duke bërë*

<sup>274</sup> Për më shumë mbi gerundin shih *Compendere e Tradurre* Nicola Flochini, Milano, 1999, f. 498- 500

Në rastin e mësipërm kemi paskajoren kur ajo është në vend të kryefjalës rrjedhimisht në rasën emërore, duke qenë se gerundi nuk ka rasë emërore.

**Genitivus.**

*Ad minores Ordines provehendus, nedum **legendi** habeant peritiam, sed etiam **scribendi** habeat peritiam* (f. 44)

*Cusc dò me marre urçeni te minore te diine **me lezuem, e me sckruem***  
(f. 36)

**Dativus**

*Tacendo operam do.*

*Përpiqem të hesht.*

**Accusativus**

*Quod tamen attinet **ad conferendum** Baptismi Sacramentum Turcarum filiis, miramur sane rei novitate percussi..* (f. 33)

*Per sàa perket **me pagheuem** te biite e Turchiet, fort pò mreculohe mi prej pune se ree....* (f. 24)

**Ablativus**

*In iudicando est criminosa celeritas* (Sirus)

*Shpejtësia në të gjykuar është e qortueshme.* (Siri)

Gerundi latin në tekstin tonë gjen përdorim të gjerë dhe kryesisht është dhënë me paskajoren geqe të tipit *me punue*, sidomos kur gerundi është në rasën gjinore dhe kallëzore, dhe asnjë herë me përcjellore. Gerundi në rasën gjinore gjen përdorim kur varet nga një emër, si në rastet e mëposhtme. Në këto shembuj gerundi latin është dhënë me paskajore të tipit *me ba*.

*Hinc **ligandi** atque **solvendi** potestas, **consecrandi**, **offerendi**, ac **ministrandi** sacrificii divina oritur auctoritas* (f. 42)

*kend8j puscteteja **me liçune, e me eghiçune, me conscecruem, me truem; e kend8j dell puscteteja e H8inuescimeja me scerb8em Sciacrifizit*** (f. 35)

*nedum **legendi**, sed etiam **scribendi** habeant peritiam* (f. 44)

*te diine **me lezuem e me scriuem*** (f. 36)

*vero **baptizandi** munus ad Parrochum solum pertineat* (f. 31)

*e nde se vece Parrochianevet perket **me pagheuem*** (f. 21)



Po me paskajore është dhënë dhe gerundi në rasën kallëzore, i cili gjithmonë shoqërohet nga parafjala *ad* e rasës kallëzore. Shembuj të gerundit latin në kallëzore mund të vërehen më poshtë.

*quod tamen attinet ad conferendum baptismi Sacramentum Turcarum filiis, miramur sane rei novitate percussi..* (f. 33)

*Per sàa perket me pagheuem te biite e Turchiet, fort pò mreculohe mi prej pune se ree....* (f. 24)

*spiritu tamen fortes ad proeliandum bella Domini* (f. 41)

*prò me scpirtì jemi te fort me uscteruem luftat e Tinecot* (f. 33)

*divino zeli fervore concurrant Pastores ad ulciscendum inobedientiae crimen in Sacerdotibus* (f. 34)

*me te nzeit te eelit Hyinuescimi te bliçen Ciobante e Scpirtinavet me paguem te kecchien e te paa giegjunit mbe Mescetaarete* (f. 24)

*Solent...divina, humanaque iura per summum scelus profanando..* (f. 48)

*Kane eaaconin... me feligiune lighiat e Tinecot, e te Nierecet..* (f. 41)

Në shembullin e fundit vërejmë se gerundi në rrjedhore na është dhënë po me paskajore të tipit *me ba*. Nuk mungojnë dhe raste kur gerundi në rrjedhore na është dhënë me përcjellore të tipit *tue ba*, siç mund të vërehet në shembullin e mëposhtëm. Është pikërisht ky rast kur studiuesit barazojnë termin përcjellore me termin *gerund*.

*et non cessent Pastores, et quasi tuba exaltent vocem suam, annunciando populo scelera eorum....* (f. 24)

*e mos te puscio gnene, pò si burri te keene eaanin, tue kalëuem populit fajet e tyn..e* (f. 13)

Në këtë rast vlen të permendim faktin se gerundi latin në rasën rrjedhore, në gjuhën shqipe vjen me anë të përcjellores, pra me formën *duke bërë*, në po ato funksione si të gerundit latin.

*Illique in oeconomicis subditi sint, nihil dando, vel accipiendo, aut habendo sine eius iussione* (f. 79)

*E paa tessir te ketii as mos te fallene, as mos te marrene, as mos te keene giaa* (f. 78)

Nuk mungojnë dhe raste në të cilat gerundi latin është dhënë me emër prejfoljor asnjans, siç ka ndodhur në rastet e mëposhtme, në të cilin gjejmë një emër të gjinisë asnjansë të tipit prejpjesor, me nyjen *të* përpara. Në këtë rast, duke pranuar tezën Çelikut,<sup>275</sup> i cili njeh si gerund formën (*të punuar, së punuari*) mendojmë se gerundi latin duhet të na ishte dhënë me trajtën *për të punuar*, dhe jo me emër prejfoljor asnjans, siç vërehet në shembujt e mëposhtëm.

*Praestantissimum docendi munus saluberrima verbi Dei praedicatione fulcitur* (f. 23)

*Σaanati i nderscimi i te mpsuemit forzohet me te shendëccimin predikim te fiallese Hyit* (f. 12)

*Discretionis zelo decernimus, ut pro substantando impotenti Parocho ...*(f. 76)

*Kemi urçenuem me urtii te eelit: kinese per te mbaitunit e Parokut paa viiuescimi* (f. 74)

### III. 5. 3 Gerundivum - Gerundivi.

Ndryshe nga gerundi, gerundivi në gjuhën latine është mbiemër foljor me kuptim pësor. Gerundiv kanë vetëm foljet kalimtare dhe deponente. Si të gjithë mbiemrat, dhe gerundivi përdoret me funksion atributiv dhe kallëzuesor. Kështu gerundivi sipas funksionit dhe ndërtimeve në të cilat merr pjesë mund të shprehë:

- idenë e veprimit për t'u kryer, pra që nuk ka përfunduar ende, psh. *res gerendae*
- gjëra për t'u bërë
- idenë e nevojës së kryerjes së një veprimi, psh. *virtus laudanda est – virtyti duhet lavdëruar*<sup>276</sup>

#### Gerundivi me funksion atributiv

Në gjuhën latine gerundivi me këtë funksion përdoret në vend të gerundit në ato raste kur folja ndiqet nga një kundrinor i drejtë. Siç mund të vërehet, gerundivi ka vlerën e mbiemrit dhe përputhet në gjini, numër e rasë me emrin, pa të cilin nuk mund të përdoret. Të shikojmë përdorimin e gerundivit në raste të ndryshme.

#### Genitivus.

---

<sup>275</sup> Sipas tij si gerund të shquar duhen parë dhe trajtat *të bërit, të bamen*, kur marrin kundrinorë të drejtë. vep.cit.f. 112

<sup>276</sup> Veçoritë mbiemërore vërehen dhe te disa gerundivë të vjetër si psh: *secundus* (nga folja *sequor*, “i dytë”, “që ndjek”); *oriundus* (nga orior “që lind”. Me vlerë të tillë gerundivi përdoret në funksion atributiv në ndërtime, të cilat mund të jenë dhe me anë të gerundit, psh: *cupiditas patriae amandae / cupiditas amandi patriam* – dëshira për të dashur atdheun.

Përdoret me emra ose mbiemra të cilët kërkojnë një përcaktim në rasën gjinore sipas funksioneve të emrit në gjinore. Në tekstin tonë gerundivi në gjinore nuk është përkthyer ose është dhënë me pjesë të tjera të ligjëratës siç mund të vërehet në shembujt e mëposhtëm.

*Nec **administrandae** compos Curae fuerit, alius illi Parochus substatur, cum quo cunctos fructus dividat...* (f. 76)  
*anì s' à i Σot me scerbyem, te vihet mbe vend te tii tieteri Paroku, i sillì te daan me atà giaan....* (f. 74)

*alio deficiente **instruendae** iuventutis suffragio, per assiduitatem praefati Magisterii* (f. 82)  
*e vesse te paa gante tue mos gietune tietr' uçe me mpsuem teriite paa pusciuem* (f. 81)

#### **Accusativus.**

Gerundivi në rasën kallëzore i shoqëruar me parafjalën *ad*, siç do të shihet rastet e mëposhtme, përdoret mjaft në gjuhën latine, për faktin se ky ndërtim shpreh synim të kryerjes së një veprimi dhe mund të përkojë me një fjali të nënrenditur qëllimore. Në tekstin shqip na është dhënë me paskajoren e tipit *me punue*, gjithnjë me kuptim qëllimor.

*.....studium, et solitudinem in eo adhibeant, ut populus gemens, et quaerens panem, inveniatur cibum **ad refocillandam** animam* (f. 23)  
*....ci kane, e giçç munde, e ciallastii ta keene mbe Populin, chi tue giemuem lypen bukne, te luftoine te giagne cuu gielne **me kanacchiune** Scpirtin e vete.* (f. 12)

*Dies Divina festivitate venerabiles **ad celebrandas** dei, Sanctorumque laudes potissimum instituti sunt pie, ac religiose transigendi ...* (f. 24)  
*Dittate nderscimat e estavet maa fort **jane jaratissune me lebduem** Hyin, e Scendenite; devotscim, e kerscenisct jane mbaitune* (f. 13)

*Qui sine Ecclesiae intentione non accipitur, non operari, ut **ad** eius sublimitatem **amandam**, atque **quaerendam**, per haec saltem humana remedia perducantur* (f. 34)

*Chi ni merret paa mende te Kiscese as veperon, as proçon: Kinese te siellene **me dasciune** te mirete, e hiirin etii me lighierate te buta, e me fialla t' ambla* (f. 25)

Nuk mungojnë dhe raste, si ky i poshtmi, kur na është dhënë me formën e re të pashtjelluar të tipit *për të punue*, funksioni i së cilës është ai qëllimor.

*Nihil nobilius, nihil pretiosus, nihilque ad aeternam salutem consequendam magis necessarium habet Ecclesia* (f. 29)

*As giàa màa te beganiscim, as giàa màa te pacimuescime, as giàa màa te nevoiscime kàa Kiscia per t'u passune scendeteja e paa sossun...*(f. 19)

*Nihil enim efficacius ad rugientis Leonis savitiam retundendam, nihil certe ad rebellantis carnis compositam petulantiam utilius potuit institui* (f. 26)

*Asgiaa maa fort pret, ndo nall Luanin e paa miscierire; as giàa màa fort nuk essapton miscin me giçç lakmi te tii, sàa ban agnini* (f. 15)

Në rastin e fundit autori ka bërë përkthim të lirë duke mos përkthyer gerundivin me paskajore funksioni i së cilës është ai qëllimor.

#### **Ablativus.**

Gerundivi në rasën rrjedhore përdoret për të shprehur funksionet e ablativit, siç është folur në kapitullin mbi sistemin emëror. Kështu, e gjejmë të përdorur me ose pa parafjalë. Kur përdoret me parafjalë si *de/ in/ a/ab/ex* etj shpreh idenë e largimit, shprehur apo dhe të vendit. Në tekst kemi gjetur shembuj të gerundivit në rrjedhore, të cilët autori nuk i ka përkthyer fare, duke iu shmangur ose duke i dhënë me fjalë të tjera. .

*communis quoque spiritus unanimitate, quamvis in excolenda vinea domini* (f. 75)

*E shkognene jetene velaenisct; e me te dasciunit scerbegnene, e punognene nde venesci te Criscit* (f. 73)

*in corrigendis Parrochorum defectibus, pecunariae solutione poenae, hanc non sibi..* (f. 51)

*cur duene me castiguem fajjet e Parrochiet te i kpussene cacch giàa. .* (f. 46)

*Pastores quoque incumbant, ut disciplinae modus in communicandis infirmis a maioribus traditus...* (f. 41)

*Te chielognene Ciobante e scpirtinavet, chi te jete mbaitune mendyra e et cinguemit per et semuute çane prej se Parese* (f. 33)

*...durissimum in reddenda ratione iudicium subituri....*(f. 51)

*...tue passune per te çane te scetreinte arresye nde Giychi* (f. 45)

### Gerundivi me funksion foljor

Kur bashkohet me foljen *esse*, pra në funksion kallëzuesor, kemi *zgjedhimin perifrastik pësor* (coniugatio periphrastica passiva), për të treguar detyrë apo domosdoshmëri të kryerjes së një veprimi. Në këtë rast kemi një ndërtim të dyfishtë: *ndërtimin perifrastik pësor personal* dhe *atë impersonal*<sup>277</sup>.

*Ndërtimi perifrastik pësor personal* është ai ndërtim në të cilin folja *esse* “me qenë” dhe gerundivi përshtaten me emrin që shoqërojnë. Në shqipen e Kuvendit ky ndërtim është dhënë kryesisht me foljen *jam* + formën e pashtjelluar të tipit *për të bërë*. Jo vetëm në gjuhën latine, por dhe në tekstin tonë ky ndërtim gjen përdorim të madh.

*damnanda est incerti iuramenti pernicioosa consuetudo...* (f. 28)

*acst per tu habinuem ajo dore bee, me tesillt te kersctenete tue mos ditune ....* (f. 18)

*Etenim cum nomen Domini invocandum sit in veritate, et in spiritu ...* (f. 28)

*Prasctu tue kiene emenit e Tineeot per tu permendune me te vertete, e per tu açoruem me scpirt* (f. 18)

*nostra non cupiditate opprimendi, sed charitate sublevandi* (f. 52)

*jane pra per t'u sctrenguem, po per t'u ndimuem me te dasciunit* (f. 46)

*omni conatu reiciendus est abusus* (f. 31)

*me giçç forze acst per t'u larguem eaconi* (f. 21)

*Ndërtimi impersonal* është ai ndërtim në të cilin gerundivi merr formën – *dum* dhe foljen *jam* në vetën e tretë numri njëjës. Në tekstin tonë ky ndërtim është shumë i përdorur. Në fakt të dyja këto ndërtime në latinishte shërbejnë për të treguar domosdoshmërinë e kryerjes së një veprimi. Duke qenë se kemi të bëjmë me një tekst normativ - taksativ e urdhërues, drejtuar besimtarëve katolikë, ndërtime të tilla ndihmojnë shumë në përcjelljen e mesazhit nga ana e autorit.

Në shqipen e Kuvendit ndërtimi impersonal është dhënë me foljen gjysmëndihmëse *duhet* + *paskajore* të tipit *me ba*, ose me foljen *jam* + formën

---

<sup>277</sup> Për më shumë mbi gerundivin dhe ndërtimet në të cilat merr pjesë shih Alfred Ernout e François Thomas, *Syntaxe latine*, Paris, 1953, f. 262 - 268

e pashtjelluar të tipit *për të bërë*. Të vërehen më poshtë shembuj të ndërtimit impersonal.

*Ideo Parrochis omnibus invigilandum est* (f. 22)

*Pr'ata giçç Parrochianeve i duhet fort me vum roe* (f. 10)

*ideo curandum est, ut homines in contrahendis Matrimoniis* (f. 45)

*prasctu duhet me sciucuem, kinese Njereee tue u martuem* (f. 38)

*Neque permittendum est ut Turcae, vel Schismatici, Patrini fungantur munere* (f. 35)

*As jane per te laane Turit, ndo Schismaticichi me mbaitune cand* (f. 26)

*Illud tamen maiore cordis dolore deplorandum est, quod nonnulli ....* (f. 40)

*Prò maa fort asct per tu chiaam me giak te embrese, se dissa Parrochiani* (f. 32)

*Inter caetera a Sacra Congregatione de Propaganda Fide collatae beneficentiae argumenta, illud quoque numerandum est ...* (f. 81)

*Chi kaa deftuem Cunvendi Scind i propagandese, asct ende aj per t'u numeruem..* (f. 8)

### III. 5. 4 *Infinitivus / Paskajorja*

Në gjuhën latine *infinitivus* (ose *infinitus*)<sup>278</sup>, (paskajorja) bën pjesë në grupin e emrave foljorë<sup>279</sup>, për të cilët është folur më lart dhe jep idenë e shprehur nga folja jashtë çdo përcaktimi kohor, funksion i kryer pikërisht nga aoristi grek. Megjithatë infiniti latin si pasojë e nevojës për të projektuar në kohë aspektin foljor që ai mbart, ka pësuar ndryshime dhe ka marrë forma të reja të cilat janë zhvilluar më vonë. Infiniti latin njih kundërvënien kohore dhe atë formale. Kështu, latinishtja dallon paskajoren e së tashmes<sup>280</sup>, tek e cila do të ndalemi më shumë, pasi në tekstin latin nuk kemi gjetur shumë raste paskajoreve të kohëve të

---

<sup>278</sup> Ky term është përdorur për të përkthyer termin grek αόριστος.

<sup>279</sup> Quhen kështu pasi kanë më të theksuara tiparet emërore se ato foljore.

<sup>280</sup> Infiniti i tashëm në gjuhën latine del me fundoret *-are*, *-ari* për foljet e zgjedhimit të parë. Psh: *laudare*, *laudari*. Sipas të dhënave të historisë së gjuhës latine, paskajorja e së tashmes formaohej duke i shtuar temës mbaresën *-se*, e cila si rrjedhojë e rotacizmit, u shndërrua në *-re*. Në latinishten arkaike është gjetur dhe një formë pësore e paskjaores më *-ier legier* në vend të *legi* (*lego*)

tjera: paskajoren e së ardhmes<sup>281</sup> dhe atë të së kryerës, në formën veprorë dhe joveprorë.

Në tekstin shqip paskajorja latine e së tashmes na është dhënë po me paskajoren e vetme që njih shqipja. Bëhet fjalë për paskajoren e tipit *me ba*, përdorimi i së cilës kufizohet vetëm në të folmet e gëgërishtes. Nëse në latinishte paskajorja e së tashmes paraqitet si formë sintetike, në shqipen e dokumentuar e deri më sot na paraqitet si formë analitike, e përbërë nga dy elementë gramatikusht të pandashëm<sup>282</sup>. Duke qenë se kemi të bëjmë me ndërtime perifrastike, mendohet se janë të formuar më pas dhe në faza të hershme këto kanë qenë togje të lira fjalësh, që me kalimin e kohës kanë humbur kuptimin e mirëfilltë duke u gramatikalizuar. Kështu *me* tek forma *me ba(m)* në fillime do të ketë qenë parafjalë dhe si e tillë përdoret dhe sot, ndërsa *ba(m)* nga pjesa më e madhe e studiuesve është marrë si pjesore, pasi formalisht përkon me pjesoren. Por, nga ana tjetër janë hedhur mendime se elementi i dytë mund të jetë paskajore ose dhe pjesore e emëruar.<sup>283</sup>

Po sipas Demirajt origjina e formës së pashtjelluar të tipit *me ba(m)*, pra paskajorja e gegëristes, i takon fazës parashkrimore të shqipes, pasi te Meshari i Buzukut, libri i parë i shqipes, këtë formë e gjejmë të ngulitur e të kristalizuar plotësisht. Në tekstet e vjetra, përfshirë dhe tekstin e Kuvendit të Arbënit, këtë pjesore e gjejmë të përdorur me po ato funksione që janë karakteristike për gjuhët indoevropiane rrjedhimisht dhe për latinishten. Kështu, ajo përdoret në fjali të nërenditura kryefjalore, kundrinore, qëllimore, kushtore etj. Gjithashtu e gjejmë të përdorur me foljet modale *duhet* dhe *mund*, ashtu si në latinishte dhe në gjuhët neolatine.<sup>284</sup> Formën e pashtjelluar të tipi *me ba(m)* e gjejmë të ndërftuar në ndërtimin e formave analitike të së ardhmes të tipit *kam me ba* dhe *kisha me ba*.<sup>285</sup>

Në gjuhën latine paskajoren e gjejmë të përdorur:

- 1) në funksion emëror (pasakjorja e emëruar ose e e thjeshtë)
- 2) në funksion foljor, si në fjali kryesore ashtu dhe në fjali të nërenditura (fjali me paskajore)

Në tekstin tonë kemi gjetur paskajoren e mirëfilltë, të përcaktuar kështu falë përdorimit të saj në funksion emëror, pra e gjejmë të përdorur si kryefjalë,

---

<sup>281</sup> Paskajorja e futurit *laudaturum, am, um esse/ laudatum iri: infiniti perfekt laudavisse/ laudatum, am, um esse*

<sup>282</sup> Për më shumë mbi formimin dhe origjinën e kësaj forme shih Demiraj, Gramatikë, vep. cit. f. 954

<sup>283</sup> Për më shumë shih Demiraj, vep.cit. f. 955 e tutje

<sup>284</sup> Buzuku (f. 103)... *ti mundën me më dëlirunë në do ..Budi (f. SC 17) ..ashtu qi mirë, të munë t'I ndëgjonj e të mundënj me të bam ndonjë ndimë. Mundenë me u vum këtu ende shumë të tjerë ...*

Bogdani, pj.I, I/III/27)

<sup>285</sup> Për këto forma është folur në pjesën e studimit mbi kohën e ardhme.

kundrinor. Nga ana tjetër kjo paskajore ka dhe veçoritë e saj foljore, pasi mund të ndiqet nga një kundrinor i drejtë ose nga një fjali e nënrenditur. Të verëhen përdorimet e paskajores latine në funksione të ndryshme, të dhëna në shqipen e Kuvendit me po ato funksione falë përdorimit të drejtë dhe vlerave të mëdha që ka paskajorja e tipit *me ba(m)*,<sup>286</sup> sidomos kur kemi të bëjmë me përkthim nga gjuhë indoevropiane.

1. Të shumtë janë rastet në funksion predikativ, veçanërisht nëse kryefjala jepet me anë të një paskajoreje tjetër.

*Deo igitur soli, cui servire, regnare est, per externam, et publicam Fidei confessionem sit devotus fidelis* (f. 21)

Vece **H8it** pràa, “cui me scerbyem, asct **me sotenuem**.” te truhet, e te fallet i Feescimi, e mballafacchie te cui dò te refegn acchie saa as gni scegn te keete (f. 8)

*Missionarum munus est docere, praedicare, et baptizare.* (f. 78)

*Detyra e essap i Missionarevet asct me mpsuem, me predicuem e m e pagheuem.* (f. 7)

*cum impossibile sit, Deo, et Baali famulatum prestare, in Christi fidelibus nihil non sanctum* (f. 21)

përse s'mund jete **me scerbyem** Hyit, e Baalit, ndò Drecchit ; s'duhet me duruem nder te feescimit te Criscitit ndogni scegn (f. 8)

3. Paskajoren latine dhe atë shqipe e kemi gjetur të përdorur në funksion qëllimor:

*ita Episcoporum munus erit, eidem prospicere, tam per animadversionem ...* (f. 34)

*ksctù bie per lig Upesckupignevet me sciuchiuem kessaj pun, kem tue calæuem me et bute Turchiet si a puna* (f. 24)

4. në funksion kundrinor, e përdorur me shumë folje që marrin funksion ndihmës, përfshirë dhe foljet ndihmëse apo *verba servilia* për të cilat është folur dhe që bashkë me paskajoren përbëjnë kallëzuesine fajlisë. Përdoret me foljet që

---

<sup>286</sup> Të verëhen përdorimet e ngjashme te Buzuku, 297, Luka 14/3: *A anshtë me ligj me shëndoshunë të shëtundenë? “Si licet sabbato curare?”* Budi (DC 8)... *dëhsëronjënë dërejt ndë faqet me e shkuom.* Bardhi (nga parathënia e fjalorit) ...*s'dijnë ç'udhë me marrë...* Buzuku (387) ..*dështa me u fëdigunë, për sa mujta, me zditunë pak mendetë e atyne qi ta ndiglognënë:*



tregojnë mundësi të kryerjes së veprimit, si **possum**, mund, **nequeo**, nuk mund ; zakonin e kryerjes së një veprimi **soleo**, kam zakon të... dëshirën apo vullnetin e kryerjes së veprimit si **volo** dua, **cupio** dëshiroj ; domosdoshmërinë e kryerjes së një veprimi etj .

*quae vetustate collapsa, et ruinis obruta nequeunt prae timore aedificari*

(f. 22)

*scretetia, tue u ruzuem, e tue u reenuem kisciat, smunden meu ndrizzuem, e meu vum mbe cambe nde per frighe te Turchiise* (f. 11)

*as faii duhet me kiene* (f. 9)

*nulla debet esse macula criminis* (f. 19)

*Si quis enim domui suae praeesse nescit, quomodo Ecclesiae Dei diligentiam habebit ?* (f. 53)

*Prò nde mos di cusc me sunduem sctepiin e vete, si pràa kaa me diitune me mbaitune kiscene e H it* (f. 47)

*ad oc ut liberetur a foetore, possit ficte baptizari* (f. 34)

*A mundet meu pagheuem Famuli i turchiet vece per pune chi mos ..*  
(f. 25)

*an prius fuerit baptizatus, qui sacro fonte cupit initiari...* (f. 31)

*te schiuretognene parrochit a asct pagheuem aj, chi do me u pagheuem*  
(f. 22)

Sipas Demirajt<sup>287</sup> i ngjashëm me funksionin kundrinor është dhe përdorimi i paskajores në ndërtime të tipit kallëzore + paskajore<sup>288</sup>. Këtë ndërtim, për të cilin do të flasim në vijim e gjejmë në gjuhën latine dhe njihet me emrin *accusativus cum infinito*.

Pak më lart thamë se infiniti i latinishtes nuk përdorej vetëm në funksion të emrit, por dhe në funksion foljor, në fjali të nënrenditura, të cilat njihen *si fjali të ndërtuara me paskajore*. Realisht, kemi të bëjmë me fjali të nënrenditura filluese të cilat në përbërje kanë një folje në formën e pashtjelluar të paskajores,

---

<sup>287</sup> Vep e cituar, f. 959 shënimi 66.

<sup>288</sup> Demiraj vijon më poshtë me një shembull nga Buzuku në shqipe dhe në latinishte.

*Ai më tha: përmbi kë të shofsh shpirtinë me u djergunë e me pushuom përmbi të, aj anshtë aj qi të pagëzonjë.... »...ille mihi dixit : Super quem videris spiritum descendentem et manentem super eum, hic est qui baptizat .. (Buzuku, 99, Gjoni, I/33).*

pra në infinitiv dhe një kryefjalë të vendosur në rasën kallëzore. Lidhëzat *se* dhe *quæ* nuk shfaqen në këtë ndërtim, por nënkuptohen. Formohet kështu ndërtimi më i rëndësishëm sintaksor i latinishtes, ***accusativus cum infinito***.

Të shohim shembullin e mëposhtëm për t' u njohur më nga afër me këtë Ndërtim, dhe se si vjen në gjuhën shqipe të Kuvendit.

***Credo te aliquid audisse.*** (Cicero)

*Besoj se ti ke dëgjuar diçka.*

***Te aliquid audisse*** është fjalia e nënrenditur kundrinore me paskajore. Në të cilën kryefjala është vendosur në kallëzore dhe folja në paskajore. (e tërë fjalia është kundrinor i foljes ***credo***).

*Funksionet sintaksore të fjalive me paskajore.*

Në gjuhën latine përveç paskajores së thjeshtë, si kryefjalë dhe si kundrinor, për përdorimin e të cilës u fol më lart, mund të jetë dhe një fjali e tërë. Këto fjali quhen përkatësisht kryefjalore dhe kundrinore dhe të dyja këto fjali jepen me anë të konstruktin ***accusativus cum infinito***.

• ***Fjalitë kryefjalore.*** Këto fjali përdoren:

1. me folje pavetore, ose folje që përdoren në mënyrë pavetore si *decet-* (i) shkon, *licet* – lejohet, *oportet* – duhet, *traditum est* – tregohet, *constat* – njihet etj. Në tekstin tonë nuk kemi gjetur asnjë fjali të ndërtuar me folje të tilla, kështu që po japim shembuj të marrë nga autorë të ndryshëm latinë.

***Legem brevem esse oportet*** (Sen, Ep. 94,38)

*Duhet që ligji të jetë i shkurtër*

2) Pas shprehjeve të formuara nga një emër, mbiemër, përemër asnjans dhe folja sum. Si psh: ***bonum est, bene est*** – është mirë; ***iustum est*** – është e drejtë, ***fama est*** – është e njohur. Në tekstin tonë kemi hasur një fjali të tillë. Të shihet se si ka ardhur në shqipe ndërtimi i kallëzores me paskajoren në fjali kryefjalore.

***praecipuus visitationis scopus est, sanam, orthodoxamque doctrinam inducere, bonos mores tueri, pravos corrigere...*** (f. 54)

*passechijra e visitimit maa mpos asct: me forzuem dijene cattolike scendosc, meu mbaitune vesse te mire, me ndiscuem te kecchiite ..*

(f. 49)

Shumë fjalë dhe shprehje të cilat u përmendën më lart mund të ndiqen nga :

- nga paskajorja në funksion emëror, për të cilën është folur
- nga fjali ffilluese në mënyrën dëftore ose në mënyrën lidhore, të prira nga lidhëza *quod*, për të cilën do të flitet veçmas.
- nga fjali ffilluese në lidhore të prira nga lidhëza *ut*

• **Fjali kundrinore.** Këto fjali përdoren me:

a) pas foljeve *dicendi* apo *declarandi*, të cilat sjellin një gjykim, deklaram si: *dico, aio, nego, respondeo, declaro, suadeo, pesuadeo, promitto, affirmo* etj.

*Indulgentiarum potestatem, a Christo in Ecclesia relictam fuisse, illarumque usum christiano populo maxime salutare esse affirmo.* (f. 17)  
*As mohogn se puscteteja me çane ndeijessete asct lane Kiscese prej Criscitit, e vertetogn, se ndime te maçe bagnene Populit te kerscten per scelbim te Scpirtit.* (f. 4)

Në këtë shembull vërejmë se folja në paskjore *relictam fuisse* është vënë në perfekt pasiv, i vetmi rast që kemi gjetur. Emri *potestatem* që në tekstin latin është vënë në kallëzore, në shqipe na është dhënë me emërore.

*Dicunt namque septem tantum annis quadragesimali ieunio adstrictos esse, tali deinceps ieiunandi lege solutos* (f. 27)  
*Tue ççane se vece sctat pare kerescma, chi t'agninohen per sctat viet jane detuer, e màa iò* (f. 17)

Më poshtë po japim një paragraf disi të gjatë, tipik të natyrës së latinishtes, tek i cili vërehen disa ndërtime të akuzativit me kallëzoren, të gjitha të drejtuara nga folja *profiteor* – deklaroj, pohoj.

*Profiteor quoque septem esse vere, et proprie Sacramenta novae legis, a Iesu Christo Domino nostro instituta, atque ad salutem humani generis, licet non omnia singulis necessaria, scilicet Baptismum, Confirmationem, Eucharistiam, poenitentiam, extremam unctionem, ordinem et Matrimonium; illaque gratiam*

*conferre; et ex his **Baptismum, confirmationem et Ordinem** sine sacrilegio reiterari non posse.* (f. 16)

*Ende refegn, e bessogn se gniment jane veçe sctat **te verteta** Scecramenta te ligiese **urçenue**, e çane prej Christit Σotit tine per scelbim te nierezet; ende se nuk jane giçç cui per nevoje te sctatta: sicuur me ççane: **Paghezimi, Cresmimi, Eucaristie, Rrefimi, Voimi scind, Urçeni i priftinet, e Martessa: te zijat appene** hiirine e hyit atyne ci i marrene paa mcat mbe scpirt. E t' adiihi<sup>289</sup>, se **Paghezimi, Cresmimi, e Urçeni**, nuk ep ligia me i marre dy here, paa raam nde mcat te maçe, ci ççohet sacrilegi (f. 3)*

***Fateor** etiam sub altera tantum specie, totum, atque integrum Christum, verumque Sacramentum **sumi*** (f. 17)

*Refegn, e bessogn ende, se ndene ci dò facchie te Bukese mpos, dò te Venese mpos, giçç ungnii Krisct i vertet, e plot Scecramenti merret.* (f. 3)

*b) pas foljeve sentiendi<sup>290</sup>, të cilat shprehin ndjesi dhe janë foljet si audio, video, aspicio, sentio (dëgjoj, shoh, vërej, ndiej): arbitror, puto, censeo, duco, cognosco, credo, teneo, scio (mendoj, gjykoj, konsideroj, njoh, besoj); recordor, memini (kujtoj) etj.*

*Constanter teneo **Purgatorium** esse, animasque ibi detentas fidelium suffragiis **iuvare*** (f. 17)

*Me giçç εembre bessogn se **asct purgatori**: E Scpirtinat chi jane nd'atà kane proçe<sup>291</sup> prej urattesc, e veperasc semira, chi per ata bagnene te Kersctenete (f. 4)*

*et veraciter teneo, eandem integram, et inviolatam usque ad extremum vitae spiritum, Deo iuvante, **retinere et confiteri**, atque a meis subditis.* (f. 18)  
*e me te vertete mbà, due ndier nde e dall te Scpirtit tim ugnii, e paa ngand me mbaitune e me luftuem, ci kesctu ta mbane giçç atà... (f. 4)*

*Quod si secus fecerint Episcopi, sciant, se **non consulere Populis, sed nocere, nec praestare** regimen, sed augere discrimen* (f. 45)

---

<sup>289</sup> T'diihet

<sup>290</sup> Foljet dicendi dhe sentiendi kur përdoren në formën pësore kërkojnë pas vetes ndërtimin e nominativit me paskajoren, për të cilin do të flitet më poshtë.

<sup>291</sup> Dobij

*Nde mos bascin ascitū Upesckupignete; te diine se nuk duene me ndimuem e me baam mire Populit, vece pò i bagnene kech, e as caleoognene creeniine, vece pò duene me pesctiele maa kech punene* (f. 37)

Në gjuhën latine foljet e ndijimit: *video, aspicio, audio, invenio* etj... kërkojnë si kundrinor *kallëzoren + paskajoren*, nëse tregojnë gjendje të një fakti që ndjek veprimin. Psh:

*Audio te mihi maledicere.*

*Dëgjoj (të thuhet) se flet keq për mua.*

Po këto folje në qoftë se vënë në dukje veprimin në aktin e zhvillimit të tij, atëherë kemi *participin e tashëm* në vend të *paskajores*. Kështu, e njëjta fjali duke vënë në dukje aktin e kryerjes së veprimit, ndërtohet me *participin e tashëm*. Konkretisht kemi :

*Audio te maledicentem mihi.*

*Të dëgjoj që po flet keq për mua.*

Në këtë rast ndërtimi i ndërtuar me *participin* në tekstin shqip e gjejmë të përkthyer me përcjellore ose me një fjali të nënrenditur përcaktore., siç vërehet në shembujt e mëposhtëm.

*Vidi senes ululantes, sacerdotes ministros Domini lugentes.* (f. 7)

*Pae plecchiete tue ulleruem Mescetarete scerbetoret e Hyit tue gimuem.*  
(f. 6)

*quod si speculator viderit gladium venientem et non intonuerit buccina, et populus se non custodierit* (f. 24)

*nde paat Capetaani scpaten, chi po vien, e mos te bii Boriis, e Populi mos u rueiiti vete vetehen.* (f. 13)

c) Foljet që shprehin vendim *statuo, decerno*, nëse ndiqen zakonisht nga *paskajorja* e thjeshtë (pa *kallëzore*) nëse kryefjala e fjalisë së varur është e njëjtë me kryesore. Nëse dy fjalitë kanë kryefjalë të ndryshme përdoren me *ut* (ose *ne*) me lidhore. Dhe e fundit, nëse kryefjala është e ndryshme nga e ajo e kryesores kemi *gerundivin* dhe *paskajoren* nëse kësaj të fundit duam t'i japim idenë e domosdoshmërisë. Ja disa shembuj me ndërtimin *gerundiv + paskajore*, të cilat në shqipen e Kuvendit janë dhënë me anë të foljeve kam dhe

jam, të përdorura me vlerë modale, të ndjekura nga forma e pashtjelluar e tipit për të bërë.

*Firmissime assero **imagines** Christi, ac Deiparae semper virginis, nec non aliorum Sanctorum **habendas, et retinendas esse, atque eis debitum honorem, ac venerationem impertiendam.*** (f. 17)

*Ende ççom, se **Figurat** e Criscitit, Σognese Beecueme, e te tierevet Scendet **jane per t'u passunë e per t'u mbaitune: me i nderune, e me i açoruem, sicundrese i perket.*** (f. 4)

*...similiter et Sanctos una cum Christo regnantes, **venerandos, atque invocandos esse, eosque orationes Deo pro nobis offerre, atque eorum Reliquias esse venerandas*** (f. 17)

*...Asctù ende jane per t'u beganissune, e per t' u ççirre per ndime Scentenite, chi reginoine mbasck me kriscne, e atà lusene Tenezone per nee; e na duhet me nderune reliquiat e tyneve.* (f. 3)

*d) pas foljeve affectuum: gaudeo, laetor – gëzohem; miror, admiror – habitem; doleo, queror, fleo – më dhimbset, ankohem...*

***Quia vero in mala tempora incidimus, Sanctissimam Eucharistiam digno honore, publica, et cauta veneratione in Parrochialibus Ecclesiis conservari non posse dolemus*** (f. 40)

*Pò persè jemi raam nde kohe te kecchie, na çimbet, se e Scendenuescimeja Eucaristia **smund ruhet** nde Kiscia te Parochiavet..* (f. 32)

*Verba dicendi* si „them, rrëfej, mendoj, të përdorur në formën pësore (*dicor, putor, habeor, existimor* ) kërkojnë ndërtimin tjetër, atë të *nominativit me paskajoren.*

Në gjuhën latine kemi të bëjmë me *nominativus cum infinitivo* kur përcaktori kallëzuesor i kryefjalës së një foljeje këpujore është një paskajore, jo thjesht një emër ose mbiemër. Ashtu si *accusativus cum infinito*, dhe ky ndërtim vjen me një fjali të nënrenditur fthilluese. Këtë ndërtim mund ta gjemë me *verba appellandi* (appelor, nominor), *verba existimandi* (habeor, existimor), *verba dicendi* (dicor, narror, feror etj ), gjë që u tha pak më lart. Psh:

***Dicitur** profecturus esse.*

*Thuhet se ti do të nisesh.*

Përcaktori kallëzuesor i këtyre foljeve mund të jetë :

a) paskajorja e foljes **sum** e ndjekur nga një përcaktor *kallëzuesor në rasën emërore*. Folja më e përdorur me këtë ndërtim është folja *videor* si folje këpujore me kuptimin « dukem », e cila mund të ndiqet nga folja *esse* ose dhe nga folje të tjera, si në fjalitë e mëposhtme.

*Mihi videtur esse honestus.*  
*Mua më duket se është i ndershëm.*

b) paskajorja e foljeve të cilido lloji qofshin. Psh :

*Mihi videtur dixisse satis.*  
*Më duket se kam thënë shumë.*

Në tekstin tonë nuk kemi gjetur shumë raste të ndërtimit të emërores me paskajoren. Një rast i vetëm është ky i mëposhtmi, në të cilën vërejmë se autori ka bërë përkthim të lirë duke mos na dhënë as dhe ndërtimin e foljes *videor* me paskajoren e foljes *esse*.

*saepius tamen orta inter eos contentione, quis eorum in aeconomica administratione videatur esse maior* (f. 75)  
*scium here prò nder tà asct dalle sciamate, tue u marre per tesiλn di màa fort me mbaitune sctepiine* (f. 73)

*Domine, salva nos perimus, ut, qui nostris iniquitatibus offensus, hactenus in puppi dormitasse videtur, exurgat tandem in auditorium nostrum ..... (f. 84)*  
*Kinese aj, chi kiè fiðem prej mcatesc sonasc, chi tascti duket se flee mbe bisct te barkese te nfrihet sevoni me na ndimuem* (f. 84)

### III. 6 Lidhëzat dhe funksionet e tyre në fjali.

Në gjuhën latine lidhëzat (*coniunctiones*) si pjesë e pandryshueshme e ligjëratës luajnë rol të rëndësishëm në fjalinë latine. Ato lidhin dy fjali ose dy njësi të së njëjtës fjali. Si pjesë e pandryshueshme e ligjëratës në latinishte ndonjë herë është e vështirë të pëtrcaktosh vendin e një moneme me formë të njëjtë, për faktin se e njëjta monemë, sipas kontekstit gramatikor ku përdoret, mund të kryejë funksione të ndryshme. Nëse vërejmë dy fjalitë e mëposhtme mund të bëjmë dallimin.

*Hoc post dicam.*                      *Këtë gjë do ta them më pas.*

*Post reditum patris hoc dicam. Këtë gjë do ta them pas kthimit të babait.*

Në fjalinë e parë *post* është ndajfolje, ndërsa në fjalinë e dytë është parafjalë. Shpesh ëshët e pamundur të inkuadrosh një formë brenda skemave të ngurta, pasi ato shkrihen e përshtaten në varësi të kërkesave të gjuhës. Kështu ne disa gramatika *etiam* njihet si ndajfolje e në disa të tjera si lidhëz.

Në gjuhën latine lidhëzat sipas funksionit sintaksor ndahen në lidhëza *bashkërenditëse* dhe në *nënrenditëse*.

**Lidhëzat bashkërenditëse** lidhin dy gjymtyrë të një fjalie ose dy fjali të një lloji (të dyja të pavarura ose të varura). Në tekstin shqip lidhëzave bashkërenditëse të latinishtes në shumicën e rasteve i përgjigjen lidhëza bashkërenditëse. Të vërehen shembujt e mëposhtëm.

*Ego idem N. Spondeo, voveo ac iuro. Sic me Deus adiuvet, et aec Sancta Dei Evangelia* (f. 18)

*Une vet N. permettoqn, e bagn bee : asctù me ndimoft, e ketà ungiil te Scend te Tineεot* (f. 5)

**Non** in comessionibus, **et** ebrietatibus, quibus nomen Domini profanatur, **sed** in oratinibus, hymnis ... (f. 24)

*Iò nde gostii, e mbe te dejunit, me te sijat cafschia ççelighiet<sup>292</sup> Emeni i Tineεot* (f. 13)

*Quicumque in manu potenti, vel Turcarum brachio excelso suffultus in Parochiam se intruserit, aut ab ordinario suspensus, vel alia Ecclesiastica innodatus censura* (f. 73)

*Giçç i silli, chi forzohet me dore te fortevet, ndo me pusctette te turchiet meu mbaitune cund Parocchianit: ndo me kiene suspenduem prej Upesckupit, o Ordinarit, ndo me kiene liçune me te tiera censura te Kiscece* (f. 70)

**Non solum** corde creditur ad iustitiam, **sed** ore **etiam** confessio fit ad salutem (f. 18)

*Nuk mbaston vece me εembre me bessuem te dereitene, pò ende refimi i gojese per te scelbuemit* (f. 5)

**Lidhëzat nënrenditëse.** Këto lidhëza si në gjuhën shqipe dhe në atë latine shprehin raporte varësie dhe përdoren në krye të fjalive të nënrenditura duke i

---

<sup>292</sup> Feligiet



lidhur me ato kryesore. Ne mendojmë të përqëndrohenmi më shumë te këto lidhëza, pasi funksioni i tyre është i lidhur ngushtë me sintaksën e periudhave. Më poshtë do të vërejmë konkretisht lidhëzat më të rëndësishme të fjalisë latine dhe rolin e tyre në fjalitë e nënrenditura, në krye të të cilave qëndrojnë.

### III. 6.1 Llojet e fjalive të nënrenditura

Në sintaksën latine shumica e lidhëzave nënrenditëse ndiqet nga folje në mënyrën lidhore, mënyrë kjo që ka zgjeruar fushën e saj të përdorimit, veçanërisht në fjalitë e nënrenditura. Kështu fjalitë e nënrenditura ndahen në :

- 1) fjali ftilluese të shoqëruarara kryesisht me lidhëzën **quod** ose **quia**.  
Lidhëza të tjera janë *ut, ne, quin, quominus + folje në lidhore*.
- 2) fjali lidhore;
- 3) fjali rrethore ; në këtë grup bëjnë pjesë fjalitë *qëllimore, rrjedhimore, shkakore, lejore, kohore, kushtore* dhe *krahasore*.

#### 1) *Fjalitë e nënrenditura ftilluese.*

Këto fjali prihen nga lidhëza *quod*, (burimi i të cilës shihet te emërorja dhe kallëzorja e përemrit lidhor) dhe shoqërohen nga lidhorja. Në tekstin e Kuvendit vijnë me fjali që fillojnë me shprehjet *per sa i përket, për faktin që ...etj.* Kjo lidhëz kur përdoret sidomos në fillim të fjalisë përbën një strukturë mjaft të njohur e të përdorur. Këto lloj fjalish ndërtohen dhe me lidhëzën polifunksionale *ut + lidhore*, gjë që vërehet në shembullin e dytë.

*quod tamen attinet ad conferendum baptismi Sacramentum Turcarum filiis, miramur sanae rei novitate percussi* (f. 33)  
*per sàa perket me pagheuem te biite e Turchiet, fort pò mreculohe mi prej pune se ree* (f. 24)

*Baptismi Sacramento Confirmatio succedit, eo rerum ordine copulata, ut, cum Baptismate regeneremur ad vitam...* (f. 35)  
*Ndaj Sci sacramentit e Pagheimit vee kremimi, ksctù riesctitune mbasck, chi me pagheimi leegnme per sedyiti mbe jet t' amesciune..* (f. 25)

*illud tamen maiore cordis dolore deplorandum est, quod nonnulli parochi, non timore perciti...*(f. 40)  
*prò maa fort asct per tu chiaam me giak te embrese, se dissa Parocchiani pa grasciune cund, vece per prittesse.* (f. 32)

## 2) Fjalitë e nërenditura përcaktore.

Në latinishte këto lloj fjalish kanë natyrën e mbiemrit (atributive) dhe kryejnë të njëjtin funksion që kryen dhe një mbiemër përcaktues, që është përcaktimi i një elementi të fjalisë duke në dhënë informacion të ri mbi të.<sup>293</sup>

Fjalitë përcaktore në latinishte prihen nga :

- përemri lidhor *qui, quae, quod*

- nga ndajfolje mënyre ose vendi.

Fjalitë me përemra lidhorë kryesisht ndërtohen me dëftore, por mund të ndërtohen dhe me lidhore. Në tekstin shqip këto fjali janë dhënë me përemrat lidhorë *që, i cili* të cilët në shqipen e atëhershme i gjejmë përkatësisht në këto forma *chi, i sili*. me folje në dëftore.

a) Fjali përcaktore të paraprirra nga përemri *qui, quae, quod*.

*Hanc veram Catholicam Fidem, extra quam nemo salvus esse potest, **quam** in presenti sponte profiteor* (f. 17)

*Kete Fee Kattolike, paa te sillene as kusc mund te scelbohet, **chi** une tascti vet pereuna* (f. 4)

*Hinc a veritate, et religione aberrant, qui vel metu poenae.....denegant etiam, quae sunt Dei* (f. 18)

*Kendyi nuk jane mb'uçe se vertetese Religionit e urçenimite Crisctit atà, **chi** ndò., mbohognene ende cafsciat e Hyit* (f. 5)

*...instituti sunt pie, ac religiose transigendi, non in comessionibus, et ebrietaibus, quibus nomen Domini profanatur* (f. 24)

*devotscim, e kersctenisct jane per te mbaitune ; iò nde gostii, e mbe te dejunit, me **te sijat** cafscia ççelighiet<sup>294</sup> Emeni i Tineeot* (f. 13)

*Matrimonii Sacramentum magnum est, ex perpetuo, et indissolubili sacrae confederationis vinculo, **quo** duo carne una copulatur* (f. 45)

*Sciacramenti i Martessese asct i maçi prej neut se paa eghiçscimi te sciocchiniisse scind, **me tesiλ** dygyveti banen gni nde gni misc* (f. 38)

b) Fjalitë përcaktore të paraprirra nga ndajfolja e vendit *ubi*.

---

<sup>293</sup> *Syntaxe latine*, vep. cit. f. 332 e tutje.

<sup>294</sup> *Feligiet*

At **ubi** abundant nostra calamitas, ibi superabundat et charitas Sacrae Congregationis de propaganda fide... ..(f. 44)

Por tû ku asct maa nevoja jona, aty maa fort asct tedasciunit e Cunvendit Scind te propagandese... ..(f. 37)

At **ubi** Turcarum vis praevallet, et iniquitas, ne divinitatis sacrarium nequissima, quod absit...(f. 41)

Pò cù silla, e forza e Turchiet asct e paa uçe, mos te felighiet, vendi scendenuescimi... ( f. 33)

### 3) Fjalitë e nënrenditura shkakore.

Këto fjali përcaktojnë dhe shpjegojnë shkakun e asaj për të cilën flitet në fjalinë kryesore. Në latinishte dhe tekstin tonë latin janë paraprirë nga lidhëzat: *quod, quia, quoniam, cum*. Nga këto lidhëza vetëm *cum* përdoret me folje në mënyrën lidhore, ndërsa të tjerat me dëftore ose me lidhore.

Më poshtë po japim shembuj me fjali të nënrenditura shkakore, të parapirira nga lidhëzat e mësipërme.

a) Fjalitë shkakore me lidhëzën *cum*. Kjo lidhëz polifunksionale njeh dhe përdorimin shkakor në krye të fjalive shkakore. Në shqipen e Kuvendit fjalitë me *cum*-in shkakor janë përkthyer herë me fjali të nënrenditur shkakore të prirë nga lidhëza *persè* të ndjekur nga folja në dëftore, ndryshe nga latinishtja të e cila folja vendoset në lidhore. e herë të prirë nga një përcjellore.

**cum** impossibile sit, Deo, et Baali famulatum prestare, in Christi fidelibus nihil non sanctum, ac religiosum... (f. 21)

**persè** smund jete me scerbyem Hyit, e Baalit, ndò Drecchit; s' duhet me duruem nder te Feescimit te Criscitit ndogni scegn (f. 8)

**Cum** nihil magis officiat animarum saluti, quam ab illis gubernari, qui seipsos regere non possunt...(f. 73)

**Persè** as dogn puna nuk maa kecchie, se meu guvernuem prej assisc, chi smund guvernognene vetveteh (f. 70)

Në shumicën e rasteve fjalitë shkakore me lidhëzën *cum*, na janë dhënë me formën e pashtjelluar të përcjellores, me nuancë shkakore.

**Cum** gravissima in hominum perniciem ortum traxerint mala, pericula, ac scandala ex clandestinis Matrimoniis (f. 45)

*Tue pass rjeçune prej martesset se clandestinevet scium te kecchija perricuii, e sckanduii, me damm te Niereeet ( f. 38)*

*Cum praeceptum Domini sit, ne fideles festis diebus laborent, operibus vacent mechanicis.... (f. 66)*

*tue kiene urçenimi i Tineeot, chi mos te punognene te Feescimit mbe dit te Festevet mos te hignene ... (f. 62)*

*Cum autem aequum sit, ut in Matris gremio Filii Patris, qui in Caelis est, per lavacrum regenerationis effisciantur... (f. 30)*

*Pò tue kiene me giychi, kinese mbe preheni t' Amese, e zija asct Kiscia... (f. 21)*

*Cum Fides Catholica, quae in Sancta Romana Ecclesia,...sit iuxta Chrysostomum lumen animae (f. 15)*

*Tue kiene Feeja Katolike, ezija nde kisce scende te Romese...Ksct "Asct dritta e Scpirtit. (f. 1)*

**b)** Fjali shkakore me lidhëzën *quia*. Quia bashkë me quoniam është një nga lidhëzat më të përdorura në krye të një fjalie të nënrenditur shkakore. Në shqipen e Kuvendit na është dhënë po me lidhëzën *perse*.

*Quia vero summa rerum divinarum ignorantia confitendi modum, et exminandae conscientiae rudi populo denegat... (f. 37)*

*Po persè prej se paaditunit se cafsciavet Hyinuescime smund keet I Catundassi arresye me sciosciune Scpirtin ndò conscienzen e vete..... (f. 28)*

*Quia vero in mala tempora incidimus Sanctissimam Eucharistiam digno honore, publica, et cauta veneratione in Parrochialibus Ecclesiis conservari non posse dolemus (f. 40)*

*Pò persè jemi raam nde kohe te kecchie, na çimbet, se e Scendenuescimeja Eucaristia smund ruhet nde Kiscia te Parochiavet.. (f. 32)*

*Quia vero iuxta Apostolum, non modo talia facientibus, sed etiam consentientibus, par poena debetur (f. 49)*

*E persè sicuur ççot Scen Pali, iò vece atyne, chi ndigiognene, e cutenden i biè detyra (f. 42)*

*Quia vero qualibet victimarum oblatione melior est acceptabile deo Sacrificium obedientia... (f. 79)*

*Pò per saa Sacrifitie truhen Hyit maa fort i pelchien Sciacrfiti i obedintese (f. 77)*

c) Fjali shkakore me lidhëzën *quoniam*. Këto fjali ndërtohen me lidhëzën *quoniam* e cila kërkon kryesisht dëftoren. Në tekstin shqip na janë dhënë po me lidhëzën *përse* të shoqëruar nga folja në dëftore.

*Quoniam vero in messi multa, Operarii pauci nequeunt in omni spirituali exultatione, et abundantia metere ...* (f. 25)

*E persè nd'are te maçe Corresit pak smund cuotene me giçç gazimend te scpirtit, e me berechiet ...* (f. 14)

*Quoniam vero ingravescente Turcarum impietate invaluit, proh dolor! abominatio desolationis in loco sancto ....nequeunt prae timore aedificari* (f. 22)

*E persè urandue e paa misceriereja e Turchiet (uh eembre plasme) hippi nde kete çee Kisciavet Tineëot, e visseve te beecueme...smunden meu ndrizzuem<sup>295</sup>....*(f. 11)

*Quoniam vero peccata post Baptismum commissa poenitentia expiantur, quae admodum omnes huius Sacramenti...* (f. 37)

*Pò persè mcatete baam mbas Pagheçimit lahen me Sciacrament t' e pendessese e sicuur kemi ...*(f. 28)

*Quoniam vero ad Sacerdotalis castra sanctitatis, ne dum per scientiae viam, sed per semitam quoque pietatis gradiendum est* (f. 44)

*Persè nd' uscterije te Priftiise scind, iò vece per scteku te dijese, pò endè per urome te scendeniise e et miscerierese duhet me ezzune* (f. 37)

d) Fjali shkakore me lidhëzën *quod*. Në tekstin shqip të Kuvendit na është dhënë përsëri me lidhëzën *persè* e ndjekur nga folje në dëftore.

*...ut Turcae, vel Schismatici, patrini fungantur munere, quod ad solos Fideles,....canonica pertinet ordinatione* (f. 36)

*As jane per te laane Turit, ndò Schismaticichi me mbaitune cand; persè vece Te kersctenevet, chi jane Cattolich i biè per lig* (f. 26)

e) Fjali shkakore me lidhëzën *ut*. Dhe pse lidhëza *ut* përdoret rrallë në fjali shkakore, në tekstin tonë e kemi gjetur një rast të tillë. Në tekstin shqip, kur kjo lidhëz ka funksion shkakor, na është dhënë me përcjellore.

---

<sup>295</sup> Godiit

*Ut autem de singulis agamus, omnium primus occurrit, sacramentorum ianua Baptismus.* (f. 30)

*Tue passune per te folle per giçç sciecramenta kaa gnia, maa pare na bie per dore Pagheëimi, i silli asct dera e tetieravet.* (f. 20)

#### 4) *Fjalitë e nënrenditura qëllimore.*

Këto fjali shprehin qëllimin e veprimit të shprehur në fjalinë kryesore. Zakonisht prihen nga lidhëza polifunkionale **ut** dhe **quo** (kur kemi krahasim) në fjali pohore, dhe **ne** ose **ut ne** nëse janë fjali mohore. Fjalitë qëllimore ndërtohen gjithnjë me lidhore.

Në tekstin shqip, siç do të shihet nga shembujt, fjalitë qëllimore janë dhënë po me fjali qëllimore në krye të të cilave qëndron lidhëza *kinese* ose pa lidhëz fare, por e nënkuptuar dhe gjithmonë kallëzuesi në mënyrën lidhore.

*Attendat Pastores, ut haec formula immutabili servetur ..* (f. 30)

*Te keene Parrochit mende mos te nderrohet forma...* (f. 20)

*Ut autem vocationis nostrae per Baptismi lavacrum non deleatur* (f. 33)

*Kinese per Pagheëimi mos te n'adal mendiet..* (f. 23)

*Ut autem omnia iuxta piam mentem peragantur* (f. 55)

*Kinese giçç puna te mbarohen secundrese mendeja..* (f. 59)

*Ut autem in posterum Pastores animarum cautius agant, cum impossibile sit, Deo, et Baali famulatum prestare, in Christi fidelibus nihil non sanctum, ac religiosum...* (f. 21)

*Kinese mbasndaj Ciobanete e scpirtinavet te veperognene màa me mende, e me urtii; persè smund jete me scerbyem Hyit, e Baalit, ndò Drecchit; s' duhet me duruem nder te Feescimit te Crisctit ndogni scegn* (f. 8)

*Et ut adamussim Ecclesiastica ieiuniorum veneretur observantia, nihilque Romanae dissonum consuetudini reperitur ...* (f. 27)

*E kinese eaman te jete beganissune eaconi i agnimevet, mos te jete giàa cundra lighiese Romese...* (f. 16)

Ndërsa fjalia e nënrenditur qëllimore mohore jepet me *ne*. Në tekstin shqip jepet po me fjali të nënrenditur qëllimore në krye të së cilës është lidhëza *kinese* e ndjekur nga pjesëza mohuese *mos + folje në lidhore*.

*Et ne in posterum sacrilega reiteratione, hoc sacramentum **administretur***  
(f. 31)

*E kinese mbasndaj **mos te pagheεognene te d itene here*** (f. 22)

*Ne autem pueri, et puellae hoc pretiosissimo divinitatis thesauro diutius **priventur...*** (f. 40)

*E **mos te jessene** Dielte ndò vascieat, paa u cunquem e paa u refyem per scium mot... (f. 32)*

### **5) Fjalitë e nënrenditura kohore.**

Janë ato fjali rrethanore të cialt saktësojnë kohën kur ndodh veprimi I përshkruar në fjalinë kryesore. Në krye të këtyre qëndrojnë lidhëzat: *cum, dum, ubi, antequam, priusquam, postquam, ut, ut primum, ubi*, që kërkojnë herë lidhoren e herë dëftoren.

a) Lidhëza polifunksionale *cum* njih një tjetër përdorim, atë të një lidhëze kohore. Kjo lidhëz kohore, njihet si *cum* –i i përgjithshëm dhe ndërtohet me dëftore ose me lidhore. Në përgjithësi këto fjali vijnë në shqipe me lidhëzën *kur* + folje në dëftore, ndërsa në shqipen e tekstit të Kuvendit na është dhënë me lidhëzën *si* + folje në lidhore. .

***Cum** autem ad infirmi domum pervenerit, annunciate prius pace, et lustrali aqua praesentibus aspersis .... (f. 41)*

***Si** te rriqn mbe sctepi te semunit, te fallet; tue ççane: pacchia e giççeve, chi riine nd'atà; e tue chittune uiit e beecuem atyne...(f. 33)*

***Cum** gravissima in hominum perniciem ortum traxerint mala, pericula, ac scandala ex clandestinis Matrimoniis (f. 45)*

*Tue passune rrjeçune prej Marteset se clandestinevet scium te kecchija perricuii, e scanduii, me damm te Niereet, ketà e dennoj (f. 38)*

b) Një tjetër lidhëz, e cila ndërtohet me dëftore ëhsët dhe lidhëza *dum*. Në këtë rast përdoret për të treguar një veprim të që ndodh në të njëjtën kohë me atë të fjalisë kryesore. Në tekstin tonë na është dhënë me lidhëzën *ndiere se* + folje në dëftore. Kjo lidhëz, mendojmë se është trajta e vjetër e lidhëzës kohore të shqipes së sotme *ndërsa*.

***Dum** inundantium iniquitatum fluctus ferventius intumescunt, Apostolici viri inquieto motu, et veluti oborta tempestate (f. 47)*

***Ndiere se** valla e mcatevet maçesctohet, spò mund keene puscimin Niereit Apostoliki: perse tue pass raam nde motti te kech ... (f. 41)*

*Quisque suo iuri integram studet mancipare, dumque illi mutuis inter se certant iurisdictionibus* (f. 61)

*Trè Upesckupigne mbasck ççone se çeu I Posterippese asct i tynë....e ndier se ketà merren nder veteh ...*(f. 56)

Në rastet e mëposhtme do të shohim se lidhëza *dum* nuk na është përkthyer fare, por nga autori ëshët bërë përkthim i lirë duke na dhënë këtë fjali kohore herë me përcjellore e herë me fjali që tingëllon si kryesore. Të vërehen shembujt e mëposhtëm.

*Impudenti roboratus audacia Parentum, qui dum aestuanti luxuriate filios exhibent...* (f. 48)

*E cendron forzuem prej sille se paaa mende te Prindevet, te ziite tue çane te bite nde dore te curveniise* (f. 41)

*Sic contemntes divinae legis mandatum, dum suarum obtemperant illecebris voluptatum* (f. 48)

*Ani ksctù tue chiestissune urçenin e liise Hyinuscimee, fleene me eembre te mire...*(f. 41)

c) Fjali të nënrenditura kohore me lidhëzën *priusquam, antequam* . Këto fjali shprehin një veprim që ka ndjekur, ndjek ose do të ndjekë veprimin e shprehur në fjalinë kryesore. Ndërtohet herë me dëftore e herë me lidhore. Në tekstin tonë është ndërtuar me lidhore dhe në tekstin shqip lidhëza ka përgjegjësen e vet *para se* + folje në lidhore.

*Priusquam vero exponantur officio audiendi confessions a Patre Praefecto...examinentur* (f. 80)

*Para se te hiignene Missionaret me refyem, te jene esaminuem prej P. Prefettit, ndò prej ssi* (f. 79)

*Omnes autem per Parochos admoneantur, ut antequam matrimoniali vinculo coniugantur, confessionis, et comunionis sacramento* (f. 46)

*Giççi i silli para se te vene cunorene, te jete avisuem prej parocut meu refyem, e me u cinguem* (f. 39)

d) Fjali të nënrenditura kohore me lidhëzën *postquam*.



*Postquam haec prima documenta tradiderint, gramaticae rudimentis Iuvenes informant....* (f. 82)

*Mbas se ketà te ngremognene, te mpsognene te riite cacchie paga te randa te haraccievet ...* (f. 83)

*postquam enim naufragerunt a Fide, et coram turcarum iudice sistentes...,*

*Deumque ipsum solemni sacrilego ritu eiurarunt* (f. 18)

*persè mbas se dahren n'fejese Crisctit, e vene perpara Cadiise, ndo tieterit turk....ende Teneeone me temaçe* (f. 5)

#### **6) Fjalitë e nënrenditura lejore.**

Këto fjali shprehin një rrethanë, reale apo e supozuar, me të cilën kryhet ajo që shprehet në fjalinë kryesore. Këto fjali ndërtohet me lidhëzat *quamvis, tametsi, etsi, quamquam, cum, ut*. Në tekstin shqip këto fjali kanë ardhur po me fjali lejore në krye të të cilave qëndrojnë lidhëza *nde se + folje në dëftore*

*Quamvis vero baptizanti munus ad Parrochum solum pertineat, (f. 31)*

*E nde se vece Parrochianevet perket me pagheeuem pro* (f. 21)

*Quamvis enim ex speciali Apostolicae Sedis indulto, interstitia dispensandi facultate polleant Episcopi* (f. 43)

*Ndone se per gni te mpos testiire te Seliese Apostolike kane Upesckupignete pusctene me liiruem, ndo me dispensuem at mone, chi ççone interstitie* (f. 35)

Në shembullin e dytë vërejmë lidhëzën e sotme lejore *ndonëse*, edhe pse në trajtë më të vjetër, kur akoma shkruhej ndaras.

## Kreu IV

### Praepositiones (parafjalët), përdorimi i tyre.

Qysh në kohët më të hershme gjuhët shprehnin lidhjet sintaksore të emrit në fjali nëpërmjet sistemit rasor dhe lakimit të emrit sipas rasave. Por me zhvillimin e gjuhëve u bë gjithnjë e më e papmjaftueshme për të shprehur të gjitha raportet sintaksore të emrit. Për këtë arsye, siç pohon Demiraj,<sup>296</sup> në një fazë të dhënë të zhvillimit të popujve që flisnin gjuhë a dialekt indoevropian, u ndje nevoja për një mjet të ri plotësues të sistemit rasor për t'i dhënë mundësi të shprehte sa më mirë e sa më qartë funksionet më të ndryshme të emrit në fjali". Lindi kështu një klasë e re fjalësh shërbyese, vendi i të cilave ishte para një emri a përemri. Bëhet fjalë pikërisht për parafjalët. E njëjta dukuri ka ndodhur dhe në gjuhën latine, në të cilën ekzistojnë parafjalët *praepositiones*<sup>297</sup>, ndonëse në latinisht funksioni sintaksor i emrit shprehet nëpërmjet rasës.

Me të drejtë ashtu siç pohohet nga studiuesit,<sup>298</sup> origjina e parafjalëve duhet të shihet te një klasë tjetër fjalësh të pandryshueshme, siç janë ndajfoljet. Në fakt, parafjalët në fillimet e tyre kanë qenë ndajfolje dhe në shumë raste të paktën në gjuhën latine dhe atë shqipe e ruajnë akoma këtë vlerë. Monema si *ante*, *post*, *adversus*, *circa*, *super*, *secundum* etj, në gjuhën latine, në varësi të përdorimit dhe funksionit në fjali janë herë ndajfolje e herë parafjalë. Të shihet përdorimi i parafjalës *post* në fjalitë e mëposhtme.

- 1) *id post faciam* – do ta bëj më pas.
- 2) *id post reditum faciam* – do ta bëj pas kthimit.

Në fjalinë e parë *post* kryen funksionin e një ndajfoljeje, ndërsa në fjalinë e dytë luan rolin e një parafjale. E njëjta dukuri vërehet dhe në shqipe, si rezultat i dukurisë së parafjalëzimit të ndajfoljeve dhe të disa lidhëzave. Për të mos harruar dhe disa forma të ngurosura të disa emrave dhe foljeve<sup>299</sup>. Konkretizim i mundshëm i asaj që u tha më lart mund të vërehet në fjalitë e mëposhtme.

*Ai mbeti jashtë shtëpisë.* (*jashtë* si parafjalë)

*Ai mbeti jashtë.* (*jashtë* si ndajfolje).

---

<sup>296</sup> Gramatikë historike. vep. cit. f. 31.

<sup>297</sup> *Praepositio* është kalk i fjalës *πρόθεσις* së greqishtes.

<sup>298</sup> N.Flochini, vep. cit. f. 287.

<sup>299</sup> Për më shumë mbi këtë dukuri të shihet *Gramatikë historike...* vep. cit. f. 627.

Në punimin tonë nuk do të ndalemi gjatë mbi historinë dhe zhvillimin e klasës së parafjalëve në gjuhën shqipe, pasi nuk përbën objekt të veçantë të kapitullit mbi parafjalët.

Në këtë kapitull do të ndalemi te parafjalët e latinishtes, klasifikimin dhe përdorimin e tyre në fjali dhe mbi të gjitha si kanë ardhur ato në shqipen e Kuvendit.<sup>300</sup>

#### IV.1 Klasifikimi parafjalëve

Në gjuhën latine parafjalët mund të klasifikohen duke u nisur nga prejardhja, si dhe nga funksioni sintaksor i parafjalës në fjali.

V.1.1 Sipas prejardhjes parafjalët në gjuhën latine parafjalët ndahen në dy grupe: në ndajfolje të mirëfillta (të parme) dhe jo të mirëfillta (jo të parme).<sup>301</sup> Të parmet janë ato të cilat përdoren vetëm në funksion të parafjalës: për shembull *a/ab/; e/ex; de; per; in* etj.

Parafjalë jo të parme janë ato të cilat ruajnë vlerën e tyre ndajfoljore dhe mund të përdoren dhe në funksion të parafjalës dhe në atë të ndajfoljes si *adversus, post, ante* etj, për të cilat u fol më lart.

V.1.2 Një ndarje tjetër është dhe ajo që mund të bëhet sipas kriterit sintaksor dhe sipas rasave me të cilat përdoren. Si rrjedhim ka parafjalë (psh. *ad, ob, inter* etj) të cilat ndiqen gjithnjë nga një emër në rasën kallëzore. Të tjera (psh. *a, ab, e, ex, de*) përdoren me emër në rasën rrjedhore. Të mos lëmë dhe pa përmendur dhe disa parafjalë të cilat përdoren dhe me emra në kallëzore dhe në rrjedhore.<sup>302</sup>

Më poshtë po bëjmë një përmbledhje të parafjalëve më të përdorura në tekstin latin dhe se si kanë ardhur ato në tekstin shqip të Kuvendit duke nxjerrë në pah përputhjet apo mospërputhjet midis përdorimit të parafjalëve të dyja gjuhëve.

#### ***a, ab***

(*a* para një bashkëtingëlloreje: *ab* para një zanoreje)

Në gjuhën latine kjo parafjalë shpreh idenë e shkëputjes apo të largimit, lëvizje nga një vend. Unde? – prej ku? Ndiqet nga emra në rasën rrjedhore. Në tekstin

---

<sup>300</sup> Një punim i mirë mbi historinë, zhvillimin dhe vecoritë e klasës së parafjalëve të vepra e Buzukut, mbetet libri i M. Karagjozit, *Parafjalët në "Mesharin" e Gjon Buzukut*, Tiranë, 2005.

<sup>301</sup> Një ndarje e ngjashme e parafjalëve është bërë dhe në gramatikën e gjuhës shqipe. Shih, vep. cit. f. 383. dhe në librin e M. Karagjozit, libër i cituar pak më lart në f. 42.

<sup>302</sup> Një dukuri e ngjashme vërehet dhe në shqipe ku mund të përmendim parafjalët *ndaj* e *për* të cilat përdoren me nga dy rase. Për më shumë shih Gramatika e gjuhës shqipe, vep. cit. f. 387.

shqip kryesisht na është dhënë me anë të parafjalës *prej*<sup>303</sup>, e cila gjithashtu përdoret kryesisht për të treguar largim nga një vend, gjë që mund të vërehet në shembujt e mëpostëm.

*A Iesu Christo Domino nostro instituta....* (f. 16)

*E çane prej Chrisctit Zotit tine...* (f. 3)

*Speciosa Christi germina a potestate tenebrarum eruta* (f. 22)

*Te hijescimat biimate Crisctit nzierre prej pusctetejese terretit mcatit* (f. 10)

*...ut sancta a sanctis tractentur...*(f. 29)

*...Kinese cafsca te scenta, prej Scentesc te jene precune* (f. 19)

Në tekstin tonë, ndryshe nga ato të autorëve të vjetër, nuk kemi gjetur as edhe një rast të vetëm të përdorimit të kësaj parafjale me kuptimin tjetër, atë të afërsisë apo drejt një vendi, pra me kuptimin e parafjalëve latine *versus, ad*. Kjo dukuri mund të shpjegohet me kristalizimin e kuptimit të kësaj parafjale, ashtu siç përdoret dhe në shqipen e sotme.

**de, e, ex** (vetëm para zanoreve)

Këto parafjalë, ashtu si dhe parafjala *ab*, shprehin idenë e largimit apo të shkëputjes dhe përoren me emra në rasën rrjedhore. Në tekstin shqip në të gjitha rastet janë dhënë po me parafjalën *prej* dhe në disa raste jo të pakta me anë të parafjalës së vjetër *n (en)*<sup>304</sup>.

*Descendit de Caelis, et incarnatus est de Spiritu sancto, ex Maria Virgine...*

(f. 16)

*Sdrrippi prej Chijeiscit, e u miscenue per virtyt te Scpiritit Scind prej Virginet Mrii..* (f. 2)

---

<sup>303</sup> *Prej* është një parafjalë e hershme, të cilën e kemi gjetur te Meshari i Buzukut, duke na dhënë përgjegjësen latine *ex, de*. Psh: *erdh një e madhe erë prej malshit së shkreta* (f. 385). Te Buzuku dhe autorë të tjerë të Veriut parafjala *prej* jo gjithnjë përdoret me kuptimin e largimit, por gjithahtu përdoret me kuptimin e afërsisë me përgjegjësen e saj të latinishtes *ad, versus*. Psh: te Buzuku *O gojëtareja jonë, ata syte e tū të përmishëriershim rutullo prej nesh* (=drejt nesh) (f.31).

<sup>304</sup> Kjo është një nga parafjalët që ndeshet më shpesh te Buzuku e autorë të tjerë pas tij, veçanërisht te Budi, Bardhi e më pak te Bogdani. Psh: te Buzuku: *erdh tek aj një krye n nierëzish* (f 103); te Bardhi: *me çkulë n fare* (f.134); *petëk n gruaje (pallea)* : te Bogdani: *..se ujënatë dalënë n'deti* (I/IV/17) Siç shihet shtrirja e saj është e madhe pasi e gjejmë dhe në shqipen e shekullit XVIII, pra në tekstin e Kuvendit. Te Buzuku:

*Et ex Patre natum ante omnia saecula; Deum de Deo, lumen de lumine* (f. 16)  
*E leem prej Atit perpara giçç Scecuje, Hyin prej Hyit: Drittene n'drittet...*(f. 2)

*.. buccur reççuem me ciaprassse t'areta, e 'n biserisc se pacimueme* (f. 7)  
*Ornata Viro suo circumamicta monilibus aureis, et gemmis pretiosis* (f. 20)

*ab iniquitatibus mundemur, hic virtutibus roboremur* (f. 35)  
*lahemi 'n fajjesc, ketu forzohemi me virtyte* (f. 25)

*ut quicumque in hoc unico signo deficit, ab Ecclesia se divellat* (f. 21))  
*Pr'atà ai chi s'ep ketà scegnajite Feese, paa rreene banet i paa Fee, e dahet 'n kiscet* (f. 9)

*illegitimo thoro procreati ....* (f. 47)  
*leem 'n prindesc, chi skane passune per lighie....* (f. 36)

Vëmendje të veçantë kërkon parafjala e hershme *n* (*ën*) që del shpesh dhe te Buzuku. Studiues të shumtë janë shprehur mbi origjinën e kësaj parafjale dhe arsyet pse kjo parafjalë përdoret kaq shumë nga Buzuku. Sipas Demirajt,<sup>305</sup> ky përdorim e ka burimin te veçoritë e të folmes së Buzukut. Për mendimin tonë, siç është shprehur dhe Mansaku<sup>306</sup>, kemi të bëjmë me një përdorim të gjërë të kësaj parafjale në gjuhën shqipe, gjë që vërtetohet dhe në gjetjen e saj dhe në tekstin e Kuvendit të Arbënit, tekst i fillimit të shekullit XVIII.

Përdorimi i kësaj parafjale me kalimin e kohës është zbehur duke filluar që nga Bogdani. Mënjanimi i saj ka ardhur në shqipen e sotme, dhe në vend të saj ka ardhur duke u përdorur gjithnjë e më shumë parafjala *prej*, të cilën siç u tha dhe më lart shfaqet më dendur dhe në tekstin tonë.

#### *ad*

Kjo parafjalë shpreh idenë e lëvizjes apo afrisë drejt një vendi dhe njihet si parafjalë e rasës kallëzore. Quo? - Ku? Në tekstin tonë kjo parafjalë vjen me parafjalën *mbë*<sup>307</sup> e ndjekur nga emri në kallëzore, siç mund të vërehet në shembullin e mëposhtëm.

---

<sup>305</sup> Vep.cit. f. 649.

<sup>306</sup> S.Mansaku, Studime filologjike,1-2,2001, f. 26

<sup>307</sup> Kjo parafjalë është mjaft e hershme me një përdorim të dendur dhe në librin e parë të shqipes. Psh: *e grishnë shokëtë qi ishnjinë mbë tjetëret barkëzë* f. 281/b

Burimin e kësaj parafjale disa studiues, përmendim këtu Bopp-in dhe Xhuvanin e lidhin me sankritishten *abi*, greqishten *amphi* dhe latinishten *amb*.<sup>308</sup>

*sedet ad dexteram Patris* (f.16)

*rri mbe te diaççet Atit* (f. 2)

*et indelebile, currus ad Caelum...* (f. 30)

*chi s'hicchiet, coccii me vot mbe Chielit* (f. 20)

Në shumicën e rasteve, në të cilat nuk tregohet drejtimi ose pika e mbërritjes në hapësirë apo kohë, siç mund të jetë fundi i një veprimi apo dhe i një qëndrimi (rrethanori i qëllimit), vërejmë që parafjala nuk është përkthyer, por na është dhënë me fjalë të tjera, si më poshtë.

*ad Eucharistiam accedimus* (f. 39 )

*t'affrohem i Sciacramentit Eucharistijese* (f. 30)

*Non solum corde creditur ad iustitiam, sed ore etiam confessio fit ad salutem* (f. 18)

*Nuk mbaston vece me embre me bessuem te dereitene, pò duhet ende refimi i gojese per te scelbuemit* (f. 5)

*prona ad malum ab adolescentia, incidat adhuc in laqueum Sathanae* (f. 36)

*persè asct hiecune prej voghieliet me baam kecch, bie prò nde lach te Diaalit* (f. 27)

### **cum**

Kjo parafjalë shpreh idenë e bashkimit e të shoqërimit. Në gjuhën latine përdoret gjithnjë me emra në rasën rrjedhore për të shprehur gjënë apo njeriun me të cilin kryefjala kryen veprimin. Në tekstin tonë vjen me anë të parafjalës *me*<sup>309</sup>, e cila ndryshe nga latinishtja njihet si parafjalë e rasës kallëzore.

*qui cum Patre et Filio simul adoratur* (f. 16)

*i silli me Atin, e Birin mbasck açorohet* (f. 2)

---

<sup>308</sup> Për më shumë të shihet Demiraj, f. 631.

<sup>309</sup> Kjo parafjalë e përdodur dhe te Buzuku : *Ti që me Atët zotënon e jet, për jetë të jetësë* f. 17/a

una **cum** Anima, et divinitate Domini ....(f. 17)

*mbasck me Scipjrt e me hyinii te vete* (f. 3)

### **in**

Kjo parafjalë shpreh gjendje në një vend të caktuar si edhe lëvizje drejt një vendi. Në gjuhën latine përdoret me emra në rasën kallëzore kur tregon lëvizje drejt një vendi dhe me emra në rrjedhore kur tregon gjendje në një vend të caktuar. Në të dyja këto raste kjo parafjalë në tekstin tonë ëhstë dhënë herë me parafjalën *ndë/në*<sup>310</sup> e herë më parafjalën *mbë*<sup>311</sup>, e cila përdoret me emra në rasën kallëzore.

*intellectum redigens in obsequium Christi* (f. 15)

*chi siell schissete nde scerbetyre te Criscitit* (f. 1)

*Credo in unum Deum Patrem Omnipotentem* (f. 15)

*Bessogn mbe gnia te vetemin Hyi Atin e Pusctuescim* (f. 2)

*In militanti Christi Ecclesia* ....(f. 19)

*Nde kisce te paame te Criscitit as lye, o faii* (f. 7)

Në rastin e mëposhtëm nuk kemi parafjalë për të shprehur rrethanorin e kohës, pasi në gjuhën latine shpesh ky rrethanor nuk jepet me anë të parafjalës, ndërsa në tekstin shqip parafjala *ndë* shfaqet e ndjekur nga emri në kallëzore.

*trium mensium spatio* (f. 54)

*nde mot te tre muojesc* (f. 48)

*Inter regnantium hac tempestate scelerum* ... (f. 28)

*Nder sciummizza te fajevet, chi nde keta kohe* ... (f. 18)

### **per**

Kjo parafjalë përdoret me emër në rasën kallëzore dhe tregon kalim apo mjet me anë të të cilit kryhet veprimi.

---

<sup>310</sup> Kemi të bëjmë me parafjalë të hershme duke qenë se e gjejmë me të njëjtën trajtë si dhe te Buzuku: *nd'ato ditë u mbëlodhnë bijtë* ... (f.161/a)

<sup>311</sup> Te Buzuku: ..u qit mbë gjuhnjë përpara Tinëzot f. 89/a.

Në tekstin shqip kjo parafjalë vjen herë me parafjalën *prej*, me rasën rrjedhore, me funksionin rrethoritet të mënyrës<sup>312</sup>, e herë me parafjalën *ndë për*<sup>313</sup>, për të treguar lëvizje përmes hapësirës në vend apo në kohë, gjë që mund të vërehet në shembujt e mëposhtëm.

*per haec Decreta excitantur ....* (f. 78)

*prej kessosc decretasc eembrohen mbe te nalte essape ...* (f. 77)

*non tantum sonet in Ecclesiis, sed per rura, per campos, per privata pauperum domicilia* (f. 81)

*pr' ata te ndiet eani jo vece nde per Kiscia, po nde per katunde, nde per basctina, nde per fuscia, nde per scptepija te vorfeniise* (f. 80)

Lidhur me përdorimin e kësaj parafjale në shembullin e mëposhtëm vërejmë se kur kjo parafjalë shpreh mjetin me anë të së cilit kryhet veprimi, atëherë përdoret dhe me rasën kallëzore, me trajtën tjetër të saj *për*<sup>314</sup>, me funksionin e kundrinoritet me parafjalë, për të shprehur mjetin me anë të të cilit kryhet veprimi.

*glorificatur, qui locutus est per Prophetas* (f. 16)

*e perlabdohet, chi ka folle per goje te Profetevet* (f. 2)

*...ne dum per scientiae viam, sed per semitam quoque pietatis gradiendum est* (f. 44)

*...iò vece per scteku te dijese, pò endè per urome te scendeniise e et miscerierese duhet me zzone* (f. 37)

Parafjala *per* e latinishtes vjen e përkthyer dhe me anë të parafjalës *me*, por me funksionin e kundrinoritet me parafjalë duke treguar mjetin me anë të të cilit kryhet veprimi

*qua iustus vivit, et per quam ....comstituitur* (f. 20)

*me cà Nierii i dereit po geliin, me të zijen deftohet ...* (f. 7)

*An in ea se quisquam per vim intruserit* (f. 57)

---

<sup>312</sup> Me të njëjtin përdorim e gjejmë dhe te Buzuku, *..e pa një dash qi ish ngatëruom për brienësh* f. 233/b dhe jo vetëm, por dhe në shqipen e sotme në shprehje të tilla si: *e kapi* për dore.

<sup>313</sup> Të vihet re shkrimi ndaras i elementeve përbërs të kësaj parafjale, e cila në shqipen e sotme shkruhet bashkë.

<sup>314</sup> Këtë përdorim e gjejmë dhe te Buzuku: *Nd'ato dit foli Zotynë për gojë të Ezaisë regjit Akax tue i thashune...* (f. 89) Jo më kot parafjalët *për* dhe *prej*, nuk ndaheshin nga studiuesit Meyer-i dhe Pedersen-i. Për ta *prej* është identike me *për* dhe *prej* shihet si zgjerim i parafjalës *për*.



*A hiini cusc nder të per forze?* (f. 51)

### **pro**

Kjo parafjalë në gjuhën latine shpreh objektin a personin në dobi a në të mirë të së cilës kryhet veprimi dhe përdoret me rasën rrjedhore. Në tekstin shqip *pro* e latinishtes vjen me anë të parafjalës *për* me funksionin e kundrinorit me parafjalë për të shprehur të njëjtën gjë si dhe në gjuhën latine.

*crucifixus etiam pro nobis...* (f. 16)

*Kië vuum mbe krychie per nee....* (f. 2)

*ut pro temporum necessitate ...* (f. 36)

*chi per nevoje te ketii moti ....* (f. 27)

*pro peccatis Populi sacrificium offerendo...* (f. 43)

*tue truem Sacrifizin per mcate Populit* (f. 35)

### **sub**

Në gjuhën latine kjo parafjalë përdoret si me rasën kallëzore ashtu dhe në atë rrjedhore. Në tekstin shqip kjo parafjalë vjen me anë të parafjalës *ndë/në*<sup>315</sup>, origjinën e së cilës Meyer-i e sheh te *intus* e latinishtes, gjë që është kundërshtuar nga Pedërseni i cili mendonte se është e shqipes<sup>316</sup>. Sipas tij ndë- është e prejardhur nga *ndër-*.

*crucifixus etiam pro nobis sub Pontio Pilato* (f. 16)

*Kië vuum mbe krychie per nee ndene Punzin Pilat* (f. 2)

*Et delebit nomen eorum sub Caelo* (f. 48)

*E kaa me prisciune emenat e tyne ndene chielese* (f. 42)

### **super**

Dhe kjo parafjalë në gjuhën latine përdoret si me rasën kallëzore ashtu dhe me atë rrjedhore. Në shqipen e Kuvendit na është dhënë me parafjalën e rasës kallëzore *mbi*. Në pamje të parë duket sikur kjo parafjalë nuk ka ndryshime kuptimi me

---

<sup>315</sup> Parafjalë e hershme, siç u tha dhe më lart, e gjetur dhe te Buzuku me të njëjtën trajtë.

<sup>316</sup> Për më shumë mbi origjinën e kësaj parafjale shih Demiraj, vep. cit f. 630 dhe M.Karagozi f. 90.

parafjalën *mbë* dhe se kanë të njëjtën prejardhje. Me të drejtë autorja e punimit mbi parafjalët të Meshari i Buzukut, M.Karagjozi<sup>317</sup> pohon se duke u nisur nga fakti se *mbë*, në librin e parë të shqipes gjen përdorim më të dendur se parafjala tjetër *mbi*, e cila nga ana tjetër, të Buzuku del vetëm 6 herë, dhe se kjo e fundit gjen përdorim më të dendur në shqipen e sotme, dukuri që me sa duket ka fillimet e saj dhe në shqipen e fillimit të shekullit XVIII, mund të themi se kemi të bëjmë me dy parafjalë të ndryshme.

*divini super se furoris gladium provocant* (f. 48)

*hieknë mbi vetehen scpatene e meniise të Tineot* (f. 41)

*haec pollutio egerssa est super omnem terram* (f. 48)

*Ketë të feliçiuunit duoli për mbi giçç çete* (f. 41)

Në shembullin e dytë vërejmë se *super* na ëshët dhënë me parafjalën e përngjitur përmbi e cila çuditërisht të Buzuku e gjejmë të shkruar bashkë, ndërsa në tekstin tonë elemente përbërës të saj janë shkruar veçmas.

### ***contra***

Kjo parafjalë e përdorur me rasën kallëzore vjen e përkthyer në tekstin e Kuvendit me parafjalën *kundra*, me origjinë ndajfoljore, nga parafjala *contra* e latinishtes, parafjalë e gjetur dendur të Buzuku me trajtën *kondra*. Kjo trajtë, *kondra*, e gjetur në tekstin tonë është më e re, pasi e gjejmë të Bogdani, veprën e të cilit autori ynë i përkthimit, siç do të shohim në vijim e ka njohur dhe se është më afër trajtës së shqipes së sotme *kundër*.

*Et zelus contra homines illos...* (f. 48)

*E eeli i tiinaj cundra atyne niereese....* (f. 42)

### ***coram***

Kjo parafjalë në gjuhën latine përdoret me rasën rrjedhore dhe në tekstin tonë vjen e përkthyer me anë të parafjalës *përpara*, e cila në gjuhën shqipe është me origjinë ndajfoljore dhe e përngjitur. Përgjithësisht shoqërohet nga emra në rasën

---

<sup>317</sup> Vep.cit. f. 47

rrjedhore<sup>318</sup>. Në shembullin e mëposhtëm vërejmë se në tekstin latin dhe atë shqip është përdorur me funksionin e rrethororit të vendit.

*Omnis, qui confitebitur me **coram hominibus**, confitebor et ego eum coram Patre meo...* (f. 20)

*Giçç i silli ci ka me refyem mue **perpara Nierzet**: une kam me refyem atà perpara tim Et...* (f. 8)

### **inter**

Kjo parafjalë në gjuhën latine përdoret kryesisht me emra a përemra të numrit shumës në rasën kallëzore, për të treguar vendin e dikujt apo diçkaje në raport me të tjerët. Në tekstin shqip të Kuvendit vjen me parafjalën *ndër*<sup>319</sup>, e cila në shqipe përdoret vetëm me amra në shumës të rasës kallëzore.

*saepius tamen orta **inter eos** contentione, quis eorum in aeconomica administratione videatur esse maior* (f. 75)

*scium here prò **nder tà** asct dalle sciamate, tue u marre per tesiln di màa fort me mbaitune sctepiine* (f. 73)

*Agnum immacultum, qui pascitur **inter** lilia, immaculata .... conscientia* ... (f. 39)

*...me eembre te paa faii per te marre nde vetehen Chingin e paa pallavii, chi culotet **nder** lulla...* (f. 30)

Siç mund të shihet në shembullin e mëposhtëm në tekstin latin parafjala *inter* shoqërohet me fjalën *multitudo*, dhe pse në numrin njëjës, pasi shërben për të treguar shumësi gjërash. Ajo që bie në sy është përkthimi *ad litteram* duke bërë që dhe në shqipe kjo parafjalë të përdoret me emër në njëjës ashtu si dhe në latinishte duke na sjellë një përdorim jo të saktë të parafjalës *ndër* të shqipes.

***Inter** regnantium hac tempestate scelerum multitudinem* ... (f. 28)

***Nder** sciumizza e fajevet, chi nde këta kohe mbalognene çene...* (f. 18)

### **post**

---

<sup>318</sup> Me të njëjtën trajtë e kemi gjetur dhe te Buzuku: *Hinje se u dergonj engjelline tem përpara faqesë sate, e aj të trajtonjënë udhënë tande* f. 87/a. ndonëse dhe të përdorur me rasën dhanore. dhe :

<sup>319</sup> Te Buzuku; *e ka me dhanë ndër duor të nierëzet, me e munduom e me vum mbë kryqt* f. 141/a.

Kjo parafjalë është e përdoret me emra në rasën kallëzore dhe në shqipen e Kuvendit vjen me parafjalën e rasës rrjedhore *mbas*. Autori ynë nuk është ndikuar nga teksti latin, duke sjellë një përdorim të drejtë të kësaj parafjale në gjuhën shqipe.

*Et abierunt post concupiscentias carnis...* (f. 24)

*E sckuene mbas lakmijasc se miscit....* (f. 13)

Ndryshe nga shqipja, e cila njeh dhe parafjalë të rasës emërore, në gjuhën latine kjo rasë nuk përdoret me parafjalë. Në fakt kemi të bëjmë me një veçori të shqipes. Bëhet fjalë për parafjalët *nga*, *tek* me variantet përkatëse dialektore *ka*, (*kaha*),<sup>320</sup> të cilat, shihen nga studiuesit si dukuri e përfutur gjatë evolucionit historik të shqipes.<sup>321</sup>

Në tekstin e Kuvendit të Arbënit, në variantin shqip nuk vërehet një përdorim i dendur i rasës emërore me parafjalë. Mezi kemi gjetur dy raste në të cilët parafjalën *nga* e gjejmë në tajtën e dialektit të veriut, *kaa*. Ndryshe nga Buzuku dhe autorë e tjerë, autori ynë, në një rast e shkruan me dy *a*, që siç kemi thënë shërben për të treguar gjatësi të zanores. Në të dyja rastet nga është përdorur para numërorëve me funksionin e rrethorës të mënyrës për të treguar mënyrën e kryerjes së një veprimi.

*Ut autem de singulis agamus, omnium primus occurrit, Sacramentorum ianua, Baptismus* (f. 30)

*Tue passune per te folle per giçç Sciecramenta kaa gnià, maa pare...*(f. 20)

*...per viros, ad id munus idoneos, quolibet saltem biennio* (f. 54)

*...kinese te visitognene Diocesen kady viet gni here, e nde mos muicin veti*  
(f. 48)

*Singulis saltem mensibus sacramentalis confessionis ...*(f. 73)

*Te refehen maa pak, caa gni here nde muoj..* (f. 70)

---

<sup>320</sup> Në librin e Buzukut, parafjala *nga* del në trajtën fonetike të hershme *ka-*, *këha* apo *kaha*. Psh: Faqetë e tyne e pendetë e tyne ishnë ndem përmbi ta e *ka* dy pendë". f. 355/b Nd atë mot erdhnë *tek Jezu parizejtë* (LXXVIII / 2a = LXXXVIII / 2a).  
*e u godit me ta ka një denarn ditet* f. 107/a ; *E shpune tek farizejtë* f. 177/b

<sup>321</sup> Lidhur mbi burimin dhe përdorimin e këtyre parafjalëve shih Demiraj, vep.cit.f. 643; R.Përnaska, *Analizë stukturorë-semantike e togfjalshave me parafjalën nga që shprehin marrëdhënie objektore*, SF.1,1991, f. 59

Kemi gjetur dhe një rast të përdorimit të parafjalës *nga*, jo në rolin e parafjalës, por të lidhëzës vendore,<sup>322</sup> siç vërehet në shembullin e mëposhtëm.  
*e mba kiscia e Romes, e me ketà giçç cund ka jane kisciat.* (f. 32)

Në fakt duhet të kishte më shumë raste, sepse siç u përmend më lart kjo dukuri haset që në librin e parë të shqipes, ndonëse rrallë. Shtrohet pyetja: Si ka mundësi që në fillim të shekullit XVIII, në një tekst kaq të gjërë të mos dilte ky përdorim duke qenë se e gjejmë dhe në shqipen e sotme? Kjo gjë mund të shpjegohet me faktin se autori si shqipfolës joburimor, ndoshta nuk e ka pasur në stilin e tij këtë ndërtim, si rezultat i përdorimit jo të shpeshtë të këtyre parafjalëve me emra në rasën emërore.

Mungesa e parafjalëve të emërores justifikohet dhe me përdorimin e gjerë, në vend të tyre të parafjalëve *prej* + *rrjedhore* ose *ndë*+ *kallëzore*, dukuri e vërejtur kryesisht në dialektin gegë, në të cilin është përkthyer dhe teksti i Kuvendi të Arbënit. Pikërisht për këtë arsye studiuesit, sidomos studiuesit e huaj nuk duhet të nisen nga tekste të tilla për të nxjerrë përfundime mbi çështje të ndryshme të ngritura dhe që i përkasin drejtpërdrejt një gjuhe.

Një tjetër fakt që vlen të përmendet është dhe përcaktimi i rasës, me të cilën përdoren disa parafjalë. Bëhet fjalë për parafjalë si *prej*, *ndaj*, *jashtë*, *përpara*, të cilat në shqipen e dokumentuar ndeshen të përdorura me emra të rasave të ndryshme, madje ndryshime të tilla dalin në veprat e të njëjtit autor, siç me të drejtë vëren dhe Demiraj<sup>323</sup>.

Parafjala *ndaj* tek autorët e vjetër ndertohet kryesisht me emra në rasën kallëzore ndryshe nga shqipja e sotme. Të shihen këto përdorime te autorët të ndryshëm.

Buzuku: *E ju e njihni përse aj jet ndaj ju* ..f. 163/b

Budi: *ndaj Krishtnë* SC f, 295

---

<sup>322</sup>Për këtë arsye studiuesja A Cirrione, *Sintassi albanese degli antichi scrittori*, Roma 1968, f. 40, duke e pasur të vështirë të pranojë pajisjen e rasës emërore me parafjalë pohon: “Rasa emërore gjendet me disa parafjalë, megjithatë është fjala për parafjalë jo të vërteta, ndërkohë që janë ndajfolje kohe, mënyre e vendi që në një formë sintaksore shfaqin natyrën e tyre si ndajfolje, kurse në një rast tjetër duken si parafjalë”. Në fakt ndoshta origjina e tyre duhet parë te ndajfoljet, ashtu siç mendohet për shumë parafjalë, por në gramatikën e shqipes trajtohen si lidhëza, përkatësisht *nga* si lidhëz vendore, si në shembullin e mësipërm dhe *tek* si lidhëz kohore.

<sup>323</sup>Vep.cit. f. 637 e tutje. Parafjala *ndaj* tek autorët e vjetër ndertohet kryesisht me emra në rasën kallëzore ndryshe nga shqipja e sotme. Të shihen këto përdorime: te Buzuku:

E njëjta dukuri vërehet dhe te parafjalët me burim ndajfoljor si *përpara, jashtë*, të cilat i gjejmë të përdorura me emra në rasën rrjedhore, por nuk mungojnë dhe raste ku i gjejmë të përodrura dhe në rasën kallëzore.

Buzuku: *jashtë ordhënit Tinëzot* f. 69/a

Buzuku: *e u ngritënë, e qitnë jashtë qytetnë* f. 155/a ; *përpara ty* f. 149

Bardhi: *te përruenë, te detine* f.175,176

Te Kuvendi: *Per jashta mallevet/ përpara nesh/ per mbrenda scerbimit* f. 67, 55, 63

Përdorimi i këtyre parafjalëve me rasën kallëzore është një karakteristikë e gjuhës së autorëve të vjetër, e cila nuk ndeshet në shqipen e sotme. Këto parafjalë përdoren me parafalë të rasës kallëzore ashtu siç u pa dhe në shembujt e mësipërm. Përballë kësaj situatë me të drejtë lindin pyetjet: Përdorimi i këtyre parafjalëve më raën kallëzore është veçori e të folmes së autorëve, veçori e shqipes apo mos vallë kemi të bëjmë me ndikim të teksteve origjinale? Mbi këtë çështje janë shprehur shumë studiues.

Sipas Bokshit<sup>324</sup> shqipja dikur i ka përdorur me rasën kallëzore e më pas janë përdorur me rrjedhoren. Sipas tij kemi të bëjmë me një dukuri të përbashkët të gjuhëve indoevropiane, të cilat njohin përdorimin e këtyre parafjalëve me rasën kallëzore. Studiuesi S. Mansaku<sup>325</sup> pohon se “..Buzuku nuk mund të përdorte këto parafjalë vetëm nën ndikimn e tekstit latin, pasi sipas tij drejtimi parafjalor nuk është lehtësisht i huazueshëm”. Këtë mendim e përforcon dhe përdorimi i dendur i këtyre parafjalëve në rasën kallëzore dhe shumë pak në rrjedhore. Gjithashtu në të mirë të kësaj teze është dhe mendimi se me kallëzore nuk janë përdorur vetëm parafjalët *te* (tej), *jashtë* përgjegjëset e të cilave në gjuhën latine *extra, trans* përdoren me kallëzore, por dhe parafjalë si *përpara, (coram)* përgjegjësjë e së cilës në latinishte përdoret me rrjedhore.

Në tekstin tonë përdorimi i këtyre parafjalëve me rasën kallëzore, siç mund të shihet dhe nga shëmbujt nuk vërehet. Pra, me fjalë të tjera, jemi në atë fazë të shqipes kur gjejmë një përdorim të drejtë të parafjalëve duke na treguar se në shqipen e shekullit XVIII kishte më shumë stabilitet dhe se kishin filluar të krijoheshin raporte sintaksore të qarta mes parafjalëve dhe emrave që shoqërojnë.

---

<sup>324</sup> B.Bokshi, *Rruga e formimit të fleksionit të sotëm nominal të shqipes*, Prishtinë, 1980, f.141

<sup>325</sup> Disa veçori morfo-sintaksore të librit të parë në gjuhën shqipe, *Studime filologjike* 1-2, f. 27

## Kreu V

### Veçori leksikore të gjuhës së Kuvendit të Arbënit.

Përkthimi dhe botimi shqip i akteve të Kuvendit të Arbënit përbën një hap të rëndësishëm për historinë e e gjuhës shqipe të shekullit XVIII dhe dialektin verior në veçanti. Ky mbetet teksti i parë dhe më i rëndësishmi i këtij shekulli pasi përcjell traditën e shkrimit të shqipes nisur në shekullin e XVI nga Buzuku për të vazhduar më tej me autorë të tjerë të Veriut si Budi, Bardhi e Bogdani. Autorët e Veriut përfshirë dhe autorin e përkthimit të tekstit latin të Kuvendit të Arbënit zgjodhën të njëjtin alfabet, të njëjtën gjuhë dhe mbi të gjitha kishin të njëjtin qëllim. Qëllimi kryesor i tyre, shkruan S.Mansaku, ishte mbrojtja dhe zhvillimi i identitetit kulturor dhe gjuhësor si përbërës themelorë të identitetit kombëtar<sup>326</sup>.

Teksti i Kuvendit të Arbënit vjen pas botimit të Çetës së Profetëve” të Pjetër Bogdanit të vitit 1685. Për këtë arsye, studiuesit e shohin mjaft të afërt me këtë të fundit, me veçoritë e përgjithshme, me tendencat themelore drejt kapërcimit të regjionalizmit të ngushtë, me fjalinë e gjatë, të balansuar, me tipin e shkrimit shumë të përhapur në botën latino – romane të kësaj kohe.<sup>327</sup>

Falë këtij teksti sigurohet vazhdimësia e lëvrimin të shqipes për faktin se qëndron mes Çetës së Profetëve dhe gramatikës së parë të gjuhës shqipe “*Dorëshkrimi i Grottaferratës*” (1710), gramatikes së Françesko da Leçes “*Vëzhgime gramatikore për gjuhën shqipe*”(1716) dhe “*Doktrinës së Kërshenë*” të Gjon Kazazit (1743).

Si teksti më i gjërë i pjesës së parë të shekullit XVIII, për pasurinë e gjuhës së përdorur dhe ndihmesën në stabilizimin e shqipes letrare në kuadrin verior, teksti i Kuvendit të Arbënit mund të merret si urë lidhëse ndërmjet shqipes së vjetër dhe shqipes së re.<sup>328</sup>

---

<sup>326</sup> S.Mansaku “*Kuvendi i arbënit në historinë kulturore e gjuhësore shqiptare*, Kuvendi i Arbënit 300-vjetori, Lezhë, 2007.f. 105

<sup>327</sup> R.Ismajli, *Gjuha shqipe e Kuvendit*, vep.cit. f. 13

<sup>328</sup> Koleç Topalli, Disa veçori gjuhësore të tekstit të ‘Kuvendit të Arbënit’, Studime filologjike, 3-4, 2003, f. 88

## V.1 Gjuha e Kuvendit të Arbënit nga aspekti dialektor

Kuvendi i Arbënit i mbajtur më 14 e 15 janar të vitit 1703 mbledhi krerë katolikë shqiptarë, priftërinj, rreth 200 besimtarë shqiptarë,<sup>329</sup> për probleme që preknin një pjesë të popullsisë së Shqipërisë. Me të drejtë lind pyetja se ç'gjuhë mund të jetë përdorur gjatë tubimit. Pa dyshim që është përdorur gjuha shqipe, pasi latinishtja si gjuhë e huaj njihej nga një numër i vogël klerikësh, dhe këta të huaj, sepse klerikët shqiptarë e për më shumë besimtarë të thjeshtë pjesëmarrës në tubim, për shkak të nivelit të ulët arsimor, nuk mund të njihnin latinishten. Por, përveç shqipes kuptohet se në tubim do të jetë përdorur dhe latinishtja, gjuha zyrtare e Kishës Katolike. Më lart u tha se teksti i kuvendit ndihmoi në stabilizimin e shqipes në variantin verior dhe lidhur me këtë nuk ka asnjë dyshim nga studiuesit. Po me të drejtë Ismajli shtron pyetjen: cila gegërishte është përdorur? Vinçenc Malaj pohon se baza dialektore e këtij teksti është ajo e Malësisë së Madhe. Sipas Ismajlit, tezë e mbështetur dhe nga Demiraj<sup>330</sup> teksti na jep një pasqyrë të qartë të gjendjes së shqipes veriperëndimore.

Po sipas Demirajt<sup>331</sup>, Malajt<sup>332</sup> përkthyesi i tekstit të Kuvendit është ndikuar shumë nga gjuha e shkrimtarëve veriorë të shekullit XVII, veçanërisht nga gjuha e Bogdanit si vepra më e afërt me të. Ismajli<sup>333</sup> radhit një sërë veçorish fonetike e morfologjike që dallojnë gegërishten veriperëndimore Ja disa prej tyre:

Kalimi i grupeve kl, gl në ki, gi<sup>334</sup> dukuri fonetike tipike e gegërishtes veriperëndimore.

Ruajtja dhe dominimi e grupit zanor *ue* në raport me grupin zanor *uo*. Pra, në tekstin tonë zhvillimi i *uo*: *ue* kishte përfunduar ashtu siç vërehet dhe te Bogdani. Prania e zanoreve të gjata të patheksuara në pozicion paratheksor dukuri që nuk ekziston në gegërishten verilindore.

Ismajli vijon më poshtë me elemente të tjera jo të rrafshit fonetik, por të atij morfologjik e leksikor.

Sipas tij<sup>335</sup> në tekstin tonë gjejmë mbaresën e foljeve në të kryerën e thjeshtë me *e* të tipit *u lodhme, plasme*, tipike të folmes së Shkodrës e Lezhës.

---

<sup>329</sup> Sipas Ismajlit, vep.cit. f. 24 “në atë kuvend morën pjesë kryeipeshkvi i Durrësirt, ai i Shkupit, ipeshkvi I Sapës, i Lezhës, i Shkodrës, I Pultitt, katër vikarët gjeneralë të misionit, prefektët e provincave franciskane të Shqipërisë e të Maqedonisë”

<sup>330</sup> Rreth Kuvendit të Arbënit 1703, Kuvendi i Arbënit 300 –vjetori, f. 20

<sup>331</sup> Po aty.f. 21

<sup>332</sup> Po aty. f. 156

<sup>333</sup> Vep.cit.f. 246 e tutje.

<sup>334</sup> Për më shumë është folur në kapitullin mbi fonetikën shih.f.

<sup>335</sup> Po aty f. 249



Ruajtja e bashkëtingëllores *nj* në mbaresat e foljeve kur në të folmet e tjera jotizimi kishte filluar më herët, ndonëse dhe në tekstin tonë ka raste të parnisë së *j*.

Përdorimi i shpeshtë i përemrit *qish*, tipik i të folmes veriperëndimore.

Një element tjetër është dhe përdorimi i rrjedhore me mbaresën *-et -lopet* për të mos harruar pa përmendur dhe parafjalën *n*, të cilën Ismajli e quan parashtesë me origjinë parafjalore, dhe që në tekstin tonë del shumë shpesh, ndërsa te Bogdani dhe gegërishtja verilindore jo aq.

Demiraj<sup>336</sup> vëren përdorimin e numërorit *katërzet* në vend të numërorit *tetëdhjetë*, tipike e gegërishtes veriperëndimore, si dhe përdorimin e trajtës *shpënesë*, në vend të trajtës më të zakonshme *shpëresë* > *shpresë*. Bazuar mbi këto elemente Malaj<sup>337</sup> dhe Ismajli<sup>338</sup> me njëfarë rezerve, si rezultat i tendencave normatizuese dhe i përzierjeve të elementeve të të folmeve të ndryshme, duke u nisur dhe nga pasiguria e autorit të përkthimit si shqipfolës joburimor, shkojnë më tej duke u shprehur se kemi të bëjmë me të folmen e Malësisë së Madhe apo të Krajës.

## V. 2 Shtresat leksikore leksikore të gjuhës së Kuvendit të Arbënit

Nga aspekti leksikor, teksti i Kuvendit të Arbënit, pohon me të drejtë Ismajli<sup>339</sup>, paraqet një thesar. Si një tekst i plotë me rreth 100 faqe, me një shqipe të pasur e të larmishme, ky tekst mbetet një dokument i rëndësishëm nëpërmjet të cilit mund të shqyrtohet pasuria e fjalorit, përdorimi i fjalëve shqipe<sup>340</sup> dhe mbi të gjitha shkalla e huazimeve nga gjuhë të ndryshme, duke u nisur nga fakti se autori i përkthimit si shqipfolës joburimor nuk ka pasur një qëndrim të prerë e të kujdesshëm ndaj përdorimit të leksikut të huazuar. Në tekstin shqip të kuvendit vërehet një numër i madh huazimesh. Siç u tha më lart, dhe siç shkruan Ismajli autori duke mos qenë shqipfolës burimor si Budi, Bogdani nuk ka pasur një qëndrim selektiv, dhe normues ndaj leksikut.<sup>341</sup> Kjo, sipas nesh vjen dhe si rezultat i mosnjohjes së fjalëve shqipe dhe huazimeve. Të bësh dallimin ndërmjet tyre kërkon punë dhe njohje të mirë të një gjuhe, për këtë arsye, mendojmë se

---

<sup>336</sup> Rreth Kuvendi.t..vep.cit. f. 22

<sup>337</sup> Vep.cit.f. 158, 174

<sup>338</sup> Vep.cit. f. 250

<sup>339</sup> Vep.cit. f. 233

<sup>340</sup> Shih Ashta, *Leksiku i nxjerrë nga Kuvendi i Arbënit*, BSHSH, Shkodër, 1978-1981

<sup>341</sup> Po aty.f. 233

autori i përkthimit ka bërë zgjedhjen duke u nisur nga shkalla e depërtimit të huazimeve në gjuhën e popullit.

Një punim interesant mbi leksikun e tekstit të Kuvendit të Arbënit mbetet ai i Kolë Ashtës,<sup>342</sup> për të cilin është folur në fillim. Autori ka nxjerrë leksikun e plotë të veprës duke shpjeguar jo vetëm kuptimin, por dhe duke dalluar huazimet nga fjalët shqipe.

Në këtë fushë shtresa leksikore e orientalizmeve paraqet interes, për faktin se numri i huazimeve turke është relativisht i madh krahasuar me veprat e autorëve të Veriut. Kështu në tekst mund të vërehen këto turqizma:

*ashiqare, bereqet, haraç, hesap, mahalla, tefteri, zaman, batall, divanisht, ajn, amanat, beganissune, bezdisune, çoban, buri, çallastija, çapraz, mehlem, nahije, pazar, derman.*

Numri i madh i turqizmeve, shpjegohet me faktin se në kohën kur është përkthyer teksti kishin kaluar më shumë se dy shekuj të pushtimit osman dhe se shqipja ishte e tejmbushur me turqizma, aq shumë sa ato kishin zënë vend dhe në terminologjinë kistare katolike, vëren me të drejtë Ismajli.<sup>343</sup> Sa më shumë shekuj pushtimi kalonin aq më shumë orientalizmat zinin vend në gjuhën shqipe. Kjo dukuri vërehet në përkthimin e ri të Radojës më 1872, tek i cili numri i orientalizmeve është shumë herë më i madh. Dhe Studiuesi Demiraj e sheh këtë dukuri dhe si rezultat të ndikimit të dukshëm të së folmes popullore mbi gjuhën e përkthyesit të Kuvendit të Arbënit.

Një tjetër shtresë leksikore është dhe ajo e huazimeve sllave, të cilat ndyshe nga ato turke, paraqiten më të pakta.

Disa nga huazimet sllave: *bëgati, brigëtuem, megjet, mërziçim, oborr, porost, livadh, robinjë, nevojë, zakon, lakmi, gosti..*

Një tjetër shtresë leksikore që bie në sy menjëherë është ajo e italianizmeve. Në fakt numri i madh italianizmeve nuk haset vetëm në tekstin tonë, por dhe në tekstet e tjera të vjetra.<sup>344</sup> Kjo dukuri, siç është pranuar nga studiuesit, ndodh si rezultat i ndikimit gjuhësor italian, të thellë e në shumë rrafshë të gjuhës, për të mos lënë pa përmendur dhe ndikimi historiko-kulturor i botës italiane mbi atë shqiptare.<sup>345</sup> Numri i madh i italianizmeve shpjegohet dhe me faktin se lloji i letërsisë që u lëvrua nga autorët e vjetër që ai fetar- didaskalik, rrjedhimisht ishin

---

<sup>342</sup> Vep.cit. BSHSH, 1978-1981

<sup>343</sup> Po aty.f. 235

<sup>344</sup> Mbi italianizmat në tekstet e vjetra të shihet libri i Kristina Jorgaqit, *Ndikimi i italishtes në letërsinë e vjetër shqipe (XVI-XVII)*, Tiranë, 2001.

<sup>345</sup> *Historia e letërsisë...* vep.cit.f. 186, 194; Eqrem Çabej, Hyrje në "*Mesharin e Gjon Buzukut*", në *Studime gjuhësore*, vëllimi VI, Prishtinë, 1976, f. 229- 233

tekste me përmbajtje të theksuar fetare. Në to sigurisht do të zinin vend të veçantë terma e fjalë abstrakte, në të cilat shqipja e atëhershme që e varfër dhe nuk mund t'u përgjigjej e vetme nevojave që dilnin për lëvrimin e tremave të tillë etj.<sup>346</sup>

Si italianizma kemi konsideruar këto fjalë:

*avisuem, debëluem, brevial., mbastuem, delikall, pagë, palanka, pancir, perikull, postafat, rakomandim, respoñduem, reneguem, esaminuem, dispensë, etj.*

Megjithatë, një çështje disi e vështirë për t'u zgjidhur mbetet dallimi i italianizmave prej latinizmave, jo vetëm te Kuvendi, por dhe te autorët e tjerë. Siç e kemi thënë dhe më lart, pjesa më e madhe e teksteve të vjetra janë përkthime nga italishtja ose nga latinishtja. Si rezultat, janë disa fjalë me të njëjtën formë, burimi i të cilave nuk është i sigurt, pra nuk mund të pohojmë me siguri nëse janë italianizma apo latinizma.<sup>347</sup> Teksti ynë përmban një numër ët madh huazimesh latine që paraqesin karakteristika depërtuese të hershme<sup>348</sup>, sepse janë të shndërruara siaps kërkesave fonetike tipike të shqipes, të përbashkëta dhe me autorë të tjerë.<sup>349</sup> Megjithatë, Ashta<sup>350</sup> ka dalluar këto huazime latine përfshirë dhe ato kishtarë: *litini, limuem, luftë, mallëkim, mëndyrë, minister, mjediçinë, mjeshtrë, obediencë, origjinall, dami, doktrinë, libëruem, regjinoj, pushteteja, provincie, primat, plagë, orakull* etj.

Ajo që vihet re është numri i paktë i greqizmave si: *panegjyr, qefallia, dispo, stolisë, kallogjer, ortodhoks, qiri, sosë, vromë* etj. Për të gjitha shtresat leksikore të tekstit të shihen Malaj<sup>351</sup> dhe Ashta.<sup>352</sup>

Shtresa leksikore më e madhe mbetet ajo e italianizmave, për faktin e thjeshtë se teksti është përkthim nga latinishtja dhe me siguri dhe autori i përkthimit njëhte dhe italishten gjithshu.

---

<sup>346</sup> K.Jorgaqi. vep.cit. f. 17

<sup>347</sup> Këtë dukuri e ka vërejtur dhe K.Jorgaqi, në librin e saj, vep. cit. f. 22-28

<sup>348</sup> E.Çabej, Hyrje në historinë e gjuhës shqipe, Prishtinë, 1970, f. 55-60

<sup>349</sup> Malaj, vep.cit.f. 160

<sup>350</sup> Vep.cit.

<sup>351</sup> Po aty. f. 159-161

<sup>352</sup> Po aty.

## Kreu VI

### Vërejtje rreth përkthimit shqip të tekstit latin

Siç është thënë në fillim të punimit, materialet e Kuvendit të Arbënit u botuan në Romë në vitin 1706 në gjuhën latine dhe atë shqipe. Teksti latin u hartua nga vetë Zmajeviçi, si njohës i shkëlqyer i gjuhës dhe i kulturës latine dhe njihet si autori i vetëm i versionit latin.<sup>353</sup> Por, ndryshe qëndron puna kur shtrohet çështja mbi autorësinë e versionit shqip. Studiuesit janë shprehur dhe kanë hedhur mendime të ndryshme mbi autorin e mundshëm të tekstit shqip, megjithatë dhe sot e kësaj dite autori i përkthimit mbetet i panjohur. Vinçenc Malaj<sup>354</sup> hedh një hipotezë duke e arsyetuar atë dhe nxjerr si përfundim mendimin se autori i përkthimit mund të ketë qenë P. Exhidio d'Armento, prefekti apostolik i provincës kishtare të Shqipërisë dhe bashkëpunëtori i pandarë i Zmajeviçit. Mbi këtë çështje Rexhep Ismajli thotë:

«Vinçenc Malaj, duke u nisur nga fakti se Zmajeviçi nuk dinte shqip, pastaj nga rrethanat e tjera që e shpien te një autor që do të jetë ndodhur pranë Zmajeviçit një kohë më të gjatë për ta përfituar besimin e tij, dhe nga fakti se i tillë ishte vetëm Exhidio d'Armento, nxjerr përfundimin se ky është autori i përkthimit. Për ne është e pamundur që kjo tezë qoftë të përfillet, qoftë të hidhet, për shkak se i gjithë argumentimi i saj është jodeciziv, ndërsa nuk kemi asfarë shenjash të tjera që do të na thoshin nga ana tjetër se ai nuk është autor i tekstit. Në këto rrethana na duket më e drejtë të themi se nuk e dimë autorin e përkthimit»<sup>355</sup>

Megjithatë, mendimi i përgjithshëm i mbështetur nga studiues të tjerë njeh si autor të përkthimit Françesko Maria da Lecce-n<sup>356</sup>. Pika kryesore ku mbështeten është fakti se da Lecce ishte i pranishëm në mbledhjen e Kuvendit dhe është një nga nënshkruesit e akteve të Kuvendit. Një nga këta studiues është Kolë Ashta<sup>357</sup>, i cili ka parashtruar disa argumente sipas të cilave da Lecce duhet të jetë përkthyesi i tekstit. Sipas tij, prania e Da Lecces në nënshkrimin e akteve të Kuvendit, datat e botimit dhjetor 1703 deri shtator 1705, të cilat përkrijnë me kohën e qëndrimit të tij në Romë, njohës i shkëlqyer dhe për disa vjet mësues i gjuhës shqipe, afëria e gjuhës së tekstit

---

<sup>353</sup> Malaj. Vep.cit.f. 97

<sup>354</sup> Të shihet Malaj, Kuvendi i Arbënit, f. 135

<sup>355</sup> Vep.cit.f. 47-48

<sup>356</sup> Francesko Maria Da Lecce, autor i gramatikës më të parë të gjuhës shqipe me titull "*Osservazioni grammaticali nella lingua albanese*", Roma, 1716

<sup>357</sup> Kolë Ashta, *Da lecce, Gramatika e parë shqipe*. Botuar më 1716. Shkodër 1966.

të Kuvendit me gjuhën e gramatikës së shkruar prej tij janë arsye të mjaftueshme, të cilat përforcojnë mendimin se Da Lecce është përkthyesi. Një tjetër studiues, i cili është marrë me jetën dhe veprën e da Lecces është G.Gurga. Ky studiues në punimin e tij serioz<sup>358</sup>, sjell fakte që vërtetojnë se da Lecce nuk mund të jetë përkthyesi i akteve të Kuvendit. Më poshtë po japim të plotë pjesën në të cilën Gurga shprehet mbi auroresinë e versionit shqip.

*“Në dritën e dokumenteve që kemi shqyrtuar mund të themi me siguri se da Lecce nuk mund të ishte autori i përkthimit. Teksti latinisht i akteve hapet me kushtimin që i bën Zmajeviçi papës Klementi XI, në fund të të cilit lexojmë datën, Perast 10 korrik 1703: Datum Perasti die X Julii anno Domini MDCCIII. Pra, Zmajeviçit u deshën së paku 6 muaj për të hartuar tekstin latinisht të akteve. Mirëpo në korrik të vitit 1703 da Lecce nuk ndodhej në Perast, e madje nuk ndodhej as në Shqipëri. Nga një letër që i shkruan Kongregatës nga manastiri S. Francesco a Ripa në Romë më datë 12 prill 1704 mësojmë se në qershor të 1703 da Lecce ishte në Durrës<sup>63</sup>. Ndërsa nga një tjetër letër nënshkruar më 7 shtator 1703 nga Lecce ku dergjej i sëmurë, ai thotë se mbërriti në Brindizi më datën 14 korrik të atij viti.”*

Nisur nga fakte të tilla bazuar në dokumente reale të historisë nuk mund të mos jesh dakord me Vinçenc Malaj kur mendonte se ishte pikërisht prefekti apostolik i provincës kishtarë të Shqipërisë dhe bashkëpunëtori i pandarë i Zmajeviçit, ai që e bëri kreu përkthimin shqip të akteve të Kuvendit.

Bazuar mbi burime të sigurta Gurga vijon me fakte të mbrojtë idenë e tij se Egidio d’Armento është autori i përkthimit.

*“Këtë bindje e mbështesim në një dokument që kemi gjetur në arkivin e Propagandës: Në fillim të vitit 1705 françeskani Alberto da Bologna i dërguar për një vizitë apostolike në provincën e Shqipërisë, propozon për vendin e provincialit të misionarëve françeskanë, vend që kishte mbetur vacant qysh prej mosnjohjes së zgjedhjes së da Lecce-s në këtë detyrë, prefektin Egidio d’Armento, i cili ndërkohë mendohej të dërgohej në Romë për të mbikëqyrur shtypjen e akteve të Kuvendit të Arbënit. Në raportin e tij Alberto da Bologna thotë se largimi i Egidio d’Armento-s nga Shqipëria do ta dëmtonte shumë mbarëvajtjen e punëve atje, kështu që ai kërkon që në vend të tij, për të ndihmuar shtypjen e akteve të dërgohet da Lecce.*

---

<sup>358</sup> Francesco Maria da Lecce *DITTIONARIO Italiano-Albanese* (1702) Hyrje, botim kritik i dorëshkrimit e fjalësi shqip përgatitur nga Gëzim Gurga, Biblioteka Françeskane “At Gjergj Fishta” Botime Françeskane, Shkodër 2009, f. 32-34.

*“Vërtet i pari, pra Egidio d’Armento, e shkroi tekstin, por i dyti, da Lecce, nuk ishte më i pakët në njohjen e gjuhës shqipe, aq më tepër që ky mund të shfrytëzonte rastin për të shtypur edhe gramatikën e shqipes që kishte shkruar”. Doemos që da Lecce, në cilësinë e mbikëqyrësit të shtypit dhe ndreqësit të bocave do të ketë ndërhyrë në tekst. Ndryshe nuk mund të shpjegohen përkimet e shumta me sistemin grafik dhe gjuhën e da Lecces. Gjithsesi kjo çështje do të sqarohet përfundimisht vetëm nëse do të gjendej dorëshkrimi apo dorëshkrimet që shërbyen për botimin e akteve. Vetëm atëherë do të mund të përcaktonim me siguri se sa dorë ka da Lecce në këtë punë”.*

Nisur nga faktet e mësipërme, me të drejtë të gjithë studiuesit pa përjashtim, janë të mendimit se autori i përkthimit nuk është shqipfolës burimor, por një njohës relativisht i mirë i shqipes, siç pohon Ismajli në fillim të punimit të tij<sup>359</sup> mbi tekstin e Kuvendit. Pas këtij pohimi lind me të drejtë pyetja: a kemi të bëjmë me një përkthim të mirë?

Përkthimi i parë i akteve të Kuvendit të Arbënit, në vija të përgjithshme nuk është përkthyer drejt. Ashtu siç është pohuar dhe nga studiuesit, Rexhep Ismajli<sup>360</sup>, Vinçenç Malaj<sup>361</sup> kemi të bëjmë me një përkthim jo të mirë e me të meta. Për këtë arsye, ndër botimet e mëvonshme që njohu teksti i Kuvendit të Arbënit që dhe përkthimi i ri i tekstit latin dhe botimi i tij në gjuhën shqipe nën kujdesin e një prifti shqiptar, At Engjëll Radoja në vitin 1872, njohës i shkëlqyer i latinishtes.

Sipas Ismajlit<sup>362</sup>, kemi të bëjmë me një përkthim *ad litteram*, ku morfemat e shqipes shpesh dalin me funksione të morfemave të latinishtes duke sjellë fjali të vështira dhe të paqarta. Besnikëria ndaj origjinalit ka shkuar deri në ruajtjen e rendit të fjalëve të tekstit burimor. E është pikërisht këtu që lindin probleme dhe pasaktësira të mëdha. Këto vështirësi dhe gabime vijnë si rezultat i përkthimit të fjalëpërfjalshëm, pasi autori duke mos njohur mirë gjuhën shqipe nuk ka marrë parasysh faktin se shqipja dhe latinishtja janë dy gjuhë të ndryshme dhe rrjedhimisht strukturat e tyre jo gjithnjë përputhen. Në tekstin shqip shumë shpesh është ruajtur rendi i fjalëve të tekstit latin, duke sjellë fjali jo tipike të shqipes dhe ndërtime gramatike jo të sakta. Meqënëse prekëm çështjen e rendit të fjalëve të fjalisë latine, mendojmë se do të ishte mirë të njiheshim më nga afër me natyrën e fjalisë së gjuhës latine.

- Rendi i fjalëve në fjalinë latine shpesh nuk është i njëjtë me rendin e fjalëve të gjuhës shqipe. Dihet që latinishtja është një gjuhë me sistem fleksioni emëror e

---

<sup>359</sup> Vep.cit. f.11

<sup>360</sup> Ismajli, vep. cit. f. 241

<sup>361</sup> Malaj, vep. cit. f.177 e tutje.

<sup>362</sup> Po aty, f. 241 - 243

foljor mjaft të zhvilluar e të pasur, me numër të madh mbaresash, falë të cilave identifikohen rasiat, pa qenë nevoja e ngulitjes së rendit të fjalëve, siç ndodh në gjuhë e reja si anglishtja, frëngjishtja, italishtja etj. Nën këtë aspekt latinishtja gëzon liri absolute të rendit të fjalëve. Shqipja gjithashtu, shquhet për rend relativisht të lirë të fjalëve, ku gjymtyrët e fjalisë mund të vendosen në vende të ndryshme pa e ndryshuar funksionin e tyre sintaksor.<sup>363</sup> Le të marrim një shembull për të krahasuar këto dy gjuhë;

***Romulus occidit Remum.*** - Romuli vrau Remin.

***Remum occidit Romulus.*** – Remin e vrau Romuli.

Në gjuhën latine të dyja frazat kanë të njëjtin kuptim. Po kështu dhe në gjuhën shqipe kemi të njëjtën dukuri. Ndryshimi i vetëm është ekzistenca e trajtës së shkurtër me anë të së cilës rimerret kundrina e drejtë, kur kjo e fundit del para kallëzuesit dhe kryefjalë.

- Në fjalinë latine përcaktori me drejtim shpesh vendoset para emrit nga i cili varet, ndërsa në gjuhën shqipe ndodh e kundërta. Të krahasohen shembujt e mëposhtëm

***discipuli liber*** – libri i nxënësit.

***Romae historia*** – historia e Romës

Megjithatë ka dhe raste ku gjejmë dhe rendin e drejte dhe duke pasur të njëjtin rend si në shqipe.

***liber discipuli***

***historia Romae***

- Siç u tha dhe pak më lart, kundrinori i drejtë mund t'i prijë kryefjalës ashtu si dhe në shqipe.<sup>364</sup>

- Folja shpesh vendoset në fund të fjalisë, por mund ta gjejmë shumë mirë dhe në pozicione të tjera.

---

<sup>363</sup> Gramatika e gjuhës shqipe, vep.cit.f. 413

<sup>364</sup> Këtë dukuri nuk e gjejmë në gjuhë pa fleksion të zhvilluar ku gjejmë rend të ngulitur të fjalëve. si anglishtja e italishtja: Psh: *Lo studente legge un libro/ The student reads the book.*

Pra, nuk mund të ndiqet një rregull i caktuar, sepse duhen marrë në konsideratë disa nivele të gjuhës: niveli morfo-sintaksor, pragmatik dhe veçanërisht niveli stilistik. Sidomos nga ky i fundit varet vendi i foljes në fjali.

- Latinishtja karakterizohet nga një lakonizëm i theksuar krahasuar me gjuhë të tjera, përfshirë dhe shqipen. Për këtë arsye kur përkthejmë nga latinishtja, pothuajse gjithnjë jemi të detyruar të përdorim më shumë fjalë për të realizuar kumtimin. Psh:

***Frangar, non flectar***

Mund të thyhem, por nuk do të dorëzohem

Shumë shpesh si tendencë për përdorim të një numri të vogël të fjalëve, në fjali mungojnë ose hiqen elemente të cilat nënkuptohen lehtë.

***De nihilo, nihil.***

Nga asgjëja s' del gjë.

***Non accipimus brevem vitam, sed facimus***

*Nuk na dhurohet jetë e shkurtër, por e bëjme ne të shkurtër.*

Pasi u njohëm me natyrën e fjalisë dhe të gjuhës latine, vendin e gjymtyrëve të fjalisë, mund të shohim konkretisht me shembuj, nëse studiuesit kanë pasur të drejtë kur kanë pohuar përkthimi i tekstit latin të Kuvendit të Arbënit lë për të dëshiruar.

Ajo që bie në sy menjëherë është ruajtja e rendit të fjalëve (*ordo verborum*) të fjalisë së tekstit burimor dhe përkthimi i fjalëpërfjalshëm i tyre.

Si latinishtja dhe shqipja deri diku, shquhen për liri të vendosjes së fjalëve në fjali, falë fleksionit të zhvilluar të të dyja këto gjuhë, megjithatë, jo gjithnjë strukturat përputhen. Për këtë arsye teksti është i tejmbushur me fjali të paqarta e të vështira. Siç do të mund të shihet nga shembujt, besnikëria ndaj tekstit origjinal nuk bën gjë tjetër veçse dëmton strukturat reale të shqipes duke na dhënë fjali që për një shqipfolës nuk tingëllojnë si të sakta nga ana gramatikore.

Gjuha latine siç u theksua më lart njihet si një gjuhë me rend të lirë, ndryshe nga shqipja, e cila në disa raste, njeh ndërtime fjalish me rend të ngulitur, ndonëse rendi i gjymtyrëve së fjalisë në shqipe nuk është bërë shpesh objekt studimi nga ana e studiuesve. Ngulitja e rendit të fjalëve në gjuhën shqipe vërehet të prapavendosja e disa prej përcaktorëve të pavetëmjaftueshëm dhe te



paravendosja e disa të tjerëve. Demiraj i ndan këto përcaktorë në dy grupe. Në grupin e parë bëjnë pjesë mbiemri, përemrat pronorë, rasa gjinore dhe vendi i tyre është prapa emrit që përcaktojnë. Sipas studiuesve<sup>365</sup> *prirja për t'i prapavendosur këta përcaktorë të emrit, duhet të jetë relativisht shumë e vjetër, por ajo që mbetet për t'u sqaruar është fakti nëse dikur këta përdorshin si para dhe pas emrit, apo vetëm para tij*". T'i japësh përgjigje të saktë kësaj pyetje mbetet një çështje e vështirë, pasi shqipja është e dokumentuar relativisht vonë. Në grupin e dytë bëjnë pjesë përcaktorët e mëvetësishëm që mund të përdoren si gjymtyrë më vete. Të tillë janë numërorët, themelorë, përemrat dëftorë, të pacaktuarit dhe pyetësit, vendi i të cilëve është para emrit, si një prirje e gjuhës e indoevropiane. Mendimi i përgjithshëm mbetet ai se shqipja, ashtu si gjuhët e tjera indoevropiane ka pasur të zhvilluar prirjen për të pasur rend dhe më të lirë. Në tekstin shqip të Kuvendit të Arbënit jo rrallë i shohim përcaktorët e grupit të parë, të vendosur para emrit që përcaktojnë, njësoj si dhe në tekstin latin. Të vërehen shembujt e mëposhtëm.

*Caetera item omnia a sacris canonibus..* (f. 17)

giçç **te tiera** lighia, chi jane lane mbë të tierë Sinnodetë Kattolike.... (f. 4)

*quemadmodum omnes huius Sacramenti **summa** premimur necessitate*  
(f. 37)

*Pò persè mcatete baam mbas Pagheimit lahen me Sciacrament t'e*  
*Peendessese sicuur giçç kemi **te maçe** nevoje per ketà....* (f. 28)

*Dolemus quidem referre **miserrimam** nostrarum Ecclesiarum **faciem*** (f. 43)  
*Per te vertete kecch kemi me deftuem **te mieren fetyren** e Kisciavet tona*  
(f. 35)

*patrumque Orthodoxorum testimonia, et Romanae Sedis **infallibilis***  
*auctoritas* (f. 19)

*descmignenat e Ateiivët, Ortoçoxet, e **paa fi8escime puscteteja** e Seliesë*  
*Romese* (f. 6)

Kjo dukuri, për mendimin tonë është thjesht një ndikim nga teksti latin, dhe bazuar mbi këto shembuj nuk duhet të hidhen hipoteza se shqipja në atë fillim të shekullit XVIII, kishte prirje të paravendosjes së përcaktorëve.

Edhe nga shembujt të tjerë dhe përqasjet që do të bëjmë do të vërehet se përkthyesi dhunon strukturat reale të shqipes për t'i futur në modelet e

---

<sup>365</sup> Gramatikë historike e gjuhës shqipe, vep e cit f. 534

latinishtes duke na sjellë një pasqyrim jo të vërtetë të këtyre strukturave nisur nga fakti se jo gjithnjë strukturat e latinishtes përputhen me ato të shqipes.

Të vihet re përkthimi ad litteram i tekstit latin, ruajtja e rendit të fjalëve në fjalitë e mëposhtme sidomos folja në fund të fjalisë shumë e shkëputur nga kryefjala, prapavendosjen e përcaktorëve përemërorë siç ndodh në tekstin latin duke sjellë fjali të paqarta e të vështira për t'u kuptuar.

*Parochis quoque omnibus, et ilis praesertim, quibus sanctae Sedis pietas in Apostolicis Collegiis, Alumnorum numero adscriptis, virtutum semina, et incrementa ad Fidem Propagandam contulit, praecipimus et mandamus..*

(f. 24)

*Parrochianevet ende giççeve, e maa mposs Alumnevet, chi per te maçe miscierire te Selise Apostolike jane kiene mbaitune e mpsuem nde Collegii per te sciummuemite Scendese Fee, ççome e urçenoime (f. 12)*

*Nihil nobilius, nihil pretiosius, nihilque ad aeternam salutem consequendam magis necessarium habet Ecclesia, quam a Christo Domino septem institute Sacramenta (f. 29 )*

*As giàa màa te beganiscim, as giàa màa te pacimuescime, as giàa màa te nevoiscime kàa Kiscia per t'u passune scendeteja e paa sossune se te sctatta Scecramenta çane prej Crisctit eotit tine.....(f. 19)*

*Deo igitur soli, cui servire, regnare est, per externam, et publicam Fidei confessionem sit devotus fidelis..... (f. 21)*

*Vece Hyit praa, "cui me scerb8em, asct me eotenuem:" te truhet, e te fallet i Feescimi, e mballafacchie te cui dò ta refegn ..... (f. 8)*

*Cum autem aequum sit, ut sancta a sanctis tractentur, et divinorum Mysteriorum praestantiae dispensatorum quoque dignitas respondeat, sacrosanta tractaturi sacramenta, exhibeant se, sicut Dei ministros in omni iustitia, et sanctitate..*

(f. 29)

*Tue kiene me lig, Kinese cafschia te scenta, prej Scentesc te jene precune, e puscteteja e t8ne, chi appne te scogn mbaras me stole te Misterievet H8inuescim, atà chi kane per te precune Scecramenta te scenta te scerbegnene si scerbetorete ..... (f. 19)*

*Quamvis vero baptizandi munus ad Parochum solum pertineat, instante tamen viate discrimine, omnibus, et in quolibet loco demandatur (f. 31)*

*E nde se vece Parrochianevet perket me pagheuem prò, nde fiil temorse giçç  
cui, e cu dò, ep lighia* (f. 21)

*Ecclesiis temporum iniuria collapsis, et vetustate consumptis, nec vel ob  
debaccantem infidelium impietatem* (f. 66)

*Mbas kisciasc se ruzueme n'moccimijet, ndo prej termekut reenuem, chi prej se  
paa lighie se Turchiet* (f. 61)

*Sunt Parochi animarum Pastores, in partes vocati Episcopalis sollicitudinis, in  
crediti Dominici gregis custodia excubantes, laborantes, desudantes.*

(f. 69)

*Jane Parochit Bariit e Scpirtinavet vum mbe vend te piessese ruituni, e se  
mbaituni, chi biè nde stræe te grighiese, tue u munduem, e tue u perdiarsune.* (f.  
66)

Besnikëria ndaj origjinalit vërehet dhe kur autori, ndoshta i detyruar të bëjë këtë gjë për shkak të ndërtimit të tekstit në të cilin mbizotërojnë nota të rrëfimit, përkthen një pjesore me pjesore, mbiemër me mbiemër.

***Oppressam*** *Dominam Gentium doloris amaritudine* (letra dërguar Papës)

*Σογνενε e gindevet ngremuem me t'izunit se çimbtunit*

***Polluta*** *templa: shih letrën dërguar papas latinisht.* (Letra dërguar papës)

*Kisciate feligete: literet pegaam*

*Vidi (proh dolor) factam sub tributum* (Letra dërguar papës)

*Pae (uh te çimbtunit) vum ndene haraccin atà...*

Në tekstin shqip ka shumë fjali të pakuptueshme, të cilat jo gjithnjë vijnë si rezultat i besnikërisë ndaj origjinalit duke na dhënë morfemat e shqipes me të njëjtat funksione si të latinishtes. Për mendimin tonë duket se në tërësi autori i përkthimit nuk njihje mirë dhe latinishten, dukuri e vërejtur dhe nga Ismajli<sup>366</sup> dhe që ka sjellë probleme të mëtejshme gjatë përkthimit. Le të marrim nja dy shembuj. Në letrën dërguar Papës Klementi XI, autori shprehet:

*Iussis parui, circuivi terram, praeambulavi universam, vidi contritiones eius.*

---

<sup>366</sup> Vep.cit.f. 241

*Urçenove o i Lumscimi Ati, kinese me tevicituemit Apostolike te vee roe mbii Kisciat t;arbeniise Provintiese sime, Ndighiova urçenit; Suolla çene; Kercova Ruculimin: pae plagat e tii.*

Në tekstin latin folja *parēre* ndërtohet me rasën dhanore, në rastin konkret me emrin *iussis*. Me të njëjtin funksion në tekstin shqip na ëhsët dhënë me foljen *ndëgjoj* me kuptim „i bindem dikujt“ ndjekur nga emri në dhanore urdhënit, por pa trajtën e shkurtër *i*, tipike e shqipes, si rezultat nuk tingëllon mirë. Më tej autori vijon me gabime dhe në rastin kur përkthen me kallëzore togfjalëshin *circuivi terram,- suolla dhenë*, nësoj si në tekstin latin, në vend që ta përkthente me dhanore *iu solla dheut*, përsëri pa trajtën e shkurtër të dhanores. Me sa duket përkthyesi ose nuk i ka dhënë rëndësinë e duhur përdorimit të trajtë ose nuk i njihë ato.

Le të shikojmë dhe një rast tjetër kur autori nuk përdor trajtën e shkurtër të dhanores duke sjellë fjali kuptimi i së cilës nuk arrihet nga lexuesi.

*Confessariis praecipimus, ut de singulis divinae legis, et Ecclesiae praeceptis, nec non ....(f. 37)*

*Urçenogneme giççeve Refyessite, chi te mpsognene Populit Urçenimit e H8it e te Kiscese (f. 28)*

Dhe në nivel leksikor autori përkthen gabimisht. Në fjalinë *preambulavi universam – kërkova rruzullimin*, fjala *universam* përkthehet si *rruzullimi*, kur realisht autori aludon për vendin në tërësi. Le të shohim një shembull tjetër.

*Sperandum quidem est, deum Optimum Maximum, in cuius manu sunt omnium potestates, et omnium iura Regnorum (f. 85)*

*Asct praa per te passune scpnessen mbe Teneone prei temire, e prei temaçe ndore te cui jane giççe sundertaare, e pusctetat e giçç Regiinet (f. 84)*

Autori gabon përsëri kur përkthen *potestates* me kuptimin e *sundimtarëve*, kur realisht autori aludon për *mundësi, fuqi*. Gjithashtu autori gabon kur përkthen *iura* jo si *ligje*, por si *pushtete*. Nga shembujt e verifikuar mund të të krijohet përshtypja se autori nuk njihë mirë dhe latinishtes, pra përkthimi me të meta nuk ëhshtë rezultat vetëm i mosnjohjes së shqipes, por dhe të latinishtes. Gjërat vështirësohen më shumë kur bëhet fjalë për periudha të gjata, me disa fjali të nënrenditura, tipike të gjuhës latine. Për këtë arsye ndoshta siç vëren dhe Malaj<sup>367</sup> ka pjesë të përkthyer gabimisht ose të lëna pa përkthyer.

---

<sup>367</sup> Vep.cit.f. 178

Një mendim tjetër disi të ndryshëm shpreh dhe Demiraj<sup>368</sup>, kur pohon se ka mundësi që përkthyesi të mos zotëronte mirë latinishten, por sheh një mundësi tjetër të të metave, e pikërisht nga mundësia që përkthyesi të ketë qenë misionar i huaj, që nuk e kishte shqipen gjuhë amtare. Si rezultat, ai ka qenë gjithnjë nën ndikimin e gjuhës italiane. Si fakte në të mirë të këtij supozimi, Demiraj vëren kudo në tekstin e Kuvendit, trajtën *kunvend* për fjalën *kuvend*, një huazim nga latinishtja *conventus*. Me të drejtë pasi kudo, në të gjitha shkrimet e vjetra e gjejmë në trajtën *kuvend*. Të njëjtën trajtë e gjejmë dhe në botimin e vitit 1868. Në të mirë të kësaj teze është dhe përdorimi në mjaft raste i mbiemrit para emrit, gjë që e kemi vënë re pak më sipër.

Besnikëria ndaj origjinalit, siç u vu re nga shembujt e mësipërm, realisht ka shkuar larg, deri në dhunim të strukturave të shqipes, duke na dhënë pasqyrim jo të saktë të strukturave të mirëfillta të saj. Për këtë arsye, thekson Ismajli, bazuar në tekste të tillë është e vështirë të dalësh në përfundime të sakta lidhur me natyrën e vërtetë të një gjuhe, dhe në rastin tonë atë të shqipes së shekullit XVIII.

Megjithatë, edhe pse kemi të bëjmë me një përkthim nga një tekst latin, me përmbajtje juridiko – kishtarë, pra me funksion kryesisht fetar, ashtu si dhe tekstet e tjera të vjetra që ishin botuar para tij, teksti ynë mbart vlera.

Teksti shqip i “Kuvendit të Arbënit”, i vështuar edhe në rrafshin e mirëfilltë gjuhësor, përbën një korpus dhe burim të rëndësishëm për të studiuar zhvillimin historik të gjuhës së shkruar shqipe në gjysmën e parë të shekullit XVIII.

---

<sup>368</sup> Kuvendi, 300-vjetori, vep.cit.f.22

## Përfundime

Në këtë studim objektivi kryesor ishte vënia e shqipes përballë latinishtes, si dy gjuhë të ndryshme nga njëra –tjetra, në mënyrë që të shiheshin më nga afër potencialet e shqipes përballë gjuhës latine. Për këtë arsye zgjodhëm tekstin e Kuvendit të Arbënit të vitit 1706, si një tekst i një rëndësie të veçantë në kuadër të teksteve të vjetra të shqipes.

Në fillim të punimit, pasi hodhëm një vështrim mbi historinë e shkrimeve të shqipes dhe fillimeve të saj, rezultoi se kontaktet e para të shqipes me latinishten dhe ndikimet e rëndësishme të traditës latino-romane, janë të hershme dhe vërehen qysh në shkrimet më të para të shqipes, duke u shndërruar si një veçori e përbashkët që karakterizon të gjitha këto shkrime.

Në vijim, tekstin e Kuvendit e kemi parë nga aspekti i rëndësisë së tij në historinë kishtarë të shqiptarëve dhe vendit të tij në historinë e shkrimit të shqipes. Kuvendi i Arbënit i vitit 1703, si ngjarje me rëndësi, u mbajt me interesimin e drejtpërdrejtë të Papës Klementi XI, me origjinë shqiptarë, i cili siç është theksuar dhe në kapitullin përkatës, nxiti dhe përkrahu botimin e librave në gjuhën shqipe, përfshirë dhe botimin e materialeve të Kuvendit të Arbënit, në vitin 1706, duke çuar në pasurimin dhe konsolidimin e shqipes së shkruar. Botimi i librave në gjuhën shqipe prej klerit katolik shqiptar, siç thekson Çabej, është një veprimtari shumë e vyer gjatë disa shekujve dhe i shërbeu mbarë kombit shqiptar.<sup>369</sup>

Teksti i Kuvendit të Arbënit, i cili përmban aktet e kuvendit, i botuar fillimisht në gjuhën latine dhe në të njëjtin vit, i përkthyer dhe i botuar në shqipe, zë një vend të rëndësishëm në historinë e shkrimit të shqipes, duke u shndërruar në një burim të rëndësishëm të gjysmës së parë të shekullit XVIII për studimin e historisë së gjuhës së shkruar shqipe.

Për këtë arsye, në kapitujt pasardhës, jemi përpjekur ta shohim pikërisht në rrafsh gjuhësor.

Analiza e tekstit në aspektin gjuhësor sigurisht ka nxjerrë në pah një varg çështjesh të rëndësishme, që lidhen me të gjitha rrafshet e gjuhës, si ai fonetik, morfosintaksor e leksikor.grafinë dhe alfabetin e përdorur.

Grafisë së tekstit shqip nuk iu bë një përshkrim i detajuar, pasi nuk ishte objekt i studimit tonë dhe të tjerë studiues janë marrë pikërisht me rrafshin

---

<sup>369</sup> E.Çabej, *Meshari i Gjon Buzukut*, pjesa e parë, vep.cit.f. 22-23.

fonetik dhe analizën fonologjike të tekstit.<sup>370</sup> Duke u mbështetur në studimet e mëparshme dhe në analizën tonë, kemi arritur në disa përfundime.

Pikë së pari, gjatë përshkrimit të grafive kryesore, u vu re se në themel qëndron grafia latino-italiane dhe alfabeti latin, gjë që karakterizon të gjitha tekstet e vjetra të shqipes dhe në këtë kuadër teksti i kuvendit siguron vijimin e traditës së shkrimit të shqipes me alfabet latin, të filluar qysh herët me Formulën e Pagëzimit (1462) si dhe me librin e parë të shqipes, Meshari i Buzukut, shekulli XVI.

Gjatë analizës fonetike një vend të veçantë iu kushtua nxjerrjes në pah të dukurive më të rëndësishme fonetike, që vërehen në këtë tekst, në sistemin e zanoreve, si dyfishimi i zanoreve për të treguar gjatësinë e tyre, mungesa e e ndonjë shenje për të treguar hundoërsinë e zanoreve, ruajtja në disa raste e diftongut të hershëm *uo* dhe e grupeve grafike *ae* dhe *oe*, ruajtja e *ë*-së në pozicion pastheksor, paratheksor dhe atë fundor.

Në fushë të konsonantizmit u vu re ruajtja e *q*-së para një *t*-je, në fjalët si *pleqtë*, *zogjtë* etj duke iu afruar më shumë shqipes së sotme, prania e grupeve bashkëtingëllore *mb*, *nd*, *ng* dhe shndërrimi në *kj* e *gj* të grupeve të hershme përkatëse *kl* e *gl*, në fjalë si *gjak*, *gjuhë*, *gjej* etj.

Të gjitha këto veçori fonetike u vështruan duke i krahasuar dhe me ato të teksteve të tjera me rëndësi për historinë e gjuhës dhe nga ky krahasim rezultoi se teksti i Kuvendit të Arbënit ndjek një rrugë deri diku të afërt me tekstet e tjera të vjetra. Megjithatë, në të vihen re veçori, si mënjanimi i dyshkronjave, prirja drejt specifikimit të shkronjave të veçanta për të shënuar tinguj të veçantë si dhe ndarja e fjalëve njëra nga tjetra, sidomos të fjalëve proklitike dhe enklitike, të nyjave, të parafjalëve etj., duke ndihmuar në procesin e stabilizimit të shkrimit të shqipes. Këto dukuri nuk vërehen te Budi dhe autorë të tjerë para tij, të cilët nuk e kishin këtë veçori ku shkruanin. Por në ndonjë pikë të veçantë, grafia e tekstit të Kuvendit të Arbënit kthehet prapa në krahasim me ndonjë tekst të mëparshëm. Në të nuk bëhet dallimi i *e*-së nga *ë*-ja, të cilën Bogdani e bën më së miri me anë të theksit të rëndë mbi grafemën *e*. Një e metë tjetër që mund të veçohet është se, në tekstin tonë, nuk vërehet tendencën e dallimit të zanoreve hundore.

Ky studim kishte objekt kryesor analizën e mirëfilltë morfologjike e sintaksore të tekstit, por me kushtin që kjo analizë të arrihej në përfaqje me latinishten. Kapitulli i tretë *Shqipja përballë latinishtes në rrafshin morfo-sintaksor* përbën

---

<sup>370</sup> R. Ismajli, *Gjuha e kuvendit të Arbënit*, vep.cit., ku autori ka dhënë në mënyrë të përmbledhur dhe sistemin të latinishtes dhe të italishtes, duke u vënë përballë sistemin fonetik të shqipes

dhe boshtin e studimit tonë me natyrë përjasëse, duke vështruar veçoritë morfo - sintaksore të të dyja teksteve, si në sistemin emëror ashtu dhe në atë foljor.

Në rrafshin morfosintaksor, pas ballafaqimit të sistemit emëror të shqipes me atë të latinishtes u vu re se latinishtja ruan sistemin tri gjinish me një numër të konsiderueshëm emrash asnjës, ndryshe nga shqipja e cila ka vetëm një numër të kufizuar emrash asnjës. Në tekstin e Kuvendit, emrat e mirëfilltë asnjës të tipit *ujtë, vojtë, damtë*, të cilët i hasim në librin e Buzukut, i gjejmë si emra të gjinisë mashkullore, pra në trajtat e reja të shqipes, çka tregon se procesi i zhdukjes së gjinisë asnjëse në fillim të shekullit XVIII kishte shkuar më tej në krahasim me shekulin e XVI, shekulli i botimit të Mesharit të Gjon Buzukut. Megjithatë, gjejmë dhe disa emra të tipit *pushtet-ja, shëndet-ja, qytet-ja* me përgjegjëset e tyre në gjuhën latine *potestas, sanitas, civitas*. Këto emra në tekstin tonë, i gjejmë ashtu si dhe te Buzuku në gjininë femërore ashtu si dhe në latinishte, ndërsa në shqipen e sotme, siç dihet, ato kanë kaluar në emra të gjinisë mashkullore, në trajtat *pushteti, shëndeti, qyteti* etj.

Në punim është bërë njëkohësisht dhe një përshkrim sinkronik i dukurive gjuhësore, i cili na lejoi të krijojmë një ide të qartë lidhur me tiparet kryesore gjuhësore të shqipes së shekullit XVIII. Shpesh kemi ndërhyrë në shpjegimin e dukurive dhe arsyet që kanë çuar drejt ndryshimeve, duke bërë kështu dhe një përshkrim diakronik.

Nga përjasja e sistemit rasor të latinishtes me atë të shqipes, funksionet morfo-sintaksore të emrit në rasa, rezultoi se latinishtja numrin e rasave të gjuhës indoevropiane e ka reduktuar në gjashtë: *nominativus, genitivus, dativus, accusativus, ablativus* dhe *vocativus*. Ndërsa shqipja ruan sistemin prej pesë rasash duke lënë jashtë thirroren. Në gjuhën shqipe të Kuvendit të Arbënit, në ballafaqim me latinishten, një gjuhë me traditë shkrimi shumë më të hershme se shqipja, u vu re një sistem i zhvilluar e i qëndrueshëm rasor, të cilin e vërejmë dhe në librin e parë të shqipes, *Meshari* i Buzukut, veçori që e bën tekstin shqip të Kuvendit të Arbënit, vazhdues të denjë të traditës së shkrimit të shqipes. Pikë së pari nga ballafaqimi i dy sistemeve rasore domosdo do të ekzistonin mospërputhje, gjë që është normale duke qenë se shqipja dhe latinishtja janë dy gjuhë të ndryshme nga njëra-tjetra. Këto ndryshime, në disa raste nuk janë reflektuar, si rrjedhim, shpesh del që në shqipen e Kuvendit është përdorur një akuzativ aty ku duhej të ishte dativi ose e kundërta. Kjo gjë ka ndodhur pasi përkthyesi ka përkthyer morfemat dhe fjalët e tekstit latin dhe ejo të tekstit në tërësi.

Ajo që mbetet një veçori për shqipen dhe që nuk del në latinishte është përdorimi me parafjalë i rasës emërore. Emrit në rrjedhore me parafjalët *e, ex, de* të tekstit latin i përgjigjet në shqipe në mjaft raste një emër në rasën emërore me



parafjalën *ka*,<sup>371</sup> duke qenë se teksti shqip është shkruar në dialektin gegë. Për të vazhduar më tej me rasat e tjera mund të themi se funksionet kryesore të rasave në latinishte janë kryesisht të njëjta me ato të shqipes me përjashtim të gjinorës së përkatësisë, e cila në shqipen e kuvendit vjen me anë të dhanores; dhanorja e interesit e ndërtuar me disa folje që kërkojnë dhanoren dhe me të njëjtin funksion janë dhënë dhe në shqipe duke sjellë ndërtim jo të saktë. Funksionet sintaksore të kallëzores dhe të rrjedhores të latinishtes kanë ardhur po ashtu në gjuhën shqipe me përjashtim të ndonjë rasti të rrallë ku emri vjen me të njëjtin funksion si në latinishte, gjë që sipas mendimit tonë shpesh ka ardhur si rezultat i përkthimit të gabuar nga ana e autorit dhe nga njohja jo e mirë e shqipes.

Për sa i takon përcaktorëve në latinishte vërehet fakti se në këtë gjuhë përcaktorët lakohen dhe përshtaten me emrin duke marrë mbaresat emërore. E njëjta dukuri u vu re dhe në tekstin shqip të Kuvendit ku përshtatja e përcaktorit është bërë edhe me ndryshimin e nyjes, edhe me mbaresat rasore në fund, e njohur nga studiuesit si dukuria e biflektivizmit e vënë re qysh te libri i parë i shqipes.

Vendit të përcaktorëve si në latinishte ashtu dhe në shqipe gëzon liri të vendosjes së përcaktorëve. Disa prej tyre qëndrojnë para emrit që përcaktojnë dhe disa pas tij. Por, në disa raste paravendosja e disa përcaktorëve në tekstin shqip, vendi i të cilëve është kryesisht pas emrit, e kemi shpjeguar me ndikim të tekstit latin.

Folja (*verbum*) në gjuhën latine ashtu si dhe në gjuhën shqipe, është elementi më i rëndësishëm i fjalisë. Te të dyja këto gjuhë folja si pjesë e ndryshueshme e ligjëratës ka të njëjtat kategori gramatikore: të vetës, diatezës, numrit, mënyrës dhe të kohës. Latinishtja ndryshe nga shqipja ka reduktuar numrin e mënyrave të foljes së indoevropianishtes duke njohur vetëm tre: dëftoren, lidhoren dhe urdhëroren. Megjithatë, është mënyra lidhore, e cila me funksionet dhe kuptimet modale që merr mbulon përdorime të mënyrës dëshirore apo volitive, mënyra e humbur e gjuhës indoevropiane, por e pranishme në shqipe, mënyrën kushtore gjithashtu dhe kjo në shqipe. Kështu, gjatë punimit tonë u ndalëm gjatë në përdorimin e lidhores në fjali kryesore ku me anë të së cilës shprehet vullnet, dëshirë, dyshim apo mundësi të kryerjes së një veprimi. Të gjitha këto kuptime modale të koniuktivit latin kanë ardhur në shqipe me anë të mënyrave përkatëse ekzistuese në të.

Për sa i përket foljeve ndihmëse dhe gjysmëndihmëse, nëse shqipja përdor si ndihmëse foljet *kam* dhe *jam* për formimin e kohëve të përbëra, në latinishte si folje ndihmëse është vetëm folja *esse*, e cila shërben për të formuar formën

---

<sup>371</sup> Trajta e shqipes së sotme nga.

joveprore të kohëve të përbëra. Foljet gjysmëndihmëse, si *posse, debere, licet*, siç është e njohur në gjuhën latine, gjë që është trashëguar dhe në gjuhët e reja neolatine, ndiqen gjithnjë nga infinitivi. Në tekstin shqip vërejmë se në shumicën e rasteve përgjegjëset e tyre *mund* dhe *duhet* janë ndjekur gjithashtu nga paskajorja, gjë të cilën nuk e shohim si ndikim nga teksti latin, por e shpjegojmë me faktin se teksti shqip i Kuvendit është shkruar në dialektin gegë, ku akoma dhe sot e kësaj dite foljet gjysmëndihmëse ndiqen nga paskajorja *gege*, e tipit *me punue*. Megjithatë, nuk mungojnë dhe raste të përdorimit të këtyre foljeve me lidhore, ashtu siç përdoret dhe në shqipen letrare.

Për të përkthyer foljet në kohën e ardhme të tekstit latin autori i ka sjellë po me folje në kohën e ardhme, por ajo që mbetet me interes është se në të gjitha rastet përdoret e ardhmja e tipit *kam + me punue*, tipike e dialektit gegë dhe e përdorur në të gjithë autorët e vjetër dhe mungesa e përdorimit të së ardhmes volitive me *do + lidhore*. Siç dihet, kjo e fundit ka zënë vend në shqipen letrare dhe në toskërishte.

Vend të rëndësishëm në punim kanë zënë format e pashtjelluara (*nomina verbalia*) si mjete për pasurimin e fjalive dhe ndërtimeve gjuhësore, duke u dhënë përparësi funksioneve të tyre sintaksore, jo vetëm në gjuhën latine por dhe në atë shqipe. Është fjala për paskajoren, pjesoren, gerundin dhe gerundivin.

Siç dihet, shqipja ka trashëguar vetëm pjesoren e së kryerës së indoevropianishtes, rrjedhimisht dhe të latinishtes. Në tekstin shqip participi i perfektit pasiv vjen në shqipen e Kuvendit po me pjesore, prej së cilës, siç dihet kanë burimin shumë mbiemra të prirë nga nyje. Për sa i përket pjesoreve të tjera, si ajo e së tashmes dhe e së ardhmes, të cilat mungojnë në gjuhën shqipe, këto kanë ardhur me forma të tjera foljore perifrastike, siç është fjalia e nënrenditur përcaktore apo përcjellorja. Një ndërtim i rëndësishëm sintaksor i latinishtes në të cilin merr pjesë pjesorja është ablativi absolut. Ky i fundit ka ardhur në shqipen e Kuvendit të Arbënit me anë të një fjalie të nënrenditur kohore, shkakore gjithnjë në varësi të kontekstit. Megjithatë, nuk mungojnë raste ku ablativi absolut, sidomos ai i ndërtuar me pjesore të së tashmes, nuk është përkthyer nga autori.

Gerundi dhe gerundivi si forma të pashtjelluara të foljes gjejnë përdorim të madh në gjuhën latine dhe në shqipe kanë ardhur kryesisht me paskajore të tipit *me punue* ose me përcjellore të tipit *duke bërë*. Pas analizave të hollësishme dhe rasteve të gjetura në tekst ndonëse të pakta, arritëm në përfundimin se me gerundi<sup>372</sup> i shqipes *të bërë* nuk na ka dalë, aq më pak për të dhënë gerundin latin. Në vend të tij gjejmë emrin prejfoljor *asnjanës të bërit* veçanërisht në rasën

---

<sup>372</sup> Po e quajmë gerund dhe jo përcjellore, pasi përcjellorja e shqipes, nëse nisemi nga teza e Çelikut, nuk ka asgjë të përbashkët me gerundin latin.

gjinore dhe rrjedhore. . Nuk mungojnë dhe raste ku gerundi në rrjedhore është dhënë me përcjellore, ku kjo e fundit shpesh nga studiuesit njihet si gerund. Gerundivi, i cili në gjuhën latine është në rolin e mbiemrit, pra me funksion atributiv, shpesh është anashkaluar dhe nuk është përkthyer, dhe në ato raste kur është përkthyer na është dhënë me fjalë që shprehin veprim i cili nuk ka përfunduar ose duhet të përfundojë në një të ardhme të afërt. Ndërsa kur është në funksion verbal i shoqëruar nga folja “esse”, pra në ndërtimin perifrastik pasiv për të shprehur domosdoshmërinë e kryerjes së një veprimi, është dhënë me foljen gjysmëndihmëse *duhet + paskajore* të tipit *me ba*, ose me foljen *jam + formën e pashtjelluar të tipit për të bërë*.

Paskajorja e latinishtes, e cila gjen përdorim të madh në sintaksën e fjalisë latine, vjen në shqipe kryesisht me anë të paskajores së gegërishtes e tipit *me punue*, dhe kur është në funksione të ndryshme në fjali. Paskajoren e gjetëm të përdorur sidomos pas foljeve ndihmëse (*verba servilia*).

Një ndërtim i rëndësishëm sintaksor në të cilin merr pjesë infinitivi latin është *infinitum cum accusativo*, ndërtim i cili ka ardhur kryesisht i zberthyer me anë të një fjalie të nënrenditur filluese ku kundrinori i fjalisë së nënrenditur kthehet në kryefjalë dhe paskajorja me folje në mënyrën dëftore.

Në një kapitull të veçantë është folur gjatë mbi parafjalët në gjuhën latine dhe ndarjen e tyre sipas rasave që drejtojnë. Lidhur me përdorimin e parafjalëve vlen të theksohet se në tekstin e Kuvendit të Arbënit vërejmë përdorimin e parafjalëve *prej, ndaj, jashtë* me rasën rrjedhore, ashtu siç ndodh në shqipen e sotme. Te Buzuku e autorë të tjerë këto parafjalë i gjemë të përdorura me emra në kallëzore, gjë që nga disa studiues është parë si ndikim të teksteve origjinale dhe nga disa të tjerë<sup>373</sup> si përdorim i hershëm në gjuhën shqipe, dhe aspak si ndikim, pasi drejtimi parafjalor nuk është lehtësisht i huazueshëm.

Përshkrimi i sistemit fonetik, analiza dhe vështrimi i veçorive morfo- sintaksore na ndihmoi për të përcaktuar nga aspekti dialektor gjuhën e Kuvendit të Arbënit, ndonëse siç shkruan Ismaili<sup>374</sup>, në të manifestohen tendencat normativizuese, me përzierje elementesh të të folmeve të ndryshme. Që kemi të bëjmë me një tekst të shkruar në gegërishte kjo nuk mund të vihet në dyshim. Sipas studiuesve dhe nisur nga disa tipare dalluese të të folmes, të natyrës fonetike, gramatikore e

---

<sup>373</sup> S.Mansaku, “*Kuvendi i Arbënit në historinë kulturore e gjuhësore*”, Kuvendi i Arbënit 300-vjetori, lezhë, 2007, f. 105.

<sup>374</sup> vep.cit.f. 245.

leksikore, baza e gjuhës së Kuvendit të Arbënit rezultoi të jetë gegërishtja veriperëndimore.

Dhe nga aspekti leksikor teksti i Kuvendit si teksti më i gjërë i shekullit XVIII, karakterizohet nga një larmi fjalësh, veçanërisht të fushës fetare. Në tekstin e Kuvendit, ndonëse jo në nivelin e gjuhës së Budit e të Bogdanit, është përdorur një numër i konsiderueshëm fjalësh shqipe. Megjithatë, duke qenë se autori i përkthimit nuk ishte njohës burimor i shqipes, ka rënë në grackën e përdorimit të huazimeve, të cilat ishin përhapur dhe kishin zënë vend në gjuhën shqipe. Megjithatë, në të u vunë re huazimet sllave të pakta në numër dhe shtimin e huazimeve turke, ndonëse jo në atë masë që vërehet në përkthimin e ri të tekstit të Kuvendit nga Radoja në vitin 1872. Shtresa leksikore e latinizmave dhe italianizmave është e madhe sidomos në terminologjinë fetare, po të nisemi nga fakti se latinishtja ishte gjuha e tekstit burimor dhe italishtja ishte gjuha e vendit të burimit të fesë.

Për sa i takon përkthimit të tekstit të Kuvendit dhe çështjeve që dalin nga analiza e përkthimit dolëm në disa përfundime:

Përkthimi i parë i tekstit nuk mund të konsiderohet i mirë, gjë që është pohuar dhe nga studiues të tekstit. Për këtë arsye, në vitin 1872, E.Radoja nxori në dritë një përkthim të ri të tekstit latin, pa dyshim më të mirë. Pas përpjekjeve për të zbuluar autorin e përkthimit të tekstit latin, mendojmë se kemi të bëjmë me një tekst të përkthyer nga një një shqipfolës joburimor<sup>375</sup>, por megjithatë, njohës relativisht i mirë i shqipes. Në përkthimin e parë vërehet se autori ka ndjekur rrugën e përkthimit të morfemave dhe të fjalëve të latinishtes dhe jo të tekstit në tërësi, pra duke bërë një përkthim *ad litteram*, të fjalëpërfjalshëm, madje dhe funksionalisht morfemë për morfemë, duke ruajtur shumë shpesh edhe rendin e fjalëve të gjuhës burim. Kjo dukuri ka çuar në një përdorim të gabuar të mjeteve dhe strukturave gjuhësore të shqipes. Si rrjedhim, shumë shpesh në tekst dalin ndërtime të vështira dhe të pakuptueshme. Po të kishim një përkthim të saktë të strukturave gjuhësore sipas modeleve përkatëse, pa i dhunuar ato, do të kishim një tekst më të kuptueshëm e më të saktë nga ana gjuhësore. Si rrjedhim, bazuar në tekste të tilla nuk mund të nxirren përfundime të sakta lidhur me natyrën e vërtetë të strukturave reale të një gjuhe.

Me gjithë mungesat dhe vështirësitë jo të vogla, teksti ka rëndësi të madhe historike e gjuhësore. Si teksti më i gjërë e më i rëndësishëm i gjysmës së

---

<sup>375</sup> Lidhur me autorësinë e përkthimit të tekstit shqip shih dhe Gëzim Gurga, *Dittionario Italiano-Albanese (1702)* Botime françeskanë, Shkodër, 2009, f. 32-34

parë të shekullit XVIII, teksti shqip ka ndihmuar në stabilizimin e mëtejshëm të shkrimit të gjuhës shqipe duke zgjeruar funksionin dhe përdorimin e saj. Ky tekst merr rëndësinë e madhe të dokumentimit të një prej ngjarjeve historike të rëndësishme, por dhe si mbështetje me vlerë për të hedhur dritë të mëtejshme në historinë e shkrimit e të lëvritimit të gjuhës shqipe.<sup>376</sup>

Analiza e tekstit të Kuvendit të Arbënit nxori në pah veçori të rëndësishme gjuhësore, të cilat dëshmojnë për një shqipe të qëndrueshme dhe të pasur, duke i dhënë tekstit të Kuvendit të Arbënit vlera të mëdha gjuhësore. Për këto vlera ky tekst është konsideruar nga studiuesit si urë lidhëse ndërmjet shqipes së vjetër dhe shqipes së re.

---

<sup>376</sup> Sh.Demiraj, *Rreth Kuvendit të Arbënit të vitit 1703*, Kuvendi i Arbënit, 300-vjetori, Lezhë, 2007

## Bibliografi

Në këtë bibliografi do të shënohen veprat që janë kryesisht studime mbi këtë tekst dhe lidhen drejtpërdrejt me të. Do të shënohen dhe veprat që kanë trajtuar dukuritë e përgjithshme të gjuhësisë sinkronike e diakronike.

Agalliu, Fatmir

- *Rreth përdorimeve të rasës rrjedhore*, Studime filologjike, 1,1990.

- *Pjesorja nw gjuhwn shqipe*, SF,Tiranw, 1972,2

Akademia e shkencave

- *Gramatika e gjuhës shqipe I*, Morfologjia, Tiranë, 1995

- *Gramatika e gjuhës shqipe II*, Sintaksa, Tiranë, 1996.

Ashta, Kolë

- *Da Lecce, gramatika e parë shqipe, botuar më 1716.*  
Shkodër, 1966. Dorëshkrim i daktilografuar. Arkivi i Institutit të Lartë Pedagogjik, Shkodër

- *Leksiku i nxjerrë nga Kuvendi i Arbënit.* Buletin, Shkodër 1/1978,2/1978,1/1979 e tutje.

- *Shenjime mbi vokalizmin në Kuvendin e Arbënit,* Buletin i Institutit Pedagogjik të Shkodër 1/1957

- *Leksiku i plotë i veprës së Gjon Buzukut (1555) në* Revistë shkencore e Institutit Pedagogjik, të Shkodrës 1/1964, dhe Buletin 1964, 1965 dhe 1966

- *Rreth disa çështjeve të tekstit të Budit*, Studime filologjike, 4,1966

Bokshi, Besim

- *Rruga e formimit të fleksionit të sotëm nominal të shqipes*, Prishtinë, 1980.

Concilium Albanum Provinciale sive Nationale habitum anno MDCCII.

Clemente XI Pont. Max. Romae, MDCCCLXVIII.

Çabej. Eqerem.

- *Studime gjuhësore III, IV,VI* Prishtinë, 1976. 1977

- *Meshari i Gjon Buzukut*, pj I. II Tiranë, 1968

- *Për një shtresim kronologjik të huazimeve turke në gjuhën shqipe*, Studime filologjike, 1975/4.

- *Hyrje në historinë e gjuhës shqipe*, Prishtinë, 1970.

- *Studime etimologjike në fushë të shqipes*, Tiranë, IV, 1996.

- *Studime etimologjike në fushë të shqipes*, Tiranë, IV, 2002
  - *Shumësi i singularizuar në gjuhën shqipe*, Tiranë, 1967.
  - *Karakteristikat e huazimeve latine të gjuhës shqipe*, Studime filologjike, 1974/2
- Çeliku, Mehmet
- *Probleme të morfologjisë shë gjuhës së sotme shqipe*, Tiranë, 1997
  - *Kuantiteti i zanoreve të theksuara në të folmet e shqipes*, Studime filologjike, 1971/ 4
  - *Parafjalët emërore të thjeshta në gjuhën shqipe*, Studime filologjike 1973/2
- Cirriacione, Angela
- *Sintassi degli antichi scrittori albanesi*, Roma, 1968.
- Demiraj, Shaban
- *Gramatikë historike e gjuhës shqipe*. Tiranë, 1986
  - *Gjuha shqipe dhe historia e saj*. Tiranë, 1988
  - *Rreth vendit të përcaktorëve në gjuhën shqipe*, SF, 1981/2
  - *Rreth disa problemeve të paskajores në gjuhën shqipe*, Studime Filologjike, 1969/1
  - *Rreth Kuvendit të Arbënit të vitit 1703*, Kuvendi i Arbënit, 300-vjetori, Lezhë, 2007
  - *Rreth kategorisë së shquarsisë e të pashquarsisë në gjuhën shqipe*, “*Studime filologjike*”, 1969.
- Domi, Mahir
- *Shqipja dhe struktura e saj gramatikore*, Studime filologjike, Tiranë, 3-4, 2001.
  - *Sintaksa e gjuhës shqipe*, Prishtinë, 1971.
  - *Mjete dhe burime për gjurmimin e shqipes në shekullin XV*, Konferenca e Dytë e Studimeve Albanologjike, III, 1969, f. 102.
- Duka, Ferit
- *Kriptokristianizmi dhe Kuvendi i Arbnit*, Kuvendi i Arbënit, 300-vjetori, Lezhë, 2007
- Ernout Alfred
- *Syntaxe latine*, Paris, 1953
- Elsie, Robert
- *Historia e letërsisë shqiptare*, Pejë-Dukagjin, 1997.
- Flochini, Nicola; Piera Bacci; Marco Moscio

- *Comprendere e tradurre*, Milano, 1999.
- Fida, Artan
- *Rreth gramatikës së F.Maria Da Leçes*, Studime albanologjike, 2000/ 1.
- Gëzim, Gurga
- *Francesco Maria da Lecce Dittionario Italiano-Albanese(1702)* Hyrje, botim kritik i dorëshkrimit e fjalësi shqip përgatitur nga BIBLIOTEKA FRANÇESKANE “ËT GJERGJ FISHTA” Botime Françeskane, Shkodër 2009.
- Grajçevic, Fadil
- “*Historia e Skënderbeut*” e Marin Barletit dhe kultura shqiptare në shekullin XVI.
- G. Stadtmuller - *Das Albanische Nationalconzil vom Jahre 1703*. *Orientalia Christiana Periodica* 22,1956
- Historia e letërsisë shqiptare, I, 1959
- Historia e letërsisë shqiptare, I, 1971
- Historia e letërsisë shqiptare, 1983
- Hysa, Mahmud
- *Krestomaci e letërsisë së vjetër shqiptare*, Prishtinë, 1987
- Ismajli, Rexhep
- *Gjuha shqipe e Kuvendit të Arbënit (1706)*, Prishtinë, 1985
- *Tekste të vjetra*, Pejë, 2000
- *Artikuj mbi gjuhën shqipe*, Prishtinë, 1987
- *Da Lecce, gramatikan me rëndësi*. Gjuhë dhe etni, artikuj,ese. Ndërmarrja botuese Rilindja, Prishtinë, 1991.
- *Mjeshtëria dhe saktësia e përkthimit*, Fjala, Prishtinë, 1990, Nr.1-2
- *Vrojtime mbi shkrimet e hershme shqipe*, Dituria, Prishtinë,1982/1-2
- Jorgaqi, Kristina
- *Ndikimi i Italishtes në letërsinë e vjetër shqipe. (XVI – XVII)* Tiranë 2001
- Karagjozi, Mimoza
- *Parafjalët në “Mesharin” e Gjon Buzukut*, Tiranë, 2005.
- Kastrati, Jup
- *Historia e albanologjisë*, Tiranë, 2000.



Kuvendi i Arbënit o Koncilli Provincial mbëlidhunë vietit mijë shtat qint e tre, E dyta shtamp, Ndë Romë, 1868.

Kuvendi i Arbënit 1703. Prishtinë 2004. Përmbledhje e kumtesave të mbajtura në Mynih 2003.

Kuvendi i Arbënit 300-vjetori. Lezhë, 2007. Përmbledhje e kumtesave, të mbajtura në Lezhë, 2003.

Likaj, Et'hem

- *Analogjia gramatikore në strukturën morfologjike të gjuhës shqipe*. Tiranë, 1984
- *Mbi format analitike në gjuhën shqipe*. Studime filologjike 1978/3

Lafe. Emil

- *Lidhëzat te libri i parë shqip*, Studime filologjike 1971/4
- *Trajtat e pjesores te Gjon Buzuku*, Konferenca e parë e studimeve albanologjike, 1965
- *Mbi habitoren dhe disa trajta të saj*, Studime filologjike, 1975/ 2

Malaj.Vinçenc.

- *Kuvendi i Arbënit 1703*. Botimi i parë, Ulqin, Tuzë, 1998 Përkthim nga Tonin Zadeja.

Mansaku, Seit

- *Ndërtimet me foljet modale mund dhe duhet*. Studime filologjike 1979/3.
- *Paskajorja e shqipes dhe kategoritë gramatikore të saj* Studime filologjike 1981/1-
- *Ndërtimet me foljen ndihmëse kam + paskajore te autorët e vjetër*. Studime filologjike 1980/2
- *Funksionet sintaksore të paskajores te autorët e vjetër*. Studime filologjike 1983/2.
- *Disa veçori morfo-sintaksore të librit të parë në gjuhën shqipe*, SF, 1-2,2001.
- *“Kuvendi i Arbënit” në historinë kulturore e gjuhësore shqiptare*. Kuvendi i Arbënit, 300-vjetori, Lezhë, 2007.
- *Ndërtimet me foljet modale mund dhe duhet*, Studime filologjike, 1979 /3

Omari, Anila

- *Pjetër Bogdani, “Cuneus Prophetarum”* (Çeta e profetëve) Botim kritik. Përgatitur nga Anila Omari, Tiranë 2005

Osmani, Tomor

- *Histori e alfabetit të gjuhës shqipe*, Tiranë, 1987

Paço, Eliana

- *Mënyra dëftore në veprën "Cuneus prophetarum"*  
Studime albanologjike II 1997/2.

Paci, Evalda - *De casuum nominum usu dissertatio in latina et albaniansi lingua*. Classica et Christiana, 3, Iași, 2008, f. 214.

Përnaska, Remzi

- *Analizë strukturore-semantike e togfjalshave me parafjalën nga që shprehin marrëdhënie objektore*, SF.1, 1991.

Riza, Selman

- *Pesë autorët më të vjetër të gjuhës shqipe*, Tiranë, 1966.
- *Sistemi i rasavet dhe tipet e lakimit*, Tiranë, 1965.
- *Nyjat e shqipes në tekstet e e pesë autorëve tanë më të vjetër*, Studime filologjike, 1983/1

Rrota, Justin

- *Gjuha e shkrueme ase Vërejtje gramatikore*, Botimi I, Botime françeskane, Shkodër, 2006.
- *Analyzimi i rasave t' emnit e zhvillimi historik i tynve*, Shkodër, 1931.

Sedaj. Engjëll

- *Papa Shqiptar Klementi XI –Albani dhe Kuvendi i Arbënit*. Prishtinë, 1988
- *Prej Mesharit të Buzukut deri te Meshari i Dom Simonit*, Rilindja, Zofingen, Tetor 1992.
- *Humanistët shqiptarë, personalitete të formatit evropian*, Flaka e Vëllazërimit, Shkup, 24 maj, 1991

Sulejmani, Fadil

- *E mbsuame e krështerë e Lekë Matrëngës*. Prishtinë, 1979

Tantucci, Vittorio

- *Urbis et orbis lingua*, Morfologia e sintassi, Bologna, Giugno 1995

Tagliavini, Carlo

- *Le origini delle lingue neolatine*, Bologna, 1964

Topalli, Kolec

- *Për kronologjinë e rënies së sonantes hundore /n/*  
Studime filologjike 3- 4, Tiranë. 2001.
- *Disa veçori të tekstit të 'Kuvendit të Arbënit'*, Studime filologjike, 3-4, Tiranë, 2003

- *Sistemi rasor i emrave të shqipes*, Tiranë, 2009.
- *Koha e ardhme e mënyrës dëftore në gjuhën shqipe*, Studime filologjike, 1980/4
- Traglia Antonio
  - *La flessione verbale latina*, Trattato di morfologia storica, Torino 1950
- Traina, Alfonso
  - *Lalfabeto e la pronunzia del latino*, Bologna, 1973.
- Tagliavini, Carlo
  -
- Shuteriqi, Dhimitër
  - *Shkrimet shqipe në vitet 1332-1850*, Tiranë, 1956.
  - *Humanistët dhe shkrimtarët e letërsisë së vjetër*, Zëri i popullit, 1983, nëntor 10.
- Xhuvani, Aleksandër
  - *Parafjalët*”, Studime filologjike, 1, 1964.
  - *Pjesorja nw shqipet, Paskajorja nw shqipet*, “Vepra”I, Tiranw, 1980
- Xhiku, Ali
  - *Vepra e Buzikut si jehonë humaniste*, Revista Perla 2005/3.
- Zamputi, Injac
  - *Të dhana të reja mbi gjendjen ekonomike shoqnore e politike të vendit tonë në shekullin e XVII –të*, BUSHSH, Tiranë, 1957, nr.1

## ***Dy fjalë***

Punimi në fjalë synon të nxjerrë në pah tiparet që karakterizojnë shqipen e fillimit të shekullit XVIII. Kjo gjë do të arrihet falë një analize përshkuese – krahasuese të gjuhës latine dhe gjuhës shqipe, e cila do të nxjerrë ndryshimet dhe ngjashmëritë ndërmjet këtyre dy gjuhëve.

Si tekst bazë është përdorur versioni latin i tekstit të Kuvendit të Arbënit dhe versioni shqip i tij në vitin 1868. Nga studimi i bërë në pothuajse të gjitha rrafshet e gjuhës, nga përjasja teorike e praktike, arritëm në përfundimin se gjatë përkthimit autori, si një shqipfolës joburimor, i ka qëndruar besnik tekstit burimor, duke sjellë morfemat e shqipes me funksione të morfemave të latinishtes. Kështu, në tekstin tonë vërehen shumë shpesh struktura jo të sakta gramatikore, të sjella sipas modeleve të gjuhës latine, gjë që ka çuar në deformim të strukturave të mirëfillta gramatikore të shqipes. Si rrjedhim, bazuar në tekste të tilla vështirë të dalësh në përfundime të sakta mbi natyrën e vërtetë të një gjuhe.

***Fjalë kyçe:*** përjasje, përkthim i fjalëpërfjalshëm, dhunim i strukturave gramatikore, ndikim, sistem rator, topika e përcaktorëve, morfema, funksion.

## ***Abstract***

This study aims to point out the differences and similarities between Albanian of XVIII century and latin. The object of this study in linguistics, will be the text of *Kuvendi i Arbënit* (Assembly of Arbën) one of the most important text in the history of written albanian language. It contains the Acts of *Kuvendi i Arbënit*, assembled in 14 -15 january 1703. This text published in 1706, first in latin and then in Albanian, is an important source to elucidate most adequately the evolution of Albanian language in the beginning of XVIII century.

Through this kind of text we may study Albanian common features and uses in its grammatical structures. In fact it is not only a religious text, but also a text in which we can make several linguistic observations. Due to an incorrect observations. Due to an incorrect translation by an author that wasn't Albanian by origin, we found out quite often grammatical errors, incorrect structures, brought in this text according to the patterns of latin language. As a result, based on such texts, it is quite difficult to draw correct conclusions on the real nature of a language.

***Key words:*** translation ad litteram, violation of grammatical structures, influence, case system, morphemes, functions.

